

Kim Mehmeti

KËSHTU ECËN NJERIU

Monografi
kushtuar akademikut Ali Aliu

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2007

Botues: Fatmir Toçi
Redaktor: Faruk Myrtaj
Korrektore letrare: Dorina Talo
Përkujdesja grafike: Mereme Nelaj
Kopertina: Irena Toçi

ISBN 978 - 99943 - 1 - 233 - 7

© Autori dhe Shtëpia Botese Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollesha", K.Postare 1420, Tiranë

Tel.: (4) 240116; 258893

Tel./Fax: (4) 240117

E-mail: toena@toena.com.al; info@toena.com.al;

toena@icc.al.eu.org

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

BUKURI E BRAKTISUR

Ato dhjetëra fshatra të bregut lindor të liqenit të Prespës, sot sikur banohej veç prej heshtjes. Titërima e saj i ka pllakosur si një mbulojë e padukshme, nën të cilën fshihen përplot fate njerëzore dhe takim-ndarje që kanë mbetur të shënuara në thellësitë e së kaluarës. Ajo heshtje i ngërthen në vete lotët margaritarë të nënave të përmalluara për pjellën e tyre, shtegtuar matanë oqeanëve, por edhe gjithë britmat gazmore të prindërve dalë në oborr tek përqafojnë djemtë që kthehen nga kurbeti. Të bëhet se heshtja, e jo gurët, është ajo që i mban në këmbë ato kulla të vjetra dhe shtëpitë të porsandërtuara buzë liqenit të Prespës. Kjo heshtje molisëse që rri varur mbi fshatrat e kësaj ane të Prespës, në të vërtetë është rrëfimi i trishtueshëm për të parët që banuan këto hapësira, në një si pushim të shkurtër, që pasardhësit e tyre të niseshin më tej dhe gjaku i tyre të degëzohej anembanë botës. Andaj edhe këto fshatra ngjajnë si vendbanime të shtegtarëve të palodhshëm, të atyre që kanë ardhur këtu vetëm për kohësisht dhe sa të bëhen gati të vazhdojnë kërkimin e qetësisë më tej; janë ndalur thujse vetëm sa të përtërijnë gjakun e fisit që do të duhet pastaj të degëzohet nëpër shtigjet e botës. Ato kulla të vjetra dhe pallate moderne,

të porsandërtuara, por të mbetura zbrazët, janë kujtim i largët i atyre që foletë familjare i kanë atje ku i ka zënë muzgu i mbijetesës, atje ku i ka çuar kali i padëgjueshëm i ngarkuar me ëndrrat për ardhmëri më të mirë, duke e ndërldhur kështu zinxhirin jetësor, që nga rrënjët e të parëve e deri te presparët e vegjël që tani rriten e jetojnë matanë oqeanëve, në Amerikë dhe Australi, zinxhir edhe për banorët e rrallë që nuk kanë shkuar në kurbet, që kanë mbetur si rojtarë të mallit për ata që shkuan, rojtarë, të cilët mund t'i takoni rrugëve të fshatrave të banuar me shqiptarë buzë liqenit të Prespës, që jetojnë të dyzuar: trupin e kanë këtu, por shpirtin atje ku shkuan të dashurit e tyre.

Fillimshekulli njëzet e një në këto hapësira është më i heshtur se shekujt e mëparshëm, përplot luftëra të përgjakura dhe ideologji, që donin ta shndërronin njeriun në numër, ngjashëm me atë të të burgosurve të pashpresë. Presparët që shkuan dhe u shpërngulën nëpër metropolet e botës, kthehen në këto hapësira si shpendë shtegtarë që duan të ringjallin kujtesën për foletë e veta, vijnë përkohësisht thujse vetëm sa të shijojnë freskinë e mëngjesit, e cila përkëdhel kullosën mbi varrezat e të parëve të tyre. Dhe ngulazi ndërtojnë shtëpi të reja në të cilat askush nuk jeton, përpos mallit dhe shpresave të atyre që i kanë ndërtuar, e të cilëve asnjëherë nuk u vdes ëndrra që të kthehen aty ku kanë parë së pari herë lindjen e diellit dhe rrezatimin e hënës. Këto fshatra janë vendbanime të çuditshme. Kullat e këtushme ngjajnë si nyje ku është ngatërruar malli i të mbeturve me të atyre që kanë shkuar në kurbet; ato janë pika ku përballen ëndrrat e të mbeturve me ato të të shkuarve dhe ku shpesh përzihen lotët e atyre që presin t'u kthehen të dashurit dhe të ëndërrimtarëve që mezi presin të shohin përsëri vendlindjen. Si rrallëkund

në hapësirat e tjera shqiptare, fshatrat e rrethinës së Prespës rrëfejnë fatin e shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve të mëmëdheut të tkurrur që mban emrin Shqipëri, mëmëdhe, i cili nga të katër anët kufizohet me shqiptarët e mbetur jashtë kufijve. Hapësira prespore rrëfen trishtueshëm për shqiptarët që kufizohen me vetveten, për shqiptarët që me dekada kanë jetuar të ndarë, si ujdhesa të largëta mbi të cilat janë përplasur valët e të njëjtit det kohor. Këto hapësira rrëfejnë për kohët kur shqiptarët nuk kanë mundur të shohin se ç'ndodh në brigjet matanë kufirit, ku e çojnë kombin anijet ideologjike të Enver Hoxhës, dhe si janë katandisur këta të Jugosllavisë së Titos, ku pas Luftës së Dytë Botërore mbetën edhe presparët, thuajse veç sa ta plotësonin atë dymilionëshin shqiptar të mbetur këtej arës etnike, të ndarë sipas vullnetit të atyre që vizatonin hartat e pasluftës. Presparët edhe sot shprehin ndjesinë se sa vrasëse është për një komb afërsia e largët që e ndan nga rrënjët dhe sa e pambrojtur është bima e rritur nën hijen e drurit të huaj. Andaj edhe sot tek ata vëren një dyshim të heshtur ndaj asaj që ndodh në kohët e demokratizimit të shteteve të porsalindura të Ballkanit, si edhe në shpresën që bulëzon se kurrë më nuk do të rimurohen muret e dikurshëm shtetërorë që ndanin vëllanë nga motra dhe nusen e ardhur këtej nga familjarët e vet të mbetur matanë kufirit.

Ka diçka që ka mbetur e do të mbetet e pashlyer nga vetëdija e shqiptarëve të Prespës, diçka që i çon të jetojnë në mes të dëshirës për të shkuar sa më larg atij liqeni dhe asaj tjetrës, të mbeten aty ku kodrinat matanë kufirit bëhen të afërta qoftë edhe vetëm pse pasqyrohen mbi syprinën e lëmueshme të gjolit ku lëshohet edhe hija e Pelisterit. Ka diçka që për një kohë të gjatë nuk do të shlyhet nga

vetëdija e banorëve të kësaj ane, e që u është vulosur në mbamendje qysh në vitet e socializmit ballkanas, kur edhe pse kishin mundësi t'i shihnin brigjet nga ana përballë e liqenit, thujse çdo mëngjes pas çdo lindje dielli, në mënyrë kanosëse u bëhej e ditur se brigjet përballë janë të largëta, se ato i ndan thellësi më e madhe se ajo e brigjeve të Australisë dhe Amerikës që nuk shiheshin nga maja e Pelisterit, për ku u davaritën shumë të rinj të këtyre anëve. Largësia që presparët i ndau nga trangu etnik kishte përmasat e lojërave të pafundme ideologjike të pasluftës së Dytë Botërore, të lojërave që ndanin popujt, familjet, shtetet, që ngritën mure thujse donin edhe shpendëve t'ua kufizonin fluturimin, edhe diellin ta mbulonin me tenda që të mos rrezatonte mbi ata matanë gardhit shtetëror.

Rrethina e Prespës të lë përshtypjen e një bukurie të braktisur. E një bukurie që të pikëllon kur e sheh. Të rikujton bukuroshen që s'ka mundur ta mbajë pranë vetes të dashurin e vet, për shkak se i dashuri s'ka pasur zgjidhje tjetër përpos ta braktisë, përballë trishtimit të brendshëm, që kurrë nuk e ka lejuar ta shijojë lirshëm bukurinë e saj mahnitëse. Atë mbresë të lënë fshatrat e banuar nga shqiptarët, ku për çdo vit pakësohet numri i banorëve. Në to, rrallë do të takoni ndonjë fëmijë duke lozur, e më rrallë akoma do të dëgjoni këngën rinore. Çdo gjë i është dorëzuar një heshtjeje, të cilën e plagos vetëm kollitja e pleqve që bredhin rrugëve, si dhe britmat e tregtarëve që vijnë në vjeshtë të blejnë mollët e njohura prespane. Mollët e Prespës tani kanë pushtuar tregjet e qyteteve të Ballkanit. Para rënies së mureve ideologjike shiteshin vetëm nëpër tregjet socialiste të Jugosllavisë së Titos, ku bënte pjesë edhe Maqedonia. Ky shtet me dy milionë banorë, tanimë i pavarur nga të tjerët, por i varur nga

varfëria dhe plogështia ekonomike, të cilat edhe më shumë i shtynë të rinjtë e kësaj ane të shkojnë të kërkojnë fatin sa më larg hapësirave ku kanë ndier ngrohtësinë e gjirit të nënës. I shtrëngon të ikin mospasja e një ardhmërie të qartë, të pranueshme, ardhmëri që i ka hije kohës në të cilën jetojnë. Në këto fshatra, ku ende qëndrojnë të padëmtuara kullat e larta, muruar nga ata që kanë qenë të bindur se kurrë nuk do t'u shuhet vatra familjare, janë ndërtuar edhe shtëpi të reja moderne, shtëpi që përcaktojnë jo vetëm frymëzimin arkitektonik të të zotëve, por edhe dyzimin e kurbetçinjve që, duke jetuar diku larg, kanë përvetësuar mënyrën e të jetuarit të atjeshëm. Atje ku janë u mungon gurgullima e përroskës ku kanë lindur, flejnë atje e ëndërrojnë këtu ku u kanë mbetur rrënjët, ku i thërrasin lojërat fëmijërore dhe varret e të parëve. E tërë krahina e Prespës, e veçanërisht fshatrat e shqiptarëve aty, që moti janë shndërruar në përmendore të ëndrrave të atyre që kanë shkuar e shpresojnë se një ditë do të kthehen, të orvatjeve të gjeneratave të pasluftës së Dytë Botërore tek mundoheshin që nëpërmjet shkollimit të të rinjve, t'i jepnin fund traditës së kurbetit, të mbyllnin rrugën e shtegtimit, rrugën që të parët e tyre e hapën qysh në fillimshkullin e njëzetë, në kohët kur shqiptarët e këtyre hapësirave kërkonin shpëtim nga bejlerët turq e më vonë edhe nga tagrambledhësit e mbretit jugosllav.

Fshatrat buzë bregut lindor të liqenit të Prespës, i ngjajnë një qaforeje të bukur në kraharorin e Pelisterit, i cili lartësohet mbi liqen si lajmëtar shekullor. Zërat e atyre që ndodhen rrëzë tij, ua përcjell lartësive qiellore. Pelisteri i lartë duket se vazhdon bisedën e qëmotshme që s'e kanë përfunduar dot kurrë banorët e asaj ane, me ujërat e liqenit dhe mjegullat që mbulojnë majën e tij. Presparët nuk

arritën ta përfundojnë këtë bisedë sepse ndiheshin si të futur në gropë, prej nga edhe britmat bëhen të padëgjueshme, thirrjet i përpijnë valët e liqenit dhe erërat e forta që rrahin majën e Pelisterit. Andaj kërkonin dalje nga ajo gropë. Banorët e këtyre fshatrave janë ndër të parët në këto anë që shijuan kurbetin duke marrë rrugën pa kthim përtej oqeanëve, në Amerikë e Australi. Dhe shkuan aq larg, thuajse donin të arrinin aty ku nuk shkohet më tej, atje nga e ke vështirë të kthehesh edhe sikur të të ngulfatë malli dhe të molisë dëshira që vetëm edhe një herë të ndiesh filladin e ardhur nga liqeni, edhe një herë të të përkëdhelin erërat që ngjiten lartësive të Pelisterit, që prej atje lart vazhdojnë rrëfimin për ç'ndodh aty poshtë në rrëzë dhe atë që shihet nga lartësitë. Kjo pjesë e Prespës është rrëfim polifonik për fatin e një pjese të shqiptarisë, është jehonë dyzërëshe e mallit të mërgimtarit dhe atyre të paktëve që mbetën në vendlindje, jo pse nuk donin të shkonin, por vetëm sa të kishte kush t'i ruajë kujtimet për të kaluarën e këtyre hapësirave, dhe që të regjistrojnë të sotmen kur në Korçë mund të shkojnë lirshëm, si në kohët para se të vizatohen hartat e shteteve të porsaformuar të Ballkanit. Këtu mbetën ata që pranuan të bëhen miklues të shpresave se e ardhmja do të jetë ajo që kishin ëndërruar të parët e tyre: se do të vijë dita kur shqiptarët, kudo që janë dhe kudo që shkojnë, do të munden lirshëm të ndërldhin trungun etnik, duke filluar nga varrezat e të parëve mbetur matanë liqenit, e deri te pasardhësit e degëzuar anembanë botës.

Njëri nga këto fshatra, mbetur si vendbanim i shtrënguar nga kthetrat e të kaluarës dhe paqartësia e të ardhmes, është edhe Arvati, ku në pjesën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë erdhi me familjen e vet Mustafa Aliu. I

ardhuri kishte bërë rrugë prej larg, derisa kishte arritur të prekte tokat buzë liqenit që i kishte falur Ali Pashë Tepelena. Kishte lënë pas vetes fshatin e lindjes dhe të të parëve të vet, Luarasin e nahijes së Kolonjës. Mustafai i kishte shkukur rrënjët shekullore nga mëhalla e Jaubelive, kullat e së cilës qysh atëherë njiheshin si vatra që kishin rritur njerëz të ditur e të shkolluar. Kishte lënë Luarasin, që të vinte buzë brigjeve të liqenit të Prespës, ku duhej të mbillte shpresën për një ardhmëri më të mirë për familjen. Sigurisht, kurrë nuk i kishte shkuar ndër mend se afërsia që e ndante vendbanimin e ri të familjes së tij me fshatin Luaras, pas grindjeve mes ndërtuesve të socializmit në Shqipëri dhe Jugosllavi, do të bëhej aq e largët sa pasardhësit e tij do të lindnin e vdisnin të joshur nga thirrja e largët e varreve të të parëve të tyre.

Arvati i sotëm ka më shumë shtëpi sesa banorë, jo si fshati i fillimshekullit të njëzetë, kur kishte pak kulla e shumë njerëz. Mbase Mustafai i ardhur nga Luarasi ka besuar se pasardhësit do të ndiheshin mirë aty ku ai hapi themelet e kullës së re. Pa dyshim ka besuar se pasardhësit kurrë nuk do ta braktisnin atë liqen që i ngjante burimit të jetës, dhe ka qenë i vendosur dhe i qetë teksa ka përcaktuar vendin e themeleve, i bindur se asgjë nuk do ta çonte të shtegtonte edhe më tej, larg vendlindjes. Këtë besohet se e ka menduar edhe djali i tij, Aliu, i martuar me Meleken, nga fshati Nikolicë e Devollit, i cili gjithashtu ndërtoi kullën e vet, që qëndron edhe sot siç e muruan mjeshtrit e vitit 1929. Në vitin 2002, nipi i tij Abaz, kurbetçiu i ardhur nga Amerika, vëllai më i vogël i Ali Aliut, i mbuloi me suva të freskët muret e kullës dhe gurët e hershëm nuk shihen me sy. Secili linte gjurmën e djersës së vet mbi gjurmën e të parëve të tij.

Por nuk ishte Abazi kurbetçiu i parë i kësaj familjeje. Rrugën e kurbetit e kishte hapur babai i tij, Feriku, qysh në vitet tridhjetë të shekullit të njëzetë. Por Feriku, nipi i Mustafait, thujse nuk kishte arritur t'i kundërvihej zërit të vendlindjes dhe është ndër të rrallët që pati shijuar kurbetin dhe që kthyer në vendlindje që të vazhdonte jetën aty ku kishte dëgjuar ninullat e para prej nënës. Kurbetçiu i viteve kur hartat detare s'ishin aq të sakta sa ta përcaktonin vijën e saktë lundruese të anijeve që çonin për në Australi, posa u kthye u martua me Sheribanen nga Belocërka e Prespës.

Nga kjo martesë i lindi djali më i madh, Aliu, i cili qysh foshnjë do të mbetej pa gjirin e ngrohtë të nënës. Pas vdekjes së gruas së parë, Feriku martohet me Myskon, një vashë matanë liqenit, nga Kolonja. Kështu degët e shtrira këtej liqenit u lidhën me rrënjët, të cilat gjyshi i tij i kishte lënë në nahijen e Kolonjës. Martesa me vajzën matanë kufirit ndarës të mbretërisë jugosllave me atë të Zogut, dëshmon se aso kohe, kur kishte filluar ndarja e shqiptarëve në shumë shtete të Ballkanit, ende u lejohej komunikimi me familjet mbetur në anën tjetër të kufirit. Kjo nuk do të jetë e mundur më vonë, në dekadat kur muret ideologjike mes shteteve do të arrijnë që "shqipëritë" e shumta t'i bëjnë aq të largëta mes tyre, sa të ndërpritet çdo lidhje familjare mes atyre që jetonin në Jugosllavi dhe në Shqipëri.

Vitet tridhjetë, si edhe e tërë pjesa e parë e shekullit të njëzetë, janë përplot gjurmë të luftërave të porsapërfunduara dhe plot mjegullnajë si pararojë e luftërave të mundshme. Këto kohë-kufi të betejave të papërfunduara, nisur gjatë shkatërrimit të Perandorisë Osmane, lënë përgjysmë prej përfundimit të Luftës së Parë Botërore, janë vitet kur të gjithë pushtetarët e mbretërit

kthyen sytë kah kufijtë fqinjë, duke dashur t'i shtyjnë sa më tej gurët kufitarë, në brendi të shteteve fqinjë, apo që murin ta bëjnë sa më të patejkalueshëm për banorët matanë kufirit. Thujse vetëm Shqipëria dhe shqiptarët s'kishin hallin si të zgjeroheshin, por si të mbronin veten, si të pamundësonin tkurrjen e mëtejme të trojeve shqiptare. Aq më shumë, u duhej të mposhtnin varfërinë e atyre viteve, t'i përkushtoheshin betejës së mbijetesës, të bënin çmos për të mos u shuar vatra në kullën e tyre, të mos mbetej shtëpi pa të qarën e foshnjës së porsalindur. Instinkti i të mbijetuarit i shtynte të mos harronin festën e madhërisme të lindjes së fëmijës, dhe kjo mbamendje do t'u mundësonte ta ruanin shqiptarinë edhe në vitet kur Enver Hoxha, i verbuar nga ideologjia, sa nuk i kishte joshur shqiptarët matanë kufirit të flasin vetëm rusishten e Stalinit, e nga ana tjetër Titoja mundohej t'u jepte shqiptarëve aq sa të mos thoshin se nuk kanë asgjë, aq sa të ishin të kënaqur e ta donin shtetin e sllavëve të jugut. Andaj edhe nuk është e rëndë të paramendohet gëzimi i babait Ferik kur, pas vajzës së parë, i lind edhe një djalë, të cilit nuk kishte si mos ia vinte emrin e gjyshit – Ali.

Gëzimi familjar i prillit të vitit 1934, me siguri ka mbetur i shënuar në gjurmët e mureve të kullës, e cila ende rrëfen për familjen e dikurshme shumëanëtarëshe, të shpërndarë në të gjitha "shqipëritë", deri dhe matanë oqeanëve. Në muret e saj ka mbetur ndonjë gjurmë edhe nga zëri i thekshëm gazmor i gjyshes Meleke nga Nikolica e Frashërit, e cila ua ka kumtuar burrave në dhomën e gjerë se lindi nipçja. Ajo shtëpi e madhe do të duhej të rriste dhe të niste nëpër rrugët e jetës edhe një njeri. Pa dyshim, pos gëzimit që shoqëron lindjen e fëmijës, ai zë në vete ka bartur edhe solemnitetin e besimit se ajo vatër

familjare që moti e kishte mësuar urtësinë se, baras me madhëstësinë e lindjes, është edhe mjeshtëria ta edukosh dhe rrisësh njeriun, të tillë që ai të arsyetojë lindjen e ta meritojë vdekjen.

Kështu nisi kalendari jetësor i Ali Aliut, kritikut të madh letrar dhe atdhetarit, që me veprimtarinë e vet do t'i shënojë edhe datat e rëndësishme të historisë më të re shqiptare. Kështu nisi rrugën jetësore gazetari, kritik, profesori dhe akademiku i ardhshëm. Jeta e tij ndërlidh ngjarjet e fundshekullit të njëzetë, në të gjitha "shqipëritë"; kjo jetë është si një nyje ku janë lidhur ngjarje, përjetime, orvatje që bëjnë të mundur të lexohet drejt kalendari i socializmit dhe ai i kohëve të reja, të cilat populli me aq vullnet i quajti demokratike, e në të vërtetë ishin thuajse njësoj të paqarta sa edhe ato të dikurshmet kur shqiptarët në heshtje jetonin disfatën e vet.

Jeta e Ali Aliut nuk ka aq shumë ditë festive nga ato kur ai të bënte kujdes që lumturinë e vet ta gëzojë të palënduar. Por, kalendari i tij jetësor është përplot me arritje që kompletojnë portretin e tij, të kritikut letrar dhe atdhetarit të përkushtuar; aty mund të gjenden data që përputhen me fatin kombëtar dhe si i tillë, ai kalendar shpreh rrugën jetësore të një personaliteti që të gjitha ia përkushtoi letërsisë dhe popullit të vet. Andaj, ky portret individual është si i ngjyrosur me (dis)fatën e popullit që i takon. Është portret i vendosur në kornizat e ngushta të një orvatjeje shekullore për mbijetesën e një populli, për mbrojtjen e një kulture dhe gjuhe të vjetër aq sa edhe vetë shkëmbinjtë e Ballkanit. Në kalendarin jetësor të Ali Aliut, thuajse gjithmonë la gjurmë viti i lindjes, ditët e largëta kur edhe gëzimi ka qenë i ngulfatur nga turbullirat e kohës, kur vetëm pikëllimi ka qenë i pastër; vetëm

dënesjen askush nuk e ka ndaluar. Kështu që foshnja e atëhershme do të bëhej një burrë, i cili edhe qeshjen e ka të përmbajtur, të ndrojtur, si diçka që u është lënë atyre që kanë pasur mundësi që lumturinë ta shijojnë pak më ndryshe se ai.

Në qëndrimin e Ali Aliut dhe në shumëçka që ka të bëjë me të, ka lënë gjurmë edhe muaji i lindjes, i cili, njësoj si luleborat në rrëzë të Pelisterit, është i mikluar nga ftohtësia e dimrit që largohet dhe ngrohtësia e pranverës në afrim. Nga qenia e tij gjithmonë reflekton një mburojë e qëndrimit serioz që duket sikur nuk nxiton të lërë t'i afrohesh, por nga ana tjetër është shtresë mbrojtëse e një ngrohtësie të natyrshme njerëzore. Ky qëndrim i Zotërisë në shpirt e në qëndrim, do të mbetet ajo mburojë që nuk do të lejojë aq lehtë të zbulohen brengat e brendshme personale, e as pikëllimet e shpeshta jetësore, të cilat nuk u ndahen atyre që qenien e vet ia kanë dhënë dhuratë pronarit më të denjë – popullit, të cilit i takojnë. Dhe, nëse është e vërtetë thënia se hapësira dhe ambienti jetësor lë gjurmë të pashlyeshme në portretin e qenies njerëzore, atëherë kuptohet ajo zemërgjerësi dhe ajo paraqitje e Ali Aliut si një Zotëri, i cili të cytë t'i afrohesh si ngrohtësi-fladit. Porsa të arrish t'i qëndrosh përballë, e kupton se është i njëjti i lartësive të Pelisterit, ai i cili nuk i takon vetëm vetvetes, por i tërë u është dhënë atyre që udhëtojnë nëpër letrat e gjuhës shqipe dhe nëpër rrafshnaltat e fatit të popullit shqiptar.

Ai që ka arritur të njohë për së afërmi Ali Aliun dhe që ka pasur rast të vizitonte kullën dhe oborrin ku ai ka kaluar fëmijërinë, nuk e ka pasur vështirë të zbërthejë atë zemërgjerësi dhe atë qetësi në sjelljen e tij: kulla ka dhoma të gjera me përplot hapësirë për shtëpiarët dhe mysafirët

e ftuar e të paftuar, nga dritaret e dhomave të saj mund të sodisësh edhe mjegullën në majë të Pelisterit, edhe liqenin, edhe kopshtet që shtrihen deri në pafundësi. Oborri i kullës është aq i gjerë, sa në të gjithmonë ka pasur vend loje për gjithë fëmijët e fshatit që jetonin nëpër shtëpi me avlli më të ngushtë. Mbase ky ambient i fëmijërisë, kjo hapësirë ku ka lozur Aliu fëmijë, do të lërë gjurmë të pashlyeshme edhe në Aliun e mëvonshëm, i cili do t'i përkushtohet pafundësisë së kopshteve letrare shqiptare, pa i ndarë ato sipas kufijve shtetërorë, gjurmë, të cilat do të ndikojnë edhe në vendosmërinë e tij që gjithmonë të jetë aty ku ndodhin ngjarjet vendimtare për shqiptarët këtj kufirit shqiptaro-shqiptar. Kjo shpirtgjerësi e tij njerëzore do ta çojë të mendojë më shumë për fatin kolektiv të popullit që i takon, sesa për vetveten. Andaj, qysh në moshën rinore, Aliu do ta kuptojë se asgjë nuk vlen e bukura, e pavlerë është dhuntia që ke, nëse atë nuk e harxhon dhe nuk ua dhuron atyre që i do dhe të duan. Kuptohet, duke mos pritur që e dhuruara të të kthehet me ndonjë kundërvlerë.

Që nga koha kur ishte nxënës i tetëvjeçares në Manastir, qysh në Shkollën Normale në Shkup dhe student në Beograd, do të kuptojë se virtytet individuale dëshmojnë nëpërmjet mënyrës sesi i harxhon ato. Sepse vjen dita kur ndalesh në majën ku je ngjitur dhe nga atje të drejtosh shikimin drejt rrëzave, të matësh gjatësinë e rrugës që ke ecur, një rrugëtim ky që nuk matet me kilometra dhe as me vitet që ke jetuar, por vetëm me peshën e veprave që ke lënë pas vetes. E, Ali Aliu eci dhe është duke ecur rrugës së rëndë të mendimit publik, shkrimeve kritike, publicistike, rrugë e rëndë sa edhe vetë peshë e atyre ngjarjeve shoqërore ku ai nuk ishte shikues

anësor, por njeri që merrte pjesë aktive dhe kishte rol vendimtar në to.

Nuk ka dyshim se Ali Aliu, qysh në fëmijëri, e ka vërejtur se me shumëçka jeta i ngjan ambientit jetësor ku rritej dhe ku ishte vendosur stationi i parë i tij jetësor; lart ngrihej maja e Pelisterit, e poshtë syprina e kaltër e liqenit ku pasqyroheshin vargmalet që rrethonin vendlindjen e tij. Njësoj siç pasqyrohet hija e veprave jetësore mbi rrugën që ke ecur. Të rritesh në një mjedis të tillë, do të thotë qysh në fëmijëri të kuptosh se lartësitë lëshojnë hije mbi rrëzë, se sado lart të ngjitesh dhe të arrish, pasqyra ku shihet portreti yt i vërtetë mbetet rrëza prej ku të shikojnë të tjerët. Të rritesh në një mjedis të tillë, do të thotë qysh në palimpsestin fëmijëror ta kesh të qartë të vërtetën se në jetë mund të zgjedhësh dy gjëra; ose të ngjitesh drejt lartësive, ose të notosh në hapësirë të mbyllur. Pra, ose të ecësh drejt majave të larta ku do të shohin të gjithë ata që janë në rrëzë, ose të mbetesh poshtë, me shikim të drejtuar nga lartësitë. Andaj edhe vendimi duhej marrë qysh në moshën e njomë, në vitet kur ngrohtësia e prehrit të gjyshes ishte foleja më e sigurt dhe ndjellja më e këndshme që gjumi të mos vonojë. Pas viteve gazmore të kaluara në katërvjeçaren e fshatit Kranjë të Prespës, thuajse ngjitur me Arvatën, Aliu duhej të merrte vendimin: do të ngjitej lartësive të Pelisterit, apo do të mbetej aty pranë liqenit?

U nis drejt majës së Pelisterit, e kaloi atë lartësi, dhe erdhi në Manastir, që të mbarojë katër klasat e larta të fillores. La pas vetes kullën, odën e burrave ku babai u lexonte fëmijëve vjershën e Abaz Aliut, Qerbelanë dhe Lulet e Verës nga ato libra të mbështjellë me letër të trashë, ngjyrë dylli.

Ali Aliu qysh në moshën e njomë kishte shijuar ç’do të thotë të ecësh si kalorës i vetmuar. Ç’do të thotë qysh si fëmijë të braktisësh vendlindjen, të lësh prehrin e sigurt të gjyshes, i cili të mbron nga të gjitha shqetësimet, e bile të shëron edhe nga malli për ngrohtësinë e prehrit të nënës, që atij i kishte vdekur kur ishte ende foshnjë pesëmuajshe. Ecjet vetjake i filloi në vitin 1946 kur u regjistrua në klasën e pestë në shkollën e Manastirit. Asokohe Manastiri nuk i ngjante këtij të sotmit, e as shqiptarët në këtë qytet nuk ishin aq të rrallë sa sot. Kështu, dhomën e ngrohtë familjare e ndërroi me ndërtesën e madhe të gjimnazit dhe të internatit. Asokohe ai mund të jetë habitur pse shqiptarët e Manastirit flisnin duke pëshpëritur, pse askush nuk tregonte zëshëm se internati, në të vërtetë ishte godina ku dikur ishte mbajtur Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe. Njëjtë siç nuk ka mundur të vërejë se shqiptarët e Manastirit të viteve pesëdhjetë jetonin në plasaritjet që ndante të kaluarën e të tyre të famshme atdhetare dhe të ardhmen tragjike, e cila do të kulmojë në vitet kur Ali Aliu u bë emër i respektuar në të gjitha viset shqiptare. Një mbrëmje të vitit 2001, kur ende s’kishte marrë fund konflikti shqiptaro-maqedonas, çmendurakët e etnitetit maqedonas ua vunë flakën edhe atyre pak shtëpive të banuara me shqiptarë, që u kishin bërë ballë shtegtimeve në Turqi apo në vendbanimet e tjera shqiptare në Maqedoninë Perëndimore. Nxënësi i klasave të larta të tetëvjeçares së atëhershme të Manastirit, pa dyshim që s’ka mundur ta paramendonte se do të vinin vitet – siç ishin ato të nëntëdhjetat të Maqedonisë së pavarur – kur maqedonasit etnikë të këtij qyteti do t’i kundërvihen hapjes së shkollës së mesme në gjuhën shqipe në këtë qytet. Dhe këtë e bënë duke dashur t’ia

shlyejnë Manastirit të gjitha shenjat e shqiptarisë, të tërbuar nga e vërteta se në këtë qytet shkollat dhe libri shqip ishin më të vjetra se ato të etnisë maqedonase, të etnisë që pretendonte se çdo gjë në Maqedoni u takonte vetëm atyre. Të prirë nga dëshira që të përvetësojnë edhe atë që nuk u takon, nacionalistët e verbuar maqedonas vunë kryqin edhe mbi Sahat-kullën e njohur të Manastirit dhe në vitin 2001 ia vunë flakën xhamisë aty. Një flakë që nuk do të dëmtojë vetëm xhaminë, por edhe kujtimet e Ali Aliut për vitet kur erdhi në këtë qytet, ku ende ishin të pashlyera gjurmët e së kaluarës shqiptare.

I ardhur nga një hapësirë mbyllur si një rreth, ku njerëzit në mos më shumë, së paku ishin të zhurmshëm, dhe të vërtetën e ruanin dhe e kumtonin nëpërmjet këngës polifonike, nxënësi i viteve pesëdhjetë ngutshëm shënonte në kujtesën e vet kohën përplot paqartësi. Vogëlushit të ardhur nga ana tjetër e Pelisterit, shumë herët i ra në sy se edhe mësuesit disi ishin të trembur. Por, atë që mësuesit trembeshin t'ia tregonin fëmijës së ardhur nga Arvati, atij që rritej duke u ndarë dhimbshëm nga jehona e këngës polifonike prespane, ai e gjurmonte vetë, e ndiente në pëshpëritjet e ndrojtura të atyre që rrëfenin për të kaluarën e këtij qyteti, djep i shumë lëvizjeve përparimtare shqiptare. Dhe ia arrinte që, nën shtresat e një realiteti të vrazhdë dhe tragjik për shqiptarët e kohës së fëmijërisë së tij, të zbulonte se ishin vitet e hallit të madh, kur shqiptarët e kësaj ane nuk dinin si të dilnin nga ajo ngushticë ku u gjetën pas Luftës së Dytë Botërore. Për të ardhurin nga ajo anë e Pelisterit s'mund të mbetej pa vënë re se Manastiri ngadalë po shndërrohej në qytet që kishte përplot shenja të shqiptarisë, por mbetej pa shqiptarë. Ai e ndiente se në qytetin ku kishte ardhur, tradita dhe kultura

shqiptare ishin më të thella, nga sa mund të rrëmonin ata që donin ta fshihnin këtë të vërtetë, ata që i mbulonin me suva edhe muret e godinës ku ishte mbajtur Kongresi i Alfabetit. Kishte dëgjuar se aty ku mësonte, dikur kishte studiuar edhe Migjeni dhe se aty në fillim të shekullit të njëzetë familja Qiriazhi shtypte dhe botonte librin shqip. E gjithë kjo s'mund t'i shpëtonte syrit të shkathët që kishte ndjekur fluturimin e shqiptonjave mbi majat e Pelisterit, njësoj siç nuk mund të mos vërente kolonën e shqiptarëve që niseshin për në Turqi dhe zbraznin Manastirin. Dhe është e pamundur që ato kolona e rrëke lotësh të mos kenë lënë gjurmë të pashlyeshme në palimpsestin jetësor të vogëlushit që rritej dhe që për çdo ditë duhej të ndahej nga shokët e klasës që shkonin në Anadoll, kinse të shpëtonin vetveten, por që mbase përgjithmonë të zhdukeshin në rrafshnaltat e Azisë së Vogël.

Fëmija i njomë që shpejtazi rritej dhe ngutshëm ecte përpara, nuk mund të mos e përjetonte pikëllueshëm pamjen sesi “e vogla zvogëlohej” dhe si shqiptari, duke kërkuar rehati, edhe një herë zgjodhi rrugën e braktisjes së trojeve shekullore. Syri i tij dëshmoi dramën sesi Qyteti i Alfabetit të Gjuhës Shqipe mbetej pa fjalën shqipe, mbeteshin pa banorë shqiptarë sokakët nëpër të cilat kishin ecur të brengosur për fatin e popullit atdhetarët Ferid Bej Ypi, Tefik Panariti, Xhafer Kolonja, Fehim Beu, Petro N. Luarasi, Ali Zahimi, Jonuz Dibra, Bejtulla Beu... Atdhetarë këta që në vitin e largët të 1910-ës filluan Kongresin e Dytë të Alfabetit, u mblodhën “të bisedonin përmbi nevojat kombëtare, përmbi diturinë, përmbi lulëzimin dhe përparimin e gjuhës sonë dhe përmbi mbrothësinë e kombit shqiptar”, siç kishte thënë Dervish Hima në fjalën e vet hyrëse në Kongresin e Dytë të Manastirit. E këtë

ngjarje historike, shqiptarët për herë të parë do ta shënojnë lirshëm në vitin 2005, në vitin kur çdokund në këto hapësira u ndie fluturimi i lirshëm i shqiptonjës dykrenore. Dhe gjatë këtij kremtimi, Ali Aliu do të ishte ndër ata që bartën barrën e organizimit dhe mbase do të rikujtojë kohën që mbeti përherë e shënuar në kujtesën e tij, si panoramë e largët e Manastirit të viteve pesëdhjetë, e viteve që morën me vete mijëra shqiptarë si dhe mbuluan gjurmët e shumë burimeve që rrëfenin për historinë shqiptare. Ashtu si dhe kujtimet për vitet e socializmit, kur Manastiri bëhej gjithnjë e më shumë “Bitolla”, kur godina ku ishte mbajtur Kongresi i Alfabetit mbetej edhe pa pllakën përkujtimore sa herë që ndonjë nacionalisti maqedonas i kujtohej të luante me ndjenjat e shqiptarëve të Maqedonisë, apo sa herë që dikujt i kujtohej të shlyente edhe ato pak gjurmë të shqiptarisë që ende nuk ishin mbuluar me kryqin ortodoks dhe ciriliken sllave.

Manastiri i viteve të rinisë së Ali Aliut ngadalë, por pa pushim, bëhej një qytet tjetër, varr i qytetit të viteve kur aty botohej e përkohshmja periodike “Bashkimi i Kombit”, mbulesë e gjurmëve të vendbanimit të fillimshekullit të njëzetë kur konsujt e huaj regjistronin aktivitetin e shqiptarëve të këtushëm, veçanërisht të klubit “Bashkimi” që mori përsipër të organizonte Kongresin e Dytë të Alfabetit. Klubi “Bashkimi” i shqiptarëve të Manastirit do ta shpërndajë në të gjitha vendbanimet shqiptare “Zëdhënjen” nëpërmjet të cilës “Klubi Central merr nder të ftonjë të gjithë klubet, si edhe ato vise që nuk kanë klub të dërgojnë nga një delegat ndë mbledhje që do bëhet këtu më 15 Marsit...” (28 mars sipas kalendarit të ri).

Kjo “Zëdhënje” e shpërndarë nëpër trojet shqiptare në fund të dimrit të vitit 1910, do t’i ftojë atdhetarët e

atëherëshëm t'ia mësyjnë Manastirit dhe të sjellin vendime që do të përcaktojnë shumëçka për kulturën dhe të ardhmen shqiptare. Por nuk do të arrijnë që këtë qytet ta shpëtojnë nga deshqiptarizimi, nga braktisja, të cilin Ali Aliu e shihte çdo ditë gjatë shkollimit të vet. Mbase në kujtesën e tij kanë mbetur të pashlyera pamjet e kolonave të shqiptarëve të përлотur që përgjithmonë braktisnin vilajetin e Manastirit, hapësirë për të cilën e përkohshmja periodike serbe "Vardar" e 13 marsit të vitit 1910 do të shkruante: "Në Vilajetin e Manastirit bëhet lufta më e gjallë rreth përdorimit të gjuhës shqipe. Manastiri është i njohur si qendër politike shqiptare. Në të dhe në rrethinë (Dibër) janë mbajtur mitingjet më të rëndësishme shqiptare. Në këtë anë do të vendoset lufta rreth përdorimit të alfabetit arab ose latin. Këtu ishte më e fortë edhe lëvizja për latinishten..."

Në Manastir do të mbahen mitingje të zhurmshe edhe gjatë viteve nëntëdhjetë. Por në këto protesta askush nuk do të kërkojë të drejta më të mëdha: të rinjtë e etnisë maqedonase do të kundërshtojnë hapjen e paraleleve në gjuhën shqipe në gjimnazin e Manastirit. Do të mbahen protesta që nuk i kishte njohur ndonjëherë bota e civilizuar: kundër shkollimit në gjuhën amtare të bashkëqytetarëve që i takojnë një kulture dhe një tradite tjetër. Pra, të ndalohej gjuha, e cila në atë qytet flitej, shkruhej e botohej në libra para se të ekzistonte vetë Maqedonia dhe libri i botuar në gjuhën letrare të etnisë maqedonase.

Mall për gjyshen. Për këngën në buzëmbremje. Për erën e këndshme të mollëve të porsaçelura. Po, ama edhe dëshirë të vazhdonte ecjen. Gjithmonë drejt majave të larta. Tani, pasi kishte mbaruar klasat e larta në tetëvjeçaren

e Manastirit (në vitin 1950), Aliut i mbeteshin dy zgjidhje: të kthehej në Arvatin e lindjes, apo të nisej drejt Sharrit. Shkoi në rrëzën e këtij mali dhe u regjistrua në Shkollën Normale të Tetovës. Tetova do të bëhet qyteti ku Aliu do të përjetojë gëzimet rinore si dhe shqetësimet e moshës, si paradhomë e pjekurisë burrërore. Ai që dikur u regjistrua në shkollën e mesme në Tetovë, do të rikthehet në këtë qytet edhe më vonë, herë si letrar, herë si aktivist politik duke dashur t'u ndihmonte shqiptarëve të këtushëm që më lehtë të gjejnë rrugën e demokratizimit të vet në vitet nëntëdhjetë. Tetova do të mbetet në udhëpërshkrimin e tij si qytet i ardhje-shkuarjeve, ku herë përballëj me dështimet politike shqiptare që i shkaktonin shqetësime, herë me të arritura që e çonin të ndiejë mburrshëm edhe frutat e kontributit të vet të dhënë për realizimin e qëllimeve kolektive.

Vitet e shkollimit të mesëm në Tetovë, e cila asokohe ishte përplot me shqiptarë, por me pak shqiptari, mbase Ali Aliut do t'i kujtohen edhe në vitet e mëvonshme kur nga ky qytet do të jehojnë britmat e të rinjve që kërkojnë të drejtën për shkollim të lartë në gjuhën shqipe. Shumë dekada pasi në Tetovë kishte jetuar vitet e shkollarit të Normales, në qytet do të hapen dy universitete në gjuhën shqipe që nuk do të shprehin vetëm ëndrrën e kahmoçme shqiptare, por edhe inatet partiake, të cilat në vend që të përqendronin potencialin kadrovik e të themelonin një institucion të fortë arsimor, bënë dy Universitete, në njërin nga të cilët (në Universitetin e Evropës Juglindore) në vitet e dekadës së parë të shekullit të sotëm, do të ligjërojë edhe Ali Aliu. Akademiku i viteve kur Tetova u bë me dy universitete, nuk mund të kishte harruar qytetin e rinisë së vet kur rrugëve të kësaj kasabaje rrokullisej

“salltaneti allaturka” si diçka që e dallonte “sheherliun” nga katundaria e thjeshtë që zbriste nga malësia e Sharrit. Ardhacakun, që ruante në shpirt polifoninë toske, nuk mund të mos e pengonte ajo shlyerje e traditës hyjnore shqiptare me “shiltet” e orientit. I riu nga Prespa, asokohe, i zbuloi edhe librat në gjuhën shqipe të bibliotekës së madhe të Tetovës, e cila kishte funksionuar gjatë kohës së Italisë, e të cilat ishin shpërndarë nëpër shtëpitë e tetovarëve. Dhe mu këtu, në Tetovë, Ali Aliu do ta ndiejë se në jetë asgjë nuk do t’ia shlyejë mallin për ngrohtësinë e prehrit të gjyshes dhe dëshirën për lexim, nevojën të gëlltisë fjalën e bukur të shkruar në gjuhën shqipe.

Pasioni për lexim i mbeti e paprekur, edhe pas shpërnguljes së normales nga Tetova në Shkup, lëvizje që e ballafaqoi me këtë qytet të kapur nga ethet e ikjes së shqiptarëve në Turqi. Në Shkup takoi studentët shqiptarë, u mahnit nga entuziazmi i tyre që të kultivonin kulturën shqiptare në shoqërinë “Emin Duraku” dhe e plagosi rëndë lajmi se një numër i madh i tyre përfundoi në burg. Asokohe u tha kinse paskan qenë “anëtarë të një organizate armiqësore”. Dhe nëse në fillim e tërë kjo ngjarje i është dukur si pikturë e trishtë që fanitet, por nuk lë ta shohësh të tërën, dhe nuk mund ta zbërthesh deri në fund, gjatë viteve të ardhshme Aliu edhe vetë do ta shijojë ç’do të thotë të jesh student shqiptar në Jugosllavinë e Titos. Do ta ndiejë se shqiptari i shkolluar në Jugosllavi mbahej si i rrezikshëm për pushtetin, si një udhëtar që ecte në jetë me prangat e burgut në çantë. Armik në syrin e rojtarëve të pastërtisë ideologjike.

Shkollën normale e përfundon në Shkup në vitin 1955, vit i paqartësive të mëdha, viti kur ngriheshin mure të larta ndërshtetërore, kur Enver Hoxha kishte vendosur

të mbetej besniku më i madh i Stalinit dhe të mos vërejë se muri me të cilin mbrohej nga “titistët”, në të vërtetë ishte ndihma më e madhe që ua jepte komunistëve jugosllavë në betejën e tyre për të mbajtur nën kontroll shqiptarët e kësaj ane të kufirit. Me diplomën e mësuesit tashmë, Ali Aliu u kthye në fshatin e lindjes ku edhe një herë pa se sa të largëta ishin fshatrat e Shqipërisë që ndodheshin matanë liqenit. Pa se bregu i liqenit përballë ishte më i paarritshëm se brigjet e Amerikës dhe Australisë ku kishin shkuar të afërmit e familjes. Diçka i thoshte se nuk ishte njeri i kurbetit. Duhej të nisej drejt një rruge tjetër, ndiente nevojë për një pasuri të tjetër lloji, atë të diturisë, nëpërmjet librave që i lexonte më ndryshe se të tjerët. Qysh atëherë mësoi të lexonte edhe bardhësinë mes dy rreshtave, e që më vonë do t’i ndihmojë të bëhet lexuesi më i kërkuar nga të gjithë krijuesit shqiptarë, për veprat e të cilëve shkroi aq shumë, sa u bë udhërrëfyes i vlerave letrare shqiptare. U bë kritik letrar, pa të cilin krijuesit vështirë se do ta gjenin rrugën drejt veprës së vet letrare.

DITARI I PAPËRFUNDUAR

Tërmeti i vitit 1963 i mori Shkupit shumë njerëz të përgjumur dhe plot objekte që ishin shenjë njohëse e këtij qyteti. Në mëngjesin e 26 korrikut qyteti u gdhi në mes të gërmadhëve, i mbytur nga britmat e qytetarëve dhe pikëllimi për viktimat që kurrë nuk arritën t'i përfundonin ëndrrat e veta. Rrezet e hershme të atij mëngjesi ndriçuan edhe stacionin hekurudhor, pjesërisht të rrënuar të kryeqendrës së Maqedonisë. Ajo godinë e ndarë përgjysmë, edhe sot e kësaj dite qëndron ashtu siç e gdhui mëngjesi i largët veror. Qytetarëve të këtushëm u rikujton një ditë të largët zie, dhe ashtu gjysmë e rrënuar, përballë pashikueshmërisë dhe madhështisë së forcave natyrore, ndaj të cilave njeriu mbetet i pafuqishëm. Stacioni i dikurshëm hekurudhor i Shkupit - ora e të cilit është ndalur në pesë e shtatëmbëdhjetë minuta - kurrë më nuk u ripërtëri dhe nuk u bë siç ishte dikur: vend ku trenat çlodheshin dhe nga nisëshin të mbushur me udhëtarë, duart e të cilëve mbeteshin të zgjatura nga dritaret e vagonëve që shkonin, vend ku njerëzit ndaheshin apo takoheshin me të shumëpriturit e tyre. Ky stacion për shqiptarët sjell rikujtime të dyfishta: tërmetin e vitit 1963 dhe kolonat e bashkëkombësve të tyre që në vitet pesëdhjetë mbushnin vagonët e trenave dhe nisëshin për

në Turqi. Përderisa për tërmetin ka gjurmë të dukshme që të rikujtojnë dhe të ringjallin në kujtesë mëngjesin e largët trishtues, për eksodin e shqiptarëve nga Kosova, Maqedonia, Serbia Jugore dhe Mali i Zi, si dhe atë të boshnjakëve nga Sanxhaku e Bosnja, që shkuan në Anadoll, nuk ka asnjë gjurmë. Për vitet kur nga ky stacion hekurudhor realizohej koncepti i kahmoçëm sllav, që nga këto hapësira të dëbohet popullata me përkatësi fetare myslimane, e veçanërisht ajo shqiptare, nuk ka as pllakë përkujtimore, e as ndonjë hapësirë muze ku të ruheshin shamitë me lotët e tharë të atyre që lanë pas vetes lojërat e papërfunduara fëmijërore dhe shumëçka pa të cilat kurrë më nuk mund të jesh ai që ke qenë dikur. Pjesa e godinës që nuk lëshoi pë nga dridhjet e tokës, sot është galeri ku artistët e arteve pamore ekspozojnë veprat e tyre. Në të vërtetë, më shumë do t'i ngjante të ishte muze i lotderdhjeve të atyre që shkuan dhe kurrë nuk u kthyen, vend ku të mbeturit do të rikujtonin ditën kur vëllai u nda nga motra, prindi nga fëmijët – nga u realizua eksodi më i madh shqiptar. Qindra mijë shqiptarë që braktisën trojet e veta dhe u shpërngulën në Turqi. Ishte një degëzim në trungun etnik shqiptar, pakësim i shqiptarëve në trojet ballkanike.

Viteve të fundit, në këtë galeri ndodh të prezantojnë punimet e veta edhe piktorët e rinj shqiptarë, që mbase nuk e dinë mirë se në ato hapësira dikur janë dëgjuar vetëm britmat e shqiptarëve që shkonin dhe atyre që mbeteshin; që nuk mbajnë mend mirë se aty janë tharë lotët e ndarjes dhe janë venitur hamendjet se kush gabonte: shtegtarët që braktisnin vendlindjen apo ata që ngulnin këmbë të mos ndaheshin nga vatra e të parëve. Ndodh shpesh që Ali Aliu të jetë ai që i shpall të hapura

ekspozitat, apo thjesht si dashmirës i artit të ndalet përpara pikturave të piktorëve të këtushëm shqiptarë duke mos mundur të shmangë kujtesën për vitet pesëdhjetë, ato ndarje të dhembshme që përgjithmonë i kanë mbetur në kujtesë. Ato pamje thuajse biblike, kolona njerëzish të ngarkuar me bohçe, shikimi i fëmijëve të trishtuar që kishin lindur këtu e duhej të rriten atje, që kishin qarë, qeshur e dëgjuar ninulla shqip, e që duhej më tej të këndonin turqisht, fshatarë që as dinin ku ndodhej Turqia e nga kalonte hekurudha që lidhte vendlindjen e tyre me vendin e shpresave, ata njerëz të gënjyer e të zhgënjyer nga një makineri e madhe ideologjike që i barazonte klasat, por jo edhe popujt. S'mund të mos linin gjurmë të pashlyeshme në vetëdijen e të riut të atëhershëm që posa kishte kryer Shkollën e Mesme të Normales së Shkupit, dhe bëhej gati që me një nga trenat që niseshin nga stacioni hekurudhor i Shkupit, të shkonte në Beograd për të studiuar gjuhën dhe letërsinë.

Ishte viti i kthesave të mëdha, kur Ali Aliu edhe një herë braktisi Arvatën e lindjes dhe u nis rrugës së rritjes si njeri i ardhshëm i letrave e atdhetarisë.

Albanologjinë në Beograd e regjistroi në vitin 1954. Sigurisht, pa e ditur fare se Enver Hoxhës atë vit i kishte ardhur ftesa të shkonte patjetër “me pushime” në Bashkimin Sovjetik, se atje, sovjetikët ia kishin “kurdisur” takimin me Svetozar Vukmanoviq-Tempon, të cilit kryekomunisti shqiptar i kishte ngritur çështjen e komisionit të Ohrit, që “zvarriste diskutimet”, por ky i dyti kishte propozuar që më mirë ishte të “shihnin liqenin e Shkodrës, ku përfitimet do të jenë më të mëdha për të dyja palët”. Asnjë fjalë për Kosovën, e as për shqiptarët që dëboheshin nga trojet e tyre. Këto gjëra nuk ka mundur

t'i dinte i riu që kishte bërë gati valixhet për të shkuar më tej rrugëve të diturisë. Muri mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë ishte shumë i lartë, aq i lartë sa mund ta tejkalonin vetëm ëndrrat e këtyre nga kjo anë, që vuanin pse kishin mbetur jashtë kufijve të mëmëdheut dhe të atyre matanë murit që ëndërronin të dilnin jashtë asaj rrethoje enveriste.

Kufiri shqiptaro-jugosllav që moti që shndërruar në mur “me gjemba” ku përplaseshin ëndrrat e shqiptarëve matanë dhe nga kjo anë e kufirit. Ai ishte shenjë e urrejtjes së ndërsjellë të komunistëve të Tiranës dhe atyre të Beogradit. Në telat me gjemba që kufizonin Shqipërinë e ndarë në mes, gërvishteshin edhe lajmet e rralla që vinin nga matanë kufirit. Ashtu të plagosura, të vërtetat për parajsën e quajtur *mëmëdhe*, më shumë përbëheshin nga iluzionet se dikush atje në Tiranë brengosej për fëmijët e mbetur jashtë shtetit *amë*. Shumë dekada më vonë, shqiptarëve këtej kufirit, ato iluzione do t'u përplasen fytyrës si flakaresh e dhembshëm, si zgjim i beftë e tronditës nga shtrati i iluzioneve të kota se Tirana zyrtare kurrë s'i kishte harruar. Në vitet nëntëdhjetë, që do të shënojnë zhgënjimin mbarëkombëtar, shqiptarët e mbetur nga kjo anë e kufirit do të kuptojnë se bashkëkombësit e tyre matanë maleve ishin dergjur nëpër burgje vetëm pse nuk donin t'i këndonin Enverit, ndërsa këta këndeje kishin mbushur burgjet jugosllave vetëm se i kishin thurur poezi Enverit apo mëmëdheut. Burgosjet për shkak të Enverit do të mbeten e vetmja lidhje e shqiptarëve që jetonin në Jugosllavinë e Titos, që ëndërronin si e si të dilnin matanë kufirit, të shkelnin tokën e shenjtë të mëmëdheut, por edhe e atyre të Shqipërisë që ëndërronin të kalonin këtej murit, të shpëtonin nga shteti ideologjik, ngritur si burg

kolektiv për popullin që jetonte atje. Në vitet nëntëdhjetë ata do ta kuptojnë sa të drejtë kishte pasur Tempoja kur dikur moti i kishte propozuar Enverit të përqendroheshin te “liqeni i Shkodrës”, i cili mund të dyja palëve t’u sillte përfitime të mëdha”: nëpërmjet këtij liqeni dhe në shumë vendkalime të tjera, në vitet nëntëdhjetë, Shqipëria e udhëhequr nga demokrati Sali Berisha do ta thyejë embargon ndërkombëtare mbi Serbinë dhe do ta furnizojë këtë shtet me naftë. Kjo do t’u sjellë përfitime të mëdha gjithë atyre që ndihmuan të mos mbeten pa naftë tanket e Millosheviqit që do të digjnin fshatrat e shqiptarëve të Kosovës dhe masakronin myslimanët e Bosnjës. Këtë shkelje monstruoze të embargos do ta pranojë në vitin 2006 si të vërtetë edhe vetë Sali Berisha. Mirëpo vetëm pasi turpi të kishte dalë në shesh, prej librit të kryetarit të asokohshëm të Malit të Zi, ndihmësit të denjë të Millosheviqit, Bullatoviç. Ai do ta zbardhë bisedën e viteve nëntëdhjetë me Berishën, nga do të shihet qartë ajo që qysh moti e pëshpëritnin shqiptarët nga kjo anë e kufirit – se edhe mëmëdheu i tyre i shet naftë vrasësit të kosovarëve. Me çka edhe një herë u dëshmuua se ngado që ta kthesh, Tiranës zyrtare prapanica i mbetet e kthyer ose nga Athina ose nga Beogradi. Dhe kurrë nuk i skuqet fytyra, sepse që moti ishte mësuar të përballë inferioritetin e vet politik ndaj fqinjëve dhe Evropës.

Titoja dhe Enveri do të mbeten armiq të përbetuar, por armiqësia e tyre nuk do të dëmtojë askënd aq shumë sa shqiptarët këtej dhe andej murit. Kjo armiqësi shqiptaro-jugosllave vetëm do t’i forcojë muskujt ideologjikë dhe policorë që shtrëngonin fort shqiptarët këtej dhe andej kufirit, do të mundësojë që Shqipëria t’i burgoste “spiunët” e Jugosllavisë, e Titoja t’i luftonte

përkrahësit e Enverit dhe “shqiptarët irredentistë” të kësaj ane. Se, në të vërtetë, askush nuk e përkrahu Enverin aq sa Titoja dhe askush nuk e mbrojti Jugosllavinë socialiste nga shqiptarët e këtushëm aq sa Partia e Punës e Shqipërisë. Jugosllavinë e Titos e mbronin nga shqiptarët e këtushëm edhe emisionet gënjeshtarë të Radio Tiranës që filluan të emetohen në vitet studentore të Ali Aliut, kur edhe ai, si shumica e të shkolluarve të rinj shqiptarë të asaj kohe, me mburrje dëgjonte zërin e ëmbël shqip që informonte për arritjet e vendit amë. Zëri që sforconte ëndrrën për parajsën e quajtur Shqipëri, nxiste revoltën kundër “sllavokomunizmit”, por i këndonte ninulla edhe iluzionit të kotë se Tirana e kuqe ishte e brengosur për shqiptarët që dergjeshin nëpër burgjet e Jugosllavisë, e cila kujdesshëm dhe në mënyrë të kontrolluar kishte filluar të ndërtonte një klasë të shkolluar të shqiptarëve. Dhe këtë nuk e bënte për të mirën e shqiptarëve, por për t’u dukur më e bukur ikebana ideologjike e popujve dhe popullsive të vëllazëruar të Jugosllavisë së Titos. Por, kuptohet, duke mos mundur ta parashikojë se shumica e atyre që Beogradi donte t’i ketë “ushtarë” të vet ideologjikë, ishin rritur në vatra familjare ku qysh fëmijë i kishin mësuar se shumëçka në jetë shitet dhe zhvlerësohet, por jo edhe qumështi i nënës, se kur përbuz qumështin amnor, kurrë më nuk mund ta meritosh vdekjen.

Katër vitet e kaluara në Beograd si student i katedrës së Albanologjisë (1955-1959), në formimin e Ali Aliut do të mbeten si katër shtresat e urtësisë që përcaktojnë shumëçka për sa i përket të ardhmes jetësore të këtij kritiku letrar dhe atdhetari të përkushtuar. Këto vite do të lënë shenja të pashlyeshme në portretin intelektual dhe

njerëzor të gazetarit, redaktorit, profesorit dhe akademikut të ardhshëm. Përcaktimi i tij për të studiuar gjuhën shqipe dhe letërsinë, do t'i plotësojë dëshirën e kahmoçme që përgjithmonë t'i mbetet besnik fjalës së shkruar artistike dhe librin ta lexojë me laps në dorë. Andaj edhe njerëzit e afërm të këtij kritiku letrar do të thonë se nuk ka asgjë më të mirë se të lexosh ndonjë libër të huazuar nga Ali Aliu: kjo të mundëson të lexosh faqet e shtypura që ka shkruar autori dhe pjesët e shkruara me dorë në bardhësitë anësore të librit ku ka lënë shënimet e veta Aliu, e që librin e bëjnë më të plotë dhe më të kuptueshëm. Këto shënime të kritikut nuk shprehin vetëm kënaqësinë që i ka ofruar vepra e mirëfilltë artistike, por shpeshherë edhe dëshpërimin nga të pathënat, apo të thënat keq të autorit. Mbase andaj viteve të fundit ai i merr me ca trishtim librat që i japin autorët shëtitës nëpër panaiet me çantat përplot me veprat e veta. E di se ata duan të dëgjojnë mendimin e tij, se ata janë shumë e ai nga të paktët që kurrë s' thotë atë që nuk e mendon, ashtu si kurrë nuk e ka tradhtuar vlerën e mirëfilltë apo ta shpallë si jo të vlefshme, njësoj siç nuk e ka lazdruar jovlerën me të thëna të pavërteta apo ta shpallë si diçka të vlefshme. Si i tillë, ishte dhe ka mbetur ndër të rrallët që lumturohen nga veprat e mirëfillta letrare të autorëve të ri, dhe me përkushtim i lexon autorët e dëshmuar, të cilëve u është shumë e rëndësishme "certifikata" kritike që u jep Ali Aliu. Thjesht, ai kremton lindjen e çdo vlere të mirëfilltë letrare shqiptare.

Vitet e rinisë të kaluara në Beograd do t'i ndihmojnë Aliut të kuptojë se i takonte një populli, i cili duhej të ecë rrugës së gjatë dhe të mundimshme drejt realizimit të ëndrrës shekullore për liri dhe përparim të mirëfilltë. Këtu do të ndiejë ç' do të thotë të jesh pjesëtar i popullit "jetim"

në këtë gadishull, një nga miliona shqiptarët, të cilët e kishin fat që në trojet ku jetonin me shekuj, ta ndiejnë veten ngushtë, të vetmuar, me shikim nga largësitë ku mbase mund të kishte ndonjë hapësirë ku mund të thurnin qetësisht ardhmërinë e tyre. Ndjenjë kjo që në vitet e mëvonshme do t'i çojë masivisht të kërkojnë shpëtim në shtetet e Evropës, ku jetonin e punonin vetëm sa të mbijetonin kohën e socializmit, vitet kur punëtorja ideologjike e Beogradit prodhonte edhe elaborate sesi të ngulfatet ndjenja etnike e shqiptarëve të Jugosllavisë. Mërgimi dhe ikja nga trojet e lindjes u bë mënyrë e mbijetesës për pjesën shqiptare të mbetur jashtë kufijve të shtetit amë.

Duke shëtitur nëpër lagjet e Beogradit, tek Ali Aliu thuajse u shtresua edhe vendimi jetësor se gjeneratës së tij kurrë nuk do t'i takonte fati t'i përkushtohet vetëm një profesioni, kurrë nuk do të ndienin krenarinë e arritjeve profesionale, por do të duhej të ishin edhe prijës të kolonave popullore, udhërrëfyes për të ardhmen e një populli, i cili asokohe ishte në përqindje të madhe i pashkolluar dhe pa elitë politike, kulturore dhe profesionale. Se shqiptari i atyre gjeneratave mund të bëhej mjek, ekonomist, jurist, profesor..., mirëpo kjo nuk do t'i vlente pa mos iu përkushtuar profesionit të atdhetarit, i cili do të duhej të lexojë saktësisht orën e bardhë të një kohe të ngjyrosur me të zezë, dhe kalendarin e viteve ku kishte rrezik që pjesa shqiptare këtej kufirit përgjithmonë të ndahet nga trangu etnik dhe të mbetet si degë pa rrënjë e pa të kaluarën e vet. Këtë Aliu do ta kuptojë në mënyrën më të vrazhdë; duke shijuar burgun e Jugosllavisë së Titos ende si student. Aliut, Beogradi ia la në trashëgimi edhe miqësitë jetësore me ata që kishte ndarë të gjitha

shqetësimet dhe çastet gazmore të moshës rinore, si për shembull atë me Agim Gjakovën, me të cilin edhe sot e kësaj dite takohen dhe, më shumë në heshtje, sesa duke folur, rikujtojnë kohën kur ata ishin të rinj teksa konceptet antishqiptare kishin moshë qindrvjeçare.

Sipas disa të dhënave, në vitin 1958, nëpër qendrat universitare të Jugosllavisë socialiste, studionin diku rreth njëqind e tridhjetë studentë shqiptarë, nga të cilët të ardhurit nga Maqedonia numëroheshin me gishtat e dorës. Numri i vogël i shqiptarëve që asokohe studionin, tregon qartë tendencat e qendrave të vendosjes ideologjike që kjo popullatë të mbetet në kthetrat e prapambetjes, që të ketë një elitë të kontrolluar dhe në numër të mjaftueshëm të kompletohej ikebana ideologjike e shtetit, i cili nuk ndërtonte as socializëm as kapitalizëm, por një “mbretëri komuniste” me tetë “pashallëqe” në të (Federata Socialiste e Jugosllavisë kishte gjashtë republika dhe dy autonomi).

Mosshkollimi i shqiptarëve në dekadat e para pas Luftës së Dytë Botërore ishte rezultat edhe i mospasjes së fakulteteve në gjuhën shqipe në Prishtinë dhe në vendbanimet e tjera shqiptare. Mosarsimin e ndihmonte edhe varfëria e shqiptarëve të Jugosllavisë, të cilët duke u marrë kryesisht me bujqësi dhe duke i pasur të largëta qendrat universitare, as që mund të shpresonin t’i shkollonin fëmijët e tyre. Ata të paktët që arrinin të vazhdonin shkollimin e lartë, ishin ose fëmijë të lindur për “libër e laps”, ose nga familjet siç ishte ajo e Ali Aliut, e cila shkollimin e të rinjve e kishte peshuar si pasuri më të madhe qysh në kohën e Osmanllijve. Andaj ishin të gatshëm të ndanin edhe bukën e gojës që fëmijëve t’u mundësonin arsimimin.

Sado që tingëllon absurde, asokohe nuk ka qenë ndonjë privilegj të jesh student shqiptar. Sepse me vetë përcaktimin të vazhdosh studimet, je përcaktuar me të pashmangshmen: të jesh nën syrin e zgjuar të shërbimeve policore jugosllave, të cilat qysh nga dita e themelimit e deri në shkatërrimin e Jugosllavisë së Titos, shqiptarin e shkolluar e mbanin për armik potencial. Aq më shumë, për UDB-në (Unutrashnja Drzhavna Bezbednost – Sigurimi i Brendshëm i Shtetit) e Jugosllavisë nuk ka qenë ndonjë problem i madh t'i mbajë nën mbikëqyrje ata studentë shqiptarë të shpërndarë nëpër qendrat universitare, larg vendlindjes dhe të vendosur nëpër konviktet së bashku me ardhacakët e tjerë me përkatësi të ndryshme etnike. Këta të rinj janë shkolluar në mes ëndrrës të bëhen profesionistë dhe pishtarë të popullit, dhe realitetit që i shtynte të shndërroheshin në shërbëtorë të “oborrit ideologjik”, të bëhen mashë e atyre që e dinin se shqiptari i shkolluar, shqiptari që u del duarsh, është më i rrezikshëm se një armatë e “sharrëxhinjve” shqiptarë që asokohe bridhnin rrugëve të Beogradit me sharrën në krahë për të nxjerrë bukën e gojës. Andaj gjenerata e Ali Aliut, ato të mëparshmet, si dhe të gjitha të mëvonshmet deri në themelimin e Universitetit të Prishtinës në vitin 1971, do të jenë gurthemeli i betonuar në rrethana kur ose mbetesh njeri, ose përjetë përbaltesh dhe humb vetveten.

Për fat të mirë të shqiptarëve që jetonin në Jugosllavinë e Titos, të paktë ishin ata që, për shkak të disa të mirave të përkohshme, zgjodhën turpin e përjetshëm. Shumica që shkolloheshin në qendrat universitare të Jugosllavisë së Titos, e që vinin nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia Jugore, dëshmuuan se kanë bosht të fortë kurrizor,

njerëzor e kombëtar. Nga kjo forcë e boshtit të tyre vertikal atdhetar e profesional do të varet për shumëçka e ardhmja e gjeneratave të reja shqiptare, e pikësëpari arsimimi i tyre. Veçanërisht kur dihet se Tirana e atëhershme s'e kishte idenë se numri i shqiptarëve që festonin ditëlindjen e Titos ishte thujse sa ai i atyre që në Shqipëri i përkuleshin Enver Hoxhës.

Në vitet '50, Beogradin e kishin banuar rreth gjashtëdhjetë studentë shqiptarë, ardhur me një valixhe në dorë e me plot ëndrra rinore. Në kryeqendrën e Federatës Socialiste të Jugosllavisë, Ali Aliu do të takohet me studentët e tjerë të ardhur nga Kosova, në mes të të cilëve edhe me Ymer Jakën, Zekeria Canën, Bardhyl Çaushin, Muhamet Kërveshin si dhe me ata nga Maqedonia: Nehat Bëllqishtën, Hamza Rekën, Mahmut Hysën, Remzi Nesimin, Ditar Qamilin... Nga të gjithë këta, takimi me Agim Gjakovën do të shënojë një miqësi të përjetshme dhe këta dy do të jenë ata që do t'u prijnë aktiviteteve studentore të kësaj gjenerate. Këto aktivitete do të mbeten shenjë e përpjekjeve të një gjenerate, e cila dëshironte t'i realizojë ëndrrat e veta duke bërë gjumë pranë "gojës së ujkut", siç thotë Agim Gjakova në kujtimet e tij të botuara nën titullin "Kosova edhe e shkrumuese është e hijshme". Duke rrëfyer për fatin e gjeneratës së vet, në këto kujtime në të vërtetë shkruan një pjesë të historisë së shqiptarëve të Jugosllavisë.

Vitet kur do të lidhet miqësia e përjetshme në mes Ali Aliut dhe Agim Gjakovës ishin përplot me paqartësi, kohë kur studentët shqiptarë në Beograd nuk kishin asnjë shoqatë të vetën apo jetë të begatë studentore. I tërë aktiviteti jashtë mësimoreve ku dëgjonin ligjëratat, thujse fillonte e përfundonte me takimet e mbrëmjes nëpër

dhomat e ngushta të konviktit. Në ato dhoma të ngushta, të mbushura me mall për vendlindjen dhe me ëndërrimtarët e rinj, shpesh ka jehuar edhe kënga shqiptare si e ardhur nga largësia e pasmaleve, si lajmës që të rikujton kush je dhe nga duhet të ecësh. Por, vallë u mjaftonte vetëm kaq studentëve që jetonin stinën e jetës së tyre përplot vrull, që shijonin moshën e iluzioneve rinore? Kuptohet që jo. Prandaj Agim Gjakova një ditë do t'i propozojë Aliut të themelonin një shoqatë letrare. Ja ç'thotë ai lidhur me këtë iniciativë në kujtimet e veta: "Intensifikimi i mendimeve dhe i "punës" për të bërë bashkëmendimtarë ma shkrepri idenë për një organizim legal, pra të një grupimi, të cilin do ta ndërtonim si 'shoqatë letrare'. Më vonë u shtri ideja për një shoqatë kulturo-artistike të studentëve shqiptarë në Beograd. Përveç gjallërimit të jetës në mjedisin tonë, qëllimi ishte që të krijohej një qendër prej nga do të mund të mbanim informacionin për organizatën e ardhshme të rezistencës."

Ky do të ishte organizimi i parë shqiptar në Beograd. "Themelimin e kësaj shoqate e bisedova së pari me Ali Aliun, duke "qortuar" pak edhe brezin e mëparshëm të studentëve shqiptarë, të cilët (në asnjë mënyrë nuk mund të mohoj përkatësinë dhe disponimin atdhetar të pjesës më të madhe të tyre) nuk kishin bërë aq sa mund të bëhej për çështjen kombëtare e për lirinë e Kosovës", shkruan më tej Agim Gjakova. Propozimin e Agim Gjakovës dhe të Ali Aliut, për themelimin e një organizate legale studentore, në zemër të Jugosllavisë socialiste, e kishin përkrahur thuajse të gjithë kolegët e tyre shqiptarë. Dhe, një mbrëmje, arrijnë të organizojnë lexim letrar, ku do të grumbullohen thuajse të gjithë shqiptarët që asokohe studionin në Beograd. Lidhur me këtë Agim Gjakova

shkruan: “Në mbrëmjen e themelimit fola ashtu si dita për rëndësinë e kulturës shqiptare. Isha mjaft i emocionuar përbrenda. Që organizimi i parë shqiptar që krijohej në atë mjedis, siç thuhet, “në gojën e ujkut”, me “intelektualë” shqiptarë. E vura në thonjëza fjalën intelektualë për të mos pretenduar në kuptimin e saj, për të cilin shumë studiues japin shpjegime e konotacione të ndryshme, por desha të them se “ata ishim”, një brez i Kosovës që po përgatitej në njëfarë mënyre të merrte barrën e rëndë të shkencës, kulturës, letërsisë e artit si edhe të drejtimit politik me aq sa do t’ia lejonin koha e rrethanat.” Në kryesi të kësaj shoqate do të zgjidhen edhe Ali Aliu, Zekeria Cana, Agim Gjakova. Latif Berisha...

Shoqata “Përpjekja” do të jetë e para, por jo edhe e fundit, e iniciuar nga Ali Aliu dhe miqtë e tij. Gjatë jetës së vet ai do të jetë nismëtar dhe themelues i shoqatave, partive, manifestimeve kulturore. Ai do të jetë një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, nismëtare e nxitëse e rrjedhave të mëvonshme që përcaktojnë ardhmërinë e Kosovës. Ali Aliu do të bëjë çmos ta regjistrojnë Shoqatën e Shkrimtarëve Shqiptarë të Maqedonisë, do ta “sjellë” në Tetovë Naimin, duke e bindur Tiranën dhe Prishtinën se edhe shqiptarëve të Maqedonisë u takonte një manifestim kulturor mbarëshqiptar. Lehtë arriti t’i bindë miqtë e vet në Shqipëri dhe Kosovë që Tetova të bëhej qendër ku çdo vit do të mbaheshin takimet letrare “Ditët e Naimit”, por kurrë nuk arriti të kuptojë dhe të tejkalojë mendjemëdhenjtë e kasabës së Tetovës, të cilët këtë manifestim e shndërruan në “dasmë private” dhe assesi nuk e kuptonin se ndaj emrit dhe veprës së këtij Rilindësi dhe Atdhetari, nuk duhej të silleshin si ndaj ndonjë tregtari

të Pollogut dhe se ky manifestim nuk duhej të njollosej me shpirtngushtësinë lokaliste. Ata që më vonë morën në duar këtë manifestim, ndanë shumë mirënjohje, shpërblime, shpallën shumë veta anëtarë nderi, por kurrë nuk u kujtuan të nderonin themeluesin e “Ditëve të Naimit”, atë që falë autoritetit të vet vuri gurthemelin e këtij manifestimi.

Aktiviteti studentor i Ali Aliut në Beograd, thujse do të përcaktojë fatin e këtij intelektual që gjithmonë të jetë nismëtar i aktiviteteve që kanë të bëjnë me afirmimin politik dhe kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë. Por ky aktivitet i tij për organizimin e jetës kulturore dhe shoqërore të rinisë së atëhershme shqiptare, nuk do të mbetet i pavërejtur nga sytë e policisë jugosllave. Dhe vetëm pritej çasti dhe “mbulesë” e volitshme kur Ali Aliu dhe shokët e tij do të duhej të paguanin të gjitha “gabimet” e tyre, pikësëpari “provokimin” që ia bënë shtetit me themelimin e shoqatës “Përpjekja”. Dhe dënimi nuk do të vononte, sepse dihej që rinia nuk është vetëm e vullshme dhe e guximshme, por edhe e pakujdesshme! Kështu Ali Aliu, së bashku me disa kolegë të tjerë, së shpejti do të përfundojë në burg. Si shkak apo pretekst shërbeu një takim i rastësishëm me Adem Demaçin në Prishtinë, gjatë një turneu letrar të anëtarëve të shoqatës “Përpjekja” nga Beogradi. Ali Aliu do të shkojë në burg vetëm pse nuk do të pranojë të tregojë atë që e dinte policia jugosllave, atë që aq zëshëm e kishte thënë Adem Demaçi. E tërë ngjarja kishte ndodhur në hotelin “Nova Jugosllavia” (“Jugosllavia e Re”) në Prishtinë. Edhe për këtë ngjarje dëshmitari më i besueshëm dhe më objektiv është Agim Gjakova: “Turneu letrar nëpër Kosovë qe shumë i bukur dhe tejet i suksesshëm, por, për ato që do

të ndodhnin më vonë, edhe fatkeq për ushtrimin e veprimtarisë së mëtejshme të shoqatës dhe të grupit tonë në përgjithësi. Me të arritur në Prishtinë, grupit të përbërë prej Ali Aliut, Agim Gjakovës, Fahredin Gungës, Din Mehmetit, Zekeria Canës, Hysni Hoxhës, Muhamet Kërveshit iu bashkëngjitën edhe Adem Demaçi e Adem Gajtani. Pasi kisha motrën me të shoqin, Nazmi Kajtazi në Prishtinë, dolëm në hotel “Nova Jugosllavija” për të ndenjur pak. Në të njëjtën kohë erdhi edhe grupi dhe Adem Demaçi e hapi çështjen e organizimit për çlirimin e Kosovës e bashkimin e saj me Shqipërinë. Edhe mua, që nuk isha fare i specializuar në “survejim” më ra në sy mënyra sesi qëndronin e flisnin. Dukej sheshit se po bisedonin diçka të fshehtë dhe konspirative, apo po thurnin diçka kundërshtare. U çova dhe u nisa për WC, jo për nevojë, por t’i bëja shenjë Ali Aliut. Në WC i thashë se janë bërë “krejt budalla” duke biseduar në këtë mënyrë në mes të lokalit në sy të të gjithëve dhe kërkova që ta ndërprisnin bisedën. Por siç doli më vonë nuk kishte pranuar Adem Demaçi. Të tjerët, edhe nëse kishin qenë “esëll”, nuk ia kishin prishur. Kështu që biseda u bë deri në fund. Kush, çka kishte thënë, në atë mbrëmje aty në kafenenë në qendër të Prishtinës nuk mund të them me siguri asgjë. Nxitës kryesor kishte qenë Adem Demaçi.”

Kjo bisedë e “fshehtë”, të cilën e kishin dëgjuar të gjithë që kishin veshë, u mjaftoi organeve policore jugosllave të fillonin ndjekjen e aktivistëve të shoqatës “Përpjekja”, të cilëve edhe ashtu u kishte ardhur koha t’u tregohej se e kishin “gabuar rrugën” dhe se shteti nuk priste nga ata të bëheshin pishtarë të popullit, por frenues që do t’i ndihmonin pushtetit komunist të ngadalësonte zgjimin etnik të shqiptarëve. U thirrën në “biseda informative” të

gjithë ata që kishin dëgjuar fjalët e zjarrta atdhetare të Adem Demaçit. Mbetet e paqartë pse Ali Aliu assesi nuk kishte pranuar të tregonte përmbajtjen e fjalës së Adem Demaçit, e cila thuhet ishte thënë “publikisht”. Ndoshta kështu ka dashur të matë guximin e vet, apo qysh atëherë kishte kuptuar urtësinë se njeriu i mbron parimet e veta jo pse turpërohet nga të tjerët, por pse nuk do të tradhtojë vetveten. Ai do t’i pranojë të gjitha vetëm në çastin kur nga një shok i tij i burgut do të merrte vesh se policia dinte çdo gjë që ishte thënë në atë takim në Prishtinë. Kjo kokëfortësi e tij, do t’i kushtojë dy muaj të kaluar në Burgun Qendror të Beogradit, ku do t’i bashkëngjitet miku i tij i dashur Agim Gjakova, i cili lidhur me këto çaste të dhembshme rinore shkruan: “Adem Demaçin e arrestuan dhe na erdhi lajmi në Beograd. Na erdhi shumë keq për shokun e shkrimtarin. Pasi kaloi festa e Vitit të Ri 1958-1959, ia behu hetuesi i tij dhe filloi të thërriteshin një nga një studentët për të dëshmuar për “krimet e Adem Demaçit”, të tregonin se çfarë bisedash kishin bërë me të, ku, si, e të tjera të kësaj natyre. E mësuam radhën nga shokët që na besonin... Më vjen Aliu e më thotë se “ata të UDB-së i dinin krejt ato çka kemi biseduar atë natë” dhe këtë ia kishin pohuar të tjerët që qenë thërritur para tij. “Natyrisht!”, ia prita. Dhe heshtëm... Mua dhe Aliun na lanë për në fund, ditën e enjte. Aliut ia caktuan dy orë para meje dhe mua dy orë më vonë. Shkova. Ishte një hetues i ardhur nga Prishtina (për të më vonë dëgjova nga Hysen Zherka se kishte qenë “udbash” në Drenicë) dhe Xhavit Shabani. Ia kishin ngarkuar procesin e hetuesisë për Adem Demaçin, të paktën lidhur me ne, studentët. Mohova të gjitha tendencat për të thënë se kisha biseduar me Ademin për diçka politike.” Pastaj Gjakova

përshkruan atmosferën e krijuar pas këtyre veprimeve policore që kishin për qëllim gjuhëzimin e studentëve të rinj shqiptarë. “Në tetor të 1958-ës kalova nëpër Prishtinë për në Beograd. U takova me Adem Demaçin dhe biseduam gjerë e gjatë për nevojën e organizimit dhe për gjithçka u morëm vesh, përveç për një çështje që qemë të kundërt në mendime e në qëndrime. Ishte fjala për konspiracionin që duhej të kishim. Ademi mbronte tezën që në rast të arrestimeve ne duhej të shpallnim qëllimet e tendencat tona, kurse unë kërkoja të kundërtën që në raste të tilla duhej të ruanim gjithçka të fshehtë dhe po qe nevoja edhe me jetën, përndryshe “atij që nuk ia mban” të mos hynte. Ademi pretendonte se duhej bërë “gjqy publik” dhe aty të demaskohej regjimi jugosllav. Unë shprehsha kundër një qëndrimi të tillë, pasi askush nuk mund të bënte një gjë të tillë, se nuk kishim asnjë përkrahës, nuk do të na linin njerëzit as të afroheshim te salla e gjyqit, madje mund të mos linin as familjarët të merrnin pjesë gjatë gjykimit, prandaj kujt do t’i flitej?! Po ashtu dëmtohej lëvizja jonë dhe ekspozoheshin shokët, dhe UDB-ja jo vetëm që do t’i izolonte, por edhe do t’i burgoste. “Gjyqi publik” dhe “demaskimi” mund të bëhej vetëm kur ne të kishim arritur forcimin e zmadhimin e lëvizjes sonë që të na lejonte një gjë të tillë dhe këtë vetëm në rastet e nevojshme dhe pa shtegdalje. Nuk u morëm vesh për këtë pikë dhe e lamë të shiheshim të nesërmen në orën katër pasdite në parkun e Prishtinës, pasi unë në mbrëmje do të udhëtoja për Beograd. Dola në orën katër dhe e prita një gjysmë ore. Ademi nuk erdhi. Në mbrëmje u nisa me autobus për Fushë-Kosovë, i hipa trenit e sosa në Beograd dhe e diskutova çështjen me Aliun, Idrizin e Latifin. Më dhanë të drejtë.”

Kur janë në pyetje ngjarjet e kësaj kohe, shumëçka do të mbetet e paqartë, përderisa nuk hapen dosjet policore që ruhen në Beograd. Pastaj nuk duhet harruar se asokohe, si edhe deri në shpërbërjen e Jugosllavisë, shqiptarët kurrë nuk kishin ndikim në qendrat e vendimmarrjes policore. Institucionet policore kishin mundësi cilëndo ta “fusnin” në kurth aq sa të krijonin një ambient irracional dhe çdonjëri të dyshonte në tjetrin se mund të ishte bashkëpunëtor i UDB-së. Por, e gjitha kjo histori nuk do të përfundojë vetëm me biseda të lodhshme me inspektorët policorë. Një ditë policët do të vijnë dhe do të burgosin Ali Aliun. Në çastet derisa do t’i nxjerrin nga konvikti studentor, Aliun dhe përcjellësit e tij do t’i shohë njëri nga shokët e tij, Nuri Bashota, i cili do të lajmërojë Agim Gjakovën që ato ditë ndodhej në Gjakovë që të mos kthehej në Beograd, sepse nuk do të mund t’i shpëtonte burgut. Ja si e përshkruan këtë ditë vetë Agim Gjakova: “Kaluan nja tre-katër ditë (nga qëndrimi në Gjakovë – K.M.) dhe një natë po rrinim në kafe “Liria” bashkë me Dushin, Avniun, Qazim Lleshin dhe Abdurrahman Koshin. Abdurrahmani u ngrit të shkonte në postë se i kishte bërë thirrje telefonike Nuri Bashotës në Beograd për të parë nëse kishte goma motori (Abdurrahmani kishte blerë një “Vespa” të përdorur). Kur u kthye, u ul pranë meje tejet i heshtur. Pas një kohe të shkurtër më preku e më tha me zë të ulët: “Çohu të shkojmë”. Ishte aty nga ora nëntë dhe mjaft herët për të shkuar në shtëpi. Nuk ia vura veshin, por ai ngulmoi disa herë. U ktheva kah ai t’i thosha “mjaft ma”, por në vend të fjalëve pashë fytyrën e tij që ishte zverdhur dhe ishte mbuluar nga një hije mërzie shumë të madhe. “Shka ke?”, e pyeta. “Sot mbas dite e kanë arrestuar Ali Aliun! Më tregoi Nuriu.”

Nuk është e vështirë të përfytyrohen thyerjet e të rinjve të asaj kohe që kishin shkuar në Beograd për të studiuar dhe që befasi e shohin veten në kthetrat e policisë. Nuk ka sesi të mos jetë e dhembshme për një të ri kur përballet me murin ideologjik, i cili ia ndrydh stinën më të bukur të jetës. Agim Gjakova do t'i bashkëngjitet Ali Aliut në Burgun Qendror të Beogradit; s'mund të pranonte të ikte në Shqipëri dhe ta linte të pambrojtur shokun e vet. Ikja e tij gjithsesi do ta ngarkonte edhe më shumë Ali Aliun dhe me siguri që nuk do të shpëtonte vetëm me dy muaj burg. Ja edhe një moment në rrëfimet e Agim Gjakovës. "Më liruan në qershor. Kur dola në korridorin nga shkohej te "pisari" (shkruesi) për të m'i kthyer ato sende që na kishin marrë, pashë Aliun para meje. Eca më shpejt dhe iu afrova. Ai ktheu kokën dhe më pa. I ndriti fytyra. Gjeti shokun që të paktën të ndante "kujtimin e vuajtjeve" bashkë. Natyrisht se nuk e dinte se mund të më kishin arrestuar edhe mua. "Nuk të la vetëm, jo!", i thashë dhe morëm sendet e dolëm jashtë. Gjëja e parë ishte të hanim diçka... U futëm në një ëmbëltore të një shqiptari dhe ndenjëm ca pa folë. Heshtja na bënte mirë për gjendjen tonë të dërrmuar. Kishim shumë për t'i thënë njëri-tjetrit dhe e dinim se do të rrinim në të ardhmen..."

Po, ata do të rrinë bashkë edhe më vonë. Ata ende kanë edhe shumë për t'i thënë njëri-tjetrit. Bashkëbisedimin ata të dy e vazhdojnë edhe sot. Mbase nuk rikujtojnë vetëm vitet studentore, por edhe vitet '90 të shekullit të kaluar, kur të dy, disa herë do të shpërngulen herë në njëherë në njëherë në tjetrën "shqipëri", duke shkuar matanë kufirit nga do të kthehen njësoj të dëshpëruar dhe ngandonjëherë edhe të heshtur. Edhe sot mund t'i takosh bashkë në Prishtinë, Tiranë apo Shkup dhe mbase më nuk rikujtojnë vetëm të

kaluarën, por zbërthejnë trishtimin e të sotmes kur shoqëria shqiptare gjithashtu kalon nëpër detin e valëzuar të paqartësive ballkanike. Në heshtje përballen me valët e kohës së pasluftës në Kosovë e Maqedoni, sepse kësaj gjenerate i takoi fati të ndërlidhë zinxhirin e ngjarjeve kolektive të popullit shqiptar që nga vitet e para të pasluftës së Dytë Botërore e deri te Luftërat Ballkanike të fundshekullit të njëzetë. Ata u rritën duke ndier erën e barutit, u shkolluan të përndjekur nga policia jugosllave dhe u përballën me çastet vendimtare të rrënimit të Jugosllavisë. Të gjitha këto shtrëngata kombëtare, Ali Aliu do t'i përballë ashtu si edhe çastet e rënda rinore: duke qëndruar në krye të kolonave, mes atyre që e dinin se u kishte rënë në hise të jenë udhërrëfyes dhe boshti kurrizor i popullit. Andaj do të jetë me studentët e vet gjatë viteve tetëdhjetë, kur do të jehojë zëri i revoltës së studentëve shqiptarë të Kosovës, ai zë që shprehte heshtjen qindravjeçare të gjeneratave të mëparshme, të cilat bënë çmos të mbijetonin e të mos u shuhej vatra familjare. Aliu do t'i përjetojë dhembshëm vitet '80, ditët kur burgjet jugosllave do të mbushen me rininë shqiptare, sepse më mirë se cilido tjetër i njihte metodat policore që përdorte sistemi komunist i Jugosllavisë së atëhershme.

Ali Aliu do t'i vuajë dhembshëm të gjitha ngjarjet tragjike të popullit shqiptar kudo që është, duke filluar nga ato vendimtares në Kosovë e deri te konflikti i armatosur i vitit 2001 në Maqedoni. Asnjëherë nuk do të heshtë, asnjëherë nuk do të qëndrojë anash, gjithmonë do të shprehë mendimin e vet lidhur me ndodhitë. Do t'i vuajë ngjarjet e 1997-ës kur shqiptarët vranë Shqipërinë, shpirtin e tij do e plagosë rëndë viti 1999 i luftës në Kosovë. Të gjitha ngritje-rëniet shqiptare do t'i përjetojë ashtu siç

mund t'i përjetojë ai që një jetë të tërë ia kishte kushtuar afirmimit kulturor dhe kombëtar të shqiptarëve. Ashtu siç i përjeton të gjitha edhe sot kur i vetëm a me ndonjë mik shëtit rreth Vardarit apo ulur në ndonjë kafene lexon shtypin ditor.

Viteve të fundit, Aliu thujse i është dorëzuar zërit të vendlindjes: është kthyer të jetojë në Maqedoni. Por shumëçka nga qenia e tij ka mbetur përgjithmonë në Prishtinë dhe Tiranë. Ai i ngjan një nyje kohore dhe hapësinore ku janë ndërlidhur ngjarjet vendimtare të historisë së re të popullit shqiptar. Në atë nyje ka mbetur i shënuar kalendari i Kosovës, e cila eci rrugës e përgjakur, që nga vitet e pasluftës së Dytë Botërore e deri në fillimshkullin njëzet e një. Në gjurmët jetësore të Aliut ka mbetur i shënuar edhe diagrami i ngjarjeve shoqërore në Shqipëri, pas rënies së diktaturës së Enverit. Në ditarin e tij do të mbeten përshkrimet e viteve gjatë të cilave ka qëndruar në Maqedoni, veçanërisht nga nëntëdhjeta e deri në ditët e sotme.

Mbase edhe shumë pak vetë e dinë se Ali Aliu ka vite që plotëson ditarin e vet. Shënon ngjarjet e ditës, takimet me njerëzit dhe shqetësimet e veta. Ditarin e tij rrallëkush ka mundur ta shfletojë. Faqet e tij janë të stërmbushura me brenga për fatin e popullit, e përplot me dhembje. "Asnjëherë më parë nuk e kam ndier kaq fuqishëm refuzimin ndaj ekranit televiziv (TVM). Më pushton një si frikë dhe neveri kur përputhen akrepat e orës mes 8-ës dhe 12-ës: pa u shqiptuar fjalia e parë, më vjen të shtyp sustën e kuqe. Frikë nga kumti tragjik, neveri nga gjithë ajo paturpësi në mashtrim dhe helm patologjik plot urrejtje ndaj shqiptarëve..." , shkruan Aliu me datë 23 mars 2001, i shqetësuar nga krismat e para që jehuan në fshatin

Tanushë në afërsi të Shkupit. Ai e njeh mirë propagandën antishqiptare, e di se Shkupi ishte dhe mbeti filial politik i Beogradit, vëllai më i dëgjueshëm i Serbisë, andaj edhe në ditarin e vet shpreh frikën se shqiptarët mund të manipulohen nga qarqet policore serbo-maqedonase.

Në ditarin e Ali Aliut ka përsoshkrime të shumë ngjarjeve, të cilat do të zënë vend në historinë më të re të popullit shqiptar. Të ofruara nga pena e tij, ato ngjarje duken të mbështjella nga shqetësimi i njeriut, i cili e harron vetveten kur bëhet fjalë për fatin kolektiv. Harrimtar i tillë i vetvetes, Aliu ishte edhe në vitet e rinisë, i tillë do të mbetet deri në vitet e sotme kur në ditarin e vet i shënon vitet e Maqedonisë së pas-Marrëveshjes së Ohrit, e cila duhej të shënonte kthesë vendimtare për këtë shtet dhe, përfundimisht, shoqërinë shqiptare ta barazonte me atë të etnitetit maqedonas. Duhej, por thuajse ka ndonjë “dreq” që gjithmonë gjërat i kthen mbrapsht! Thuajse vetëm sa t’ua humbë qetësinë atdhetarëve të llojit të Ali Aliut, i cili mund të durojë shumëçka, por jo edhe veprimet e dëmshme për shqiptarët kudo që janë. Dhe kur kjo ndodh, ai nuk hesht. Nuk do të heshtë as në vitin 2006, kur pas zgjedhjeve parlamentare në të cilat Bashkimi Demokratik për Integrim do të fitojë shumicën e votave të shqiptarëve, pjesë e koalicionit qeveritar të udhëhequr nga VMRO-DPMN-ja, do të bëhet Partia Demokratike Shqiptare, me katër deputetë më pak se BDI-ja. Me çka blloku politik antishqiptar i etnitetit maqedonas, do të arrijë të realizojë ëndrrën e vet të kahmoçme: ta largojë nga pushteti partinë e udhëheqësit të dikurshëm të UÇK-së, atë të Ali Ahmetit. Me këtë akt degradues, shqiptarëve të Maqedonisë do t’u merret e drejta më e shenjtë – që vetë të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në institucionet më

të larta shtetërore. Duke mos mundur të heshtë këtë të padrejtë që u bëhet shqiptarëve, Ali Aliu do të reagojë si gjithmonë në raste të ngjashme. Ashtu reagon individ i përgjegjshëm që shumëçka mund ta durojë, por jo edhe atë kur shkelet mbi trupin kolektiv shqiptar. Ai reagon publikisht duke shtruar pyetje konkrete, të cilave askush nuk do t'u përgjigjet, por shumëkush do të mundohet të njoftosë dhe të heshtë këtë atdhetar, i cili kurrë nuk e heshti të vërtetën për veten dhe të tjerët. Pyetjeve që shtroi ai dhe disa miq të tij nuk iu përgjigjën as ata, të cilët që moti kishin shpallur "tradhtarë" dhe të "shitur" të gjithë shqiptarët e Maqedonisë që i kundërviheshin politikës së tyre. Krerët e PDSH-së kurrë nuk treguan se cili ishte ai "qëllim më i lartë kombëtar" që i shtyu të shkelnin votën shqiptare, që i çoi të bëhen pjesë e qeverisë duke shkelur vullnetin e shumicës politike shqiptare. Ata, si dhe gjithë qarqet maqedonase që përkrahnin këtë "të drejtë demokratike" të mandatarit, në njëfarë mënyre arritën të rivendosnin mazhorizimin etnik kundër të cilit u derdh gjak gjatë vitit 2001. Në emër të atij gjaku, nënshkruesit e një letre të hapur - drejtuar opinionit vendor dhe të huaj - në mesin e të cilëve dallohet zëri i Ali Aliut, pyesin: "Nëse partinë që do të shprehë vullnetin e tyre në shumicë në organet më të larta shtetërore do ta votojë populli maqedonas, përfshirë edhe qeverisjen me shtetin, atëherë pse votojnë shqiptarët? Cili është dallimi i qeverisë një-etnike dhe asaj që nuk përfill vullnetin e popullit shqiptar? Vallë nuk do të thotë kjo mundësi që etnia maqedonase - nëpërmjet partisë së vet fituese - të bëjë rivlerësimin dhe korrigjimin e vullnetit politik të shqiptarëve? Cilët vallë përfaqësojnë qeveritarët shqiptarë të zgjedhur nga mandatarët e jo nga shumica e shqiptarëve, dhe cili është

ndryshimi në mes këtij përfaqësimit të shqiptarëve dhe atij të kohës së socializmit kur mjaftonin disa “shqiptarë të ndershëm” që të përmbushej çelësi etnik? Si do të mbrohet vota e lirë e shqiptarëve nga mazhorizimi etnik, nëse mandatarit i mundësohet të përfshijë në koalicionin qeveritar cilëndo parti shqiptare, pa marrë parasysh mbështetjen që ajo ka te shqiptarët? A nuk do të thotë kjo mundësi që gjithmonë – me arsyetim të afërsisë ideologjike të partive – të anashkalohet subjekti më i fortë politik i shqiptarëve? Cili do të ishte interesi më i lartë qytetar dhe kolektiv, cila do të ishte e drejta më e shenjtë për shqiptarët e Maqedonisë, përpos që me votën e vet të lirë të caktojë përfaqësuesit e vet në organet më të larta shtetërore?”

Në vend që t’u përgjigjeshin këtyre pyetjeve, kryesuesit e PDSH-së vazhduan të bënin atë që i bënte të pranueshëm te qarqet antishqiptare – shanin gjithë shqiptarët që nuk përkrahnin veprimin e tyre politik, veprim që shqiptarëve të këtushëm ua rikujtonte kohët e diferencimit të tyre në të “ndershëm” dhe të rrezikshëm për pushtetin. Ndërkohë, Ali Aliu i mbetej besnik vetvetes. Gjatë jetës së vet ai kishte shtruar shumë pyetje, të cilave nuk u ishte përgjigjur askush. Por për fat të tij, nuk i ka lënë pas vetes të papërgjigjura pyetjet që i janë shtruar atij. Andaj ai lirshëm shëtiti brigeve të Vardarit. Ballëllart shikon nga mali që qëndron si rojtar i Shkupit, drejt Vodnos ku tani ngrihet një kryq gjigant dhe të lë përshtypje thuajse është vënë mbi ndonjë varr masiv. Ku ta dish, ndoshta ai kryq dëshmon se në këto hapësira, ende nuk ka përfunduar beteja e dikurshme kundër atyre me përkatësi myslimane dhe kundër simboleve që ortodoksëve ua rikujtojnë këtë fe. E ai kryq u ndërtua në

kohën kur Maqedoninë e qeverisnin VMRO-DPMNE-ja dhe PDSH-ja. Ndërtimin e këtij kryqi e ndihmoi financiarisht qeveria e atëhershme, duke përdorur edhe taksat që paguanin myslimanët. Edhe atë me pëlqimin e qeveritarëve shqiptarë të PDSH-së, me pëlqimin e kryesuesve të kësaj partie, të cilët në vitin 2006 e bojkotojnë “ardhjen” e përmendores së Skënderbeut në Shkup me mospjesëmarrjen e vet në manifestimin madhështor mbarëshqiptar.

Aliu i sotëm që shëtiti buzë Vardarit, nuk është më ai aktivisti i dikurshëm studentor, as gazetari i gazetës “Flaka e vëllazërimit”, por udhëtari që palodhshëm është ngjitur lartësive jetësore, ai që ka ecur nëpër jetë duke e ditur se vitet e jetës rrjedhin njësoj si ujërat e Vardarit. Pa mundur kurrë të kalojnë dy herë mbi të njëjtin gur, pa mundur për së dyti herë të përplasen mbi bregun ku njëherë kanë kaluar. Ato vite jete të Aliut mbetur diku thellë në të kaluarën, herë-herë rikthehen zhurmshëm e derdhen nëpër shtratin e kujtimeve. E kujtimeve nuk mund t’ua rregullosh shtratin ashtu si kanë bërë me atë të Vardarit të sotëm, nga shëtisin të rinj dhe të moshuar, biçikletistë dhe këmbësorë, të vetmuarit dhe ata që s’kanë nevojë për bezdisjen e të tjerëve. Nuk është e mundur që shtratin ku rrjedhin kujtimet ta shtrosh me pllaka, por vetëm me ngjarjet që kanë ndodhur. Dhe ai shtrat nuk i ndan pjesët e jetës në lagje, siç ndodh me Vardarin që ndan Shkupin në dy pjesë: në pjesën shqiptare dhe atë të etnitetit maqedonas. Lumit të kujtimeve nuk i nevojiten as ura, si ato mbi Vardarin, të cilat kanë gjithnjë e më pak kalimtarë. Pa kalimtarë ka mbetur edhe Ura e Gurit, simbol i kryeqendrës së Maqedonisë, fotografinë e të cilës e gjeni në të gjitha panoramat e qytetit, dhe në të gjitha kujtimet

e atyre që kanë vizituar atë. Pas konfliktit të vitit 2001, kur shqiptarët e Maqedonisë morën armët në duar që të realizojnë atë për çka një dekadë të tërë i gënjyen partitë e tyre, Ura e Gurit ka mbetur edhe pa lypsarët e vegjël romë, të cilët dikur kërkonin lëmoshë në shqip e maqedonisht. Pas këtij konflikti ata duhej të përcaktohen: vallë duan lëmoshën shqiptare apo atë të etnitetit maqedonas?! Në bazë të këtij vendimi, të shtegtojnë nga ana veriore apo ajo jugore e Vardarit. Dhe të ëndërrojnë se një ditë urave të Vardarit do t'u kthehen kalimtarët nga ana e Shkupit të Vjetër për të kaluar në pjesën maqedonase të kryeqendrës së Maqedonisë, dhe anasjelltas. E derisa të jetësohet kjo ëndërr e tyre, edhe Maqedonia do të jetë ëndërr e mbetur pezull mbi kufirin që e ndan “të kaluarën e errët” të njëmendësisë së deridjeshme komuniste, me “demokracinë e sotme të ndritshme”, e cila filloi me pyllëzimin e shtetit me kryqe. Më të madhin e ngritën mbi Vodno, kryq që natën shfaqet rreptë i ndriçuar, me qindra llamba elektrike. Mbase që, të gjithëve që ngrenë kokën për nga Vodnoja, t'u bëjë me dije se Maqedonia edhe më tej mbetet një truall ku gërshetohen shumë ëndrra etnike, e ku dominojnë ato dy kolektivitete më të mëdha në numër: e maqedonasve etnikë dhe e shqiptarëve. Dhe si e tillë, sajesa shtetërore e nacional-romantikëve të vonuar, Maqedonia, herë të bëhet e afërt, herë e largët, njëlloj sikur sheh një pikturë mbi të cilën janë gërshetuar imazhe që mbulojnë njëra-tjetrën.

Gërshetimi i ëndrrave etnike për ardhmërinë e Maqedonisë, më i dukshëm u bë pas vitit të konfliktit ushtarak. Të shqiptarët u kthye ndjenja e atij që ka marrë fatin e vet në duar. Të maqedonasit u shfaq ndjenja e të lënduarit, ajo e zotërisë së trembur që ka mbajtur në

pronësi edhe atë që nuk i takon. Atij i është kanosur me forcë ai i cili deri dje nuk ka patur zgjidhje tjetër përpos të nënshtrohet e të heshtë. Këto dy ndjenja të dëmshme për një shtet multietnik, do të jenë shenja njohëse e viteve pas Marrëveshjes së Ohrit.

Kohërat e pasluftës u ngjajnë atyre pas përmytjeve të mëdha, kur avullohet uji, por mbetet balta ngjitëse, nëpër të cilën është e vështirë të ecësh. Paslufta u ngjan pasvërshimeve edhe nga fakti se rrëzohen gjithë urat dhe duhet kohë e përpjekje që të ripërtërihet komunikimi i mëparshëm. Pas vitit 2001, Maqedonia u gjet e zhytur pikërisht në baltën e këtyre postkonflikteve, në lloçin e mosbesimit ndëretnik, në lymën e ndasive etnike e partiake të të gjitha sferave të jetesës, përfshirë edhe ato ku politikës së ditës i është ndaluar hyrja, si kultura, arsimit, shëndetësia... Në Maqedoni, pas Marrëveshjes së Ohrit, u përhap duhma e padurueshme e një shoqërie ku çdo gjë ishte e zhvendosur nga binarët e normales, ku kalbeshin normat minimale të moralit shoqëror, ku ishte varrosur vetëdija se aty ku shteti është projekt i parcializuar partiak dhe etnik, ai mbetet përgjithmonë si mozaik i shëmtuar, i pakompletuar me të gjithë katrorët dhe nuancat që e përbëjnë atë.

Maqedonia e viteve të para të shekullit njëzet e një, u përball me rrezikun të shpërbëhet, sepse shqiptarët më në fund e kuptuan se çdo pushtet njih vetëm forcën, se edhe partitë e tyre, të joshura nga grazhdi i shtetit, shpejt harrojnë premtimet e dhëna. Në vitin 2001, të rinjtë e armatosur shqiptarë u përplasën me institucionet shtetërore, morën pushkët në duar dhe dolën maleve të Maqedonisë, prej nga dërguan betimin se ishin të gatshëm të flijonin rininë e vet, për të mos duruar më manipulimet

politike. Këtë porosi ua përcollën edhe partive shqiptare, që deri atë vit bashkëqeverisnin me ato të etnisë maqedonase duke harruar premtimet e dhëna ditën e parë që uleshin nëpër kabinetet ministrore.

Konfliktin e 2001-shit, Ali Aliu do ta përjetojë si ai që ruan në vetvete thirrjet e shumë gjeneratave. Në krismat që u dëgjuan në fshatin Tanush, në afërsi të Shkupit, ai njohu revoltën shekullore të shqiptarëve të këtushëm, të cilët ndoshta së pari herë në historinë e tyre, bënë diçka për vete pa qenë të nxitur nga kushdo qoftë i jashtëm. Për fat të Maqedonisë, dhe të gjithëve atyre që jetonin në këtë shtet, ky konflikt nuk zgjati shumë dhe përfundoi me Marrëveshjen e Ohrit. Por, edhe shumë vite pas vitit 2001, Maqedonia do të jetojë mes orvatjeve të qarqeve politike të etnitetit maqedonas, që donin çdo gjë ta kthenin aty ku ishte para konfliktit të vitit 2001, dhe atyre që e dinin se ky shtet nuk mund të jetë vetëm si dëshirë e etnisë maqedonase. Këtë konflikt disa do ta vlerësojnë si gabim, të tjerët si e vetmja gjë që u mbeti shqiptarëve ta bëjnë për të realizuar atë që ëndërronin. Mbase asnjë shqiptar i Maqedonisë nuk habitej nga qëndrimi i tillë i elitave të etnitetit maqedonas ndaj luftës së 2001-shit dhe pjesëtarëve të UÇK-së, por të gjithë u habitën kur këtyre qëndrimeve iu bashkëngjiten edhe krerët e PDSH-së, të cilët gjatë zgjedhjeve parlamentare të 2006-ës, thaujse i barazuan qëndrimet e veta me ato të bllokut ekstrem maqedonas: udhëheqësit e UÇK-së i quajtën “vrasës të egër”, duke e kompletuar këtë pohim me thëniet se ata vetë kishin dhënë para të majme “për ta çliruar kalanë e Tetovës nga ushtarët e UÇK-së”.

Të tilla janë kohërat e pasluftës, përplot rrëmujë, të gjithë vrapojnë të kumtojnë diçka, të gjithë duan të

tregohen personazhe të rëndësishëm në ngjarjet vendimtare, të zhvlerësojnë kundërshtarin e mbivlerësojnë vetveten, shtyhen mes veti që t'i kapë objektivi i historisë, ku mbetet i shënuar portreti grupor i fituesve. Ali Aliu ishte dhe mbeti nga ata të rrallët që kurrë nuk i ka përdorur bërrylat. Edhe sot, kur i rikujton këto ngjarje, ai nuk i referohet vetëm kujtesës, por edhe fletëve të ditarit të vet. “Duke u sjellë rrotull televizorit, m’u kujtua poezia e Agim Spahiut: “Ku të shkoj në nëntëmbëdhjetë”, shkruan Ali Aliu në ditarin e tij të ditës 23 mars 2001, duke bërë aluzion në lajmet qendrore përplot me ofendime ndaj shqiptarëve. Ditari i tij në të vërtetë është një nga gjurmët e shumta që mund t’u ndihmojë shkruesve të historisë, një nga burimet e shumta që mbushin lumin e të vërtetave për një popull e një hapësirë. Si të tilla, kujtimet e tij ofrojnë shumëçka për ata që në të ardhmen do të merren me historinë më të re të Ballkanit dhe Maqedonisë. Veçanërisht për historianët që do të shkruajnë historinë e gjithë trojeve shqiptare. Në shënimet e Ali Aliut, pasqyrohet edhe një Maqedoni e çuditshme, shtet të cilin maqedonasit etnikë thuajse e duan vetëm “për inat të shqiptarëve”, kurse këta të fundit “nuk e japin” vetëm që të “plasin maqedonasit”.

Maqedonia e viteve të paskonfliktit të 2001-shit, dëshmon se në Ballkan mund të ekzistojnë edhe shtete të ngritur mbi themelet e diletantizmit politik, që bosht kurrizor kanë pseudointelektualizmin, dhe forcë mbrojtëse aviacionin ushtarak me pilotë të huazuar nga Ukraina. Në këtë sjaesë të çuditshme shtetërore, ku shumica e banorëve janë të sëmurë kronikë nga mbamendja e shkurtër, nuk duhej pritur asgjë më shumë, sesa atë që ndodhi: nga një “luftë e vogël”, siç ishte ajo e

2001-shit, të lindë një histori e dyfishtë dhe “madhore”: historia që do të kremtojnë maqedonasit etnikë, që me shpenzime të shtetit u ngrejné përmendore “mbrojtësve” të tyre (lexo: policëve dhe ushtarëve) dhe historia e shqiptarëve, të cilët me çifteli private përmes këngëve i madhërojnë “çlirimtarët” e tyre (lexo: pjesëtarët e UÇK-së). Edhe gjatë viteve të ardhshme, 2001-in do ta përcjellin dy të vërteta diametralisht të kundërta. Kështu që kapitujt e “lavdishëm” të historisë bashkëkohore të Maqedonisë, kanë dy botime që nuk përputhen me asgjë: atë në gjuhën shqipe ku lavdërohet UÇK-ja, dhe atë në gjuhën maqedonase ku lavdërohet trimëria e maqedonasve etnikë. Diku në mes këtyre të vërtetave, mbetet pezull dhembja e atyre që humbën familjarët, pasiguria për të nesërmen, kriminalizohet shteti me stazhin më të shkurtër të shtetformësisë në Ballkan, por me ambicien afatgjatë të mbetet në hartën e këtij gadishulli. Pra, shtet ku ekzistojnë dy botë dominante paralele: e shqiptarëve etnikë dhe e maqedonasve etnikë. Shtet ku gëlltitet sasi e madhe e politikës ditore dhe ku partizohen edhe çerdhet e fëmijëve, shkollat, spitalet..., e lëre më Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve, e cila pas 2001-shit, filloi të kërkojë dy-tre akademikë shqiptarë, që ngutazi të korrigjonte atë që nuk ishte bërë gjatë pesë dekadave të kaluara: vlera më e rëndësishme që hapte dyert e këtij institucioni, u shfaq thjesht përkatësia etnike dhe partiake! Kjo nismë e re “demokratike” u mundësoi akademikëve të etnitetit maqedonas të shihnin se shqiptarët e Maqedonisë kishin dy akademikë të tyre, anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës: Ali Aliun dhe Eqrem Bashën. Mbase duke u ndier ngushtë nga kjo e vërtetë, në vitin 2005, ASHAM do ta pranojë Ali Aliun si anëtar të saj të jashtëm.

Për shumëçka, Maqedonia ishte dhe mbeti pasqyrë ku shihet fytyra e njëmendtë e Ballkanit shumë-etnik, ku çdo gjë është larg vetëdijes së respektimit të shumëngjyrshmerisë kulturore, gjuhësore dhe religjioze. Që Maqedonia është shtet me institucione të brishta, i ndarë etnikisht dhe larg ëndrrës së vet për stabilitet, më së miri mund të ndihet në kryeqytetin e këtij shteti. Në Shkup, ku as Ura e Gurit nuk është më ajo e rinisë së Ali Aliut, sepse disa rinovues ambiciozë dëshmuar sërish atë që është e mundur vetëm në Ballkan: nga një margaritar arkitektonik, i ruajtur me shekuj si emblemë e Shkupit, të bënin një “më të vjetër dhe më të bukur”. Mirëpo arritën jo urë, por një monstër. Në Shkupin e pas konfliktit të vitit 2001, urat mbi Vardar thuajse nuk shërbenin më për të kaluar lumin: maqedonasit etnikë gjithnjë e më rrallë vizitonin Çarshinë e Vjetër dhe Bit-Pazarin, ku fëmijët shqiptarë shisnin cigare, dhe ku prindërit e tyre ofronin forcën e vet si punëtorë krahu.

Jo veç në të kaluarën, por edhe sot, fatin e Ballkanit e përcaktojnë ata që rrëzojnë ura, ata që lumenjtë i lënë pa ura. Andaj edhe në këto hapësira ndodh që edhe urat të mbeten pa kalimtarë. Urat e mbetura pa kalimtarë, si ajo e Gurit mbi Vardar, mbase e rrëfejnë të vërtetën e kahmoçme për urëndertuesit dhe urërrënuesit. Mund të sillej shembull Ura e Mostarit ndërtuar nga osmanllinjët, urë të cilën ushtarët kroatë pamëshirshëm e rrënuan gjatë luftës disavjeçare në Bosnjë. Të gjithë këto ura, ato që janë rrënuar dhe ato që kanë mbetur pa kalimtarë, e shkruajnë legjendën e njohur që e rrëfejnë gati të gjithë popujt e Ballkanit, e cila flet për vështirësitë që ndërliken me ndërtimin e urave: është legjenda për vëllezërit, të cilëve gjatë natës u rrëzohej gjithçka që e ndërtonin ditën,

derisa flijuan në themelet e urës nusen e bukur të vëllait më të vogël. Legjendat ndonjëherë janë fryt i përpjekjeve të kolektiviteve etnike të stolisen edhe me tipare të ëndërruara, me vlerat që nuk i posedojnë, si në rastin konkret: nëpërmjet kësaj legjende, popujt e Ballkanit, mbase padashur, theksojnë atë që rrallëherë e kanë dëshmuar me vepra - të flijojnë më të bukurën në vetvete për të ndërtuar ura bashkëpunimi mes popujve që jetojnë në këto hapësira.

Ballkani është truall legjendash, dhe Maqedonia për shumëçka mbetet pjesë e “legjendës” ballkanase. Nëse jo për diçka tjetër, pa dyshim për shkak të viteve nëntëdhjetë dhe dekadës së parë të shekullit të njëzetënjë. Gjithçka po shkatërrohej e kalbej në Maqedoni, përveç “fabrikës” të quajtur “marrëdhënie ndëretnike”, e cila mundësonte profit të lartë për politikën ditore, prodhonte politikanë, analistë, kolumnistë e intelektualë, të cilët nuk bënë gjë tjetër përpos ngatërronin lëmshin multietnikë të Maqedonisë, bënë analiza të përditshme të marrëdhënieve shqiptaro-maqedonase. Ndër ta bënë pjesë edhe “atdhetarët” shqiptarë që u përkuleshin tempujve të partive shqiptare në Tetovë. E kur është fjala për partitë, ato kurrë nuk i kanë dashur krijuesit dhe kokat e pavarura. Andaj partitë e shqiptarëve të Maqedonisë, s’do të kenë marrëdhënie të mira as me Ali Aliun. Posaçërisht do t’u pengojë deklarimi i tij i hapur lidhur me rrjedhat shoqërore në Maqedoni.

Jo vetëm aktivistët partiakë në Maqedoni, por edhe ata në Kosovë e Shqipëri, e dinin se Ali Aliu ishte dhe mbeti “aktivist” besnik dhe i denjë i letërsisë kombëtare dhe interesit mbarëshqiptarë. Prandaj më së paku donin ta kenë kundërshtar të vetin. Edhe pse, në të vërtetë, ai

kurrë s'ka qenë dhe kurrë s'ka pasur prirje të jetë kundërshtar pa arsye. Ai mbeti ithtar i besimit të thellë se rruga e ndershmerisë ndaj vetvetes dhe të tjerëve, është e lodhshme dhe e rëndë për ta përshkruar, por e vetmja që mundëson të qëndrosh drejt. Të jetosh kokëllart, edhe atëherë kur shtetet ballkanase me shumëçka u ngjajnë gropave përplot me baltën ngjitëse të pashpresës dhe ku të rinjtë kanë vetëm një ëndërr: të ikin nga aty, e të shkojnë diku, atje ku për afirmimin profesional, parashenja etnike nuk paraqet pengesë e as përparësi. Shtetet e shoqëritë ku ambicia e vetme e të rinjve është sesi ta braktisin vendin e vet, rezultojnë se nuk shqetësohen për të ardhshmen e vet. Këto shoqëri e shtete nuk kanë dot ardhmëri. Prandaj në Maqedoninë e sotme, dita-ditës rritet numri i prindërve që përkrahin regjimin e rreptë të vizave të shteteve perëndimore ndaj qytetarëve të Maqedonisë, sepse e dinë se sikur të mos ekzistonin vizat, Maqedonia për një kohë të shkurtër do të boshatisej dhe aty do të ngelnin vetëm pleqtë dhe të pafuqishmit. Do të shndërrohej në një fshat të braktisur, ku njerëzit vijnë vetëm për të vdekur, ose për të varrosur të afërmit e tyre. Do të ktheheshin vetëm ata që do t'i sillte malli për vendlindjen, që do të dëshironin të shihnin Urën e Gurit, apo liqenin e vendlindjes. Maqedonia gjithnjë e më shumë duket si një copë toke ku janë gërshtuar shumë ëndrra etnike, dhe si e tillë i ngjan një sajese shtetërore themeluar gabimisht nga disa nacionalë-romantikë të vonuar. Maqedonia mbetet ëndërr e largët, e zbehtë, diçka krejt tjetër nga ajo që gjatë tërë jetës e kishte ëndërruar edhe Ali Aliu. E ai e dëshironte si shtet ku shqiptarët do të arrijnë të realizojnë ambiciet e tyre kolektive dhe individuale. Mbase Aliu s'ka mundur të paragjykojë faktin që hapësira ku lindi e mbaroi shkollën

tetëvjeçare e të mesme, sa i përket mërgimit, do të ishte trualli, të cilin shqiptarët pandërprerë do ta braktisin. Mërgimi do të rridhte si lumë që nuk ka të ndalur. Dikur të shtyrë nga varfëria dhe konceptet sllave, teksa sot për shkak të “rrjedhave demokratike”, “fazës së pafund të tranzicionit”, kur të riut shqiptar të Maqedonisë asgjë nuk i vlejné aftësitë e dhuntitë personale, nëse nuk u përkulet tempujve partiakë në Tetovë, nëse s’bëhet shërbëtor i “pronarëve” të partive politike shqiptare, të cilat shesin shumë shqiptari, e prodhojnë vetëm dëshpërim kolektiv. Ndoshta prandaj edhe Ali Aliu i viteve të fundit, e ndien veten si kalorës i vetmuar që nuk gjen prehje as në Prishtinë, as në Tiranë e as në Shkup. Disi çuditshëm ndihet edhe në fshatin e lindjes, i cili që moti ka mbetur i heshtur dhe i shkretë.

IZOIPSET E JETËS

Tërësia jetësore e një njeriu i ngjan një hartë topografike, në të cilën janë shënuar të gjitha rrugëtimet, ngjarjet që kanë përcaktuar jetën, fatet e njerëzve që i kemi dashur e na kanë dashur. Jeta është si një hartë, relievin e së cilës e përbëjnë çastet, ditët, muajt, vitet që kemi lënë pas vetes dhe që ndërlidhin izoipset jetësore. Në të, si në çdo hartë tjetër, ka përplot maja dhe fushëtira, ka lartësi sunduese që ngrihen mbi gjitha pikat e tjera dhe pikërisht sipas tyre vizatohet portreti i individit, përcaktohet emblema përfaqësuese e një jete. Në hartë ka shenja, të cilat nuk bien shumë në sy, si të neglizhuara në ultësirat e jetës, mbetur nën hijen e majave më mbresëlënëse, kuotave më të larta. Si ato gjurmët mbetur në shpirtin e njeriut. Varësisht nga shkalla e zvogëlimit e përdorur për të shënuar në hartë përjetimet e dhembshme a çastet gazmore, ato s'arrijnë dot të rrëmbehen nga syri menjëherë, për shkak të shenjave të tjera mbizotëruese në topografinë jetësore. Prandaj dhe ai që merr përsipër të rrëfejë rrugën jetësore të një njeriu, me shumëçka i ngjan një hartografi. Kujdesshëm, ai duhet të veçojë pikat më të dukshme, pa të cilat harta do të humbte funksionin e vet. Duhet t'i bëjë të dallueshme lartësitë nga ato që s'kanë peshë të veçantë për relievin jetësor, që edhe këto

të fundit aty janë, por nuk ndikojnë në përcaktimin e fushëgropave në shpirt; ato nuk ndryshojnë dot rrjedhën e lumenjve e përraskave që derdhen në detin jetësor, nuk përcaktojnë me asgjë gjarpërimin e rrugicave të ngushta nëpër të cilat ka mbetur edhe ndonjë gjurmë nga shputat e përgjakura të udhëtarit. Hartat jetësore, si ato gjeografiket, mund t'i kenë të shënuara të gjitha vendkalimet që ndërlihdin stinët jetësore, por jo edhe shqetësimet e brendshme, përjetimet që mbeten përgjithmonë në palimpsestin shpirtëror të individit, në atë tis të hollë të shpirtit ku lënë gjurmë të gjitha ato përjetime, që as mund t'ia rrëfesh ndokujt, e as t'ua përcjellësh të tjerëve, por vetëm t'i marrësh me vete në varr.

Kur bëhet qëndisma e fijeve jetësore, duhet kujdesur në të vërtetën se veçu, që ka ndërthurur atë pëlhurë, jo gjithmonë ka punuar ashtu si e paramendojmë ne nga kjo largësi kohore, e as ashtu siç thonë hamendjesitë tona. Kur shqyrtohet endja e pëlhurës jetësore të një njeriu, pikësëpari duhet të rivihet në tejqyrë veçu kohor kur ka ndodhur ngjarja, sepse vetëm ashtu është e mundur të bëhet ndarja e çasteve më të rëndësishme jetësore nga ato që janë thjesht pjesë e kalendarit individual. Nuk ka dyshim se sado kujdesshëm ta qëndisësh pëlhurën jetësore të një njeriu, prapë në të mbeten shenja të padukshme, mbetet në të shumëçka si prapavijë e mbuluar nga ngjarjet që kanë qenë përcaktuese për udhëtimin nëpër jetë. Vërtet që s'ka çaste të pavlerë në jetën e njeriut, por jo të gjithë tik-taket kohorë që i kemi jetuar, mbeten të shënuara në hartën tonë. Njësoj siç nuk ka pikë të parëndësishme mbi rruzullin tokësor, por jo të gjitha janë të shënuara nëpër hartat topografike dhe jo të gjitha janë pika përcaktuese të relievit tokësor. Disa nga peshat që bart mbi vete, nuk

janë të shënuara në hartë, por i peshojnë tokës, njësoj si dhe disa nga përjetimet dhe rrethanat që i kanë nxitur ato, e që mbeten pronë shpirtërore e individit, i cili ato i merr me vete në jetën andej, njësoj si guaska që mban mbyllur margaritarin në të.

Jeta e Ali Aliut është hartë përplot me maja, me izoipse të ngjeshura. Është vështirë ta vizatosh në përpjesëtim të vogël, të mos shënosh rrugëtime të begata të kritikut letrar e atdhetarit. Jeta e Ali Aliut me shumëçka shënon edhe ecjen e shoqërive shqiptare gjatë shekullit të njëzetë dhe në vitet e para të mileniumit të tretë. Shkrimet e tij vlerësuese për veprimtarinë botuese, librat e shumtë të tij me kritika letrare, antologjitë dhe zgjedhjet që ka bërë, janë regjistër i pagabuar i bibliotekës shqiptare. Intervistat, analizat, paraqitjet publike që shprehin zërin e qartë të intelektualit, i cili nuk lë t'i kalojnë ngjarjet shoqërore pa thënë të vërtetën e tij për to, janë pasqyrë ku qartë shihet fytyra kolektive e elitave bashkëkohore shqiptare. Është mëkat që një relief aq i pasur jetësor, i cili ndërlihd shumë ngjarje nga historia më e re shqiptare në të gjitha trevat ku ata jetojnë, të mos përfshijë edhe shtegtimet e tij nëpër “shqipëritë” e shumta, nga edhe mund të shihet qartë se bëhet fjalë për një “bredhacak”, rrugëtimi i të cilit përputhet me ngjitjen e popullit të tij drejt majave të ëndërruara, drejt lartësive nga ka mundur të shohë qartë shenjën e të sotmes e të ardhmes, të tanishmen dhe të nesërmen kolektive të shqiptarëve. Në këtë Ballkan përplot megjull, në Jugosllavinë e Titos e Shqipërinë e Enverit, kjo bredhje nuk ka qenë e lehtë, apo pa rreziqe.

Deri në rënien e koncepteve komuniste shtetërore, këtej dhe matanë kufirit, nuk ka qenë e lehtë të jesh shqiptar as të “shqiptarizosh”. Pra, nuk ka qenë e lehtë të

rritesh si njeri që nderon të huajën, por që gjithmonë mbron veten. S'ka qenë e lehtë të ecësh si njeri që vëren se në hapësirën ballkanase popujt thuajse ekzistojnë për inat të njëri-tjetrit, e jo për të mirën e vetvetes; si njeri, të cilit i pengon të jetojë i gjuhëzuar e i përbuzur dhe të qëndrojë kryelart përballë të gjithë të tjerëve që mbajnë drejt boshtin e vet etnik.

I linduri në Arvat të Prespës, pasi studioi në Beograd, u kthye të punojë në Shkup. Në gazetën "Flaka e vëllazërimit", Ali Aliu do të punojë që nga viti 1959 deri në vitin 1968. Menjëherë pas Vitit të Ri të 1969-ës, apo disa muaj pas demonstratave të Tetovës, Aliu do të shtegtojë në Prishtinë. Do të bëhet banor i kryeqendrës së Krahinës së atëhershme Socialiste të Kosovës, të cilën kryeqendër për herë të parë e kishte vizituar si student, në vitin 1958. Ardhjen e parë në Prishtinë ai e kujton siç kujtohen ndodhitë që të përcaktojnë rrjedhën e mëturjeshe të jetës. Sepse, pas asaj vizite, Aliu nuk do të arrijë kurrë më t'u ikë syve dinakë të policisë jugosllave.

Kryeqendra e Kosovës, qysh në rini Aliut i dhuroi emblemën e njeriut të rrezikshëm për Jugosllavinë e Titos, si dhe dy muaj burg. Kështu mes tij dhe Prishtinës, thuajse u lidh një miqësi që nuk do të ndërpritet kurrë. E miqësitë e këtilla, janë si të lidhura me pranga: të çojnë ose të mallkosh çastin kur je njoftuar, ose përjetë të bekosh rrethanat që kanë mundësuar takimin.

Ali Aliu s'mund të mos e lidhte jetën me Piemontin kulturor të shqiptarëve që jetonin në Jugosllavinë e Titos, me Prishtinën, qoftë edhe thjesht për shkak se ishte përcaktuar t'i përkushtohet letërsisë e të mirës së popullit të vet. E ato vite, Prishtina i ftonte t'i ktheheshin të gjithë fëmijët e shkolluar, të gjithë ata që më vonë do të jenë

shtyllë bartëse e Universitetit të Prishtinës, i cili do të themelohet në vitin 1971 dhe do të bëhet qendra më e rëndësishme arsimore për shqiptarët e Jugosllavisë.

Ali Aliu do të vijë e do të shkojë nga Prishtina, si ai që e di se njeriu mund të ikë nga shumëçka, por jo edhe nga vetvetja. Ai dhe Kosova u bënë të pandashëm, bënë besëlidhjen e heshtur se do të ndanin fatin e përbashkët. Pas kësaj, rrugëve të Prishtinës Aliu do të ecë si matës i largësive deri tek ardhmëria më e mirë që do të mundësonte arsimimin e rinisë shqiptare dhe përparimin e popullit. Që pastaj do të mundësonte edhe një zhvillim të begatë kulturor, flatërimin e lirshëm të vargut të thurur në gjuhën shqipe, dhe hapësirë për gjeneratën e re krijuese që kishte filluar të pushtojë faqet e gazetave dhe periodikut në gjuhën shqipe.

Vendbanimet do t'i ndërrojë shpesh Aliu, por Prishtina do të mbetet ai stacion jetësor nga nisi udhëtimi nëpër rrugët e degëzuara. Në vitet e turbullta të shpërbërjes së Jugosllavisë, do të jetojë herë në Shkup e herë në Tiranë. Jo pse nuk e dinte se më mirë e kishte të jetonte pranë nipërve e të dashurve të vet, por s'e linte të prehej zëri, të cilin e dëgjojnë vetëm të përgjegjshmit ndaj vetvetes, ndaj popullit të vet dhe kalendarit kohor që e jetojnë. Jehona e atij zëri të brendshëm ishte që pandërprerë i rikujtonte se gjyshja Meleke e kishte rritur që të ecte si Njeri. Ajo jehonë, Aliun e mbante larg nga të gjitha pushtetet, nga ai socialist e deri te të mëvonshmit në demokratizimin e shoqërive shqiptare. Përderisa pushtetarët ishin më të qetë kur e kishin më larg vetes, Aliu ndihej shumë mirë nga ajo largësi që i mundësonte të jetojë në paqe me bindjet e tij. Në mos më shumë, të kontribuojë në afirmimin e tërësisë letrare shqiptare, duke bërë vlerësime e duke

kompletuar antologji që sforconin trungun krijues. Pena e kritikut letrar kurrë nuk i përfilli “principatat letrare”, por gjithmonë vlerësonte me peshoret që përcaktojnë verifikim mbarëkombëtar. Si i tillë, Ali Aliu mbeti thujasë i vetmi që vizatoi “hartën etnike” të vlerave letrare shqiptare, njeriu që dy gjëra kurrë nuk i tradhtoi: kritikën letrare dhe idealet e veta atdhetare.

Gjatë veprimtarisë krijuese, ai shkroi dhe botoi mbi njëzet libra nga fusha e mendimit kritik letrar, përpiloi antologji poezish e tregimesh, me çka mbeti vizatuesi më i çmuar e më i saktë i “hartës topografike” të letërsisë shqiptare. Si i tillë, pagabueshëm shënoi vlerat e mirëfillta që janë të pashmangshme kur flitet për vlerat letrare shqiptare. Siç nuk i heshti edhe shkaqet që nxisnin akulturimin e shoqërive shqiptare, moskomunikimin kulturor të shqiptarëve, mosqarkullimin e librit, për muret mentale që shoqërive shqiptare nuk iu ndanë, edhe pas rënies së socializmit.

Ai vinte e shkonte nga kryeqendrat kulturore shqiptare, e pas tij, njësoj si edhe hija e trupit, e ndiqte njeriu më besnik, bashkudhëtari që çdo gjë të vetën e vuri në shërbim të “toskës së vet” – bashkëshortja Merza, një shembëlltyrë e gruas bujare shqiptare. I ndodhte të harronte veten, por kurrë nuk harroi Aliun e saj, i rastiste të harrojë të palosë në valixhe ndonjë teshë të vetën, por kurrë nuk i kishte ndodhur që Aliut t’i mungojë ndjenja se ka pranë burimin e qetësisë së vet. Merza nuk ishte vetëm një bashkëshorte e devotshme që kujdesej për familjen, por edhe ekuilibruesja e saktë e kandarit jetësor që ndiente çdo shqetësim të të shoqit.

Se sa Ali Aliu arriti t’i shembë muret letrare dhe të mos respektojë tendencat që letrat shqipe të ndahen sipas

kufijve shtetërorë ku jetonin e krijonin shqiptarët, më së miri dëshmon e vërteta se qysh në vitet e socializmit u bë kritik i njohur mbarëshqiptar. Të tillë e bëri orvatja e tij që librin shqip të botuar në Tiranë t'ia bëjë të afërt edhe lexuesit nga kjo anë e murit kufitar, dhe anasjelltas. E në dekadat e socializmit, librit në gjuhën shqipe i ishte e ndaluar të kalojë nga njëra “shqipëri” në tjetrën. Ishin ngritur mure të larta, që nuk linin të shohësh ç'ndodh në Tiranë, e ç'hall kanë shqiptarët e Jugosllavisë. Për fat të keq, ai mur nuk do të rrënohet gjithaq lehtë as pas rënies së socializmit, e bile as pas çlirimit të Kosovës nga robëria shekullore serbe. Sepse, edhe pasi filloi komunikimi më i lirë shqiptaro-shqiptar, kishte një mur, të cilin shumica nuk e shihnin, një mur që kishte mbetur në nënvetëdijen e tyre thuajse po aq i lartë, i patejkalueshëm sa ishte edhe në vitet kur shqiptarëve nga kjo anë e kufirit dhe atyre të xhaxhit Enver, njohja e ndërsjellë e vlerave kombëtare, u lejohej në sasi të caktuara nga Komitetet Qendrore këndeje e andej kufirit. Njohjen ua lejonin “kujdesshëm”, që të mos e shijonin vetëdijen e vlerave të përbashkëta, dhe të mos kujtoheshin se i takonin të njëjtës kulturë dhe traditë. Ky mur - i muruar gjatë dekadave të socializmit, por i padukshëm pas rënies së komunizmit - mbeti i lartë dhe i pakalueshëm në vetëdijen shqiptare edhe në vitet e demokratizimit. Si i tillë nuk u lejonte të shohin se “demokracinë” dhe lidhjet ndërkulturore ua ndërtonin “maunokratët” partiakë, se edhe andej dhe këtej kufirit, në sferat e kulturës, çdo gjë funksiononte si në kohët kur nga librat e botuara në Prishtinë, në Shqipëri arrinin thuajse vetëm ato të shkrimtarëve që kishin “licencën” ideologjike.

Për fat të mirë, sa i përket librit, kjo situatë do të ndryshojë në fillimshekullin e njëzetentë. Edhe atë falë botuesve të Shqipërisë, të cilët me kohë e kuptuan se edhe

libri është mall si çdo mall tjetër, dhe arritën të pushtonin edhe tregun në Kosovë, Maqedoni e kudo ku jetonin shqiptarët. Kjo mbeti ëndërr ende e largët për botuesit nga kjo anë e kufirit, mbase edhe nga shkaku se ishin mësuar që programet vjetore të mos i planifikojnë sipas shitjes së librit, por varësisht nga ndihma materiale që u jepte shteti. Apo edhe për shumë arsye të tjera, të cilat kurrë nuk mungojnë të ambalazhojnë cilindo arsyetim, por jo edhe të vërtetën se botuesit nga Maqedonia dhe Kosova mbetën brenda “mureve” mentale të trashëguar nga e kaluara. Botuesit e Tiranës arritën të bëhen mbarëshqiptarë, sa i përket qarkullimit të librit në të gjitha trojet ku jetonin shqiptarët.

Megjithatë, mbase është e kuptueshme që ndërlidhja kulturore, informative e shoqërive shqiptare të mos shkojë aq ngutshëm. Bëhet fjalë për shoqëri që me dekada ishin udhëhequr nga “muratorët” ideologjikë, të cilët as që mundoheshin të fshehin lartësinë e murit dhe qëllimin pse e kishin ngritur atë. Gjatë atyre dekadave edhe Ali Aliu e dinte se cilat kanale duheshin përdorur që t’i arrinte në duar libri më i ri i Petro Markos, Dritëro Agollit, Ismail Kadarese, Fatos Arapit, Xhevahir Spahiut... Më vonë, në vitet e “tranzicionit”, shqiptarët sërish u ballafaquan me disa “muratorë” që muronin ndryshe: ngritën mure me dyer të çuditshëm nëpër të cilat më lehtë mund të kalonte një maunë me cigare pa paguar doganë, sesa një valixhe me librat e Fatos Kongolit në relacionin Tiranë-Shkup, apo ato të Ali Podrimjes në drejtimin Prishtinë-Tiranë. Dhe për çudi, edhe elitat kulturore shqiptare shtireshin se nuk e shihnin atë mur, linin përshtypjen se ishin mësuar me mure, se nuk u pengonte që muri të mbetej i tillë – i lartë dhe i ngjashëm me atë të dikurshmin kur, në mos

më shumë, muratorët kishin aq guxim sa të vinin mbi të mbishkrimin: “Nga ana tjetër nuk ka asgjë tuajën!”.

Duke mos e parë këtë mur, edhe njerëzit e artit dhe kulturës nuk do të reagojnë edhe pas fjalëve të Ali Aliut të thëna nëpër shtypin shqiptar se “barrierat e quajtur kufij shtetërorë që tërhiqen nëpër trupin, mishin e gjallë të hapësirës sonë etnike, janë fatkeqësia jonë më e madhe”. Por, kjo fatkeqësi thuhetse nuk i prekte interesat e njerëzve të kulturës, të cilët vepronin sipas logjikës së politikës ditore. Kështu që edhe artistë e krijuesë, shkrimtarë e aktorë, më madhërisëm e ndienin veten kur i ftonte për darkë ndonjë “bajraktar” partiak nga kjo apo nga ana tjetër e kufirit, sesa kur duhej të mbronin dinjitetin e lëmisë, të cilës i takonin. Pra, njerëzit e artit dhe kulturës, fatin e bashkëpunimit të vet, ua lanë në duar atyre që jetonin sipas bindjes se interesi kombëtar fillon dhe përfundon me marrjen e përqindjes nga maunat që kalonin nga kjo pjesë në pjesën tjetër të shqiptarisë, nga kjo në anën tjetër të “mëmëdheut”, ku njësoj si këtu, edhe atje, zvogëlohej numri i artistëve, e rritej ai i politikanëve, të cilët më vonë do të bëheshin kapitalistët e shoqërive shqiptare, dhe që qysh moti atdhetarinë e kishin ngritur në profesionin më fitimprurës që çuditërisht mundësonte çdo kënd të bëhej e të mbetej pjesë e “elitave të oborrit”. Të asaj gjoja elite që di të përsëritë sloganin e thënë në shekuj: “Mbreti vdiq! Rroftë mbreti!”

“Çfarë bëjmë ne për t’i hequr barrierat e tilla? Pse nuk konsiderohet si çështje me përparësi qarkullimi i lirë i vlerave tona kulturore dhe shpirtërore?” - pyet Ali Aliu publikisht në vitin 1996. Këtë pyetje nuk ua shtron vetëm pushtetarëve, por edhe të gjithë atyre që përbëjnë elitën kulturore të një populli, të cilët në vitet nëntëdhjetë

shtireshin se nuk e shihnin atë mur që ndante artin dhe kulturën shqiptare në aq copë sa ishin kufijtë shtetërorë që ndanin në mes veti këtë popull. E demokracia e viteve nëntëdhjetë, shqiptarët i ndau të jetojnë në gjashtë shtete: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Serbi, Mal të Zi dhe Greqi. Në të gjitha këto shtete shqiptarët kishin udhëheqësit e posaçëm partiakë, me gjasa përfaqësuesit e vet, të cilët gjithnjë premtonin se do ta çonin popullin e vet në Evropën e Bashkuar, se do ta vendosnin popullin shqiptar në vendin e merituar në këtë Ballkan shumetnik e shumëkulturor. Në të vërtetë, poshtërsisht talleshin me popullin e vet: premtonin shkuarje në Evropën e përbashkët dhe komunikim normal në Ballkanin e popujve të armiqësuar, ose ndërkohë, popullin e vet, edhe pse i takonte një kulture, një gjuhe dhe një tradite, e mbanin të mbyllur në “principatat” ku “bajraktarët” vendorë dhe elitat kulturore të “oborreve”, betononin muret e ndasive kulturore.

Ali Aliu shpesh pyeste Tiranën, Prishtinën dhe Shkupin zyrtar, pse nuk qarkullojnë lirshëm vlerat kulturore shqiptare andej dhe nga kjo anë e kufirit. Pyeste pse shtypi nga Tërana e Prishtina nuk vjen në Shkup si ai i Beogradit dhe Sofjes. Por, përgjigjen e heshtnin “muratorët” që muronin demokraci, që në të vërtetë ndërtonin “maunizmin” interballkanik, i cili mundësonte qarkullim të lirshëm e pa doganë për mallra të ndryshëm, përpos për vlerat kulturore që mbeteshin të komunikojnë si në kohët kur “kishat” ideologjike përcaktonin edhe standardet estetike. Këta “muratorë” që premtonin se do ta çonin popullin atje ku realizoheshin ëndrrat, e përbuznin shqiptarinë njësoj si ideologët e deridjeshëm. Andaj edhe njerëzit e kulturës i mbanin për shërbëtorë të

dëgjueshëm, dhe as që mendonin t'i përgjigjen pyetjes: si do ta përfaqësonte vetveten kultura e copëtuar shqiptare në Evropën e shteteve pa kufij? Dhe, me çfarë kjo shqiptari do të hynte në atë bashkësi ekonomish dhe vlerash kulturore.

Edhe pas rënies së përmendoreve të Enverit, Leninit e Stalinit në Tiranë, edhe pas heqjes së fotografive të Titos nga vendet publike në shtetet e formuara pas zhbërjes së Jugosllavisë së dikurshme, në vetëdijen e shqiptarëve thuajse mbeti hiya e murit disadekadash që i ndau dhe i bëri të jenë të një gjuhe dhe të një kulture, por me probleme në komunikim. Mbeti një mur që ndante vlerat shqiptare kulturore në ato të “mirëfilltat” - të Shqipërisë, dhe në ato të kësaj ane të kufirit që nuk i përfillte Tirana arrogante. Këtë ndarje nuk e bënë vetëm “maunokratët” politikë që Shqipërinë me det e lanë pa peshkim dhe Kosovën me plot qymyr e lanë pa rrymë elektrike. Në betonimin e këtij muri kontribuan edhe ata që s’mund të krijojnë pa qenë nën hijen e “oborreve” partiakë dhe që “atdhetarinë” e kishin “mall” që herë e shisnin matanë murit, e herë këtej – varësisht ku e “hante” tregu. Ndërkohë, askush nuk e vërente se muri i mbetur në vetëdijen shqiptare, nuk e largonte popullin vetëm nga verifikimi i vlerave mbarëkombëtare, por e bënte më të largët edhe nga të tjerët.

Edhe pasi në Tiranë u shtuan shtëpitë private botuese dhe filluan të hapen panairë të librit thuajse në çdo qytet shqiptar andej e nga kjo anë e kufirit, mbeti në vetëdijen shqiptare një mur që ndante kulturën e këtij populli. Në këtë mur nuk kishte të shkruar asnjë parullë politike, por në të qëndronte portreti i një vetëdijeje provinciale, që kurrsesi nuk e kuptonte se nga ky rruzull tokësor ishin

zhdukur popuj e etni, mirëpo asnjëherë për shkak të mungesës së politikanëve, por vetëm atëherë kur kishin përbuzur kulturën dhe vlerat e veta. Mbase ky mur do të mbetet i tillë derisa shqiptarët nuk do të kuptojnë se nga pikëpamja e organizimit politik dhe shtetëror, Shqipëria mund ta pranojë e ta ndiejë Kosovën si “shtet tjetër”, e shqiptarët e Maqedonisë si qytetarë që të drejtat arrijnë t’i realizojnë në shtetin me të cilin Tirana zyrtare ka “marrëdhënie të mira fqinjësore”, por kjo logjikë nuk mund të vlejë edhe për tërësinë kulturore të popullit shqiptar.

Prandaj dhe, baras me mbushjen e gropave nëpër rrugët që ndërlidhin shqiptarët këtej e andej kufirit, duheshin mbushur edhe gropat e mendësisë, e cila nuk guxon t’u shprehë mosbesim “muratorëve”. Ali Aliu ishte një nga mbushësit e palodhshëm të gropave të këtilla mentale. Ai e dinte se vitet e socializmit ishin vitet e zërave të ngulfatur, ndërsa ato të paskomunizmit, vitet e zhurmës marramendëse kur çdo lagje kultivonte vlerat e veta letrare, prandaj bënte çmos që të mos ngulfatet zëri që rrëfente të vërtetën. Ai zë, shpeshherë i vetmuar, kishte jehonën e brengës se politika ditore është gllabëruese, se ajo përpos që harxhon të ardhmen e popullit bëhet edhe varrtare e shumë gjeneratave të reja krijuese. Si i tillë, shtatëdhjetëvjetorin e lindjes së vet në vitin 2004, do ta presë me dhjetëra tituj librash me kritika dhe studime letrare, me mijëra njësi bibliografike të botuara nëpër gazetatat dhe periodikun shqiptar. Në sallën mbushur përplot të Qendrës Teatrore për Fëmijë, ku u shënuar përvjetori i lindjes së Aliut, qëndronte ulur bashkëshortja e tij, e cila njësoj sa edhe bashkëshorti i saj, i ndiente madhërishtë sukseset e tij. Në çastet kur të tjerët flisnin

për Aliun mbase mungonte vetëm rrëfimi i Merzës, rrëfimi për një rrugëtim jetësor përplot me shqetësimet dhe hidhërimet, por gjithmonë duke ndjekur drejtimin e një vatre të ngrohtë familjare. Merza mbeti njeriu që më së miri e njihite hartën jetësore të Aliut. Ajo kishte ecur nëpër shtigjet e jetës duke i qëndruar pranë, duke ia dhuruar atij gjithçka i duhej. Mbi të gjitha qetësinë në gjirin familjar.

Gjatë socializmit, si edhe në vitet e demokracisë, Aliu e dinte se ditët më të ndritshme të artit kanë qenë dhe do të mbeten ato të kohëve kur ahengjet mbretërore nuk janë vlerësuar nga madhësia e pjatave të mbushura me haje ekzotike, por sipas numrit të poetëve që kanë nderuar me pjesëmarrje oborret mbretërore. Jo çdo poet i ka shkuar në darkë cilëndo koke të stolisur me kurorë, jo çdo aheng ka merituar të jetë i denjë për poetët. Pra, ka pasur kohë kur poetët kanë pranuar ftesën e oborrit, të ulen pranë tryezave në krye të të cilave janë shtruar kokat e kurorëzuara, me çka është rritur shkëlqimi i fronit dhe njëkohësisht është madhëruar diadema e artit. Këto kohë, kur edhe mbretërit joartdashës e kanë ditur se perandoria e tyre nuk vlen gjë pa mbretërinë e artit, kanë lënë të shënuara edhe ngjarje kur ahengjet e oborrit janë përfolur. Jo pse sunduesi ka bërë të njohur ndonjë nga të dashurat e radhës, por pse poeti nuk është përkulur të përshëndesë madhërinë mbretërore kur ka kaluar pranë tij. E këtë poeti nuk e ka bërë që të përbuzë mbretin, por që të dëshmojë se artit nuk i shkon për shtat gjunjëzimi. Apo vetëm sa të tregojë se ahengjet mbretërore nga ato shpirtërore që ofron arti, nuk dallohen vetëm nga përmbajtja dhe mënyra e shtruarjes e stolisjes, por mbi të gjitha i veçon e vërteta se mbeturinat e darkave mbretërore i kanë ngrenë qentë e

oborrit, ndërsa mbeturinat e sofrës së artit janë bërë ushqim shpirtëror për oborrtarët e mbretit.

Kohë nga më të ndryshmet, Aliu i kishte shtjelluar mirë në shkrimet e veta, qysh në vitet studentore. Ka pasur kohë që mbahen mend nëpërmjet shenjës stolisëse të vulosur në mburojat prej ari të mbretërive, mirëpo nuk ka mburojë mbretërore që s'ka dashur të mbetet e përmendur në vargjet e poetit. Dhe, meqenëse ka pasur mbretër që nuk kanë merituar vargjet e poetit, si dhe poetë që nuk e kanë merituar diademën e artit, është krijuar një baraspeshë e natyrshme: mbretër që kanë ditur se ahengjet do t'u mbeten pa prezencën e poetëve të mirëfilltë, kanë hapur portat për krijuesit, të cilëve nuk u ka takuar sofrat shpirtërore e artit. Kështu pra, perandorët kanë pasur "poetët e oborrit", ndërsa krijuesve të mirëfilltë u është mundësuar të ruajnë rendin e duhur pranë sofrës së tyre letrare. Apo që mbretit t'i mbetet ajo që i takon mbretërisë, ndërsa krijuesit ajo që i takon letërsisë: të parëve shkëlqimi që vuan për vargjet e poetit, të dytëve ndjenja se darkat e mbretit majmin trupin, por dobësojnë shpirtin.

Ka pasur kohë kur s'ka qenë turp për poetin të shkojë në darkë te mbreti, siç ka pasur edhe kohë të atilla kur oborri e ka ditur se poeti nuk do ta pranojë ftesën për darkë. Jo një herë ka ndodhur që mbreti të mburret me pjesëmarrjen e poetëve në darkën e tij, por thuajse asnjëherë nuk ka ndodhur që poetët të mburren pse i ka gostitur mbreti. Jo pse poetët nuk dinë të hanë e të pinë, por për shkak se mbretërit në darkë nuk të thirrën as që të ngihesh, as që të dehesh, por vetëm sa të ta matin grykësinë dhe të të shohin të përkulur. Duke e ditur këtë, poetët u janë larguar darkave mbretërore dhe kanë preferuar të ushqehen në "kafenetë ku ha e pi populli", aty ku çdonjëri

shikon pjatën e vet, dhe nginj barkun që ka. Ka pasur kohë që portretizuan relacionet mbret-shkrimtar, por edhe atëherë kur perandorët kanë sunduar e shkrimtarët kanë krijuar, njësoj edhe në kohët e demokratizmit të shoqërive shqiptare kur demokratët “maunokratizonin” e shkrimtarët “onanonin”, nuk ka pasur dilema se cila sofër i takon secilit.

Ka pasur edhe më parë kohë të ngjashme me ato të viteve nëntëdhjetë dhe të fillimshkullit të njëzetënjë, me përplot mbretër që shtrojnë darka dhe me shkrimtarë të panumërt të uritur. Siç ka pasur përplot krijues që me plot bindje i janë vënë në shërbim oborrit mbretëror duke menduar se perandorisë i duhet ndihmuar të ruajë forcën, me çka artit i ndihmohet të ruajë freskinë. Mirëpo, edhe atëherë kur shkrimtari vullnetarisht i ka shërbyer oborrit, si edhe me vonë kur oborri ka pasur “poetët e vet”, asnjëherë nuk ka ndodhur që perandori të përcaktojë vlerat e mirëfillta artistike, e as poeti të ndikojë se si do të rreshtohen kalorësit e mbretit. Sepse, edhe atëherë, si në të gjitha kohët e tjera, është ditur se kur kanë rënë mbretërit - ka mbetur arti, e kur është përbuzur arti - kanë humbur shkëlqimin kurorat mbretërore. Me çka është bërë besëlidhja e madhe mes shkrimtarëve dhe perandorëve: me mbeturinat e ahengjeve mbretërore të majmen qentë e oborrit, e me mbeturinat e krijuesve të kompletohen radhët e “krijuesve të oborrit”. Kështu mbretërit i janë shmangur rrezikut që ahengjet të kalojnë pa prezencën e poetëve, ndërsa shkrimtarit të mirëfilltë i është mundësuar të mos vijë në një darkë të pasur që t'i përkulet mbretit.

Ka pasur kohë kur mbretërit kanë ditur si mbahet në kokë kurora e sunduesit, e krijuesit, kanë ditur si ruhet

nderi i penës. Por, jo gjithnjë ka pasur aq “maunokratë” sa në vitet e demokratizimit të shoqërive shqiptare, në vitet kur u shtua numri i “principatave kulturore” shqiptare, me plot poetë që pretendonin të ndodhë e pamundura: të nginjen në darkat mbretërore, e të mbeten edhe zotërues të sofrave shpirtërore të krijimtarisë. Duhet thënë: ka kohë kur penës krijuese i bashkëngjitet edhe lapsi i angazhimit në proceset shoqërore, por vetëm nëse ngjyra e angazhimit politik nuk njollos sofrën shpirtërore të krijimtarisë. Pra, nuk është degraduese për shkrimtarin angazhimi në rrjedhat shoqërore, por është përbuzëse nëse krijimtaria bëhet dekor mbulues i intrigave politike. Ajo që ndodhte në vitet nëntëdhjetë me shumicën e krijuesve shqiptarë, nuk kishte të bënte me angazhimin dinjitoz të një elite, e cila – si edhe i tërë populli – përballej me vështirësitë e mbijetimit dhe kthesave të mëdha, por ishte pasqyrim i mjerueshëm i një kohe kur krijuesi flinte në shtratin e letërsisë, teksa ëndërronte të bëhet i besueshmi i “oborrit”. Kuptohet, në ato vite, si asnjëherë më parë, krijuesi ishte i përballur edhe me dilemën se vallë duhej të mbetej thjesht regjistrues i ngjarjeve, apo edhe kontribues që do të ndihmojë popullin që sa më shpejt të dilte nga balta e “maunizmit”, që ndokush e quante demokraci.

Këto dilema, Ali Aliu nuk i kishte, prandaj i qëndroi besnik sofrës krijuese dhe “odës së burrave”, ku fjala e thënë matej me peshoret e ndershmërisë krijuese. Si i tillë, arriti të ruajë pastërtinë krijuese në vetvete dhe ndershmërinë atdhetare. Si i tillë, kurrë nuk harroi penën e mprehtë të kritikut letrar, dhe gjithmonë ishte në radhët e para kur duhej flijuar shumëçka për të mirën kolektive.

Ali Aliu e dinte se ka kohë kur duhet edhe krijuesit të bëhen pjesë e lokomotivës që çon përpara në përparimin

e një rendi të ri shoqëror, prandaj edhe nuk do të pranojë rolin e vëzhguesit pasiv gjatë ngjarjeve të mëvonshme kulturore dhe shoqërore që ndodhën në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni. Por, ai e dinte edhe ku duhej vënë kufiri që ndan angazhimin politik nga punëtoria krijuese. Edhe pse është rëndë që njëkohësisht të bartësh peshën e angazhimit konkret politik dhe freskinë e punës individuale krijuese, nuk është e pamundur të mbrosh diademën krijuese nga njoilat që nuk shlyhen, nga ato të ndotura nga “yndyra” e intrigave politike. Por kjo është e mundur vetëm në mjedise ku ka kulturë politike dhe ku dihet se kur dëgjohet fjala e “sharrëxhiut” dhe kur e “pulaxhiut”. Meqenëse në vitet nëntëdhjetë dhe në ato të fillimit të mileniumit të tretë, shoqëritë shqiptare ishin të trullësuar nga zhurma e udhëheqësve partiakë, zhurmë, e cila krijonte iluzionin se edhe demoni edhe bardi, edhe i pafytyri edhe bujari, edhe “maunokrati” edhe demokrati, jetojnë në të njëjtën “lagje”, u bë thuajse e pamundur që krijuesi i mirëfillt të jepte kontributin e vet qoftë edhe në sferat që i njeh dhe që kanë të bëjnë me hapësirën që i takon atij, kulturën. Prandaj dhe ndodhte që ministra të Kulturës të bëhen “sharrëxhinjtë”, teksa drejtorë institucionesh kulturore “pulaxhinjtë”. Askush s’e dinte ku qëndron faji: vallë te “maunokratët” që shpejt kuptuan se njerëzit e artit ngandonjëherë sillen si zonjat aristokrate që edhe duan të gjithë t’i përkëdhelin, por edhe të mos u prishen flokët e krehura mirë. Pra, rrijnë në kafene, recitojnë vargje e shajnë “maunokratët”, të cilët e kishin për osh të besonin se edhe artistëve shqiptarë - njësoj si edhe udhëheqësve partiakë – u pëlqejnë ndasitë në “principata kulturore”, ku çdo Princ kishte krijuesit e “oborrit” dhe çdo poet mbretërit që e ftonin në darkë. Me çka u dëshmuua se

krijuesi shqiptar ende nuk e kishte kuptuar se koha pas rënies së komunizmit ishte kohë kur për kulturën vendosin të pakulturuarit dhe për politikën kapitalistët e nesërm më të mëdhenj, pikërisht nga të cilët do të varej afirmimi i vlerave kulturore. Prandaj, ai që kishte kuptuar këtë, s'kishte pse të shtrojë pyetjen a duhet apo jo krijuesi të angazhohet në rrjedhat shoqërore shqiptare, por të kërkojë nga artistët të mos lejojnë që fatin e artit ta përcaktojnë ata që, nga vlerat që kishte bota kulturore shqiptare, të çmonin vetëm monedhat e gjelbra vetëm për vete. Pra, angazhimi politik i krijuesve kurrë s'ka qenë i dëmshëm, nëse njeriu i artit di të mbajë mbi shpinë peshën e kohës së vet ashtu siç mban mbreti kurorën. Angazhim politik po, ama vetëm nëse krijuesi e ndien madhështinë e diademës së artit që bart, sepse kjo ndjenjë nuk i lejon t'ua kenë zili kurorën "maunokratëve" që ngutshëm mbushnin xhepat, teksa vihej re se thuajse kurrë nuk ishin shtruar aq shumë darka mbretërore, sa në vitet nëntëdhjetë të shekullit të njëzetë. Kurrë s'kishte pasur poetë të uritur, sa në vitet kur shqiptarët hoqën qafe ideologjinë komuniste.

Edhe në ato vite kishte njerëz të artit që ecnin kryelart në jetë. Nga ata që arrinin të shihnin kufirin midis angazhimit shoqëror dhe aktit krijues. Njëri ndër ta ishte edhe Ali Aliu. Jetëshkrimi i tij është përplot me bredhje të begata nëpër kryeqendrat ku jetojnë shqiptarët. I pranishëm kudo ku njerëzit kishin nevojë për kontributin e tij, kurrë nuk harroi se ishte "shtetas" i letërsisë botërore dhe i asaj shqiptare, nga Rilindja e deri në fillimshekullin e njëzetënjë.

Me ardhjen në Prishtinë dhe punësimin e tij si redaktor i prozës në Shtëpinë Botuese "Rilindja", përfundimisht

gjen vendin që më së shumti dëshironte: tërëçka t'ia përkushtojë librit. Në vitin 1969, Prishtina nuk ishte kjo që shihet sot kur lëshohesh nga Çagllavica (vendbanim në hyrje të kryeqendrës së Kosovës) për t'iu bashkëngjitur lumit të makinave që qarkullojnë në qendrën administrative e kulturore të Kosovës. Në vitet gjashtëdhjetë, Prishtina ishte qytezë e vogël, me ëndërrimtarë të mëdhenj. Nuk kishte kaq banorë sa sot, s'e kishte Pallatin e Shtypit "Rilindja", hyrjen e të cilës, pas luftës, e mbuloi kullosa sepse mbeti e zbrazur. Pallatin që dikur ishte fole ku çelnin ëndrrat krijuese të shqiptarëve të Jugosllavisë, godinë që është ngritur në afërsi të ndërtesës së vogël ku Ali Aliu kishte punuar si redaktor pas braktisjes së Shkupit.

Kur vjen njeriu në Prishtinën e pasluftës, që me asgjë nuk i ngjan asaj të viteve kur rioshët letrarë të Maqedonisë e kishin si nënë të kujdesshme që u jepte forcë dhe kurajë të mos tradhtojnë ëndrrat krijuese, s'mund të mos kujtojë se as atmosfera krijuese, e as vetë Kosova, ende nuk është ajo që shumë gjenerata ëndërruan të jetë. Pallati i dikurshëm i shtypit ka vetëm katet e njëjta, por askush atje nuk pret e përcjell krijuesit e rinj si deri në vitet tetëdhjetë. Barku i nginjur i Prishtinës së pasluftës, më shumë të rikujton të rinjtë shqiptarë degdisur kryeqendrave të botës, mençurinë e atyre që braktisën këto hapësira si të panevojshëm dhe të tepërt, hijen e pikëllimit në fytyrat e tyre teksa presin të shtegtojnë sa më larg vendlindjes. Hije kjo e lëshuar mbi foletë e braktisura rinore, ku kanë mbetur veç pendlat e ëndrrave dhe vezët e paçelura të ambicieve rinore. Prishtina e pasluftës, si edhe e tërë Kosova, e populluar nga mijëra të huaj si ushtrues të protektoratit ndërkombëtar, i ngjan një

internati ku të huajt duan të qëndrojnë sa më gjatë që të mos i humbin pagat e majme mujore, ndërsa të rinjtë vendas duan ta braktisin sa më shpejt këtë gropë ngulfatëse që nuk të ofron mundësi të sigurosh bukën e gojës. E zënë në kthetrat e varfërisë thuajse të përgjithshme, e joshur nga jeta e begatë e të huajve që ushqehen mirë në restorantet e saj, Prishtina e fillimshekullit të njëzetënjë, i ngjan syprinës së valëzuar ku pasqyrohen edhe ëndrrat e gjeneratës së Ali Aliut dhe atyre të pasluftës. Edhe vetë lagjet e qytetit, duken si një rrëfim, ndërthurur nga e kaluara dhe e sotmja e Kosovës. Vendbanimi Dragodan, ku ka shtëpinë familjare Ali Aliu, e nga ku Prishtina shihet si në pëllëmbë të dorës, është kurorë godinash të bukura të elitës kosovare, e cila u shfaq në vitet '70, kur Jugosllavia e Titos thua kishte vendosur të bëjë disa korrigjime për të drejtat e popullit shqiptar. Ishte dekada kur Prishtina u bë kryeqendër universitare e shqiptarëve të Jugosllavisë, dekadë të cilën disa e quajnë si më të dëmshmen për shqiptarët nga kjo anë e kufirit, duke mbështetur pohimin e vet në faktin se ky dhjetëvjetësh e bëri të padukshme rrjetën e merimangës që Serbia thurte rreth Kosovës. Sido që të jetë, vitet shtatëdhjetë, Prishtinën e bënë kryeqendër të kulturës shqiptare dhe për shumëçka, fole të veprimtarisë botuese të tërësisë letrare shqiptare.

Ardhja në Prishtinë, shpejt do ta rreshtojë Ali Aliun mes kritikëve të njohur letrarë. Mbase asokohe s'ka mundur të parashikojë ecjen e vet të mëtutjeshme, as atë të Kosovës. Por, vendosmërinë t'i përkushtohet kritikës letrare do ta shprehë qartë në recensionet botuar në të përditshmen "Rilindja" dhe në periodikun shqiptar. Në vitet e ardhshme mendimi i tij kritik do të bëhet letërnjoftim i letrave shqiptare. Ndërsa Prishtina e Kosova

do të bëhen hapësirë, të cilën gjithnjë e më shumë do ta braktisin ata që ende nuk i kujton historia, por që e shkruajnë atë – gjeneratat e reja, gjë që edhe një herë do të dëshmojë se ka një histori që e shkruajnë historianët dhe e lexojnë nxënësit, por ka edhe një histori që ecën pranë nesh, e nuk e lexon askush përpos atyre që e përjetojnë me jetë-vuajtjen e vet. Ka një histori të ndarë në kaptina të sakta, që shkruajnë fituesit, por edhe një histori që mbetet jashtë kapitujve, e të cilën e lexojnë humbësit. E lexojnë të ngjashmit me një krijues të ri nga Kosova, fjalët e të cilit mbetën të shënuara në fletoren gazetareske: “I rëndë, më është malli për vendlindjen dhe dëshpërimi pse i varrosa ambiciet krijuese, por më i rëndë më është bërë gjumi në të cilin kurrsesi nuk mund të depërtojnë ëndrrat e mia të dikurshme!” Fjalët e atij që nuk kishte kujt t’ia dhuronte fletoren e vet të mbushur përplot vargje, prandaj ia dorëzoi të parit bashkëkombës që takoi, duke mos dashur që fletorja e tij të bëhet fole dhe varr i vargjeve që kishte shkruar. Poeti i ri i kishte treguar gazetarit pse nuk donte t’i ruajë ato vargje, dënese shpirtërore, që rrëfenin për ëndrrat e vyshkura rinore: “Nuk dua t’i ruaj, se më rikujtojnë farën e mykur të gjyshit që nuk arriti ta mbjellë në pranverën kur digjej Kosova!” E në shumë vargje të poetëve kosovarë të fillimshekullit të njëzetënjë, ishin ngatërruar ëndrrat rinore, vetmia, shpresat e davaritura, iluzionet e bëra gërmadhë si edhe nyja e së vërtetës se dikush ua kishte harxhuar ardhmërinë. Por, në ato vargje askund nuk kishte akuzë apo fajësim: kishte vetëm hutesë dhe një kumt të rëndë sa vetë pesha e paperspektivës së rinisë shqiptare në të gjitha “shqipëritë” që ndërtonin udhëheqësit shqiptarë. Vargjet e gjeneratave të reja vizatonin hartat shpirtërore të rinisë të pasluftërave në Kosovë e

Maqedoni, të gjeneratave të çliruar nga të huajt, por jo edhe nga vetvetja, gjeneratave që ishin portret i prindërve, të cilët mbase gabimisht ua kishin shpjeguar lirinë: nuk u kishin treguar me kohë se rruga që shpie drejt lirisë dhe demokracisë së mirëfilltë, duhej të kalonte në lagjen e “maunokracisë” dhe akulturimit të shoqërive shqiptare!

S’ka dyshim se gjenerata e Ali Aliut, si dhe të mëvonshmet, nuk kishin bërë ndonjë gabim që t’i pengonte të ecnin kryelart nëpër lagjet e Prishtinës. Por duket se nga ngutja që Kosova sa më shpejt të shpëtojë nga kthetrat serbe, shumëkush kishte ngatërruar ëndrrat dhe rrugët. Nga tymi i mauneve, shumëkush nuk e kishte parë me kohë se “liria” dhe demokracia e Kosovës, kishin rënë në duart e “shkërdhatokratëve” të cilët e lanë rininë kosovare në udhëkryqet pa semaforë. Për shkak të llafazanërisë demokratike, nuk dëgjohej zëri i të ndërgjegjshmëve e të përgjegjshmëve përpara vetes dhe historisë, si Ali Aliu, i cili çdokund ngrinte zërin kundër ndërtimit të shumë “shqipërive” ku vdisnin ëndrrat rinore, ëndrrat e etura për fjalët që mund t’u besohet, ëndrra si të dala nga vargjet e mikut të dashur të Aliut dhe poetit të madh kosovar, Azem Shkrelit, i cili deri në vdekje lotoi vargje për Kosovën: M’i kthe të pathënat/ T’i mbulojë me plisa me barë/ Mbase do lulojnë/ Fjalët që u zihet besë... (A. Shkreli, nga poezia “Pas heshtjes” – K.M.). Të gjitha këto lotvargje, para se t’i botonte, Shkreli ia jepte t’i lexojë mikut të tij të dashur, kritikut meritor, Ali Aliut.

Kosova e fillimshkullit të njëzetënjë, me shumëçka i ngjante të lodhurit nga pritja. E lodhur nga pritja të bëhej shtet i pavarur. Kjo pritje e lodhte edhe Ali Aliun, i cili edhe kur ecte atje diku larg Prishtinës, shpirtin e kishte në Kosovë, edhe kur bënte gjumë matanë maleve,

mëkonte ëndrrën kosovare. Mbase shpesh do të ketë ëndërruar edhe oborrin ku kishte lozur fëmijë, sepse vjen një moshë kur njeriu, ngado që të shkojë, ecën drejt lumit të kujtimeve fëmijërore, bëhet trup, të cilit, ngado që të shëtit, shpirti i mbetet atje ku ka shijuar gllënjkat e para të ajrit të kësaj jete. Aliun e kishin shkundur gjithë gropat e ndodhive tragjike të popullit që i takonte, si edhe rrugët e ngushta të të gjitha “shqipërive”.

Mbase më kot Ali Aliu mundohej t’ia shpjegonte vetes përse në Kosovën e lirë e demokratike të fillimshekullit të njëzetënjë askush nuk kujdesej për krijuesit e rinj, pse në “shqipëritë”, të cilat tërë jetën ai i ëndërroi ndryshe, më me ndikim dhe më mirë bashkëpunonin mes veti organizatat e “gjahtarëve” shqiptarë, sesa ato të krijuesve letrarë. Në Prishtinën e fillimshekullit njëzet e një, Aliut i mungonin shumë njerëz të dashur me të cilët dikur kishte pirë kafënë e mëngjesit, kishte ndarë ëndrrat rinore, ambiciet profesionale dhe atdhetare. Shpesh e kaplonte heshtja dhe ndjenja e vetmisë. I mbruhej kjo ndjenjë se kryeqendra e protektoratit që bërë e zhurmshme, ishin shtuar britmat publike që shpjegonin sa “shqipëri” do të mjaftonin që të plotësoheshin dëshirat e të gjithë kryesuesve të partive politike, të cilët donin të kenë secili shtet të vetin ku të bëhen kryetarë! Në atë llafazanëri mediale, nuk mungonte as zhurma e atyre, të cilët donin aq gjuhë letrare dhe identitete kulturore të shqiptarëve, sa ishte edhe numri i grupeve të parazitëve që përfitonin nga gjendja e mjerueshme materiale e popullit të vet.

Në një Prishtinë të tillë, të zhurmshme e shumëzë-rëshe, mbyteshin pëshpëritjet e të rinjve, të cilët mbase dhembshëm pajtoheshin me fatin se edhe më tej – njësoj si dikur – ardhmëri mund t’u ofronte vetëm nëna parti: e

vetmja që mund t'i furnizonte me “certifikatën” që hapte dyert e të nesërme së ndritshme – libreza partiake. Gjithnjë e më të rrallë bëheshin muruesit e parajsës në këtë botë, ata që u shtrinin të rinjve dorën në nevojë. Prishtina e dekadës së parë të shekullit njëzet e një, si gjithë kryeqendrat e tjera shqiptare, i ngjante lulishtes pa rojtarë, ku vinin të huajt dhe zgjidhnin për vete ajkën rinore. Dukej sikur Kosova do të mbetej vetëm me “ujqit” e vjetër, që ngutshëm ndërtonin strofullat e veta në malin shumëpartiak, si për të bërë të dukshëm dallimin mes monizmit të egër dhe “maunizmit” të pashpirt. Me çka, u harruan idealet e gjeneratave që flijuan çdo gjë që brezat e rinj të mos përjetojnë burgjet, varfërinë, ngushticën e hapësirës ku jetojnë.

Duke u bërë një “Unmikistan” i çuditshëm, Kosova e fillimshkullit të njëzetënjë, mbeti e pazbërthyer deri në fund edhe për Ali Aliun, i cili mbase më shumë dhembje e përjetonte të vërtetën se arti shqiptar humbiste disa gjenerata të reja të krijuesve kosovarë; veprat e një gjenerate do të vyshken në stinën e ashpër të akulturimit të shoqërisë shqiptare në tërësi. Mbase Aliu e dinte se i takonte gjeneratës që e ëndërronte lirinë, ndërsa gjenerata e djalit të tij, Agimit dhe e nipërve, e jetojnë lirinë pa ëndrra. Në rininë e vet ai e pikturonte lirinë e ëndërruar, kurse gjeneratat e pasluftës së Kosovës ishin venitur në ngjyrën qumështore të pashpresës. Dikush duhej të dilte e t'u thoshte hapur të rinjve: mos pandehni se ardhmërinë mund t'ua ndërtojnë ata që nuk mund të përballen me të kaluarën e vet, mos pandehni se ndonjëherë do të kuptoni si duken të lumturit e kësaj bote; mjafton të njihni lumturinë tuaj, të dini t'i kënaqeni asaj që keni, asaj t'i besoni e t'i përkuleni si robër të përjetshëm. Ashtu siç iu

përkul asaj që pati si fat të vetin jetësor Ali Aliu dhe gjenerata e tij. Siç iu përkul hises së fatit të vet edhe në vitet gjashtëdhjetë, kur u punësua në gazetën “Flaka e vëllazërimit” në Shkup në faqet e së cilës mbeten përgjithmonë gjurmët e shkrimeve të njeriut që e dinte se gazetari i atëhershëm duhej të jetë diçka më shumë se lajmësi i rëndomtë, duhej të ishte zgjuer dhe udhërrëfyes i popullit të vet.

Vitet që do të kalojnë në gazetën “Flaka e vëllazërimit”, janë ato që do të përcaktojnë shumëçka nga e ardhmja jetësore e Ali Aliut. Jo vetëm që do ta çojnë të shpërngulet në Prishtinë, por hija e këtyre viteve do t’i zgjatet mbi ardhmërinë dhe do ta ndjekë pas deri në shkatërrimin e Jugosllavisë së Titos. Ai erdhi në këtë gazetë javore në gjuhën shqipe në Shkup dhe qëndroi aty jo si kalimtar i rastit, por si kalorës që e njuh Jugun dhe Perëndimin e udhës së vet atdhetare dhe krijuese. E tërë periudha e tij gazetareske dhe redaktorese e kaluar në gazetën “Flaka e vëllazërimit”, do të mbajë shenjën e viteve kur bashkëpunoi me kryeredaktorin e kësaj gazete, Lutfi Rusin. Bashkëpunimi me këtë njeri të dalë nga lufta, të ardhurin prej një familje arsimdashëse nga Dibra, Ali Aliun do ta bëjë të ndihet i sigurt dhe mbase edhe i mbrojtur nga syri policor. Lutfi Rusi, si askush tjetër, u vu në mbrojtje të atyre pak të rinjve atëherë të shkolluar në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë. Atij nuk do t’i duhen shumë të dhëna që tek Ali Aliu të dallojë penën e guximshme që do të sillte probleme nëpër komitete, por të cilin s’kishte si të mos e merrte në gazetën që drejtonte. “Për mua (mendon për Lutfi Rusin - K.M) mbetet personi më i kompletuar, jo vetëm si drejtues i Redaksisë, por në përgjithësi në mes njerëzve që kam njohur”, shkruan Ali

Aliu në kujtimet e veta për vitet në “Flakën e vëllazërimit”, dhe shton: “Në një rast kur, si të thuash, e hëngra në besë, u acarua aq shumë, saqë ishte në prag të veprimit fizik: Kisha shfrytëzuar rastin kur ai ishte në pushim vjetor dhe, unë si redaktor krejt i pavarur, botova një varg artikujsh që për atë kohë u quajtën gati skandaloze”. Bëhet fjalë për shkrimet “Tetova e shikuar së afërmi”. Në këto artikuj, më nga afër dhe më guximshëm se kurdoherë më parë, paraqitej jeta kulturore e shqiptarëve të Maqedonisë. Por jo vetëm aq: në ato shkrime hapur nënvizoheshin padrejtësitë që u bëheshin shqiptarëve të Maqedonisë. Ai guxim thujse i paparë dhe i papritur në ato kohë, do ta kompletojë portretin intelektual të njeriut që kurrë nuk do të përkulet.

Ishin shkrimet e para që u kishin dalë duarsh komiteteve qendrore, prandaj ishin alarmuar të gjithë “rojtaret” e socializmit. Redaktori i ri i “Flakës së vëllazërimit” Ali Aliu, thujse i kishte zënë në gjumë. “Dhe natyrisht” – rikujton më tej Ali Aliu kohën e këtyre shkrimeve, - “plasi sherri. Presioni mbi Lutfi Rusin që të thotë vetëm një fjalë - Aliu ka botuar artikujt pa lejen time - nuk dha rezultate. Natyra e Lutfi Rusit s’mund ta bënte këtë, jo për arsye se isha unë në pyetje, por ai këtë nuk do ta bënte për cilindo gazetar që të ishte në pyetje”. Pra, Lutfi Rusi do të qëndrojë mbështetës pas penës së gazetarit të vet, gjatë tërë atyre viteve, kur Aliu filloi të shkruajë për tema, të cilat të tjerët nuk guxonin të flisnin as nëpër kafene: të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni.

Në vitet gjashtëdhjetë “Flaka e vëllazërimit” jetonte vitet e veta më të ndritura, falë drejtuesit të saj, Lutfi Rusit si dhe entuziazmit të një gjenerate gazetareske, e cila dëshironte të ndryshojë vetveten dhe botën përreth. Ali

Aliu u bë boshti i guximshëm i kësaj gjenerate. Në vitin 1967 kur “Flaka e vëllazërimit”, ndër të parat, filloi të përdorte gjuhën e unifikuar letrare shqipe, tekstet e Aliut përktheheshin për nevojat e komiteteve komuniste ku peshoheshin nga rojtarët e sistemit socialist.

Aparatura e atëhershme ideologjike, nuk mund të pajtohej me “sabotimin” gazetaresk që ia nxirrte në sipërfaqe të palarat “parajsës” së popujve dhe popullsive të vëllazëruara, siç bënë shumica e teksteve të Aliut, e veçanërisht artikujt me mbititullin: “Tetova e shikuar së afërmi”. Shkrimet e Aliut zërtheheshin nga baballarët ideologjikë, peshoheshin masat që duheshin ndërmarrë që të përmirësohej dëmi i bërë, por gazeta ishte nisur rrugës së vet. Ndoshta këto shkrime do të harroheshin, ndoshta “rojtarët” e socializmit do të tërhiqeshin, duke e ditur se Lutfi Rusi nuk do të lejonte që dikush nga jashtë të përzihej në “oborrin” e tij, por në vitin 1968, në Tetovë, do të ndodhë diçka e papritur dhe tronditëse për ato kohë: jehoi zëri i revoltës shqiptare kundër diskriminimit që u bëhej. Drejt Tetovës u nisën kordonët policore, njësoj siç do të ndodhë edhe shumë herë gjatë dekadave të mëvonshme, kur në këtë qytet buiste fara e revoltës shqiptare. Pasi i ngulfatën demonstratat me gjak, ideologët duhej të gjenin fajtorët dhe nxitësit e kësaj revolte. Nuk dihet se kush tregoi me gisht drejt gazetës “Flaka e vëllazërimit”, cili ishte ai që kishte thënë se tekstet e Aliut ishin fitili që kishte ndezur zjarrin e revoltës, por dihet se edhe pas këtij sulmi nga qarqet policore, Aliun dhe “Flakën e vëllazërimit” do t’i shpëtojë Lutfi Rusi. “Ata artikuj (bëhet fjalë për artikujt me mbititull “Tetova e shikuar së afërmi” – K.M.) pas demonstratave të njohura të 68-ës në Tetovë, u kualifikuan si nxitës dhe frymëzim kryesorë.

Prandaj dhe, në pushimin e një debati të Komitetit Qendror lidhur me demonstratat e Tetovës, Lutfiut i ishte afruar një ish-bashkëluftëtar (Nesho Markovski) dhe i thotë: “Sa është kontributi yt, Luto, në këtë dasmë!”, rikujton Ali Aliu ditët e largëta kur sërish rrezikohej të përfundonte në burg. Në këto kujtime nuk harron të regjistrojë edhe përgjigjen që Lutfi Rusi ia kishte dhënë bashkëluftëtarit të vet: “Po ta kisha nisur unë dasmën nuk do të kalonit kaq lehtë, se ti e di që unë di të luftoj, dhe jo ti!”

Akuzat se “Flaka e vëllazërimit” kishte nxitur protestat e 1968-ës në Tetovë, mbështeteshin në tekstet e Ali Aliut, “Tetova e shikuar së afërmi”. Këto tekste do të mbeten nëpër sirtarët e rojtarëve të socializmit jugosllav për dekada me radhë, dhe bëhen pjesë e dosjes policore të Ali Aliut, të cilën ai do ta shfletojë në vitet nëntëdhjetë, kur u hapën dosjet policore për qytetarët e Maqedonisë. Por kurrë nuk do të ketë forcë ta lexojë deri në fund, sepse ajo shpалos të dhëna trishtuese, të pabesueshme, çon të dyshosh në shumëçka që ka ndodhur, në shumë njerëz që ke pasur rreth vetes, që të krijojnë një situatë të kesh frikë të shikosh topografinë jetësore të atyre që të janë shpallur miq. Ajo dosje përplot me kallëzime të ndryshme nga më të pabesueshmet, kishte mbititull: Armik i përbetuar i Jugosllavisë socialiste dhe si e tillë mbetet e hapur edhe gjatë viteve pas shkatërrimit të Jugosllavisë së Titos. Në dosje mbetën shënuar edhe ditët e fundit të Aliut në Shkup, ku u bë thuajse e pamundur veprimtaria e tij profesionale si gazetar.

Pasi u bë e ditur se mund ta pësojë, Aliu vendosi të shpërngulej në Prishtinë, ku kishin filluar erërat e një liberalizimi të papritur. Thuajse qendrat ideologjike të Jugosllavisë Federative kishin vendosur t’i linin shqiptarët

të merrnin pak më lirshëm frymë. Të preheshin pas viteve në të cilët Rankoviçi mblodhi nga kosovarët edhe armët që nuk i kishin, por që duhej t'i blinin nëse donin t'i shpëtonin burgut edhe mundimeve, me çka pasuroi arsenalin e armëve të policisë shtetërore.

Emri i Ali Aliut, kishte arritur në Prishtinë shumë vite para se ai të hynte në atë ndërtesën e vogël ku ishte vendosur Shtëpia Botuese dhe Gazeta “Rilindja”, Kryeredaktor i së cilës ishte Ramiz Kelmendi. Jo vetëm pse atje punonin disa nga shokët e tij nga vitet studentore, por edhe nga shkrimet që kishte botuar nëpër gazetatat në gjuhën shqipe. Andaj edhe ardhja e tij në “Rilindje” i ngjante arritjes së zërit të pritur krijues dhe atdhetar. Pra, ardhja e tij në Prishtinë do të mirëpritet nga ata që e njihnin mprehtësinë e penës së tij gazetareske dhe krijuese si kritik letrar. Punësohet si redaktor i prozës pranë Shtëpisë Botuese Gazetareske “Rilindja”.

Asokohe në “Rilindja” punonin edhe redaktorët Mehmet Gjevori, Sulejman Drini dhe Ali Rexha. Më vonë do të vijnë edhe redaktorët Rrahman Dedaj, Nazmi Rrahmani dhe Fahredin Gunga. Me çka do të fillojë murimi i një veprimtarie botuese, e cila do t'i tejkalojë edhe përmasat e ëndërrimtarëve më të mëdhenj: gjatë periudhës së frutshme thujse dydekadëshe të veprimtarisë botuese të “Rilindjes” shohin dritë me mijëra tituj, ndër të cilët thujse të gjitha kompletet e rilindësve shqiptarë, përfshi këtu edhe veprat e atyre që Enveri i kishte ndaluar të botoheshin në Tiranë. Kështu që ndodhi një paradoks i paparë në botë: shqiptarët e kësaj ane të kufirit mbanin boshtin e bibliotekës kombëtare, në vend që atë ta bënte Tirana nga i kishin kthyer sytë të gjithë shqiptarët kudo që jetonin. Ata kishin kthyer shikimin

atje, por muret e larta kufitare nuk u lejonin të shihnin burgun që në formë të shtetit, Enveri e kishte ngritur për shqiptarët e atjeshëm. Andej mbante të kthyer shikimin çdo intelektual i kësaj ane të kufirit, përfshi edhe Ali Aliun. Dhe të gjithë do të ëndërrojnë të vizitojnë mëmëdheun. Kjo ëndërr Aliut do t'i realizohet qysh në vitin 1970. Por as ai, as cilido tjetër nga grupi i shkrimtarëve kosovarë që vizituan asokohe Shqipërinë, nuk do të arrijë të shohë atë që kujdesshëm e mbanin të “mbuluar” ushtarët e partisë, ata që kontrollonin kureshtjen e çdo ardhacaku, që ndiqnin lëvizjen e atyre që vinin e duhej të shkonin, dhe që rrezikonin të rrëfenin se “parajsa” që ndërtonte Partia e Punës së Shqipërisë në të vërtetë murohej mbrapsht dhe në vend të gabuar – në mes të ferrit.

Shkuarja e parë e Ali Aliut në Shqipëri ndodhi në vitet kur shqiptarët e Jugosllavisë filluan të marrin frymë më lirshëm, ndërsa ata të Tiranës mezi arrinin të merrnin ndonjë lajm se çka ndodhte në botën kulturore të shqiptarëve të këtushëm. Kurse në Prishtinë botoheshin kompletet e Ismail Kadaresë, Sterjo Spases, Lasgush Poradecit, Petro Markos..., e shumë e shumë të tjerëve, përfshi edhe disa nga ata krijues që nuk e kishin lehtë t'i botonin veprat e veta në Tiranë. Kështu që, i shkuari në Tiranë, Ali Aliu kishte lexuar thuajse çdo gjë që kishin shkruar krijuesit e mëmëdheut. Dhe përpos që kjo vizitë e Shqipërisë ia mundësoi të njoftohej personalisht me krijuesit veprat e të cilëve i kishte vlerësuar nëpërmjet syrit kritik, atje do të thurë edhe miqësi të përjetshme. Mes shumë miqësive që i kultivoi me vite, ishte edhe ajo me të ndjerin Petro Marko, miqësi e cila ka jo pak edhe bazë e përmasë letrare. Kjo miqësi, do të mbetet në shpirtin e Aliut si shenjë e vulosur me hekur të nxehtë,

andaj do të shkruajë një tërësi ku do të shpjegojë lidhshmërinë mes dy krijuesve dhe largësinë e botëve shqiptare, të cilat kurrë nuk arritën me lehtësi e pa pengesa të shijojnë tërësinë kulturore të cilës i takonin. “Përjetimet e regjistruara, që ndërlidhen kryesisht me Petro Markon, shikuar nga kjo distancë dhe intensitet, për mua, fitojnë dimension plus: shkrimtari i madh më shfaqet si një paradigmë e fatit historik shqiptar gjatë shekullit të njëzetë. I lindur në fillim të tij, si një kalorës – hero mitologjik dhe tragjik, shfaqet e zhduket pandërprerë në të gjitha betejat shqiptare të shekullit. Në rastet më të zymta, si një Don Kishot, herë i vë gjoksin qerres shqiptare që rrokulliset tatëpjetë dhe herë shtyn atë që ta nxjerrë nga balta, herë fluturon mbi të si engjëll mbrojtës”, shkruan Ali Aliu për mikun e tij, Petro Markon. Ndihet që shumëçka te kjo që thuhet në këtë copëz rrëfimi për miqësinë me këtë shkrimtar, vlen edhe për vetë autorin Ali Aliu, që e vëren te miku i vet.

Petro Marko mbeti mik i dashur i Ali Aliut deri në ditët e fundit të jetës. Aliu do ta vizitojë edhe në fshatin e lindjes të Markos, Dhërmi. Për herë të parë Aliu në Dhërmi do të shkojë në vitin 1973. Vendlindjen e këtij atdhetari dhe krijuesi do ta vizitojë edhe në vitin 1991, kur, duke qëndruar i heshtur pranë gruas dhe dy fëmijëve të Petros, pranë Fatos Arapit dhe Xhevahir Spahiut, do t'i thotë lamtumirën e fundit mikut të dashur, i cili e kishte lënë me gojë: varrimi të bëhej në Dhërmi, pa fjalime dhe zhurmë, në të të merrnin pjesë vetëm Ali Aliu, Fatos Arapi dhe Xhevahir Spahiu. “Petro Marko, tanimë e prej kohësh, ishte bërë i zhgënjyeri i madh, por që s’pushoi, deri në grahmat e fundit, ta dojë Shqipërinë si i marrosur”, shkruan Ali Aliu në kujtimet e tij për Petro Markon. Pastaj

shton: “E kishte që me lindje këtë dashuri. Brodhi rebelueshëm nëpër Evropë, u gjend në beteja kundër dhunës dhe robërisë – ndërkaq që pikërisht kjo dhunë ia mposhti Shqipërinë për afro gjysmë shekulli, para së cilës ishte i pafuqishëm. Pra, fryma e shpirti kryengritës nuk iu shua asnjëherë...”

Në shkrimin e gjatë për individualitetin e Petro Markos, ka diçka që në të vërtetë përkon edhe për vetë autorin, Ali Aliun: dashuria e tij ndaj njerëzve që kanë flijuar shumëçka për atdheun, ata që e deshën atdheun pa pyetur nëse vallë atdheu në hall sa arrinte t’i donte ata. Mbase kjo dashuri e Aliut ndaj mikut dhe shkrimtarit Petro Marko, ka të bëjë me të vërtetën se njeriu shpeshherë i adhuron të ngjashmit me veten, ose ata që posedojnë diçka që ai vetë ëndërron ta ketë. Kësaj radhe bëhet fjalë për lidhshmëri miqësore të të ngjashmëve: Ali Aliu kishte parë shumëçka të vetën në atë kolos. Te Petro Marko mund të shihnin pjesë të vetvetes të gjithë ata që kanë flijuar shumëçka individuale për popullin që i takojnë. Andaj edhe jo rastësisht Aliu do të arrijë të “lexojë” shenjat e heshtura të këtij krijuesi, i cili besonte edhe atëherë kur shumica e të tjerëve ishin kapur në kthetrat e mosbesimit se Shqipëria postkomuniste do të arrinte të ngrihej në këmbë dhe t’i shërojë plagët e rënda nga koha enveriane, të cilat gjakonin në fillim të viteve nëntëdhjetë, kur u mbushën ambasadat perëndimore me ata që donin të iknin sa më largët mëmëdheut që ua thartoi qumështin e nënës. “Mos u dëshpëro që e sheh Shqipërinë e katandisur kështu. Do ta marrë veten shpejt... Do zbutet edhe syri, shikimi i egërsuar i njerëzve në rrugë, edhe agresiviteti, edhe dëshira për të shkatërruar dhe për t’u vetëndëshkuar, edhe tërbimi për të ikur...!” - do t’i thotë Petro Marko i

shtrirë në shtratin e të sëmurit, mikut të vet Ali Aliut. Do ia thotë këto fjalë mbase edhe që t'ia shtojë besimin të qëndrojë në rrugën e vet të atdhetarisë, sepse Petroja asokohe e dinte se Aliu kësaj radhe nuk kishte ardhur në Tiranë si kritik letrar, e as si profesor i letërsisë, por si përfaqësues i Kosovës dhe me ambicie më të gjera e të mëdha se të vlerësonte ambientin kulturor në Shqipëri: duhet t'ia kumtonte Tiranës të vërtetat politike për Prishtinën.

Në fillim të viteve nëntëdhjetë, kritiku letrar Ali Aliu kishte shkuar në Tiranë me vetëdëshirë dhe me qëllim të vlerësonte se vallë çfarë ndihme mund t'i ofronte mëmëdheu Kosovës, në rast të ndonjë konflikti të armatosur. Në vitin 1991, në bashkëpunim me oficerët e lartë të ushtrisë shqiptare, Aliu arriti të themelojë kampet e para për stërvitjen e ushtarëve të ardhshëm që do t'i sillnin lirinë Kosovës.

HESHTJA E DJESHME DHE ZHURMA E SOTME

Më 4 maj të vitit 1980 vdiq Josip Broz – Tito, kryetari i përhershëm i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Shumëkush, vdekjen e Titos e mori si shenjë se duhej bërë vlerësimi për shëndetin e shtetit, të cilin udhëhoqi. Ata që shtronin pyetjen se çka do të ndodhte me Jugosllavinë socialiste pas Titos, në të vërtetë e dinin se kjo federatë e popujve dhe popullsive të “vëllazëruar” ishte më e sëmurë se kryetari i saj. Nëse Titoja vuante nga gangrena e këmbës, të cilën ia imputuan në Klinikën e Lubjanës, shteti të cilin udhëhiqte lëngonte nga gangrena historike e nacionalizmave të heshtur. Jugosllavia ishte shteti në të cilin që arritur një baraspeshë në armiqësitë historike mes popujve, shpallur vëllezër ideologjikë, por që në të vërtetë ishin armiq të përbetuar, me shumë llogari të papastruara nga e kaluara. Siç ishte armiqësia serbo-kroate dhe ajo serbo-shqiptare. Andaj edhe varrimin madhështor të Titos, shtypi botëror e përcolli me dilemën se vallë edhe sa kohë do të mbetej gjallë krijesa shtetërore në të cilën vetëm populli serb kishte realizuar ëndrrën e vet të jetojë në një shtet si i privilegjuar. Pra, ç’do të mbetej nga Jugosllavia e Titos në vitet kur do të mungonte ai, që mjeshhtërisht arrinte të gjithë t’i shpërblejë apo dënojë, që

të kuptonin se ishte “mbreti” i një perandorie socialiste. Tito mbase e dinte se armiqësitë e heshtura mes popujve që përbënin Jugosllavinë që udhëhiqte, ishin si prush i padukshëm i mbuluar me hirin e harmonisë së rrejshme ndëretnike, prush që nuk lëshon as tym të ngrohtë, por posa t’ia afrosh kashtën, e djeg tërë shtëpinë.

Vdekjen e Titos e shënuan edhe botimet speciale të gazetave nëpër të gjitha qendrat e Federatës, me tekste të ngjashme dhe thuajse me të njëjtën fotografi në faqen e parë: gjysmëprofili i kryetarit, me tri dekoratat e heroit të popullit. Vetëm e përditshmja kosovare “Rilindja” kishte botuar një fotografi krejt ndryshe nga ajo në të përditshmet e tjera jugosllave: nën mbititullin “Vdiq shoku Tito - Jeton vepra” qëndronte një portret i rrallë i Titos, i viteve të fundit të jetës së tij, me syze të errëta që s’lejonin të shihej nga e kishte drejtuar shikimin. Gazetat vendase botuan edhe hartën e globit tokësor nga mund të shihej se vetëm pak shtete nuk kishin dërguar përfaqësuesit e vet në varrimin e Titos. Ndër ato pak shtete ishte edhe Shqipëria. Ajo Shqipëri, e cila për shumë dekada mbeti ëndërr dhe shpresë e vetme për shqiptarët këtej kufirit, e cila në të vërtetë emrin e Kosovës e kishte fshirë edhe nga librat shkollorë, e lëre më nga kalendari i saj politik.

Përderisa shtypi botëror shtronte dilemat çka do të ndodhte me Jugosllavinë pas vdekjes së Titos, gazetat vendase qysh në kryetutujt theksonin se vendi do të ecë rrugës së idesë titiste, dhe se ideja e udhëheqësit të vdekur do ta mbajë gjallë federatën e kredhur në dhembje nga humbja e prijësit, që mbase ishte komunist, por jetoi si mbret i vërtetë.

Prishtina e atyre ditëve nuk u ngjante kryeqendrave të tjera të federatës Jugosllave: më shumë se dhembja,

kosovarët i kishte kapluar hutesa: si do të bëhej më tej? Shqiptarët që moti kishin zbritur nëpër nëntë shkallët e mbijetesës në rrethana nga më të pamundurat. Tanimë ishin lëshuar në rrafshin ku duhej të dilej nga ëndrrat, duhej të përballeshin me realitetin e vrazhdë të mbetur pa mjeshtrin e baraspeshës – pa Titon, mes aspiratës shqiptare që Kosova të jetë subjekt i barabartë me republikat e tjera të Federatës dhe orvatjet serbe që ajo të mbetej “protektorat” i saj. Shqiptarët duhej të përballnin vuajtjet me ambiciet, të matnin sa janë të gatshëm për një fillim të ri, teksa të rinjtë e këtij populli duhej të rikujtojnë llullën e gjyshit prej nga tymonte një e kaluar shekullore e jetuar në sundimin serb, dhe nipërit e shkolluar të masnin saktë boshtin kurrizor me guximin për të bërë realitet ëndrrën e gjyshit për një Kosovë që do t’u takonte kosovarëve. Ishte e pamundur që kosovarët e ditëve kur Jugosllavia mbante zi për kryetarin e saj, të mos e ndienin se tani do të vinte koha kur qartë do të bëhej e dukshme se jetonin në një autonomi nga e cila ishin të pakënaqur, edhe ata, edhe serbët. Për shqiptarët ajo ishte e pamjaftueshme, ndërsa për serbët Kosova ishte djepi që mbante gjallë mitin se Serbia shtrihet deri atje ku ka arritur granata e ushtrive pushtuese serbe dhe, nëse mbeteshin pa Kosovën, duhej të dalin nga shtrati i ngrohtë i mitologjisë, që i vetëgënjente se janë popull “hyjnor”, i cili që moti i kishte ndërprerë lidhjet komunikuese me realitetin ku shqiptarët kishin harxhuar kohën e ëndrrave të kota. Duke e ditur se tani do të duhej të dëshmonin se janë popull me vetëdije të qartë kombëtare, se nuk janë më ata të dikurshmit, fatin e të cilëve duhej ta përcaktojnë komitetet qendrore të Tiranës dhe Beogradit, kosovarët e vitit 1980 rikujtonin vizitën e fundit të Titos në Prishtinë,

ku ai kishte akuzuar udhëheqësit e Autonomisë Socialiste se nuk janë mjaft syçelët në mbrojtjen e Federatës së popujve të vëllazëruar nga nacionalizmi shqiptar.

Titoja, si askush tjetër, e dinte se Kosova ishte hap i mbetur në ajër, një ndër pamundësitë e tij që njëkohësisht të kënaqte edhe kërkesat e shqiptarëve edhe të neutralizonte ambiciet serbe që Kosova të mbetej “syri” mitik i këtij populli. S’ka qenë larg të pamundurës që Titoja të kishte dëgjuar edhe për atë që flitej hapur nëpër çajtoret ku shqiptarët informoheshin për atë që nuk e botonin gazetat: gjatë rrugëtimit të Stafetës së fundit nëpër Kosovë - me të cilën çdo vit në mënyrë solemne, rinia jugosllave i uronte ditëlindjen kryetarit të shtetit, duke e bartur atë dorë më dorë, duke e shëtitur nëpër gjithë qendrat e Jugosllavisë, që më 25 maj të arrinte në Beograd - të rinjtë kosovarë e kishin hedhur në disa ara të mbjella me misër. Kjo mund të mos ishte e vërtetë, por edhe si trill, shpjegonte disponimin e saktë të rinisë shqiptare të Kosovës, gjë të cilën do ta vërtetojë pranvera e vitit 1981.

Mars-prilli i vitit 1981 mbajnë shenjën e demonstratave, të cilat i filloi rinia kosovare, por që shpejt morën përmasat e revoltës gjithëpopullore. Ky vit do të bartë jehonën e zërit të ngulfatur me shekuj të një populli, zërin e kosovarëve, të cilët që moti ishin zgjuar dhe e kishin kuptuar padrejtësinë historike që u ishte bërë. Por mbase u duhej kohë që t’i hapnin të nëntë rrugët që u mundësonin të komunikojnë me vetveten dhe me botën. Jo rastësisht, ai zë jehoi bindshëm pas shumë dekadave heshtjeje, dhe jo rastësisht u dëgjua në kohë kur Prishtina ishte bërë qendër universitare dhe Piemont kulturor e arsimor për shqiptarët e Jugosllavisë. Ai zë jehoi kur ishte sforcuar boshti kurrizor intelektual i shqiptarëve nga kjo

anë e kufirit. Dhe gjithnjë jo rastësisht, revolta studentore shpërtheu në hapësirat e Universitetit të Prishtinës, për të përfshirë thuaj gjithë shtresat e popullatës kosovare. Sepse aty, në atë universitet, gatuhet brumi atdhetar që do të mund të bartte mbi shpinë barrën e ardhmërisë së popullit të vet. E atë brumë e ngjishnin intelektualë që e dinin se në Jugosllavinë e Titos, shqiptarët ndiheshin si fëmijë bonjak, që dhunshëm i kishin ndarë nga prindërit, fëmijë të cilit të tjerët donin t'ia përcaktonin edhe lojën edhe hapësirën ku mund të lozte. Edhe shtrëngimet, mosdhënien e lirisë, ia shpjegonin si kujdes bamirës i “vëllait të madh”, i cili kinse ndihmonte rritjen e tij, që a thua kishte për qëllim përgjithmonë të mbetej “adoleshent”.

Në mesin e atyre që përgatisnin gjeneratat e reja për kohën e re, të atyre që forcuan boshtin atdhetar të gjeneratave që do të korrigjonin gabimet e vjetra, ishte edhe prof. Ali Aliu. Në universitetin e Prishtinës ai erdhi të ligjërojë Teorinë e Letërsisë. Në Katedrën e Albanologjisë, si edhe shumica e profesorëve të atëhershëm shqiptarë në Prishtinë, u mësonin të rinjve edhe alfabetin e atdhetarisë. Rinisë shqiptare ia shpjegonin shenjat e torturës shekullore serbe dhe të kolonizimit serbo-malazez të Kosovës.

S'ka dyshim se demonstratat e vitit 1981 ishin të papritura për të gjithë. Ato filluan me 11 mars dhe së shpejti përfshinë të gjitha shtresat e popullit shqiptar. Atyre nuk iu bashkëngjitën vetëm elitat politike dhe ato intelektuale. Nga 11 deri në 26 marsi, kur shpërthyen demonstratat e dyta të studentëve, të gjithë kishin kohë të dalin nga hutesa, por edhe kësaj radhe elitat intelektuale nuk iu bashkëngjitën revoltës gjithëpopullore. Përderisa

intelektualët shqiptarë në heshtje përcillnin ngjarjet dhe shihnin sesi më 1 prill u gjakos rinia shqiptare, Beogradi e kishte kuptuar se këto protesta ishin mundësi e mirë që njëherë e përgjithmonë t'i spastronin llogaritë me shqiptarët. Revolta gjithëpopullore ishte shenjë edhe për karrieristët shqiptarë që të pastronin llogaritë dhe ta largonin nga skena politike “lobin e kuq gjakovar” që gjatë dekadave të kaluara kishte thurur rrjetën e vet burokratike nëpër organet më të larta të Autonomisë, si dhe në ato republikane dhe federative. Ky klan nuk vendoste vetëm për rirreshtimin e elitave politike, por edhe për strukturimin e tërë burokracisë institucionale dhe eliteve krijuese.

E ku, ku ishin intelektualët, ku ishin profesorët e universitetit gjatë protestave të marsit dhe prillit të vitit 1981? Mos vallë në këto protesta dolën vetëm ata që s’kishin ç’të humbnin? Kur shpjegon mospjesëmarrjen e inteligjencisë shqiptare në këto demonstrata, në librin e tij “Vite të humbura”, Mehmet Kraja shkruan: “Duke qenë një inteligjenci autonomiste dhe e institucionalizuar, ajo ishte formuar dhe ende mbahej fort nën kontrollin e ashpër të pushtetit. Njësoj si burokracia politike, mbas së cilës mbahej, ajo me kohë ishte distancuar nga populli dhe kishte krijuar klane të vogla e të mbyllura, që përfshiheshin në klanin e madh të një elite superstrukturore... Nga ana tjetër, ajo ishte e shënjuar saktësisht nga pushteti, dhe veprimi i saj i fshehtë ishte krejt i pamundur, njësoj siç ishte e pamundur përzjerja me turmën e diferencuar qartë nga niveli social.” Se ku qëndronte Ali Aliu në këtë vit, nuk është e vështirë të qartësohet: ishte i zënë nga kthetrat e dosjes së vet të pasur policore, ku ishte e shënuar çdo lëvizje e tij, ku nga dita

në ditë shtoheshin të dhënat për veprimtarinë e tij “armiqësore”. Nga pozita e një “armiku” të verifikuar si i tillë qysh në vitet studentore, Ali Aliu edhe nuk mund të bënte asgjë më shumë përpos rrëmujën e popullit që mbushte rrugët e Prishtinës ta ndiqte nga dritarja e kabinetit të tij. Mbase edhe duke e ditur më mirë se çdokush tjetër se kjo ishte gjenerata që jetësonte ëndrrën e gjeneratës së tij, plotësisht i vetëdijshëm se kjo ishte diçka që medoemos një ditë do të ndodhte, se kjo protestë gjithëpopullore ishte vetëm fundi i zbritjes nëpër nëntë shkallët e durimit dhe një ngjitje e re drejt një rruge, të cilën asokohe askush nuk e dinte se ku do e çonte Kosovën. Ai shumë shpejt e kuptoi ç’ domethënie kishin ato protesta, gjë që do ta dëshmojnë ngjarjet e mëvonshme, të cilat nuk do të përcaktojnë vetëm fatin e Kosovës, por edhe atë të Federatës Jugosllave.

Përderisa elita politike dhe intelektuale kosovare dukej se mbeti jashtë kolonave gjithëpopullore, qarqet politike dhe intelektuale të Beogradit shpejt e morën veten dhe e dinin se ku ishte vatra që ndezi zjarrin e revoltës rinore shqiptare. Andaj edhe ngutazi goditën Universitetin e Prishtinës, institucionet kulturore dhe shkencore të Kosovës, duke i shpallur si “fole të irredentizmit dhe nacionalizmit shqiptar”. Me këtë treguan hapur se cilët i mbanin si armiq më të mëdhenj, se pikërisht intelektualët shqiptarë që asokohe nuk ishin mes demonstrantëve, pikërisht ata kishin ngjeshur brumin që i printe revoltës popullore. Beogradi e lexoi qartë orën politike që trokiti në kalendarin e Jugosllavisë dhe ngutshëm u angazhua të kompletonte aleancën antishqiptare me qendrat e tjera jugosllave. Kuptohet, duke u kujdesur që kolonat antishqiptare të kenë sa më shumë politikanë shqiptarë,

me çka do të mundë të mbulohej qëllimi kryesor: njëherë e përgjithmonë shqiptarëve t'u thyhej boshti kurrizor, e Kosova të bëhej provincë plotësisht e kontrolluar nga serbët. Të bëhej ajo që ishte para shpalljes së kushtetutës së vitit 1974. Andaj edhe mobilizuan mediat, institucionet shtetërore, shkencore e kulturore, u rirreshtuan të gjithë që mund të ndihmonin që "lufta" të fitohej me sa më pak beteja. Që Kosova të gjunjëzohej sa më shpejt, pa e kuptuar askush se çka kishte ndodhur në atë Krahinë Socialiste. Mbase kjo ngutje dhe ky vetëbesim se fitoren e kishin të garantuar, i verboi sa të mos shihnin se shpalosën urrejtjen shekullore ndaj tërë një populli, sa të mos vërejnë se urrejtja e papërmbajtur e tyre, e ngulfatur me vite, në të vërtetë e harxhoi edhe atë pak besim tek optimistët më të mëdhenj shqiptarë se mund të kishin ardhmëri në Jugosllavinë e mbetur pa Titon.

Qarqet serbe e dinin se arma më e fortë e shqiptarëve ishte arsimimi, se kjo armë pamundësonte realizimin e elaborateve të ngjashëm me ato të Çubrilloviqit për shfarosjen e shqiptarëve nga trojet jugosllave, prandaj edhe sulmuan institucionet arsimore dhe kulturore. E dinin se beteja antishqiptare nuk do të ishte e frytshme, nëse nuk arrinin të njollosnin institucionet arsimore, shkencore dhe kulturore të shqiptarëve në tërësi dhe veçanërisht shtresat intelektuale të këtij populli. Madje këtë, jo vetëm nga kjo anë e kufirit, por në tërësi. Kështu që filloi beteja mediatike për shtypjen që kinse shqiptarët u bënë serbëve, dhe për intelektualët shqiptarë që gjumin e bënë në shtratin politik të Jugosllavisë, por shihnin ëndrra me Tiranë. Prandaj, vitet tetëdhjetë mund të emërohen si dekada e një torture psikike mbi popullatën shqiptare, e cila mori përmasat e një çmendurie kolektive të qarqeve politike

dhe kulturore të Beogradit. Deri ku shkonte kjo çmenduri antishqiptare, më së miri dëshmon rasti nga i cili do të ndihej i përbuzur çdo popull, por jo edhe serbët – ai i Martinoviçit. Bëhet fjalë për një homoseksual, të cilit i thyhet shishja në anus gjatë masturbimit. Tërë këtë ngjarje, mediat serbe e ngritën në rrafshin e “tragjedisë kombëtare”, duke i shpallur shqiptarët si dhunues. Edhe pse mjekët dhanë shpjegime se bëhet fjalë për një të sëmurë, intelektualët serbë e ngritën Martinoviçin në rrafshin e heroit kombëtar. Për të shkruajtën libra e incizuan filma dokumentarë. Me çka u dëshmua se prapanica e Martinoviçit në të vërtetë ishte fytyra e vërtetë e elitave intelektuale të Beogradit që, të verbuara nga urrejtja kundër shqiptarëve, nuk vërenin se “masturbimi” që bënin, do të përfundonte me një njollë të pashlyeshme mbi fytyrën e popullin serb. Do të çonte kjo drejt një ekstaze kolektive, e cila serbët do t'i katandisë drejt një vetëshkatërrimi të paparë gjatë historikut të Ballkanit.

Revolta shqiptare e vitit 1981 do të shënojë fillimin e shkatërrimit të Jugosllavisë së Titos dhe njëkohësisht edhe rrënimin e një ideologjie me përmasa globale – asaj komuniste. Demonstratat e vitit 1981 ishin ajo furtunë e papritur që do ta ngrrejë hirin mbi prushin e urrejtjeve historike mes popujve që përbënin federatën Jugosllave, dhe do të hapë portën për grindjen disadekadëshe mes popujve jugosllavë, grindje që do të përfundojë me disa luftëra dhe me shpërbërjen e shtetit të Titos. Kjo shpërbërje, që do të fillojë me shkëputjen e Sllovenisë, me luftën në Kroaci dhe Bosnjë, do të marrë fund vetëm me luftën e vitit 1999 në Kosovë. Por, para se malet e Kosovës të mbushen me të rinjtë e armatosur shqiptarë, Prishtina duhej t'i fitojë betejat që ia kishin borxh

intelektualët. Kështu që në vitet tetëdhjetë, kosovarët do të duhet të jepnin provimin se sa të fortë e kishin boshtin kurrizor intelektualët, të cilëve u ra në hise t'i kundërviheshin një makinerie antishqiptare serbe të udhëhequr nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë dhe e përkrahur nga i tërë potenciali medial dhe kulturor. Kështu, politikës serbe i prinin punëtoritë e gënjeshtrave, që ai popull i kishte ndërtuar me shekuj dhe i përdorte si armë të forta që të heshtë të vërtetën për pozitën e shqiptarëve në Jugosllavinë e Titos.

Fushatat që Kosovës t'i merreshin edhe ato pak të drejta që iu dhanë me kushtetutën e 1974-ës, në njëfarë mënyre, shënojnë periudhën më të ndërlikuar të historisë së Kosovës. Vitet e fundit të dekadës së tetëdhjetë të shekullit të njëzetë, do të jenë ato vendimet që do të përcaktojnë rrugën e mëturjesme të shqiptarëve të Jugosllavisë, sepse janë vitet kur jehoi zëri i intelektualëve shqiptarë. Për qarqet e Beogradit, ai zë ishte njësoj tronditës sa edhe britmat e demonstruesve të vitit 1981, sepse ata nuk ishin mësuar që dikush t'u kundërvihet. Kur Serbia bëri hapin përfundimtar, për të shpartalluar Autonominë e Kosovës, u dëgjua zëri i koordinuar, i pritur gjatë, i intelektualëve shqiptarë: me 21 shkurt të vitit 1989, u publikua apeli i ashtuquajtur "Apel 215" të cilin e kishin nënshkruar 215 intelektualë kosovarë, që e tronditi tërë Jugosllavinë e atëhershme. Nënshkruesit e këtij apeli viheshin në mbrojtje të Autonomisë së Kosovës. Këtë apel ata ia drejtonin opinionit vendas dhe atij ndërkombëtar, por siç duket çdo gjë kishte marrë fund: s'kishte mbetur kokë e kthjellët që mund të dëgjonte zërin e arsyes. Atë zë nuk e dëgjuan as viktimat e mëvonshme të Millosheviqit, si për shembull, kroatët dhe boshnjakët. Mbase ata kishin

harruar rrëfimin për frikacakun që dëgjonte trokamat e fashistëve në dyert e fqinjëve dhe nuk ndërmori asgjë, gjer një ditë kur të njëjtit trokitën edhe në derën e tij, por tashmë nuk kishte kush ta dëgjonte, e lëre më t'i ndihmonte. Shpejt, në Kosovë u shpall gjendja e jashtëzakonshme, e institucionet serbe kremtuan ndryshimet e kushtetutës republikane dhe ato të Kosovës, sipas të cilave ndryshime Serbia i “bashkoi tri pjesët e saj”, bashkim që do ta çojë drejt rrugës që e shpuri aty ku ndodhet sot – e mbetur jo vetëm pa Kosovën, e cila edhe kurrë nuk i ka takuar, por edhe pa “syrin e dytë në kokë”, Malin e Zi.

Ata që nënshkruan “Apelin 215”, në të vërtetë kishin nënshkruar fatin e vet si “armiç” të përbetuar të Jugosllavisë. Kishin vënë edhe shenjat e para se nga do të çonte rruga e mëtutjeshme e ardhmërisë. Ata që shpërndanin përmbajtjen e Apelit, duke kërkuar përkrahës që do të ngrinin zërin kundër çmendurisë shoviniste serbe, e dinin se asokohe, një veprimtari e tillë, mund t'i kushtonte më së paku disa vite burg. “Puna e mëtutjeshme rreth shpërndarjes së Apelit shkoi sipas ndarjes e kryerjes së zellshme të detyrave: Ramiz Kelmendi në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe ku t'ia dilte, Ali Aliu dhe Masar Stavilevci në Fakultetin Filozofik, Zenun Çelaj në “Rilindje” - dëshmon një ndër nënshkruesit dhe shpërndarësit e Apelit, Zekerija Cana në librin e tij “Apeli 215 i intelektualëve shqiptarë”. Duke mos harruar të shënojë edhe çastin e vënies së nënshkrimeve, edhe atë, “sipas kësaj radhe: Ali Aliu, Ramiz Kelmendi, unë (Zekerija Cana – në kllapa imja), Gazmend Zajmi dhe Rexhep Qosja”. Me çka, Ali Aliu vazhdon të qëndrojë në krye të kolonave që përcaktojnë fatin e popullit, dhe do të

ecë rrugës së cilës ishte nisur qysh si student në Beogradit. Ai do të vazhdojë t'u qëndrojë besnik bindjeve të veta se asgjë nuk vlen, as dhuntitë krijuese, as ato njerëzore, nëse në çastin e duhur të gjitha ato që i posedon, nuk i flijon në tempullin e atdhetarisë, gjë që e kishte dëshmuar qysh me shkrimet e guximshme në Shkup, si dhe me paraqitjet e tjera publike. Gjë të cilën e kishte dëshmuar edhe gjatë takimit të shkrimtarëve serb me ata shqiptarë, në Beograd.

Në bisedat serbo-shqiptare, të inicuar nga Shoqata e Shkrimtarëve të Serbisë, mbajtur në vitin 1988 në Beograd, foli edhe Millan Komneniqi, i cili fjalën e vet e filloi me një të vërtetë, të cilën të gjithë e dinin, por nuk e thonin hapur: “Zotërinj, jemi në luftë! Kur e dimë këtë, atëherë pse e fshehim? U shpall ose nuk u shpall lufta, kjo është vetëm punë forme.” Shkrimtarët shqiptarë që merrnin pjesë në këtë takim, e të cilët duhej të flisnin për “Serbët dhe shqiptarët në Jugosllavinë sot”, mund edhe mos ta kenë pritur që dikush ta thotë kaq zëshëm të vërtetën që ata e dinin qëmoti, por qëndrimi i tyre në këtë takim u bëri të ditur qarqeve të Beogradit se lufta që kishte filluar para shumë shekujve, kësaj radhe do të ishte e ashpër, se shqiptarët nuk ishin më ata të kohës së Esad Pashës. Këto do t'ua dëshmojnë të gjithë të ardhurit nga Prishtina. “Mjetet e informimit në Beograd me pishë i kërkojnë ata intelektualë shqiptarë, të cilët, duke sulmuar të ashtuquajturin “botëkuptim albanologjik”, në të vërtetë përpiqen të diskreditojnë studimet albanologjike dhe, nëpërmjet tyre, krijuesit më të merituar shqiptar. E pse? Me qëllim që brenda studimeve shqiptare dhe inteligjencisë shqiptare, nën maskën e vetëdijes kritike, pa të cilën ato kurrë s'kanë qenë, të nxitet fryma policore, e cila edhe ashtu i ka sjellë mjaft dëm albanologjisë dhe

mjaft vuajtje inteligjencies shqiptare.”, do të theksojë Rexhep Qosja në këtë takim. Ndërkaq Ibrahim Rugova do të bëjë me dije se “fatin e Kosovës duhet ta marrin në dorë popujt që jetojnë aty, në mënyrë që autonomia të pasurohet edhe më shumë, që të çlirohet potenciali njerëzor, i cili është i bllokuar plot shtatë vite, që të lirohen njerëzit e dënuar e që praktika gjyqësore të harmonizohet me atë Jugosllave dhe të garantohet e drejta e punës dhe e shkollimit.” “Historia nuk është vetëm e kaluar, vetëm ajo që ka ndodhur. Histori është edhe e tanishmja, edhe e ardhmja. Ajo që po ndodh dhe ajo që mund të ndodhë. Dhe ajo nuk ndodh vetë, ajo nuk mund të ndodhë pa ne. E kaluara nuk ka ndodhur vetëm që të mos harrohet, por edhe që të mos përsëritet.” – do të thotë Azem Shkreli në këtë takim serbo-shqiptar. Por pala serbe njihje dhe pranonte vetëm historinë e vet, e cila më shumë ishte e lagur nga mjegulla e mitologjisë, sesa nga e vërteta. Pala serbe në këtë takim do të dëgjojë edhe fjalët e Ali Aliut. Ai do t’u tregojë kolegëve serbë se shqiptarët që moti e kishin kuptuar qëllimin dhe trukun serb, dhe do të thotë: “Satri ka diktuar trukun dhelparak të Stalinit: ai nxirrte ligje me pretendime jashtë çdo mundësie reale në mënyrë që më pastaj, duke qenë i sigurt në mosrespektimin e tyre, i ka lënë vetes gjithmonë mundësinë e hapur për ndëshkimin e kundërshtarëve. Pozicioni i shqiptarëve në Jugosllavi është i ngjashëm me pozicionin e kundërshtarëve të menduar kësisoj. Meqë ata janë deklaruar të rrezikshëm, sikurse edhe historia e tyre, vlerat kulturore e shpirtërore, letërsia, folklori, meloditë, etj. dhe meqë është ngritur “Muri kinez” midis shqiptarëve në Jugosllavi dhe atyre në vendin amë, a nuk është vallë i pamundur dënimi i çdo shqiptari që do të lexojë ose dëshiron të dëgjojë melodinë burimore?”.

Nëse Komneniqi tha hapur se “lufta serbo-shqiptare” kishte filluar, Ali Aliu pa përdorur dorashka, në mes të Beogradit, u kumtoi serbëve se që moti e kishte të qartë se nuk bëhej fjalë për fillimin e ndonjë lufte, por për vazhdimin e luftës shekullore të serbëve kundër çdo gjëje që ka parashtesën “shqiptare”. Dhe, duke e ditur se boshti kurrizor i shqiptarëve që jetonin jashtë mëmëdheut do të mbrohej apo do të thyhej në Kosovë, ai nuk harron edhe atë që ndodhte me shqiptarët në trojet e tjera shqiptare. Andaj, në fjalën e vet do të sjellë shembullin e situatës mjeruese në sferën e arsimit të shqiptarëve të Maqedonisë, duke thënë: “Nga 400 nxënës që janë çregjistruar dhe përjashtuar nga shkollat e mesme të Kumanovës, 250 sosh janë regjistruar në Kosovë, kurse për të tjerët nuk dihet se ku janë tretur.” Kolegëve serbë Ali Aliu do t’u dëshmojë se shqiptarët tashmë e kishin kuptuar ku donte të çonte punëtorja serbe e gënjeshtreve dhe, duke dashur t’ua dëshmojë keqpërdorimin e monopolit informativ që mbante në duar dhe e kontrollonte Beogradi, Ali Aliu do t’ua rikujtojë kolegëve të vet serbë rastin e Martinoviqit. “Të marrim tashti rastin e Martinoviqit. Nuk bëri punë kurrfarë raporti profesional për shkakun e lëndimit të tij dhe të gjithë kësaj ngjarjeje. E vërteta është se edhe sëmundja duhej të përfshihej në këtë fushatë antishqiptare. Prandaj atë e ngritën në shkallën e shenjtit, që duke e degraduar në këtë rast deri në fund, hyri në libra, fotografi dhe akademi, kurse këto ditë edhe në film!”.

Në të vërtetë, rasti i Martinoviqit ishte vendosur aty ku e kishte vendin: në ballinën e një politike perverse dhe “homoseksuale”, të cilës i prinin edhe elitat kulturore të Serbisë, elita të cilat i irritonte çdo e arrirë shqiptare. Kështu që ishin të gatshme të përkrahnin edhe veprime

që i takonin shekullit të nëntëmbëdhjetë: t'i privojnë shqiptarët nga çdo vlerë e tyre duke i hequr nga bibliotekat e shkollave edhe librat e shkrimtarëve të shquar, si ato të Ismail Kadarese, Dritëro Agollit..., bërjen e listave të këngëve të ndaluara. Kjo betejë në Maqedoni kishte marrë përmasa monstruoze me të ashtuquajturat 'paralele etnikisht të përziera' nëpër shkollat e mesme, me çka thujse u mbyllën gjithë shkollat në gjuhën amtare.

Përderisa Kosova vlonte, shqiptarët e Maqedonisë jetonin pjesën e tmerrit të vet. Aq më keq, që moti kishin mbetur pa elitat kulturore, të cilat pas vitit 1974 kishin shtegtuar në Kosovë, ku mundnin të frymonin më lirshëm. Në vitet tetëdhjetë shqiptarët e Maqedonisë vuanin burgje edhe thjesht me shkakun se fëmijën donin ta quanin Ilir, apo pse dëgjonin këngë patriotike popullore. Ata bëheshin viktima të keqtrajtimit policor vetëm pse nuk përkrahnin aksionin komunist për prishjen e mureve rreth shtëpive të tyre. Në të vërtetë, te shqiptarët e Maqedonisë, politika serbe provonte atë që dëshironte ta zbatojë në Kosovë. Shkupi, si filial i dëgjueshëm politik i Serbisë, printe në luftën "kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar". Komunistët maqedonas u bënë më "serb se serbët". Nuk ngurronin që edhe varrimet e dasmat e shqiptarëve t'i përdornin për "diferencimin" e tyre në të "ndershëm" dhe "armiç".

Të gjetur në një situatë të tillë, shqiptarët e Maqedonisë e mbanin shikimin kah Prishtina, e cila si nënë e mirë, kurrë nuk i harroi. Zërat që vinin nga Prishtina, e që shprehnin revoltën për atë që ndodhte edhe me shqiptarët e Maqedonisë, edhe më shumë i tërbonte komunistët maqedonas. Ali Aliu ishte një nga ata që kurrë nuk harroi nga e kishte nisur rrugën dhe ecjen e vet jetësore. Ai e

dinte se kishin ardhur kohë kur shqiptarët duhej të vepronin si një, të mos lejonin t'i përçanin. I tillë do të mbetet edhe pas betejave gjatë viteve tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë, të cilave edhe u printe. I tillë do të mbetet edhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë, nga e cila do të shkëputet edhe Maqedonia ku ai kishte familjarët e vet, ku kishte lënë lojërat fëmijërore, mbase t'ia ruante freskia e liqenit të Prespës. Do të shkëputej Maqedonia e fëmijërisë së tij, ajo që shërbeu si derë kalimtare për shqiptarët që shpërnguleshin në Turqi, Maqedonia e rinisë së tij kur shqiptarët nuk kishin ku të shkolloheshin në gjuhën amtare, Maqedonia e viteve të pjekurisë intelektuale, e cila nuk ishte e gatshme të dëgjojë të vërtetat që ai i shpaloste lidhur me pozitën e shqiptarëve. Ajo Maqedoni, që kurrë nuk e duroi Aliun dhe e detyroi të shpërngulej në Prishtinë.

Edhe Maqedonia e mëvonshme, ajo e viteve të dekadës së parë të shekullit të njëzetënjë, do të jetë një kreature e çuditshme shtetërore, e cila nuk do të dëshirojë të dëgjojë zërin e Ali Aliut, i cili hapur thoshte se ky shtet nuk mund të ndërtohet vetëm sipas dëshirës së etnitetit maqedonas. Zërin e tij publik nuk do të duan ta dëgjojnë as disa kryesues të partive shqiptare, të cilët për hir të përfitimeve personale, harruan popullin. Dhe të cilëve aspak nuk u pengonte se Maqedonia tani e pavarur, më shumë se cilado republikë tjetër, kishte trashëguar kodin gjenetik të politikës serbe antishqiptare dhe të mëmës Jugosllavi nga e cila lindi. Si e tillë, Maqedonia e shpalli pavarësinë duke mos respektuar vullnetin politik të shqiptarëve, dhe i vuri vetes vetëm emblemën e etnitetit maqedonas. Si e tillë, Maqedonia mbeti një shoqëri ku më së miri shihej sa të shtrenjta janë improvizimet politike, zgjidhjet gjysmake

të problemeve ndëretnike dhe sa vështirë është të ndërtohet shtet të vogël në kohët e vrapit marramendës të orës botërore. Si e tillë, Maqedonia do të mbetet e shënuar në hartat botërore si një pikë e zezë dhe e vogël, e cila mbulonte vizionet e mëdha e të kundërta të shqiptarëve dhe të maqedonasve etnikë. Vizione, që kishin të bëjnë për të njëjtin shtet, e që herë pas here, përplaseshin ndërmjet veti. Ato përplasje u rikujtonin faktorëve politikë vendorë e të huaj të gjitha improvizimet nga e kaluara, të gjitha zgjidhjet “sezonale” që kishin për qëllime të përkohshme, sa të kalohej lumi i derdhur ndëretnik, e pastaj të ndërtohej ura. Ali Aliu e dinte se kur bëhej fjalë për vizionet politike, ato ose rrëshqasin mbi tokë dhe ngadalë bëhen realitet, ose fluturojnë e bëhen erë dhe mjegull. Çdo gjë varet nga iluzionistët: nga ajo nëse ata qëndrojnë me këmbë në tokë, apo flatrojnë në qiellin e andrallave të kota. Andaj edhe ky shtet - si edhe shumë shtete të tjera në hapësirat e Ballkanit – jetonte me iluzionin se një ditë do të bëhet pjesë e Evropës së bashkuar, dhe ngushëllohej me bindjen se këto do t’ia mundësonte “pozita e rëndësishme gjeostrategjike”. Apo, thënë ndryshe, se do të mbijetonte falë asaj se i ngjante një “are” mbi të cilët kishin pretendime shumë pronarë, por të cilët nuk posedonin “tapi” për të dëshmuar pronësinë. Ndërkohë, thuajse të gjithë harronin se, këqyrur nga këndi i lojërave globale, pesha “gjeostrategjike” e Maqedonisë ishte më e “lehtë” se ajo e tubacionit të naftës-jellësit AMBO, i cili mbase ndonjëherë edhe do të ndërtohet në këtë pjesë të Ballkanit.

Maqedonia e pavarur i ngjante një shoqërie pa fizionomi të qartë shtetërore. Ajo në të vërtetë shprehte vizionet e mjegullta të etnitetit maqedonas, të cilat

mbështeteshin mbi bindjen se nuk është e lehtë të ndërtosh shtet të përbashkët me shqiptarët, të cilët nuk i ngin asgjë, dhe se përtej ëndrrës së mjegullt të shqiptarëve, do të vijë dita kur të gjitha “shqipëritë” do t’i bashkojë Brukseli. Mbase konceptet politike të Maqedonisë së viteve nëntëdhjetë dhe të dekadës së parë të mileniumit të tretë, më së miri i shprehte papërcaktueshmëria e veprimit politik të disa udhëheqësve partiakë shqiptarë, të cilët herë rrisnin namin e vet me nacionalizmin e ashpër dhe atdhetarinë e përmasave “rilindëse”, e herë me multietnicizëm të përafërt me kozmopolitizmin që do e pëlqente cilido neokomunist i botës, e lëre më demokratët e etnitetit maqedonas. Portreti shtetëror i Maqedonisë, mbeti i mbuluar edhe nga mjegulla e paqartësive të etnitetit maqedonas nëse janë vëllezër të sllavëve të jugut, apo nipërit e Aleksandrit, siç filloi të propagandohet pas zhbërjes së Jugosllavisë. Ky portret mbeti i paqartë edhe falë ambicieve politike të shqiptarëve, të cilat ishin të menaxhuara nga prijësit partiakë, të cilët derisa ishin në opozitë, i përkuleshin vetëm shqiptonjës dykrenore dhe flisnin vetëm shqip, e kur vinin në pushtet, puthnin cilindo flamur të partisë maqedonase që i bënte pjesë të koalicionit qeveritar, dhe përdornin aforizma serbe për të shpjeguar qëllimet partiake.

Në një Maqedoni të tillë, çdo gjë mbetet e pathënë deri në fund. E tillë do të mbetet edhe Marrëveshja e Ohrit, e cila duhej të jetë gurthemel më i fortë i harmonisë ndëretnike. Gurthemel, i cili mbase u humb gjatë “përkthimit” të kësaj marrëveshje të shkruar anglisht, të cilën njësoj duhej ta kuptonin edhe maqedonasit etnikë, edhe shqiptarët, por e përkthyer me alfabetin cirilik dhe latin, ajo nuk kishte të njëjtën domethënie. Mbase edhe

për shkak të përkthimit të dyfishtë, Marrëveshja e Ohrit u shfaq gurtthemel i dobët për të mbajtur mbi vete vizionet e etnitetit maqedonas, të cilët edhe më tej do të ëndërrojnë të mbeten “pronarë” të vetëm të shtëpisë, me shqiptarët “qiraxhinj” të zhurmshëm në të. Pra, ende pa kaluar pesë vite nga nënshkrimi i saj, Marrëveshja e Ohrit u tregua si kornizë jo e përshtatshme, jo sa duhet e gjerë dhe e gjatë, që të mbajë pranë njëri-tjetrit portretet e dy etnive numerikisht më të mëdha të Maqedonisë – atë të etnitetit maqedonas dhe atë të shqiptarëve të këtushëm. Se Marrëveshja e Ohrit ishte e gozhduar me ambicie të mëdha, por pa ia përcaktuar madhësinë e duhur, u dëshmuua gjatë mosmarrëveshjeve të vitit 2006, në procesin e formimit të koalicionit qeveritar, kur mandatarin nuk përfilli vullnetin politik të shumicës shqiptare që kishin votuar për Bashkim Demokratik për Integrim, të Ali Ahmetit dhe, duke përdorur metodën “demokratike”, të cilën nuk ia pengonte as kushtetuta e as ligji, mandatarin i qeverisë, kryetarin e partisë VMRO-DPMNE-së, përfshiu në kabinetin e vet “vëllezërit e gjakut” të PDSH-së. Me çka edhe nxori në sipërfaqe një mangësi të madhe të Marrëveshjes së Ohrit: ajo nuk ka përcaktuar më qenësoren për shqiptarët e këtushëm – si të mbrohet vullneti shumicë politike i tyre nga mazhorizimi etnik. Kjo e detyroi Ali Ahmetin që edhe një herë të përveshë mëngët dhe të fillojë “betejën” kundër asaj që nuk i pengonte Arbër Xhaferit: të bindë opinionin vendor dhe ndërkombëtar se Marrëveshja e Ohrit nuk vlen gjë nëse shqiptarëve u merret e drejta që vota e tyre e lirë të përcaktonte se cilët do të jenë përfaqësuesit e tyre në organet më të larta shtetërore, dhe të dëshmojë se lojërat me vullnetin e shumicës politike të shqiptarëve të

këtushëm – bile edhe kur janë të ndihmuara nga një parti shqiptare – këtë shtet mund ta çojnë vetëm drejt një marrëveshje të re të Ohrit. Me çka, mbase do të pasurohej historia bashkëkohore e këtij shteti, mirëpo do të kalbej nga brenda edhe ajo pak forcë lidhëse në mes të qytetarëve me përkatësi të ndryshme etnike. Këtë gjë, atë vit zëshëm e shprehte edhe Ali Aliu, duke shtruar edhe pyetje direkte, drejtuar kryesuesve të Partisë Demokratike Shqiptare: Cili ishte ai interes më i lartë kombëtar, që i shtyu të bëhen pjesë e qeverisë së VMRO-DPMNE-së (Vnatreshna Makedonska Revolucionerna Organizacija – Demokratska Partija za Makedonsko Nacionalno Edinstvo, Organizata e Brendshme Nacionale Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim Nacional Maqedonas), dhe të shkelnin mbi vullnetin politik të popullit që prezantonin. Por, në vend të përgjigjeve, mori ofendime nga kalemxhinjtë e pafytyrë, që mbase edhe harronin se i drejtoheshin njeriut, i cili tërë jetën ia kishte kushtuar të ardhmes së ndritshme shqiptare. Ata nuk e kuptonin se Ali Aliu, më shumë se kushdo qoftë tjetër, kishte arsye të jetë i pakënaqur me marrëveshjen e Ohrit, ngaqë ai e dinte se ora e bardhë historike nuk mundësonte realizim të ëndrrës kombëtare për bashkim. Andaj edhe i dukej e pakuptimtë që marrëveshjen më shpresëdhënëse për një shtet të përbashkët, ta shkelte (edhe) një parti shqiptare; i dukej e pabesueshme që atë ta zhbënin prijësit partiakë që çdo gjë e kishin arritur duke rrahur gjoksën për shqiptari, e duke qëndruar nën flladin e flamurit me shqiponjën dykrerëshe.

Ali Aliu e dinte se Marrëveshja e Ohrit nuk shprehte vetëm mosguximin politik të partive në Maqedoni që të shkojnë deri në fund në “gozhdimin” e kornizës që do të

përcaktonte marrëdhëniet ndëretnike shqiptaro-maqedonase, por edhe hamendjen e institucioneve euro-atlantike sesi të shkohet më tutje me këtë shtet “eksperimental”, i cili duhet të arsyetonte “investimin” ndërkombëtar se Ballkani s’ ishte tokë jopjellore për konceptet multietnike. Sikur mos ishte kështu, as partitë politike të Maqedonisë, e as institucionet ndërkombëtare, nuk do të nënshkruanin marrëveshje ku mungonin zgjidhjet, marrëveshje, të cilat vetëm naivët mund t’i besonin se herdo - kurdo nuk do t’u vijë radha të shtrohen në tavolinën e bisedimeve. Mbase të prirë nga dëshira që sa më shpejt të merrte fund konflikti i 2001-shit, nënshkruesit e Marrëveshjes së Ohrit nuk kishin mundur t’i kushtonin rëndësi edhe asaj çështjeje pa të cilën nuk mund të qëndronte ndërtesa multietnike e Maqedonisë – zgjidhjen kushtetuese të koalicionit dyetnik qeveritar, mundësinë që funksionet më të larta shtetërore të mos u takojnë, gjithmonë dhe të gjitha, vetëm maqedonasve etnikë, por të bëhet e mundur në këto poste të zgjidhen edhe shqiptarët.

Sido që të jetë, mbetet e vërteta se, njësoj si Maqedonia, edhe partitë shqiptare të viteve nëntëdhjetë e të dekadës së parë të shekullit njëzet e një, kurrë nuk arritën të profilizohen si subjekte me koncepte të qarta politike. Mbetën duke u lëvarur mes vizioneve demagogjike atdhetare të kryesuesve partiakë - përderisa ishin në opozitë - dhe ambicieve multietnike, kur vinin në qeveri. Të tillë mbeten edhe votuesit shqiptarë: të hutuar nga pamundësia të përcaktojnë nëse partitë e tyre mbështeten në koncepte të qarta politike, apo veprojnë si “kompani private” që u sjellin përfitime vetëm rretheve të ngushta partiake. Dhe s’ mund të mos vërejnë se nuk ishin vetëm

qarqet politike të etnitetit maqedonas ato që ëndërronin dhe që kishin nostalgji për Maqedoninë para Marrëveshjes së Ohrit, por kishte edhe udhëheqës partiakë shqiptarë që me ëndje kujtonin vitet kur në arën politike të Tetovës mbillnin patriotizëm e atdhetari, teksa në sofrën e pushtetit në Shkup ushqeheshin me frutat që ua sillte “maunokracia”. Kështu, shqiptarët e Maqedonisë vonë do e kuptojnë se partia të bën shërbëtorë të pavlerë, nëse nuk e dinë pse i beson. Shqiptarët e Maqedonisë, edhe pas Marrëveshjes së Ohrit që shënoi fundin e konfliktit të 2001-shit, nuk ishin shumë më larg se përpara nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje: ndodheshin në paradhomën e zhurmshme ku shumica e etnitetit maqedonas, e përkrahur nga “analistë” e “strategë” shqiptarë, zbërthente atë që mund të shpjegohet, por s’mund të arsye-tohej: mandatarit ka të drejtë të zgjedhë cilëndo parti shqiptare si pjesë të koalicionit të vet qeveritar.

Maqedonia mbeti e ngërthyer në kthetrat e “mosmarrëveshjes historike” mes shqiptarëve të këtushëm e maqedonasve etnikë. Mbase mund të ndodhë që ky shtet të mbetet vetëm si “kreaturë” e vizioneve të kundërta etnike, një shoqëri të cilën nuk mund ta përcaktosh as si shtet njëetnik, as si multietnik, por thjesht si shtet, i cili qëndron mbi themelet e koncepteve të pathënë deri në fund. Dhe si i tillë, ky shtet i ngjante dhe i ngjan një sajese të çuditshme të ambicieve të paqarta etnike, një pushimoreje të përkohshme ku edhe etniteti maqedonas edhe ai shqiptar prehen dhe fshijnë djersët. Thujse bëhen gati të vazhdojnë gërryerjen e mirëfilltë të themeleve mbi të cilat do të ndërtojnë ardhmërinë e përbashkët. Mbase edhe hamenden sesi t’i pastrojnë llogaritë e lënë anash

pas konfliktit të 2001-shit, apo ndoshta janë në pritje që dikush t'u ndihmojë të kuptojnë se shteti nuk ndërtohet nga inatet partiake dhe etnike, dhe se janë të mbyllur të gjitha mundësitë për konflikte ndëretnike, e që kanë mbetur hapur vetëm dyert për Marrëveshjen numër dy të Ohrit, e cila ndoshta do të përcaktojë kufijtë e kantoneve të Maqedonisë. Këtë mundësi duhej t'ua shpjegonte dikush edhe bashkëpunëtorëve të Ali Ahmetit, të cilët të kuptonin se viti 2006 ishte një mundësi historike për të përcaktuar deri në fund disa zgjidhje pa të cilat kurrë s'do të ketë harmonizim të marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni. Duhej dikush t'ua shpjegonte udhëheqësve partiakë të BDI-së se ndodheshin para një beteje politike, të cilën duhej ta zhvillonin duke lënë anash popullin, para një "luftë", të cilën duhej ta bartin mbi supë prefektët e komunave të kësaj partie dhe kabineti i qeverisë së Gruveskit. Luftë mes institucioneve vendore që i kontrollonte BDI-ja dhe qeverisë, e cila nuk do të shkaktonte ndasi të mëtutjeshme brendashqiptare, por do t'ia rikujtonte Gruveskit dhe të tijve të klubit "Nostalgjikët e Maqedonisë së para 2001-shit", ku bënte pjesë edhe Arbër Xhaferi, se shteti mund edhe të kthehej atje ku ishte para Marrëveshjes së Ohrit, por vetëm nëse të gjithë shqiptarët e Maqedonisë bëheshin anëtarë të PDSH-së dhe pranonin të votonin për kandidatët e VMRO-DPMNE-së, ashtu siç bënë disa tetovarë gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, kur një kandidat i BDI-së i humbi zgjedhjet si shkak se disa shqiptarë të atjeshëm mbështetën kandidatin e VMRO-DPMNE-së. Me çka, mbase për herë të parë, u promovua veprimi politik shumetnikë. Ky veprim, edhe si i tillë, nuk shprehte aspak zhvillimin e konceptit multi-etnik në shtet, por dëshmonte

mjerimin politik të udhëheqësve partiakë, të cilët kurrë nuk paguajnë vetë kur ulen të drekojnë në restorant, dhe ku ka më shumë rëndësi t'i kushtojnë vëmendje madhësisë së pjatës apo kamerieres së bukur.

Në të vërtetë, partitë shqiptare në Maqedoni nuk e shihnin atë që Ali Aliu publikisht e kishte thënë qysh në vitin 1995: “Qarqet politike të etnitetit maqedonas gjithmonë do të duan të ndërtojnë mekanizma të pushtetit që do të mbajnë nën mbikëqyrje dhe nën kontroll të gjitha partitë politike, shoqatat kulturore, humanitare, arsimtare, të gjitha institucionet e arsimit dhe kulturës, gazetat dhe kanalet radiotelevizive të shqiptarëve të Maqedonisë. Dhe këtë do ta arrijnë me ndihmën e specialistëve të rinj e të vjetër të çështjes shqiptare, si edhe me ndihmën e “atdhetarëve” të mëdhenj shqiptarë që atdhetarinë e kanë si tullë për t’u ngjitur në lartësitë e pushtetit ku realizojnë përfitime të mëdha personale!”. Vallë, këtë që Ali Aliu e kishte vërejtur qysh në vitet nëntëdhjetë, nuk e shihnin prijësit partiakë të Maqedonisë së paskonfliktit të 2001-shtit? Përgjigjen e kësaj pyetje do të mund ta japin ata që do të kenë mundësi të hapin dosjen complete me mbititullin “Maqedonia pas shpërbërjes së Jugosllavisë” ku do të mund të gjejnë dëshmi për saktësinë e pohimeve të thëna publikisht nëpër mediat maqedonase se shumë parti të këtij shteti – ndër të cilat edhe Partia Demokratike Shqiptare – ishin ngjizur në kabinetet e errëta policore, vetëm e vetëm sa të dëmtonin bërthamën politike të shqiptarëve të Maqedonisë. Këto pohime, dhe shumë hamendësi të pambështetura në fakte, do të mund t’i zbardhin gjenerata, të cilat nuk do të kenë ngarkesa dhe hipoteka partiake, që e dinë se e sotmja e çdo populli është arë ku mbillet fara e ardhmërisë dhe se e ardhmja është

pemë përplot frute nga e cila ushqehen të gjithë që jetojnë të sotmen. E, fara që hidhnin partitë shqiptare të Maqedonisë në fillimshekullin e njëzetënjë, ishte farë e grindjeve ndërpartiake, një luftë e pakuptimtë, që dëmtonte interesat e popullit. Nuk ishte nga ajo fara e mbarë që do t'i ndihmonte Kosovës, e cila padurueshëm priste pavarësinë e vet, priste kurorëzimin e gjakut të derdhur rinor nga 1981-shi e deri në 1999, kur Jugosllavinë e Millosheviqit e bombardonin trupat e NATO-s, duke e parë se klika e tij nuk ishte nginjur me gjakun e derdhur në Kroaci e Bosnjë: dëshironte edhe atë të rinisë kosovare.

Fara e mbrapshtë që dëmtonte popullin shqiptar ishte hedhur edhe në arën politike të Shqipërisë, ku prijësit partiakë grindeshin si armiq të përbetuar. Edhe në Tiranën e dekadës së parë të mileniumit të tretë, vinte në shprehje politika grindavece dhe Shqipëria mbetej peng e Berishës dhe Nanos, si edhe e një elite që nuk kishte forcë të pastrojë arën politike nga kullosa e egër e grindjeve të pakuptimta ndërpartiake. Tirana e vitit 2005 mbase as që e dinte se Shtëpia Botuese “Sermebe” e Shkupit, kishte botuar veprat e zgjedhura në katër vëllime të Ali Aliut, sepse ajo jetonte kohën e arrogancës së vet kulturore kur mendonte se matanë kufirit ka shumë pak krijimtari të vlefshme, që duhet çmuar. E në këto libra, në të vërtetë ishte përmbledhur pasuria e bibliotekës kombëtare, apo si do të thotë prof. Alfred Uçi gjatë përrurimit të veprës katërvëllimëshe në Shkup: “Veprat e zgjedhura” në katër vëllime të Akademikut Ali Aliu, po të shprehemi përmbledhtazi, do t'i quanim një enciklopedi e plotë e letrave shqiptare, një tekst historie i letërsisë shqiptare për universitetet, një manual i teorisë bashkëkohore të kritikës letrare.”

Dhe tingëllon mirë që ky përrurim u bë në Shkup, ashtu si veprat e zgjedhura në katër vëllime të Ali Aliut që u botuan në kryeqendrën e Maqedonisë. Shkupi ia kishte borxh njeriut, i cili kudo që shtegtoi, nuk harroi të drejtë shikimin nga qyteti, të cilit thujse ia kishin shlyer çdo emblemë shqiptare. Qytetit që dikur, gjatë shekujsh, kishte qenë qendër e rezistencës dhe kulturës shqiptare. Prandaj përrurimi i veprimtarisë krijuese të Ali Aliut, kishte domethënien e një vetëdije të re që paralajmëronte Shkupin e fillimshkullit të njëzetënjë, që tani kishte edhe një komunë shqiptare, udhëhequr nga një i ri, i cili kishte kuptuar çka i kishin borxh gjeneratat e reja Shkupit. Prandaj dhe ky kryetar i shkupjanëve shqiptarë, i quajtur Izet Mexhiti, do të jetë një ndër ata që kanë më shumë merita për “ardhjen” e Skënderbeut në Shkup dhe ringjalljen kulturore të shqiptarëve aty.

Shkupi i dekadës së parë të shekullit të njëzetënjë, me asgjë nuk i ngjante atij ku Aliu kishte qenë nxënës i shkollës së mesme, atij të viteve pesëdhjetë, kur nëpër tregjet e qytetit dominonin plisat dhe thujse të gjitha dyqanet e artarëve dhe orëtarëve ishin pronë e shqiptarëve katolikë. Shkupin e atëhershëm, kur nëpër lagjet shqiptare mundje gjatë dimrit të blesh kungull të pjekur e të ëmbël si mjalti, e morën me vete kolonat e shqiptarëve myslimanë që u shpërngulën në Anadoli ku u bënë turq dhe vagonët e mbushur me shqiptarë katolikë, që shtegtuuan në Kroaci ku u shkrinë dhe u bënë kroatë. Shkupi i rinisë së Ali Aliut ishte tretur në trishtimin e atyre që shtegtonin në humbëtitë, por edhe në hidhërimin e shqiptarëve të tjerë që mbetën në vendlindje duke u mëdyshur tërë jetën nëse kryqi a gjysmëhëna gëlltiti më shumë shqiptarë nga këto troje. Kryeqendra e Maqedonisë

nuk kishte asnjë ngjashmëri me qytetin e viteve kur Ali Aliu punonte si gazetar në “Flakën e vëllazërimit”, me atë të viteve gjashtëdhjetë, kur paralagjet ishin përplot me kopshte që ushqenin me frute gjithë shkupjanët. Atë kryeqendër e gëlltiti tërmeti i verës së vitit 1963, dhe e mbuloi industrializimi socialist, i cili ndërtoi fabrikat dhe hekuranën e madhe, që edhe sot qëndron aty përgjithësi si një elefant i ngordhur, të cilin s’ke si e nxjerr nga kafazi. Kopshtet e dikurshme të Shkupit të paratërmetit, u zhdukën nën themelet e katrorëve shumëkatësh ku do të strehoheshin iluzionet e proletarëve të barabartë. Shkupi i viteve të Maqedonisë kinse demokratike, nuk ishte më as ai i viteve shtatëdhjetë kur – për nga numri i banorëve – kryeqendra e Maqedonisë socialiste ishte kryeqyteti i shqiptarëve (me afër 300 mijë banorë shqiptarë), jo thjesht pse u pakësua numri i tyre, por për shkak se Tirana theksoi joshjen të bëhej qytet “bregdetar” duke arritur deri në Durrës, ndërsa Prishtina e çliruar nga thundra serbe, thuajse u bashkua në jug me Ferizajn. Shkupi i dekadës së parë të mileniumit të tretë, nuk ishte as ai i viteve tetëdhjetë, kur jehonin britmat e të rinjve shqiptarë që mbushnin stacionin e autobusëve, teksa shkonin në Prishtinë ku nëna Kosovë u mundësonte të studionin dhe edukoheshin shqip, pasi që Maqedonia nuk duronte alfabet tjetër përpos atij cirilik. Britmat e rinisë shqiptare të Shkupit të viteve tetëdhjetë i heshti beteja e ashpër kundër “nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”, kur u mbyllën të gjitha institucionet arsimore në Kosovë. Shkupi i kohës së grindjeve ndërpartiake shqiptare të vitit 2006 nuk i ngjante as atij të viteve nëntëdhjetë, kur së pari herë pas shumë dekadave, nëpër këtë kryeqendër fluturoi lirshëm shqiponja dykrerëshe e shqiptarëve,

njësoj si në kohët kur nëpër lagjet e tij shëtisnin kryengritësit shqiptarë të Rekës së Epërme (regjion në afërsi të Dibrës) që disa herë me radhë në kohën e Perandorisë Osmane çliruan Shkupin, që prapë t'ua linin të tjerëve.

Shkupi i vitit 2006 ishte një qytet pa fizionomi që vështirë ta kujtonte të kaluarën. Si edhe banorët e tij, qyteti kishte stinët e jetës së vet, të cilat nuk përfundonin kur mbyllej një kalendar kohor dhe fillonte shfletimi i tjetrit, por vetëm atë ditë kur nuk kishte kush ta kujtonte. Mbase ngjashmëria mes njerëzve dhe qyteteve nuk përfundon këtu: njeriu që jeton në më shumë vendbanime, mbetet pa tipare dalluese të grupit nga vjen, ndërsa qytetet ku shpesh ndryshon përbërja e banorëve, mbetet pa fizionomi. Siç kishte mbetur Shkupi i vitit 2006, kur Akademiku i parë i shqiptarëve të Maqedonisë, Ali Aliu (anëtar i rregullt i Akademisë së Arteve dhe Shkencave e Kosovës që nga viti 2000), u bë anëtar i jashtëm i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Maqedonisë, shtetit kryeqendra e të cilit dhe Ura e Gurit, emblemë shekullore e tij, ishin ndryshuar. Kishin bërë, të mos i ngjante asaj të dikurshmes, disa urëndërtues të rinj, në rrekje për ta bërë “më të bukur e më të vjetër” nga ajo që e kishin ndërtuar dhe lënë pas vetes Osmanllinjët. Tashmë ajo i ngjante një plaku me feste në kokë, por të veshur me pantallona të arnuara sllave. Urës së Gurit që ishte kronikë e saktë e kohës, ndërtuesit maqedonas të kohëve të reja ia zhveshën “ferexhenë” orientale që të jetë sa më “evropiane”, e tillë siç mendohej të bëhet Maqedonia e pavarur, e që në fundshekullin e njëzetë kishte më shumë se katërqind mijë të papunë, shtet nga ku çdo ditë niseshin autobusë me të rinj që braktisin vendlindjen. Ashtu siç

mbeti shtet që në të vërtetë nuk vlen hiç më shumë seç ka dhe ofron kryeqendra e tij, ku nga provinca kanë ardhur të jetojnë thuajse të gjithë të përkatësisë etnike maqedonase, përpos atyre që janë larg jetës e afër vdekjes - pleqtë. Shkupi i sotëm, ka shumë bulevarde përplot gropa, është qytet ku thuajse askush nuk përfill ngjyrat që ndizen dhe fiken nëpër semaforë. Udhëkryqet e kësaj kryeqendre shpesh janë gdhirë të bllokuar nga protestuesit e ngjyrave të ndryshme etnike dhe partiake. Në ato udhëkryqe shpesh përplasen e kaluara dhe e sotmja e këtij qyteti, si dy të huaj që jetojnë në të njëjtin qytet, por nuk kanë asgjë të përbashkët mes veti.

Shkupi i viteve kur Ali Aliu bën shëtitjet e përditshme buzë Vardarit, nuk ka asgjë të përbashkët me atë të dekadave të dikurshme që ka mbetur vetëm nëpër panoramat e vjetra. Mbase vetëm lumi Vardar është ai që ndërlidh të kaluarën dhe të sotmen e këtij qyteti. Valët e lumit që buron në Vrutok (në afërsi të Gostivarit) dhe derdhet në detin Egje, janë ato që detit ia rrëfejnë të gjitha që kanë parë, që nga burimi e deri në vendin ku uji i ëmbël i dorëzohet pushtetit të njelmësisë detare. Valët e këtij lumi, te burimi i përkëdhel jehona e zërit të myezinëve, që vjen nga minaret e larta të Gostivarit, ndërsa para se të derdhen në det fillojnë të matin kohën sipas rënies së kabanave të kishave ortodokse. Por edhe si i tillë, Vardari arrin të mbetet shtrat i përjetshëm për peshqit e vet. Më në fund, ku është parë që lumi t'ia dorëzojë banorët e vet uJORË detit! Ku është parë që peshqit e lumit të durojnë ujin e njelmët të detit. Kalimthi, lumi bën edhe një punë të veten, prej shekujsh kështu: e ndan Shkupin në dy pjesë thuajse të barabarta - në pjesën jugore që shtrihet deri në rrëzë të malit Vodno dhe në pjesën veriore, e cila ngadalë

i afrohet kufirit me Kosovën. Apo në pjesën moderne ku jetojnë banorët me përkatësi etnike maqedonase dhe atë me lagje pa infrastrukturë urbane, ku dëgjohen britmat e fëmijëve shqiptarë, të cilët mbushin rrugët e ngushta, duke mos patur hapësirë ku të shfryjnë lazdraninë fëmijërore. Aty është duke u ndërtuar godina e re e gjimnazit në gjuhën shqipe “Zef Lush Marku”, e cila me vite mbeti vetëm ëndërr e shqiptarëve të këtushëm, edhe pse leadershipët e partive shqiptare, sa herë që janë mbajtur zgjedhjet lokale apo parlamentare, kishin përruruar fillimin e ndërtimit të saj me vënien solemne të gurthemelit. Mbase ndërtimi i gjimnazit shqiptar në Shkup vonohej edhe për shkak se ndërkohë duhej të ndërtohej kryqi gjigant në majë të malit Vodno, për të cilin u harxhuan edhe para nga taksapaguesit shqiptarë dhe i cili sot shihet ngado që të hysh në Shkup. Kryq, i cili, ndoshta nuk shpreh gjithaq adhurimin ortodoks ndaj simbolit të tyre religjioz, sa bindjen e atyre që mendojnë se në Maqedoni edhe malet, njësoj si edhe qielli dhe hëna në të, janë me origjinë ortodokse fetare. Kryq që do të shënojë kohën kur fashitet gara dekadëshe mes dy përbindëshave – kapitalizmit dhe marksizmit, por edhe kohën kur fillon rivaliteti midis religjioneve.

Në historinë e Shkupit do të mbeten të shënuara shumë data të lavdishme dhe tragjike nga e kaluara. Sa i përket historisë së Shkupit, shqiptarët që jetojnë në këtë qytet do t'i rikujtojnë datat kur paraardhësit e tyre mbronin dhe çlironin një ndër kryeqendrat e kulturës dhe identitetit të tyre. Shqiptarët do të rikujtojnë në të ardhmen edhe dy eksodet e mëdha kur këtij qyteti iu shlye shumëçka shqiptare dhe bindshëm filloi të dominojë shenja njohëse e etnitetit maqedonas: atë të viteve

pesëdhjetë të shekullit të njëzetë kur u nisën kolonat për në Anadoll e Kroaci, dhe ato të viteve nëntëdhjetë të po këtij shekulli kur Shkupit iu zhveshën të gjitha shenjat e shqiptarisë. Përderisa eksodi i parë ishte i dhunshëm, i nxitur nga të tjerët, deshqiptarizimin e Shkupit të viteve nëntëdhjetë e bënë vetë shqiptarët, të cilët rrënuan edhe ato pak institucione shqiptare në kryeqendrën e Maqedonisë dhe i shpërngulën në Tetovë. Duke qenë të prirë nga instinkti provincial dhe mendjemadhësia e leadershipëve partiakë, të cilët mbase kishin ambicie gjithëpopullore e kapacitet mëhalleskë, të gjitha partitë shqiptare zgjodhën që selitë e veta t'i kenë në Tetovë. Kështu arritën të realizonin ëndrrën sllave që Shkupi të ketë sa më pak veshmbathje të kulturës dhe civilizimit shqiptar, që në kryeqendrën e Maqedonisë të dominojë vetëm alfabeti cirilik dhe kryqi gjigant në majë të malit Vodno.

Shkupjanët e dekadës së parë të mileniumit të tretë, kanë shpresë se gjenerata e perfektit të komunës së “Çairit”, ajo e Izet Mexhitit, do të arrijë të korrigjojë gabimet e bëra në të kaluarën dhe do t'ia arrijë të ringjallë Çarshinë e Vjetër, rrugicat e të cilës vite me radhë janë shkretuar. Mbase përmendorja e Skënderbeut, i cili qëndron mburrshëm në vijën “kufitare” që ndan “Shkupin e shqiptarëve” nga “i maqedonasve”, do të arrijë t'u mundësojë shkupjanëve të rinj të mos mbajnë kokën kthyer nga Tetova, ku janë dy universitetet në gjuhën shqipe. Mburrrshëm të kalojnë Urën e Gurit, të cilën gjithnjë e më rrallë e shkelin ata të etnitetit maqedonas. Këtë urë e braktisën edhe lypsarët e vegjël romë. Edhe ata e lanë të shkretë urën shumëshekullore. Disa prej tyre u ulën përpara kishave ortodokse në pjesën e Shkupit maqedonas, e të tjerët para xhamive në pjesën shqiptare.

Lypsarët që ende i besojnë konceptit multietnik, tani janë nëpër udhëkryqet e Shkupit ku u shtrijnë dorën vozitësve në pritje t'u ndizet drita e gjelbër në semaforë, atyre vozitësit që thujnë nguten të arrijnë aty ku janë - askund.

Kryeqendra e Maqedonisë e dekadës së parë të shekullit njëzet e një, është më e urbanizuar se Prishtina dhe Tirana. Sepse Shkupi përfitoi nga tërmeti i viteve gjashtëdhjetë dhe nga dekadat socialiste kur personalisht Titoja dha urdhër që ky qytet të shprehte solidaritetin jugosllav dhe botëror. Rrugët e Shkupit janë më të gjera dhe me më pak gropa se ato të Tiranës. Ajo që bulevardet e këtij qyteti i bën të ngjashme me tollovinë e kryeqendrave fqinje, janë vozitësit nevrinë, të cilët posa ulen pranë drejtuesit të makinave, fillojnë të shajnë cilëndo që u del përpara. Edhe në Shkup, si në Tiranë, gjobë për gabimet gjatë vozitjes paguajnë veç ata që nuk kanë asnjë dajë deputet apo figurë të njohur publike. Dhe sa herë që kalojnë kolonat e veturave qeveritarëve, pezullohet lëvizja në ndonjë lagje, apo bulevard. Burrështetasi e Maqedonisë e dinë se banorët e shtetit që drejtojnë nuk kanë pse të nguten, se prej moti kanë arritur aty nga nuk shkohet më tej - në stacionin e pashpresës. Vozitësit aty e dinë se s'ka pse respektohen shenjat e semaforëve, por duhet t'ua lëshosh rrugën veturave të biznesmenëve, qeveritarëve, parlamentarëve dhe "maunokratëve", të cilët kanë imunitet dhe mund të të shkelin e të kalojnë mbi ty si mbi ndonjë mace rruge që s'ka as Zot, as pronar: atyre s'kanë ç'u bëjnë gjyqtarët e "pavarur" që vërtet mbajnë në dorë peshoret ligjore, por dënojnë sipas kandarit partiak.

Shkupi modern e demokratik është letërnjoftimi i vetëm i Maqedonisë. Në të jetojnë edhe më shumë se dyqind mijë shqiptarë. Shqiptarët më të dukshëm të

Shkupit janë shitësit e vegjël të cigareve në Bit-Pazar dhe “katundarët” e vendbanimeve që rrethojnë kryeqendrën e Maqedonisë si një unazë bashkëshortore, e cila simbolizon pandashmërinë deri në vdekje mes të fejuarve. Unaza e formuar nga fshatrat e banuar me shqiptarë, ka mbetur pa gishtin e vet, se brenda qytetit ka shumë shqiptarë, por pak shqiptari. Shqiptaria është mbyllur në çajtoret e tymosura ku vështirë mund të dallohen fytyrat e atyre që zhurmshëm diskutojnë se vallë PDSH-ja, apo BDI-ja e Ali Ahmetit ka bërë më shumë që kryeqendra e Maqedonisë të jetë Shkup i shqiptarëve po aq sa “Skopje” e etnitetit Maqedonas. Kur i lodh tymi i cigareve e ngrihet tensioni nga çaji i rëndë turk, adhuresit e PDSH-së, njësoj si të BDI-së, bien dakord se Vardari që ndan Shkupin në dy pjesë, prej moti i ngjan lumit që ka ura, por jo kalimtarë që lëvizin nga bregu jugor në atë verior.

Shkupi i vitit 2006 nuk është as ai i fëmijërisë, as ai rinisë së hershme të Ali Aliut. Nuk i ngjan as pjekurisë së Akademikut të parë të shqiptarëve të Maqedonisë, sepse përderisa Ali Aliu ka fizionomi të qartë krijuese dhe atdhetare, Shkupi ka mbetur me hapin në ajër, pezull mbi plasaritjen që ndan të kaluarën dhe të ardhmen e këtij qyteti. Shkupi i viteve nëntëdhjetë ishte pronë e mafies ndërtimore, të cilës nuk i interesonte as e kaluara, as e ardhmja e kryeqendrës së Maqedonisë, por vetëm fitimi nga pallatet e larta, të cilat mbinin jo vetëm aty ku ishte e paraparë sipas projekteve, por çdokund ku themelet i gërryen paraja dhe forca partiake. Andaj edhe Shkupi i atyre viteve s’ishte vetëm letërnjoftim i Maqedonisë, por edhe portreti pa fizionomi i një kohe kur çdo gjë luhatej mes së djeshmes së errët të njëmendësisë komuniste, dhe të sotmes tymosur me çmenduri demokratike.

RRËNOJAT E ILUZIONALEVE

Asnjë vendbanim tjetër nuk e shpaloste aq bindshëm, si Tetova, realitetin e shoqërisë së shqiptarëve të Maqedonisë në dekadën e parë të shekullit njëzet e një. Atë realitet që qëndronte pezull mes të mundshmes dhe të dëshiruarës, mes humbjeve nga e kaluara që s'kompensoheshin dot me asgjë, dhe përditshmërisë së tyre që thuajse qëndronte mes udhëkryqit me semaforë të prishur. Këtë realitet, sa e ngjyrosnin të rinjtë e ndodhur përpara ardhmërisë si kopsht me ëndrra të venitura, po aq edhe gjeneratat e vjetra me hove të thyer, me njërën këmbë në ideologjinë socialiste, e tjetrën në kaosin demokratik. Askund si në Tetovë, nuk mund të lexoheshin porosinë domethënëse të rinisë shqiptare në Maqedoninë e fillimshkullit të njëzetënjë, që shkruheshin sa nga shikimi i syve lozonjarë të ndonjë vashe të mbuluar me shami, aq edhe nga buzagazi lazdran i ndonjë goce me barkun cullak e dy të tretat e gjinjve të zbuluar. Tetova u bë vendbanimi që kishte domethënien e letërnjoftimit si grup të shqiptarëve të Maqedonisë, jo vetëm pse kishte dy universitete e më shumë “shtëpi publike” sesa biblioteka, por edhe se aty ishte më i dukshëm akulturimi dhe kriminalizimi i shoqërisë shqiptare, aty ashiqare shihej procesi i rrugaçërimit të partive shqiptare, të cilat thuajse

tërë aktivitetin e vet e mbështesnin në “muskujt” e fortë partiakë dhe grindjet e veta i derdhnin mbi popullin e hutuar. Aty mund të shihej qartë se shtresa e paktë intelektuale e këtij populli, ishte vetëmargjinalizuar e kishte mbetur në margjina të rrjedhave shoqërore; kjo shtresë ishte bërë thjesht spektatore pasive e ngjarjeve që shtonin grindjet brendashqiptare, grindje që arritën kulmin në vitin 2006, kur më nuk dihej se vallë shqiptarët e Maqedonisë janë në mosmarrëveshje me vetveten, apo me të tjerë që jetonin në këtë shtet. Këtë vit, në qytet ndodhën vrasje që i çonin tetovarët të ecnin kokulur, ngarkuar me peshën e hamendjes se vallë e vërtetë do të jetë thënia se kur shqiptarit i mungojnë armiqtë, ai armiqësohet me vetveten? Në këtë vit Tetova varrosi edhe trimin e vet, Isa Likën (Komandant Ilirin e UÇKS-së), i cili arriti t’u shpëtojë vrasësve maqedonas gjatë konfliktit të 2001-shit, por jo edhe atyre që e sulmuan përpara pragut të shtëpisë së vet. Kjo i shtynte jo vetëm tetovarët, por të gjithë shqiptarët e Maqedonisë, të mendonin se ndoshta konflikti i 2001-shit ende nuk kishte marrë fund, se ai tashti vetëm kishte shtegtuar mes shqiptarëve, se hakun që disa qarqe maqedonase donin ta shpaguajnë nga bashkëluftarët e Ali Ahmetit, tani e merrnin shqiptarët që u kishin shitur edhe shpirtin qarqeve të etnitetit maqedonas, qarqeve që edhe më tej donin t’i sundojnë shqiptarët sipas parimit: “përçaj e sundo”, sipas rregullit, “futi grindjen, dhe le t’ia hanë kokën njëri-tjetrit”.

Tetova e dekadës së parë të mileniumit të tretë, nuk dinte si të dilte prej spirales së partive që e kishin shndërruar në “seli” të mosmarrëveshjeve brendashqiptare, s’dinte si shpëtohej nga kafenetë e panumërta ku ushtonte “turbo-folku” turko-serb. Tetova e atyre viteve nuk dinte edhe si

t'ia dalë në krye me nevojën për objekte kulturore dhe sportive, ku do të harxhonin kohën të rinjtë shqiptarë që ia mësynin këtij qyteti si haxhinj të devotshëm që duan t'i përkulen altarit të diturisë. Më qartë se cilido vendbanim tjetër, Tetova zbulonte të vërtetën se shoqëria shqiptare në Maqedoni binte në gjumë duke e dëgjuar tik-takun e orës “provinciale”, e zgjohej me cingërimën e orës së iluzionit se është bërë “metropol” i rëndësishëm mbarëshqiptar. Tetova kishte objekte me nam dhe nishan, për shembull Xhaminë e Larme, Teqenë e bukur, Kalanë, Kodrën e diellit me hotele dhe hapësira për ski... Por, për të shënuar saktë kalendarin e shqiptarëve të Maqedonisë, duhet thënë se objekti më i njohur i tyre ishte kafeneja “Dora”, të cilën kryesuesit e PDSH-së që moti e kishin promovuar seli alternative të saj. Kjo shpjegonte se politika e shqiptarëve të Maqedonisë ngjishej dhe piqej nëpër kafene, se mund të ndodhte që shqiptari i këtushëm të mos e dijë në ç'lagje janë bibliotekat dhe shkollat, por kurrsesi s'mund të ndodhte të mos e dinte adresën e saktë të Tempujve partiakë ku bëhej bekimi politik i të “vlefshmes” dhe anatomohej e “pavlefshmja”. Mund të ndodhte që shqiptari i Maqedonisë të mos e dinte ku ndodhej drejtoria e “Takimeve të Naimit”, e cila prej moti nuk ftonte në këto manifestime themeluesin e tyre – Ali Aliun, por saktësisht të dijë ku janë selitë alternative të partive shqiptare, të cilat mbase shërbenin edhe si bordele politike, ku kryesuesit partiakë këmbenin mallin kombëtar për përfitime personale. Në Tetovën e dhjetëvjeçarit të parë të këtij shekulli, më lehtë mund të gjeje selitë e partisë, sesa dekanatin e Universitetit Shtetëror të Tetovës. Mbase edhe shkak se ai që i dinte adresat e selive partiake, nuk kishte pse interesohej për institucionet arsimore, sepse

“certifikata” partiake ishin bërë çelës për dyert e punësimit aty ku nuk vlenin doktoraturat shkencore. Apo edhe ngaqë e dinte se këtë Universitet njëra parti e ndërton, e tjetra e rrënon, siç ndodhi në vitin 2006 kur ministri i Arsimit të Maqedonisë – shqiptar i PDSH-së, i diplomuar në kryeqytetin e shtetit amë si regjisor – ndërroi rektorin e këtij institucioni arsimor, si t’u dëshmonte qarqeve politike maqedonase se aty shiteshin diploma. Me çka bëri diçka që s’e kanë bërë as mbretërit: atyre që e pyesnin për autonominë e këtij universiteti, u shpjegonte për qindra diploma të falsifikuara; atyre që i arsyetoheshin se, edhe sikur të ishte ashtu siç thoshte ai, prapë mbetet pa përgjigje pyetja se a vlejné edhe për shqiptarët ligjet që ka ky shtet për autonomitë e universiteteve, apo institucionet shqiptare u janë lënë në duar “pashallarëve” të vet demokratikë. Jo se ai nuk e dinte këtë, jo se ai nuk e kishte të qartë se po të vepronte në Univesitetin “Shën Kirili dhe Metodi”, ashtu si me të shqiptarëve, do të harronte edhe si e kishte emrin, e jo më të mbetej ministër, pra jo se nuk e dinte se me veprimin e vet njolloste fytyrën arsimuese të shqiptarëve të Maqedonisë, por mbase kishte qëllim më të lartë “atdhetar”: të dëshmojë përpara shqiptarëve të Maqedonisë se vepra epokale e BDI-së – legalizimi i Universitetit Shtetëror të Tetovës – asgjë nuk vlen dhe se të tërin do të duhet ta rindërtojë nga e para PDSH-ja. Ai dëshmoi atë që e pohonin qarqet politike të etnitetit maqedonas: se partitë politike shqiptare ende nuk kanë arritur pjekurinë politike të vazhdojnë murimin e kalasë aty ku e ka lënë tjetra, por të udhëhequra nga inatet primitive, çdo gjë e rifillojnë nga themeli. Mbase për këtë shkak, shqiptarët e Maqedonisë gjithmonë mbeteshin në fillim: aty ku ishin në vitet e demokratizimit. Me dallimin se tani më qartë mund ta shihnin se jo çdo e keqe u vinte nga të “huajt”.

Me shumëçka Tetova e fillimshekullit i ngjante lumit të vrullshëm mbi syprinën e të cilit thyhej realiteti i shoqërisë së shqiptarëve të Maqedonisë. Por, kjo fare nuk do të thoshte se banorët e kësaj hapësire nuk kishin tiparet e veta dalluese, që portretin e tyre e bënë më të ndryshëm nga ai i shqiptarëve të krahinave të tjera. Edhe sikur të mos kishin ndonjë veçori që i bënte të kenë portret të vetin, ato do t'ua trillonin të tjerët, siç ndodh çdokund në këtë Ballkan ku popujt jetojnë të humbur në mjegullën e sajësive të trilluara për veten e të tjerët, nga e cila mjegull nuk arrijnë të shohin realitetin në të cilin jetojnë. Ndokush mundej t'u mohojë tetovarëve shumë aftësi, apo edhe t'ua shtojë tiparet që nuk i kanë, por assesi nuk mundej të mos e pranojë se ishin tregtarë të lindur, të cilët sikur t'i lësh edhe në mes të shkretëtirës, të nesërmen do të hapin dyqane ku të gjithëve do t'u shesin rëra. Bile edhe duke i bindur blerësit se rëra në thasët e tyre ka veti që s'i gjen dot as te rëra, të cilën e ka dhënë Zoti. Si të tillë, ata ishin tregtarët më të njohur në Jugosllavinë e dikurshme. I gjeje në të gjithë tregjet, duke filluar nga Sllovenia e deri në qytetet më jugorë të federatës së dikurshme.

Pa dyshim që banorët e Pollogut ishin ndër të parët që çelën dyert e rënda të kurbetit. Ia mësynë botës për të siguruar ekzistencën, qysh në vitet kur për shqiptarët nga kjo anë e kufirit, preferohej vetëm punësimi si druprësit sezonal. Si rrallëkush tjetër nga këto hapësira, tetovarët e dinë se përpos me djersë, monedhat e shteteve perëndimore duheshin lagur edhe me lotët e përmallimit për familjarët e lënë në vendlindje. Si askush tjetër e njihnin shijen e dhëndërisë së ngutshme, që ende pa u ngrohur mirë në shtratin bashkëshortor, t'i bënte gati valixhet e kurbetit ku me djersë e lot duhej siguruar

mbijetesa e familjes. Si pak të tjera, gratë tetovare e kishin gëlltitur helmin e takim-ndarjeve, e njihnin kuptimin e jetesës që qëndronte vetëm mbi boshtin se ke pranë pjellën, e cila rritej duke parë fotografinë e varur në mur, prej nga i shikonte babai që ndodhej larg, në kurbet.

Mbase edhe nuk ishte e rastit që, ata që kishin kaluar edhe nën “gurin e mullirit”, pra tetovarët, të parët të lexonin kalendarin e kohës së re të kapitalizmit dhe ndër të parët themeluan partinë shqiptare. U bënë gati për sistemin shumëpartiak qysh në ditët kur hapësirave të këtushme ende u vinte erë socializmi, në kohë kur shqiptarët e tjerë të Maqedonisë ende mbanin njëren këmbë në rrugën ideologjike, e tjetrën në bulevardet joshëse të demokracisë. Tetovarët të parët themeluan Partinë për Prosperitet Demokratik, me kryetarin shqiptar dhe sekretarin e përgjithshëm prej etnitetit maqedonas; ashtu siç munden veç ata që s’lejojnë asgjë t’i befasojë, dhe qëndrojnë me një këmbë “këtu” e me tjetrën të gatshme të lëshohet aty ku do ta kërkojë nevoja; ashtu siç munden dhe dinë veç ata të cilët përvoja jetësore i kishte mësuar sesi të mbijetonin edhe në ditët kur s’ishte e qartë se ç’përmbajtje do të kishte e nesërmja. Shumë shpejt gjërat morën rrjedhën, e cila tani lehtë mund të shpjegohet: brenda një dekade, Tetova u bë kryeqendër e iluzioneve të shqiptarëve të Maqedonisë. Kryeqendër ku lindnin dhe rriteshin ambiciet kolektive të shqiptarëve të këtushëm, u bë djep ku bënëin gjumë të gjithë ambiciet e joshura nga rendi i ri shoqëror. Kështu, ata që kishin ambicie politike, duhej të drejtoheshin kah “Meka” e pashmangshme ku ndaheshin “certifikatat” e atdhetarisë – Tetova. Pra, Tetova me dekada e heshtur dhe me rininë e shpërndarë nëpër tërë rruzullin tokësor, përnjëherë u

bë zhurmëm madhe. Zhurma e saj zgjoi edhe shqiptarët e tjerë të Maqedonisë, veçanërisht ata të Shkupit, të cilët edhe sot përsërisin atë që e kanë menduar gjithmonë për bashkëkombësit e tyre tetovarë: atë që ka pjellë Tetova, duhet ta rritë Shkupi. Ndoshta këtë e thonë ngaqë ua kanë zili tetovarëve, apo ngaqë sepse edhe sot e kësaj dite ata jetojnë me bindjen se Tetova prodhon shqiptari, por shkupjanët duhet të “shqiptarojnë”.

Historia e Tetovës është e shkruar mbarë e mbrapsht, varësisht nga shkruesit dhe nga prirjet që kanë pasur. Por, sido që ta përpilosh atë, nuk mund të mos e theksosh se nga fushata socialiste kundër “irredentizmit dhe nacionalizmit shqiptar” e viteve tetëdhjetë, pësoi shumë pjesa e arsimuar e popullatës tetovare. Shumica e të “distanuarve” të atëhershëm (të përjashtuarve nga puna), nuk u gjunjëzuan, nuk e epën, si ata të cilëve posa ua ngatërron hapin, e humbin dëshirën për udhëtim të mëtejshëm. Me çka edhe njëherë dëshmuam thënien se çdo e keqe që nuk të gjunjëzon aq sa të mos mund të ngrihesh sërish në këmbë, ta sjell një të mirë. Thënie që vlen vetëm për ata që nuk dorëzohen, që e kanë kuptuar se jeta nuk është vrapim i ngutshëm nëpër livadhe të lulëzuara, por ecje e lodhshme drejt lartësive nga shpesh edhe mund të rrokullisesh. Kështu që tetovarët qysh në vitet e socializmit, bënë “trajtime” kapitaliste duke marrë në duar thuajse gjithë tregjet e perimeve të ish-Jugosllavisë. Kuptohet, edhe duke qenë pronarë të ëmbëltoreve më të njohura në bregdetin e Adriatikut. Dhe, ndërkohë ndërtonin pallate të bukura familjare në vendlindje, ndërtonin shtëpi, të cilat ua vrisnin sytë komisarëve komunistë që shpresonin se me “diferencimin” ideologjik, kishin asgjësuar pjesën e shkolluar të shqiptarëve të këtushëm.

Nuk ka dyshim se kohën e re demokratike, tetovarët e pritën më të gatshëm se cilido mjedis tjetër i shqiptarëve të Maqedonisë. Demokracinë e pritën me dyqane dhe ëmbëltores të vogla, por edhe me përvojë të madhe se ç' do të thotë të mbështetesh vetëm mbi djersën e derdhur. Jo rastësisht, ata ndër të parët realizuan “bashkimin” mbarëshqiptar duke e çuar groshën tetovare në Tiranë, posa atje ra përmendorja e Enver Hoxhës. Shqiptarëve të mëmëdheut, u ofruan edhe shijen e akullores, e cila i lagte buzët e fëmijëve të atjeshëm, por i thante xhepat e cekët të prindërve të tyre të varfër. Tetovarët ndër të parët e kuptuan se e përkthyer në gjuhën praktike, koha e “tranzicionit” ka domethënien e viteve kur politikanëve të sotëm u mundësohet të bëhen kapitalistë të së nesërme. Pra, ata ndër të parët e kuptuan se ai i cili do të arrijë të sotmen ta jetojë si politikan, e ka të siguar të nesërmen si kapitalist i pasur. Dhe përderisa shqiptarët e tjerë të Maqedonisë pyesnin se çka ndodh në Tetovë, dhe prisnin nga andej t’u arrinin projektet për të ardhmen e tyre, pra përderisa shqiptarët e tjerë të kësaj ane ishin të hutuar nga atdhetari-tregtia e politikanëve tetovarë, rrëzë malit të Sharrit u themeluan edhe shumë parti tjera politike. Parti, të cilat ngutshëm e kishin kuptuar veprimin më të frytshëm politik: të shesësh atdhetari në Tetovë, e tatimin e shqiptarisë ta mbledhësh në institucionet shtetërore të Shkupit.

Lidershipët shqiptarë nga Tetova e shpërndanë ëndrrën e tyre metropolitane për Tetovën me peshë mbarëkombëtare, e cila ishte rritur në djepin e ngrohtë të provincializmit e lokalizmit. Pra, elitat partiake nga Tetova bënë atë që nuk e priste askush: hoqën dorë nga Shkupi si qendër shekullore e shqiptarisë dhe shpallën Tetovën si pikë të

rëndësishme të trekëndëshit të qendrave kulturore dhe administrative shqiptare. Ashtu realizuan deri në përpikëri konceptin sllav që Shkupit t'i zhvishen “tirqet” dhe “plisi” i bardhë shqiptar dhe, shenjë njohëse e tij të mbetet vetëm kryqi mbi malin Vodno dhe alfabeti cirilik.

Sot, shumëkush pyet si ndodhi që kërkesa e shqiptarëve për një universitet të përfundojë me dy institucione të larta arsimore, dhe të dy universitetet të ndodhen në Tetovë. Shumëkush pyet edhe pse partitë shqiptare më mirë ndihen kur i kanë selitë alternative nëpër kafenetë e Tetovës, sesa në kryeqendrën administrative të Maqedonisë – në Shkup. Ata që shtrojnë këto pyetje vetëm dëshmojnë se nuk e kanë dëgjuar barsoletën për drejtuesin e një ndërmarrjeje ndërtimore nga Tetova, i cili kishte konkurruar për ndërtimin e një tuneli në një shtet perëndimor, dhe kishte ofruar çmim më të lartë se gjithë të tjerët. Kur e kishin pyetur për çmimin, ai u kishte dhënë përgjigje të shkurtër, por domethënëse: me atë çmim do të fitoni dy tunele! Tetovari i barsoletës nuk e kishte pasur vështirë të shpjegojë si dhe pse punëtorët e tij shqiptarë që do të fillonin gërryerjen e tunelit nga anët e kundërta të malit, do e shponin kodrinën pa u takuar askund në mes të saj me njëri-tjetrin! Ashtu si nuk u takuan askund inatet e partive që kishin për detyrim të realizonin kërkesën e shqiptarëve për një universitet. Themeluan universitetin privat të Evropës Juglindore, me emrin alternativ “Universiteti i PDSH-së” dhe Universitetin shtetëror të Tetovës, të cilin shqiptarët e këtushëm e përjetojnë si vepër madhore të partisë së Ali Ahmetit. Emërtimi alternativ i universiteteve shqiptare me seli në Tetovë mund të jetë nxitur edhe nga qëllimkëqijtë, por sido që është domethënës për ta kuptuar realitetin e tyre

në Maqedoninë e dekadës së parë të shekullit të njëzetën. Për të kuptuar përditshmërinë e kësaj pjese të popullit shqiptar, zhytur në baltën ngjitëse të politikës së ditës, e cila i mban në kthetrat e veta edhe institucioneve mbi dyert e të cilëve duhej të gjeje mbishkrimin “Është e ndaluar hyrja për partitë politike”. Realiteti i këtyllë ndikonte që as zhurma studentore të mos arrijë t’i heshtë pëshpëritjet se në dy universitetet e Tetovës ligjërojnë shumë aktivistë të dikurshëm partiakë, të cilët u bënë “instantë” doktorë shkencash duke marrë diploma në Qafë të Thanës, apo në vendkalimin kufitar bullgaro-maqedonas. Ky realitet mundësonte që as zhurma e shkaktuar në grindjen ndërpartiake të mos arrijë të heshtë të vërtetën se askund si në Tetovë mund të shihej realiteti i plotë i shoqërisë së shqiptarëve të Maqedonisë në fazën “tranzitore” të këtij shteti. Kjo shoqëri luhatej në kolovajzën ku s’kishte vend për urtësinë se nga këpucët e ngushta vuan derisa ato të shkoqen, ndërsa nga iluzionet e kota vuan tërë jetën.

Mbase Ali Aliu, nuk e njihte sa duhet Tetovën e kohëve demokratike të viteve nëntëdhjetë, kur në vitin 1994 u rikthye të jetojë në Maqedoni, duke mos mundur të kthehet në Prishtinë ku e prisnin miqtë, por edhe policia serbe. Pa dyshim, asokohe nuk e njihte mirë edhe ambientin politik në Maqedoni, sepse me vite kishte jetuar jashtë këtyre trojeve. “Deri para një viti e ca, gjendjen në Maqedoni nuk e njihja së afërmi. Para kësaj isha i prirur të besoja se gjendja duhet të jetë ndryshuar edhe në të mirë të shqiptarëve. Më mbante shpresa se ata intelektualë shqiptarë ku bëja pjesë edhe unë, e që dikur jo me shumë dëshirë u larguan nga Maqedonia, nga presioni për qëndrimet e tyre të drejta në mbrojtje të interesave

kombëtare, tani nuk do të konsideroheshin edhe më tej si të padëshirueshëm!” – shkruan Ali Aliu në ditarin e vet, mbase i ngulfatur nga pyetjet që tani nuk duhej të mbuloheshin me tekste përplot metafora, por u duhej shtruar atyre që morëm në duar fatin e shqiptarëve të Maqedonisë, të cilët thuajse nuk e shihnin se edhe në vitet nëntëdhjetë Aliu ishte i padëshiruar në Maqedoni, njësoj si në të tetëdhjetat, kur ishte autor i ndaluar, veprat e të cilit ndodheshin në indeks, ishin tërhequr nga bibliotekat, si edhe të shumë autorëve të tjerë shqiptarë. Ali Aliu shpejt do të vërejë se qëndrimi armiqësor i dikurshëm ndaj intelektualëve shqiptarë nuk kishte ndryshuar as në Maqedoninë demokratike të viteve nëntëdhjetë. Të pranishme ishin forma të ndryshme për t’ua vështirësuar qëndrimin në Maqedoni intelektualëve të “rrezikshëm” që ktheheshin asokohe nga Prishtina. Faktori shqiptar i atyre viteve ishte marginalizuar deri në pakuptimësi. Partia e vetme dominante që mori pjesë në qeverinë e parë të Maqedonisë si shtet të pavarur, Partia për Prosperitet Demokratik, thuajse ishte vetëm ikebanë politike, sa për t’ua mundësuar pushtetarëve maqedonas të lavdëroheshin përpara botës se e realizonin barazinë e të gjithëve që jetonin në Maqedoni. Me pjesëmarrjen e kësaj partie në pushtet u “institucionalizua” një “bashkim vëllazërim” i elitave partiake dhe lënia e popullit thuajse aty ku ishte edhe gjatë komunizmit, gjë që do të funksionojë i tillë deri në konfliktin e vitit 2001.

I posakthyer në Maqedoni, Ali Aliu menjëherë e kuptoi se epokën e demokratizimit shqiptarët e këtushëm e kishin filluar mbrapsht, edhe pse e kishin pritur me kalë të bardhë, të cilin nëpër rrugët e Tetovës e shëtitin prijësit e atëhershëm të partisë së vetme shqiptare, Partisë për

Prosperitet Demokratik. Të magjepsur nga freskia e puhizës shumëpartiake, pakkush në fillim të viteve nëntëdhjetë kishte vënë re se ngjyra e bardhë e kalit ishte e përljer me të jashtëqiturat e veta, dhe aspak nuk i ngjante kalit për marshime festive. Atëherë as që ishin të rëndësishme detajet, por vetëm pamja e përgjithshme. Ishte i rëndësishëm portreti grupor i forcës politike të shqiptarëve të Maqedonisë dhe askush nuk merrej me vlerësimin e tipareve individuale të atyre që dolën në krye të kolonës partiake, që më vonë do të bëhen deputetë republikanë dhe ministra. Në këtë dhjetëvjeçar, filluar me mitingje euforike, shqiptarët e Maqedonisë do ta pasurojnë historinë e vet me shumë protesta, me përplot ballafaqime me kordonët e policisë, e cila deri në konfliktin e 2001-shit, kishte në radhët e veta vetëm pjesëtarë të etnitetit maqedonas.

Në zgjedhjet e para parlamentare të vitit 1990, shqiptarët e Maqedonisë votuan “demokratikisht” për partinë e jo për kandidatët - pra për inat të maqedonasve etnikë, e jo për vete. Dhe posa harxhuan euforinë fillestare, posa u nginjën me mashtrimet partiake të stolisura me mëlmesa të larme patriotike parazgjedhore, nisën të ndiejnë etje për më shumë parti. Me çka filluan përplasjet e para brenda PPD-së, e cila më shumë i ngjante një lëvizjeje gjithëpopullore, sesa një subjekti të mirëfilltë partiak. Dhe këto grindje, përfunduan me përçarjen e kësaj partie.

Në artikullin e tij me titull “Kush ndikoi në përçarjen e PPD-së”, të botuar në gazetën “Flaka” më 7 prill 1995, Ali Aliu do të shkruajë: “Kallauzët e vet për detronizimin e PPD-së nga brenda, pushteti (policia) maqedonas (i) ka pasur që në formimin e tij. Ata që e njihnin me kohë këtë

mjeshtëri për punën e tyre dekada me radhë (siç është rasti edhe me autorin e këtij teksti) ishin të vetëdijshëm për rrezikun permanent që i kërcënohej nga brenda kësaj partie.” Por, mbase nuk ishin vetëm “kallauzët” ata që ndihmuan që të hapet dera e përçarjes së kësaj partie. “Kallauzët” nuk do të arrinin qëllimin e tyre pa përkrahjen e mëmëdheut dhe qarqeve politike të Kosovës. Mëkatet e veta për përçarjet në PPD, kishin edhe Prishtina e Tirana. Por, ndërhyrja e Tiranës dhe Prishtinës nuk kishte motive të njëjta. Ajo që i bashkonte këto motive ishte vetëm bindja se ishin pjekur rrethanat të bëheshin ndryshime në kreun e PPD-së. Edhe atë me qëllim që shqiptarët e Maqedonisë të bashkoheshin rreth një elite të merituar partiake. Por, në vend që të arrihet kjo, u bë e kundërta. Dhe ndërsa kryetari i LDK-së, Ibrahim Rugova, ndikoi në përçarjen e PPD-së duke mos vepruar, duke mbajtur qëndrim mospërfillës ndaj situatës së krijuar në këtë parti – edhe pse e dinte se për shqiptarët e Maqedonisë zëri i Kosovës ishte si i perëndisë - mëkati i Tiranës kishte përmasa perverse. Grindjes brendashqiptare, Shqipëria zyrtare i dha përmasa monstruoze: në kulm të zënkave brendapartiake, ATSH-ja doli me një koment monstruoz të stilit stalinian, në të cilin një pjesë e kryesuesve partiakë të PPD-së, do të shpallen kuislingë e tradhtarë të popullit. Ky koment, i bërë në kohë kur shqiptarët e Maqedonisë i konsideronin si vlerësime të shenjta ato që thoshte Tirana, përfundimisht përcaktoi fatin e kësaj partie: ndarjen e saj. U bë e qartë se Sali Berisha mbante krahun e atyre që kishin për detyrë ta dobësonin këtë parti – atë të Arbër Xhaferit. Pikërisht disa nga të akuzuarit në komentin e ATSH-së si tradhtarë të popullit shqiptar, disa muaj më vonë do të dënohen me disa vite burg nga shteti

Maqedonas, si shovinistë shqiptarë që kanë armatosur shqiptarët dhe popullin e kanë bërë gati për luftë. Me çka megjulla e hutesës te shqiptarët e Maqedonisë u bë aq e dendur, sa nuk e shihnin se dikush qëllimisht ua ngatërroi tradhtarët dhe heronjtë, dhe u jepte goditjen më të rëndë nga e cila do të lëngojnë vite me radhë.

Politika e atëhershme përçarëse e Tiranës zyrtare do të sjellë dy dëme: do të dobësojë subjektin politik shqiptar në Maqedoni dhe njëherë e përgjithmonë Shqipërisë do t'i marrë primatin e palës njëanëse. Do t'i përballë shqiptarët e Maqedonisë me iluzionin e tyre se Tirana zyrtare nuk mbante anën e asnjë partie, por qëndronte mbrapa interesit mbarëkombëtar. Fara e mosbesimit ndaj Tiranës zyrtare, të cilin e mbolli Sali Berisha nëpërmjet "komisarëve" të tij që ndihmuan shpartallimin e PPD-së, do të mbijë në vitet më vonë dhe do të jetë frytdhënëse sa u përket grindjeve ndërpartiake në të ardhmen politike të shqiptarëve të Maqedonisë. Kur kësaj t'i shtohet e vërteta se shqiptarët e Maqedonisë kishin bërë çmos të ndihmonin partinë e Sali Berishës, se PPD-ja kishte ndihmuar edhe financiarisht PD-në e Saliut, mbetet i pakuptimtë interesi i kryesuesve të Tiranës që të shpartallonin PPD-në. Mbetet i pakuptimtë nëse nuk ka ndonjë kuptim tjetër për të cilin Ali Aliu flet në artikujt e shumtë të botuar asokohe në shtypin shqiptar, ku nuk përjashton mundësinë se të gjithë ata që mbollën grindjen brendashqiptare në Maqedoni, mbase ishin të udhëhequr nga interesa që nuk kishin asgjë të përbashkët me të mirën gjithëshqiptare.

Nuk ka dyshim se Ali Aliu asokohe ishte ndër të rrallët që i njihnte rrjedhat politike mbarëshqiptare. Prandaj zëri që shpaloste shumë të vërteta, njësoj u pengonte edhe

qarqeve politike në Tetovë, edhe atyre në Tiranë e Prishtinë. Me çka edhe njëherë, por kësaj radhe nga disa qarqe politike shqiptare, ai ishte personi që duhej heshtur. Heshtjen e tij e dëshironin ata që e dinin se ishte kthyer në Maqedoni, pasi kishte bërë rrugën e gjatë nga formimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, deri te shefi i parë i Zyrës së Përfaqësimit të Kosovës në Tiranë, në vitet 1991-1992. Ai kishte qenë pjesëmarrës aktiv në shkruarjen e historisë së re të shqiptarëve këtij dhe andej kufirit, dhe ishte kalendar i saktë i tërë ç'kishte ndodhur në Kosovë e Shqipëri në vitet e para të themelimit të partive shqiptare. Duke qenë dëshmitar i saktë i rrjedhave politike të dekadës së nëntëdhjetë, mbase do të mbetej edhe ëndërrimtari më i dëshpëruar lidhur me grindjen ndërpartiake në Tetovë, Kosovë e Shqipëri. Ai kishte shënuar në mbëmendjen e vet vitet e paqartësisë së plotë të fundëdekadës së tetëdhjetë në Kosovë, të kohës kur në pjesët e tjera të Jugosllavisë bëhej rirreshtimi i forcave nacionale. Vitet kur iu bashkëngjiti idesë që edhe Kosova të kishte një subjekt politik që do t'i artikulonte kërkesat e shqiptarëve. Kur ndër të parët e kishte kuptuar se më nuk mjaftonin vetëm paraqitjet publike nëpër mediat jugosllave që të kumtoheshin pretendimet shqiptare, por duheshin bashkuar forcat intelektuale dhe politike në një subjekt politik, i cili do të merrte përgjegjësinë për rrjedhat e ardhshme dhe për fatin e Kosovës.

Dhe duhej vepruar shpejt, sepse shtrëngata politike që kishte përfshirë Jugosllavinë paralajmëronte "vërshime" të mëdha, nga të cilat do ta pësonin ata që nuk ishin bërë gati të mbrojnë "arën" e vet. Pra, u kishte ardhur radha intelektualëve të Kosovës të dëshmonin se nuk do e linin popullin e vet të pakokë në vitet kur të

gjithë etnitet e tjera bënë rirreshtimin e forcave të veta. Andaj edhe kishte lindur ideja për themelimin e një force të re politike, ideja për themelimin e LDK-së.

Ali Aliu pa hamendje do të përkrahë idenë e vitit 1989 për themelimin e LDK-së, që shumë shpejt do të marrë përmasat e një lëvizjeje gjithëpopullore. Kuvendi themelues i LDK-së kishte propozuar këtë listë të anëtarëve të kryesisë: Ibrahim Rugova kryetar, Jusuf Buxhovi sekretar, Fehmi Agani, Nekibe Kelmendi, Ali Aliu, Bujar Bukoshi dhe Mehmet Kraja anëtarë. Që duhej vepruar ngutshëm, më së miri dëshmon e dhëna se edhe gjysmë ore para fillimit të Kuvendit, themeluesit e LDK-së nuk e dinin se cili do të ishte kryetar i saj. Ja sesi e përshkruan ditën e mbajtjes së Kuvendit Themelues në librin e tij “Vite të humbura”, një ndër themeluesit e LDK-së, Mehmet Kraja: “Gjysmë ore para se të fillonte mbledhja e këshillit nismëtar, ne realisht nuk dinim se kë do të bënim kryetar... Gjatë rrugës për në lokalet e Shoqatës së Shkrimtarëve, ku do të mbahej edhe mbledhja e këshillit nismëtar dhe pastaj edhe Kuvendit Themelues, ua thashë Ali Aliut dhe Xhemajl Mustafës: do të këmbëngul që Rugova të pranojë postin e kryetarit, ndërsa besoj se ju do të më përkrahni. Ata ishin dakord.”

Dhe kështu, kritiku e profesori i letërsisë, u zhyt në ujërat politike. Notin e tillë as e njihte, as e kishte të afërt, por e ndihmonte instinkti tanimë i mprehur i atdhetarit. Ai instinkt që e printe që nga vitet e rinisë, e që njëkohësisht e ndihmonte të mos bëjë gabime, të mos njolloset nga lojërat politike, instinkt që në të ardhmen do t'i tregojë çastin se kur duhej të tërhiqej, që do t'ia bëjë të ditur çastin kur ishin humbur idealet fillestare të aksioneve ku kishte qenë nismëtar.

Si aktivist i palodhshëm i LDK-së, Ali Aliu do të bëjë rrugën e një idealisti të zjarhtë, deri te deluzioni dëshpërues, që do e çojë të matë gabimet e gjeneratës që i takonte. Do të ngjitej shkallëve të lodhshme nëpër ngjarjet vendimtare për ardhmërinë e shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, si ai që e lexon mirë orën historike, e cila do të përcaktonte edhe fatet e popujve të Ballkanit. Dhe do të arrijë në majat nga ku qartë do të shohë se portreti i politikave shqiptare në këtë gadishull herë ishte i njollosur nga naiviteti dhe herë nga mendjemadhësia. Më së shpeshti atë realitet e baltoste grindja brenda partive politike shqiptare, si arroganca e Tiranës dhe mendjemadhësia e Prishtinës. Proceset e politikave shqiptare linin përshtypje se çdo udhëheqës partiak dëshironte të jetë kryetar i “shqipërisë” së vet. Kishte shumë pretendentë për kryetar shteti e “baballarë” gjithëshqiptarë, e pak “shqipëri”.

Ali Aliu, si shumica e shqiptarëve që jetonin në Jugosllavinë e atëhershme, kurrë nuk do t'i harrojnë vitet kur shumica e popullit nga kjo anë e kufirit, fuqishëm i dha krahë Partisë Demokratike të Shqipërisë. Jo vetëm se e shihnin si rrënuese të ideologjisë poshtëruese për shqiptarët, komunizmit enverist, por edhe pse besonin se duke u demokratizuar, Shqipëria do të bëhej faktor që do të ndihmonte çlirimin e Kosovës dhe çështjen shqiptare në përgjithësi. Por, nuk kaloi shumë kohë e ndodhi zhgënjimi i madh: Berisha e shpalosi ëndrrën e vet të bëhet president i Shqipërisë dhe, nga zjarri i madh që t'u hakmerrej gjithë atyre që nuk mendonin si ai, thaujse harroi Kosovën. Harroi shqiptarët që jetonin në Jugosllavi, të cilëve u ishin tharë sytë për mëmën Shqipëri, u ishte shterur zëri duke e thirrur atë të tregohej më e kujdesshme

ndaj tyre në kohët kur s'kishin si të depërtonin në institucionet ndërkombëtare për të rrëfyer pozitën e tyre të mjerë politike dhe ekonomike në të cilën ndodheshin.

Në dimrin e viteve 1991-1992, në diasporën shqiptare (kryesisht në Zvicër e Gjermani), kishin filluar përgatitjet e para për rekrutimin e të rinjve nga Kosova që do të përgatiteshin ushtarakisht në Shqipëri. Dy nga bartësit kryesorë të këtij projekti ishin Hafiz Gagica, kryetar i Degëve të LDK-së për diasporën dhe Ymer Berisha që jetonte në Zvicër. Planin e tyre për stërvitjen e luftëtarëve për çlirimin e Kosovës, Gagica dhe Berisha do t'ia besojnë Ali Aliut. Ata, njësoj si edhe Aliu, ishin të bindur se siç rridhnin ngjarjet, një ditë do të ndodhte patjetër edhe lufta. “Një projekt të tillë, më thanë, mund ta realizonin vetëm në Shqipëri, për ç’gjë nuk ishin të sigurt nëse do të hasnin në mirëkuptim nga shteti shqiptar... Pikërisht ky plan i tyre, të cilin ma besuan, më motivoi që në Kryesi, të insistoj për hapjen sa më parë të përfaqësisë sonë në Tiranë...” – shkruan Ali Aliu në ditarin e tij. Dhe, pasi do e bindë kryesinë, ai do të shpërngulet në Tiranë ku do të bëhet përfaqësuesi i parë i Kosovës në Shqipëri.

Pakkush e dinte qëllimin e mirëfilltë të shkuarjes së tij në Tiranë. Por, siç duket, ndër ata të paktët ishte edhe shërbimi sekret serb, që dëshmohej nga fakti se ato vite Aliu ishte në shënjestër të shtypit serb, ku emri i tij nënvizohej si një nga më të rrezikshmit. Që policia serbe e mbante Aliun si nga më të rrezikshmit për rrënimin e pushtetit të atëhershëm jugosllav, do të dëshmojnë shumë ngjarje të mëvonshme, si edhe e lajmi, të cilin më 12 gusht të vitit 1994 do e botojë Qendra për Informimin e Kosovës, e ku bëhet e ditur se “më 10 gusht rreth orës 17.00, tre policë dhe disa punëtorë serbë, rrënuan uikend-

shtëpizën e dr. Ali Aliut, pushimoren në Shtërpcë të Brezovicës...”. Pushteti serb po i hakmerrej atij që ndër të parët e kuptoi se shqiptarët duhej të bëhen gati për rrënimin e robërisë shekullore serbe. I hakmerreshin atij që ndër të parët bëri çmos për stërvitjen ushtarake të rinisë, së cilës i kishte rënë në hise të bënte realitet ëndrrën e gjyshërve të vet.

Pa dyshim, ndër më kontribuesit për realizimin e planit që me kohë të stërviten ushtarakisht të rinjtë e Kosovës, është edhe Ali Aliu. Si dhe Perikli Teta, asokohe ministër i Mbrojtjes në qeverinë e koalicionit mes Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike. “Perikli Teta e lejoi planin, caktoi një oficer për të organizuar dhe udhëhequr projektin, caktoi lokalitetin diku në periferi të Tiranës, oficerët për stërvitje dhe krejt infrastrukturën e nevojshme”, thotë Ali Aliu, duke rikujtuar qëndrimin e tij në Tiranë dhe duke theksuar gjithashtu se asnjëherë nuk e kishte vizituar këtë kamp nga frika që mos zbulohet, i prirë nga vetëdija se spiunët e Beogradit asokohe bridhnin kryq e tërthor nëpër Shqipëri.

Të rinjtë për stërvitje, përmes një fshehtësie absolute, rekrutoheshin kryesisht nga Kosova, nën kujdes të Ymer Berishës dhe Hafiz Gagicës. Përmes linjave ajrore, ata sillleshin në Tiranë. Janë mbajtur shënime të plota për secilin të ri që asokohe kishte kaluar nëpër këtë kamp për stërvitje, me emër dhe mbiemër dhe pseudonim, dhe do të ishte mirë që një ditë të bëhej publike lista e këtyre trimave të ardhur para kohe, të atyre të cilët bëheshin gati të çlironin Kosovën, që e dinin se një ditë mbase do të duhet të flijojnë jetën e vet për ardhmërinë. Duhet një ditë të zbardhet lista e atyre që e kishin të qartë se Kosova do të përballet me luftë, të atyre që i panë mjegullat e

luftës mbi Kosovë qysh në vitet kur nuk ishin të paktë shqiptarët që mendonin si duhej shpëtuar Jugosllavia e Titos.

Për sa i përket viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, ai është një qëndismë e begatë ngjarjesh dhe ndodhish në qendër të të cilave qëndronte edhe Ali Aliu. Dhe kushdo që do të shkruajë historinë e re të popullit shqiptar, nuk do të mund ta kompletojë atë pa ndjekur rrugëtimin e angazhimit politik dhe atdhetar të Ali Aliut. Mbase vetëm për këtë dhjetëvjeçar do të duhej të shkruhej një libër i veçantë ku hollësisht do të zinin vend edhe përjetimet e Aliut, që zbërthejnë iluzionet e realitetin shqiptar të asaj dekade, dhe që zbardhin trimërinë dhe hutesën e disa gjeneratave. Atje do të zërë vend edhe një ditë e pranverës së vitit 1992, kur ishte në përfundim e sipër stërvitja ushtarake e grupit të dytë të të rinjve kosovarë, dita kur Aliun do e marrë në telefon Perikli Teta që ta lajmërojë se kishte lindur një problem me djemtë e ardhur nga Kosova. Pas një kohe, në zyrën e Aliut do të vijë oficeri përgjegjës për stërvitjen, bashkë me dy-tre të rinj nga Kosova, të cilët Aliu nuk i njohte. Në të vërtetë, të rinjtë kosovarë kishin kërkuar të mos ktheheshin nga kishin ardhur, si tjerët, me aeroplan përmes Evropës, po ta kalonin kufirin me Kosovën në këmbë. “Të gjithë ne që kemi vendosur të kthehemi në këmbë, kemi ndër mend që secili të marrim nga katër ose pesë kallashnikovë!” – i kishte thënë Aliut njëri nga të rinjtë kosovarë. “E pashë se vendimi i tyre ishte i arsyeshëm dhe i guximshëm. Gjithsesi edhe me rreziqe. Prandaj, këtë çështje nuk kishte dashur ta presë ministri. U mendova pak dhe iu drejtova oficerit për lidhje: Dakord, le të bëhet siç kanë vendosur djemtë, por me kusht që kalimi në kufi të sigurohet qindpërqind!” –

shkruan Ali Aliu lidhur me këtë ngjarje. Ai që kishte folur deri atëherë në emër të grupit, pas një kërkesë të këtillë të Ali Aliut për sigurinë e kalimit të kufirit, kishte thënë: “Profesor, ai që në këto punë kërkon siguri të plotë, më mirë e ka të rrijë në shtëpi!” Dhe profesorin e kishte lënë pa fjalë. Personi që kishte shqiptuar ato fjalë, përkatësisht mësimin që ia bëri profesorit, ishte Sali Çeku, më vonë miku dhe bashkëpunëtori i dashur i Aliut. Sa herë që më vonë Aliu do të shkojë në Shtutgart të Gjermanisë, ku ishte larguar Çeku nga Kosova pasi policia serbe i kishte rënë në gjurmë, Aliun e priste ky trim kosovar. Trimi fjalëpakë dhe punëtor i palodhshëm, që kurrë më në të ardhmen s’do të ketë qejf ta rikujtojë bisedën e dikurshme të zhvilluar mes tij dhe profesorit, në zyrën në Tiranë. Për herë të fundit, Aliu me Çekun do të takohet në Tiranë, në gusht të vitit 1998. Ato ditë Aliu ishte në Prespë. Zëri i Çekut i erdhi nëpërmjet telefonit nga Tirana. E lajmëronte mikun e vet se kishte nevojë urgjente që të shiheshin. Asokohe Çeku u ishte bashkuar radhëve të UÇK-së. Aliu e dinte se karakteri i tij nuk i lejonte kurrë të ankohej, të alarmohej, të dramatizonte situatën, apo të kërkonte takim urgjent pa pasur ndonjë nevojë të pashmangshme. Pasi ishin takuar në Tiranë, Çeku i kishte rrëfyer Aliut për vështirësitë që të hynte në kontakt me pushtetarët e këtushëm që ta ndihmojnë. Dy ditë ishte munduar, por askush në Tiranë nuk ia kishte hapur derën, teksa ai kishte shpërthyer rrethimin dhe më këmbë kishte kaluar kufirin. Sepse gjendja atje nga ku ai vinte ishte tragjike. Edhe kësaj radhe do t’u vijë në ndihmë miku i Aliut, Perikli Teta, i cili do t’i mundësojë Çekut të marrë një pjesë të pajisjes së armatosur nga e cila varej fati i shokëve të tij që u bënë ballë forcave serbe në Kosovë.

“Bisedën e fundit, me telefon celular, me Sali Çekun, e bëra nga Shkupi, gjatë luftës, në pranverën e vitit 1999, vetëm disa ditë para se të vritej. Ishte optimist, i bindur plotësisht në fitore: ajo tani nuk është larg, me ditë, tha, duke i dëshiruar shëndet njëri-tjetrit!” - rrëfen me dhembje Aliu, duke rikujtuar mikun dhe luftëtarin që ndiente afërsinë e lirisë. Liria nuk vonoi shumë, erdhi, por për Çekun mbeti e pashijuar, e largët sa vetë përjetësia, sa vetë kujtimi për ata që s’arritën të plaken.

Ngjarjet e vitit 1992, janë nga më ngasëset. Në dimrin e atij viti, Sali Berisha do të prishë koalicionin qeveritar mes PS-së dhe PD-së, të Ylli Bufit si kryeministër dhe Gramos Pashkos zëvendëskryeministër. Kjo qeveri nuk arriti të mbushë as vitin edhe pse dukshëm ndikoi në qetësimin e masës së acaruar. U bë fare e qartë se Sali Berishës nuk i pritej: siç dukej, postin e presidentit të Shqipërisë, e dëshironte me pasion patologjik. Pas prishjes së koalicionit qeveritar, u bë e qartë se, për postin e kryetarit të shtetit, Berisha ishte i gatshëm të ndërmerre çdo masë e të ndjekë çfarëdo rruge qoftë. Situata e re politike në Shqipëri me të drejtë i kishte shqetësuar bartësit e projektit për stërvitjen e të rinjve nga Kosova, me në krye Ali Aliun. Kjo zhvendosje e forcave politike në Tiranë, mund të çrregullonte bashkëpunimin mes Zyrës së Kosovës dhe pushtetmbajtësve.

Zgjedhjet e mëvonshme parlamentare në Shqipëri, do t’i fitojë PD-ja, e cila do të caktonte edhe mandatarin për themelimin e qeverisë. Në emër të Kryetarit të LDK-së, Ibrahim Rugova, i cili tani ishte informuar për stërvitjen e të rinjve të Kosovës në Shqipëri, si edhe në emër të Bujar Bukoshit, kryeministër i Kosovës në ekzil, dhe në emër të vet personal, Ali Aliu do të lutë Sali Berishën që

në përbërjen e re të qeverisë të rizgjidhej ministër i Mbrojtjes Perikli Teta dhe ministër për Punë të Jashtme Muhamet Kapllani. Kapllani ishte i rëndësishëm për LDK-në sepse kishte marrë përsipër të ndihmonte politikën e jashtme kosovare edhe nëpërmjet afërsive miqësore që kishte, si bie fjala me Gensherin dhe Bekerin. Përgjigjja e Berishës lidhur me këtë kërkesë të LDK-së ishte se për Perikli Tetën pajtohej, ndërsa për Kapllanin nuk donte të dëgjonte.

Kryetari i PD-së, dhe njëkohësisht Presidenti i Shqipërisë, nuk do ta mbajë fjalën as për Perikli Tetën. Deri në mbrëmjen e ditës së fundit, para shpalljes së kabinetit të ri qeveritar, për ministër të Mbrojtjes kishte figuruar emri i Perikli Tetës, i këtij personaliteti të shquar, me moral të lartë, me përkushtim e dashuri për Shqipërinë e Kosovën, oficer i lartë e i shkolluar. Por, në mëngjes të ditës së ardhshme, si ministër i Mbrojtjes figuronte emri i Safet Zhulalit, mësues matematike nga Peshkopi, pa fijen e përvojës në këtë resor. Mbase as edhe sot e kësaj dite, Ali Aliu nuk e ka të qartë pse u bë kjo lojë. Ardhmëria do e bëjë gjithnjë e më të qartë atë që Ali Aliu shkruan në ditarin e vet: “Sali Berishën më nuk kisha vullnet ta pyes për asgjë. Për mua ai tani ishte një dinak që tërë energjinë e kishte vënë në funksion të hakmarrjes me ata që nuk mendonin si ai, një person që nuk zgjidhte mjete për të eliminuar të gjithë ata për të cilët kishte krijuar bindjen se i ka kundërshtarë. Fillova të dëgjoj përreth se po i vinte fshesën të gjithë atyre që “seç kishin me këta kosovarët e Aliut...”.

Duhet thënë se gjatë qëndrimit të Ali Aliut në Tiranë, LDK-në, e cila asokohe ishte lëvizje, në një mënyrë e përkrahnin të gjithë shqiptarët e ish-Jugosllavisë. Nga ana tjetër, PD-ja e Sali Berishës kishte përkrahjen e plotë të

LDK-së. PD-së iu dhanë ndihma të shumta materiale nga degët e LDK-së nëpër Evropë, Amerikë dhe Australi. Me porosinë e Ali Aliut, përpara zgjedhjeve të pranverës së vitit 1992, PD-së i erdhën në ndihmë nja tridhjetë vetura të përdorura si dhe ndihmë në financa dhe në ushqim. Aliu dhe gjithë shqiptarët e ish-Jugosllavisë, besonin se çështja e Kosovës do të jetë shqetësim dhe angazhim i të gjithëve në Shqipëri, e jo vetëm i PD-së. Dhe prandaj ai kujdesej që të mos merrte pjesë në mitingjet parazgjedhore të asnjë partie. Kjo sjellje e Ali Aliut, për Sali Berishën do të jetë skandaloze. Berisha nuk mund ta kuptonte se shqiptarët e ish-Jugosllavisë kishin nevojë për përkrahjen e mëmëdheut, e jo vetëm të një partie të Shqipërisë, cilado që të ishte ajo. Ai nuk mund ta kuptonte se Aliu nuk mund të hiqte dorë as nga miqësitë e vjetra me Dritëro Agollin, Alfred Uçin, Xhevahir Spahiun, Fatos Arapin, Petro Markon e shumë të tjerë, disa nga të cilët Berisha i mbante për “komunistë të fëlliqur”. Mbase kontaktet me këta krijues të mëdhenj shqiptarë, ishin një ndër mëkatet e pafalshme të Aliut, që Berisha nuk ia harroi kurrë përfaqësuesit të Kosovës në Tiranë. Aq më shumë, kur në shtypin e atëhershëm të Tiranës, vlonin shkrimet me sulme, e me shpifje, me fyerje nga më brutale dhe nga më të egrat e mundshme, kundër disave nga ata me të cilët Ali Aliu vazhdonte të rrinte nëpër kafene dhe në vende publike. Asokohe temë e ditës ishte Dritëro Agolli.

Pikërisht shkak i këtyre mëkateve, në verën e vitit 1992, Sali Berisha, do të fillojë një fushatë tinëzare kundër Ali Aliut. Dhe do të kërkojë që ai të largohet nga Zyra e Kosovës, me akuzën se Aliu është përkrahës i komunistëve. Porositë e tij, raportet në Kryesinë e LDK-së për kalimin e Ali Aliut në anën e komunistëve, kishin

krijuar opinion edhe te një pjesë e aktivistëve partiakë në Prishtinë. Kështu Berisha hapi rrugën tinëzare për ta larguar Aliun nga Tirana. Atëherë edhe vetë Ali Aliu e kishte të qartë se qëndrimi i tij i mëtejshëm në Shqipëri do t'i acaronte marrëdhëniet mes LDK-së dhe PD-së, dhe në vjeshtën e vitit 1992 vendos të kthehet në Prishtinë. Ashtu si e do radha, para largimit nga Tirana, Aliu do t'i bëjë vizitën e fundit Sali Berishës, tani President i Shqipërisë. Dhe ky malësor që rrihte gjoks për burrëri, për sinqeritet, në pyetjen e Aliut nëse ka pasur vërejtje për punën e tij, do të përgjigjet: Jo nuk kam asnjë vërejtje për qëndrimin tënd në Shqipëri. “Për një moment” – shkruan Ali Aliu lidhur me këtë përgjigje të Berishës, “mendova se ato që si akuza në adresën time i kisha dëgjuar, mund të mos ishin aspak të vërteta: Sala, thashë me vete, ka gjithë ato cene, ama burrërinë për të ta thënë mendimin troç e ka të lindur, mendova për një çast. Në të vërtetë, ai nuk e ka as këtë tipar burrërie: shumë më pas, nga goja e një këshilltari të tij, e dëgjova ankesën e Salës: na ka dëmtuar shumë (Aliu) që nuk distancohej publikisht nga komunistët, që nuk përfshihej në manifestimet tona...”.

Ali Aliu ka mundur asokohe të mos e njohë mirë Saliun, mbase edhe si shkak se ende nuk e kishte dëgjuar anekdotën që rrëfenin njohësit e mirë të kryetarit të Shqipërisë: në moshën e djalërisë, në vendlindje, një mbrëmje, Sala në shtëpi qenkësh kthyer me një dele mangët nga tufa. Kur e konstaton këtë, kthehet prapë në pyll për ta kërkuar... Dalin edhe familjarët e tjerë ta kërkojnë, e gjejnë dhe bashkë me delen kthehen në shtëpi. I bëjnë zë Saliut se u gjet delja e humbur, por Saliu ua kthen: jo, do ta gjej unë, s'guxon ta gjej tjetërkush! I ati,

që e ka njohur mirë të birin, jep urdhër që ta afrojnë delen diku afër tij, ta gjejë ai vetë se nuk kthehet për tërë natën në shtëpi...

Iluzioni i shqiptarëve të ish-Jugosllavisë se Tirana zyrtare do të bëhej mbështetëse e fortë për zgjidhjen e problemit të Kosovës, treqj po aq shpejt sa nguteshin grindjet e Sali Berishës me të gjithë që mendonin ndryshe nga ai. Këtë më së miri e ndiente Ali Aliu, të cilit për shkak të detyrës së vet i duhej të kontaktojë shpesh me presidentin e Shqipërisë. Gjatë këtyre takimeve, nuk e kishte rëndë të zbulojë karakterin grindavec të Berishës, si dhe të vërtetën që dikur moti e kishte thënë Haveli: më i neveritshëm se komunisti, është antikomunisti me urrejtje patologjike. Apo edhe ata që bëhen kundërshtarë të verbër të asaj që kanë qenë dikur. Gjatë shumë takimeve, Aliu do të përballet me këtë karakter të Berishës. Kjo do të ndodhë edhe në vitin 1992, para zgjedhjeve të marsit, gjatë qeverisjes së përbashkët mes PS-së dhe PD-së, për një udhëtim të Rugovës nga Gjermania në Tiranë, kur Aliu duhet t'i sigurojë vendosje në kryeqendrën e Shqipërisë. Sali Berisha, që kishte paralajmëruar se do të dalë të presë Rugovën në aeroportin e Rinasit, pasi kishte marrë vesh se në aeroport do të dilte edhe ministri i Jashtëm, merr në telefon i alarmuar Ali Aliun dhe i thotë: Kush e ka informuar atë komunist për ardhjen e Ibrahim Rugovës? Pasi Aliu i sqaron çështjen, ai përgjigjet se nuk do të dalë në aeroport bashkë me ministrin "komunist", duke fajësuar për këtë Ali Aliun. Në këtë rast ministri dilte në emër të qeverisë shqiptare, për ta zyrtarizuar vizitën e kryetarit të LDK-së, kurse Sali Berisha do të dilte në emër të PD-së, kryetar i cilës ishte. Mbase Berisha e kishte vështirë të kuptonte se Ali Aliu udhëhiqej nga

parimi se Kosovës i duhet mbështetja e tërë Shqipërisë, e të gjithë spektrit politik, e jo vetëm i një partie. Pas bisedës telefonike me Aliun, Berisha i telefonon edhe ministrit të Jashtëm të asaj kohe, Ilir Bokajt, të cilit i thotë se Rugova është mysafir i tij dhe se ministri s'ka ç'kërkon në aeroport. Ata të ministrisë i drejtohen Aliut për sqarim, nëse kërkesa që në aeroport të mos dalë ministri është kërkesë e tij, apo mos vallë kjo ishte kërkesë e Ibrahim Rugovës. Aliu u sqaron se kjo nuk ishte kërkesë e askujt nga pala kosovare dhe se ministri mund të veprojë ashtu si e vlerëson ai vetë. Një ngatërresë e tillë, e vogël, por me domethënie të mëdha sa i përket shpjegimit të situatës së atëhershme politike në Tiranë, ia kishte prishur lezetin asaj pritjeje në aeroport. Mbase kjo kishte ndodhur edhe si shkak se Sali Berisha qysh atëherë kishte bindur veten se Shqipëria në të vërtetë është ai vetë dhe partia e tij.

Ngatërresat mes Ali Aliut dhe Sali Berishës filluan të bëhen të shpeshta. Ndoshta Aliut, nga natyra i qetë dhe plot respekt ndaj bashkëbiseduesit, i ka penguar zëri i lartë i Berishës dhe prirja e presidentit të Shqipërisë të mos përfillë mendimin e tjetrit. Por s'ka dyshim se ajo që Aliun përfundimisht do e shtyjë të largohet nga presidenti i atëhershëm i PD-së, mbi të gjitha ishte tendenca e Berishës që mëmëdheun e ëndërruar, shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, t'ua sillte vetëm me ngjyrat e partisë së vet. Andaj edhe deluzioni i madh, me të cilin u përballën shqiptarët jashtë mëmëdheut, do të ketë përmasa dëshpëruese. Qëndrimi partiak, e jo shtetëror, i Sali Berishës ndaj çështjes Kosovare, ndikoi që ngadalë edhe zyra e Kosovës në Tiranë t'i ngjajë një ujdhesë mbi të cilën përplaseshin, dhe pamëshirshëm e gërryenin, grindjet ndërpartiake në Tiranë dhe instruksionet e

turbullta nga Prishtina. Thënë më thjesht, partitë e Tiranës kërkonin nga Ali Aliu të pamundurën: të bashkëpunojë vetëm me atë që qeveriste Shqipërinë, e jo me të gjitha. Ndërsa Prishtina shpeshherë u besonte të pavërtetave partiake lidhur me aktivitetet e Zyrës së Kosovës, e që Tirana i përcillte në kryesinë e LDK-së. Kjo e vështirësonte pozitën e Aliut, i cili dinte atë që nuk e kuptonin demokratët e porsalindur të Tiranës dhe patriotët e Prishtinës: shqiptarët e ish-Jugosllavisë donin Shqipërinë, se ata prisnin mbështetjen e Tiranës zyrtare, pa marrë parasysh ngjyrat e partisë që qeveriste mëmëdheun.

Ali Aliu, si përfaqësues i Kosovës në Tiranë, nuk përballej vetëm me shpirtngushtësinë partiake të Sali Berishës, por edhe me qëndrimet kundërthënëse dhe mosbesues ndaj veprimit politik të LDK-së së shqiptarëve të ish-Jugosllavisë. E veçanërisht të atyre të diasporës evropiane, gjë të cilën më së miri e shpjegon një ngjarje e verës së vitit 1992, kur përpara hyrjes kryesore të Muzeut Historik të Shqipërisë, ku ishte vendosur përfaqësia e Kosovës, Aliut do t'i drejtohet një njeri i panjohur dhe dukshëm i revoltuar. “Është kjo këtu zyra e Kosovës, apo e Beogradit?” – e pyet i panjohuri Aliun, pa kurrfarë hyrjeje apo përsëritjeje. Shihej haptazi se kishte qenë i acaruar tej mase dhe se ishte mospërfillës ndaj përfaqësisë nga tregonte me kokë, e të cilën herë e emëronte si zyra e LDK-së, e herë si përfaqësi të Kosovës. “Natyrisht që zyra është përfaqësi e Kosovës, por unë nuk ju njoh kush jeni dhe çka doni!” – i përgjigjet Aliu i habitur nga sjellja e të panjohurit. “Nuk ka nevojë ta dini cili jam. Unë e di cili jeni ju. Por, mua më intereson ta di nëse keni farë bashkëpunimi, ndonjëfarë marrëveshjeje me këta këtu, me këtë shtet, dhe nëse keni farë ndikimi, a është ai në

shërbim të Kosovës, apo të Beogradit!”- ia pret Aliut, bashkëbiseduesi i panjohur. “Edhe bashkëpunim, edhe besim, edhe ndikim kemi në pushtetin e këtushëm shqiptar dhe atë e shfrytëzojmë në të mirë të Kosovës, po më thoni ç’hall keni, meqë nuk doni të prezantoheni!” – i thotë të panjohurit Aliu me qetësinë e vet, e cila mbase është vetëm mbulesë që fsheh shqetësimet e shumta të brendshme. “Policia e Shqipërisë, në aeroportin e Rinasit, m’i ka sekuestruar nja tridhjetë këmisha antiplumb. Kërkoj të protestoni rreptë dhe të këmbëngulni që të m’i kthejnë menjëherë, nëse, siç thoni, punuakeni në të mirë të Kosovës!” – ia kthen kosovari. “Po a e ke lajmëruar rastin në Ministrinë e Rendit, a ke qenë atje për t’u sqaruar?” – e pyet Aliu. “Po, isha personalisht te ministri (Bashkim Kopliku) dhe ai më tha, shko merru vesh me Ali Aliun. Për mua, më tha ministri, Kosova është në Tiranë” – shpjegon i panjohuri me ironi. Kuptohet, pas ndërhyrjes së Ali Aliut, këmishët antiplumb i ish-in kthyer të riut kosovar, të cilin Aliu nuk e kishte pyetur për emrin edhe kur ish-in ndarë. Ditë më vonë, Aliu do e merrte vesh se kishte biseduar me Adem Jasharin, i cili kishte qenë pjesëmarrës në turnin e dytë të stërvitjeve ushtarake në kampin në afërsi të Tiranës.

Nuk ishte hera e parë që Aliu përballej me reagime të tilla, sidomos të rretheve të caktuara nga diaspora evropiane, rrethe dhe individë që nuk kishin fare besim në qëndrimin politik të LDK-së, në kursin gjoja paqësor të saj, në deklaratat gandiste dhe jo rrallëherë, qesharake të Ibrahim Rugovës. Aliu, për afërsisht i njëjtte rrethet dhe individët me mendim të tillë, me të cilët ndeshj sa herë që vizitonte ndonjë degë të LDK-së në diasporë, degë të cilat, me shumë mundim, ai vetë i kishte themeluar. Disa

nga ata individë, ishin të vendosur, kategorikë, dhe mbështeteshin në argumente të fuqishme për drejtimin e vet politik. Por, nga ana tjetër, pa pasur mbulesën e LDK-së, e kishin të vështirë të çajné rrugë, të realizojnë idetë e veta, të fitojnë sa më shumë mbështetje, sidomos të shtetit shqiptar. Të parët që e kuptuan këtë, ishin disa nga bashkëpunëtorët më të afërt të Jusuf Gërvallës, si Hafiz Gagica dhe Ymer Berisha, të cilët për të realizuar projektin e tyre për stërvitje ushtarake të të rinjve kosovarë, e që e kishin filluar para se LDK-ja të themelonte degët e veta në Evropë, u bashkuan, hynë në gjirin e kësaj lëvizjeje.

Nuk ka dyshim se pa mbështetjen e përfaqësisë së Kosovës në Tiranë, zor se do të mund të realizohej projekti i tyre, pavarësisht se, kryetarin e LDK-së ata e njoftuan për këtë aktivitet vetëm pasi kishte përfunduar qëndrimi i grupit të parë në poligonin ushtarak për stërvitje. Qeveria e Stabilitetit, e përbashkët e PS-së dhe PD-së, ishte e bindur se kosovarët kishin pajtueshmëri të plotë, të gjithë palët, rreth një projekti apo veprimi me peshë për Kosovën edhe pse jo çdoherë ishte ashtu. Grupet ekstremiste, siç emëroheshin asokohe, vetëm kur nuk gjenin rrugë tjetër për të realizuar ndonjë qëllim të vetin, e shfrytëzonin infrastrukturën e ngritur nga degët dhe nëndegët e LDK-së, së cilës as nuk i besonin, dhe aq më pak e përkrahnin.

Pa dyshim se qysh para ardhjes në Tiranë, Ali Aliu e kishte kuptuar se mëmëdheu nuk do të mund të mbështeste Kosovën aq sa ëndërronin shqiptarët e ish-Jugosllavisë. Me deluzionet e veta ai i ishte përballur më herët se shqiptarët e tjerë që mëmëdheun e njohën shumë vite më vonë. Që Shqipëria nuk ishte e gatshme të mbështetë Kosovën në rast të ndonjë konflikti të armatosur, Aliu e kishte kuptuar edhe gjatë takimeve të shumta me

zyrtarët e Tiranës para ardhjes në Tiranë. Ishte takimi i vitit 1990, kur LDK-ja mbushte vitin e parë të themelimit, dhe në vlim të aktivitetit të vet në diasporë. Në vjeshtën e vonë të atij viti, nga një lidhje e LDK-së në Bon, aktivistëve të kësaj lëvizjeje, u vjen informata se ambasada e Shqipërisë në Gjermani propozon një takim të lartë mes Tiranës dhe LDK-së. Këtë lajm-propozim, Bujar Bukoshit ia kishte përcjellë Jonuz Hyseni, i lindur në fshatin Poipov të Vuçiternës, inxhinier me firmë të vetën të regjistruar në Bon. Vite më parë ai kishte realizuar lidhje të afërta me Ambasadën Shqiptare, dhe ndikonte, aq sa kishte hapësirë, për të mirën e Kosovës e çështjen shqiptare. Siç do t'i rrëfejë dhjetë vite më vonë Ali Aliut, ai kishte mbajtur lidhje, nëpërmjet telefonit, edhe me Ramiz Alinë dhe Sali Berishën, ende pa u themeluar PD-ja. Jonuzi do t'ia zbulojë Aliut edhe një detaj të panjohur dhe tepër interesant: Ramiz Alia kishte qenë tepër i interesuar që të themelohej një parti demokratike, duke e nxitur idenë që një ndër dy kandidatët e mundshëm të saj, të ishte edhe Sali Berisha.

Për ofertën e ardhur nga Boni, Bukoshi i tregon Aliut. Pas disa ditësh, Bukoshi lajmëron Ali Aliun se duhet të udhëtojnë urgjentisht për në Bon. Takimin e parë do e kenë me Jonuzin, në zyrat e firmës së tij. Pas një kafeje, duke vozitur nëpër rrugë anësore, për të mos rënë në sy, ndërmjetësi do t'i shpjerë Bukoshin dhe Aliun tek Ambasada Shqiptare, ku i priste ambasadori dhe një person tjetër. Aty do t'i lajmërojnë se për të nesërmen ishte caktuar një takim, në një vend turistik të Vjenës.

Takimi me numrin dy të Shqipërisë u bë në një nga restorantet e lidhura varg njëri pas tjetrit dhe përplot mysafirë, diku jashtë Vjenës. Këshilltari i parë i Ramiz Alisë, Sofo Lazri, ishte ai që priti delegacionin e LDK-së

në këtë takim. Pasi ua përcolli përshëndetjet e Ramiz Alisë, Sofo Lazri paksa do t'i qortojë kosovarët pse edhe pas një viti të themelimit të LDK-së, nuk kishin kërkuar takim me Tiranën zyrtare. Në këtë takim Sofo Lazri nuk kishte lënë anash as shpjegimet për sukseset kolosale të Shqipërisë në të gjitha fushat, e veçmas për suksesin e madh në tufëzimin e bagëtisë, e që dihet se ishte njëri nga dështimet më të mëdha të “reformave” shqiptare.

Përderisa Sofo Lazri ishte i prirur të lavdërojë sukseset e Shqipërisë komuniste, pa dyshim se Ali Aliu dhe Bukoshi me padurim kishin pritur të dëgjonin se sa Tirana zyrtare ishte e informuar për lëvizjet, rrjedhat, gjendjen dhe shpresat për të ardhmen e Kosovës. Ata të dy donin të dëgjonin nga Lazri se çka ishte i gatshëm të bënte mëmëdheu për Kosovën, meqë shumica e shqiptarëve anembanë Jugosllavisë së atëhershme, besonin se shqetësimi i parë dhe më i madhi i Shqipërisë, në ato vite, ishte plaga gjithëshqiptare, Kosova. Shqiptarët besonin se Kosova ishte në krye të rendit të ditës në diplomacinë e politikën e mëmëdheut, por Bukoshi dhe Ali Aliu nuk dëgjuan asnjë fjalë nëse kosovarët kishin bërë mirë apo keq që kishin formuar partinë e tyre, e lëre më ndonjë sugjerim, udhëzim a porosi konkrete për aktivitetet që rridhnin dhe që duhej t'u prinin aktivistët e LDK-së.

Jo me shumë takt, si njeri i letrave përplot emocione, e jo si diplomat me dorashkat e gjakftohtësisë, Ali Aliu ia pret fjalimin përfaqësuesit nga Tirana duke ia rikujtuar atë që duhej të dijë këshilltari i parë i presidentit të mëmëdheut: i shpjegon duke i thënë se “gjitha parashenjat, sipas vlerësimeve tona, janë se Beogradi do ta ashpërsojë gradualisht drejtimin politik në Kosovë dhe ndaj Kosovës, se terrori nga dita në ditë shkallëzohet, se ekziston frika

se një ditë situata do të bëhet shpërthyesë dhe kosovarët detyrimisht do të gjenden përballë armatës jugosllave, do të futemi në luftë”. Që në fund t’ia shtrojë pyetjen e drejtpërdrejtë se “ç’është në gjendje të ndër marrë Shqipëria në një situatë të tillë, sa është e gatshme ta ndihmojë Kosovën përballë një rreziku të tillë?” “Në një situatë të tillë, do të na ngushtonit shumë!” – përgjigjet pa u hamundur përfaqësuesi i Ramiz Alisë.

Nuk ka dyshim se nga ky takim, Ali Aliu dhe Bukoshi kishin dalë si të qullur. Kishin humbur vullnetin të vazhdonin më tej bisedën. Ata u ngjanin njerëzve të cilët ngutshëm ishte rrënuar kështjella e iluzioneve se Tirana zyrtare e ndiqte situatën e shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, se sadopak mëmëdheu bëhej gati të ndante me Kosovën të keqen, me të cilën nuk kishte si të mos përballej në të ardhmen kjo pjesë e shqiptarisë.

Takimi i dytë i Ali Aliut dhe Bukoshit me Sofo Lazrin do të ndodhë pas disa muajve, gjithashtu në organizim të Ambasadës Shqiptare në Bon. Në takimin e muajit shkurt të vitit 1991, do të jetë prezent edhe Ibrahim Rugova. Delegacioni kosovar do të arrijë në Bon pasdite vonë. Aty, në Ambasadën Shqiptare, do të dëgjojnë kujën e grave nga dhembja që në Tiranë ishte “rrëzuar shoku Enver”. Në të vërtetë, atë ditë kur Aliu, Bukoshi dhe Rugova do të arrijnë në rezidencën e ambasadorit të Shqipërisë në Bon, demonstruesit në Tiranë do të shënojnë fundin e një epoke të egër komuniste, duke e përplasur për toke përmendoren e stalinistit më të devotshëm në këtë botë – atë të Enver Hoxhës.

Delegacioni i LDK-së të nesërmen do të fluturojë për në Tiranë. Aliu vinte në Shqipëri pas plot dhjetë viteve.

Ishte koha kur Tiranën e kishin kapluar tronditje historike, në ditë kur nuk dihej se çka do të sjellë e nesërmja. Ishte udhëtimi i parë i Aliut për në Tiranë me aeroplan. Kuptohet, udhëtonin pa viza (leje) nga policia Jugosllave, leje që ishte e domosdoshme për shqiptarët vetëm kur vizitonin Shqipërinë. Në aeroportin e Rinasit, përfaqësuesit e LDK-së, do t'i presë delegacioni shtetëror me në krye Sofo Lazrin dhe përfaqësuesit e Partisë Demokratike me në krye Sali Berishën. Përpos me Gramos Pashkon, i cili kishte qenë në delegacionin e PD-së, Ali Aliu ishte takuar herë pas here edhe me Sali Berishën. Nga delegacioni shtetëror, Aliu njihej vetëm me Sofo Lazrin, me të cilin ishin takuar edhe një herë më parë në afërsi të Vjenës.

Delegacionit kosovar kjo pritje mund t'i jetë dukur paksa e çuditshme. Në mos për hiçgjë tjetër, atëherë shkakun se mëmëdheu i priste i ndarë në dy delegacione. Përfaqësuesit e LDK-së ishin kureshtarë të dinin se cilët ishin themeluesit dhe drejtuesit e partisë së parë demokratike në Shqipëri, por nga ana tjetër, nismëtarë dhe realizues i vizitës së tyre ishte qeveria shqiptare. Ali Aliu, Rugova dhe Bukoshi, ishin mysafirë të shtetit shqiptar. Delegacioni kosovar nuk e kishte të vështirë të vërente atmosferën e acaruar në mes përfaqësuesve shtetërorë dhe atyre të PD-së. Duke vërejtur këtë atmosferë të tendosur, Ibrahim Rugova do t'i përshëndesë nikoqirët duke theksuar se i gëzohet të qenit të tyre bashkë, se më shpresëdhënëse për Kosovën është kur atë e presin demokratët dhe komunistët e bashkuar. Në këtë drejtim kishin folur edhe Aliu dhe Bukoshi, mbase duke dashur në atë mënyrë të mbanin gjallë iluzionin e vet se kur bëhej fjalë për Kosovën, mëmëdheu nuk ndahej në parti politike,

se për hir të së mirës mbarëkombëtare, partitë në Tiranë nuk do të shalëronin kalin e marrosur të konfrontimeve që do të përçajjnë popullin, se nuk do të bënin gara cili është atdhetar më i madh, e që më në fund të shihej se shqiptaria ishte në rrezik të kishte aq “shqipëri” sa edhe parti politike.

Të ardhurit nga Kosova, e dinin se vetëm një Shqipëri e bashkuar rreth çështjes së Kosovës, vetëm një Shqipëri e dëlirur nga antagonizmat ndërpartiake, do të mund t'i bëhej krah i fortë Kosovës, ëndrrës së kosovarëve për t'u çliruar nga robëria shekullore serbe. Dëshira e tillë e kosovarëve, thuhet ishte më e kapshme për pushtetarët e atëhershëm komunistë - të cilët natyrisht që e ndienin fundin e vet - sesa për kryesuesit e PD-së, të cilët nga larg e ndienin shijen e lezetshme e të qenit në pushtet dhe besonin se së shpejti do të merrnin në dorë fatin e Shqipërisë. Por, ajo që kishte ndodhur vetëm një ditë më parë (rrënimi i përmendores së Enverit), e kishte ndehur mbi Tiranë tendosjen deri në kufi të konfliktit dhe dhunës.

Nga Rinasi për në Tiranë, treshi kosovar udhëtoi i ndarë në tri vetura të veçanta. Asaj dite kur ata u futën në kryeqytetin e mëmëdheut, rrugët ishin të shkreta. Në sheshin para presidencës, para hyrjes së saj, ishte vendosur një tank dhe plot ushtarë të armatosur. Qyteti dukej si në orë policore, apo shtetrrëthim. Kolona e veturave, i çoi kosovarët në një vilë në kodrinë. Në atë vilë, siç u thanë nikoqirët, kishte punuar dhe pushuar shoku Enver. Ishte e ruajtur dhoma në të cilën ai kishte shkruar serinë e vëllimeve të veprave të tij të njohura. Por, vendosja në atë vilë - shumë komode, e qetë dhe e vendosur në mes të pyllit - treshit nga Prishtina nuk u pëlqeu: kishin kureshtje të madhe të dilnin sa më shpejt rrugëve të Tiranës, për të

cilat i kishte marrë malli dhe ku do të mund të takonin miqtë dhe të njohurit e shumtë. Sidomos shkrimtarët dhe intelektualët e Shqipërisë me të cilët edhe Aliu edhe Rugova kishin miqësi shumëvjeçare. Nga kjo vilë ata mund të dilnin vetëm me veturë. Pastaj mund të kenë pasur edhe ndjenjën se me qëllim i kishin izoluar. Dëshirën e tyre për të qenë në qytet, ata do t'ua thonë nikoqirëve dhe po atë mbrëmje do të vendosen në një vilë tjetër në Tiranë.

Po atë natë, pas takimit me miqtë dhe të njohurit e tyre, treshi i LDK-së do të jetë i ftuar nga Sali Berisha. Mysafirët nga Prishtina do të vizitojnë në apartamentin e tij, në pallatin diku pas hotelit “Arbëria”. Në një si dhomë dhe kuzhinë bashkë, në banesën e Saliut, pos tre kosovarëve, do të jenë të pranishëm edhe katër-pesë veta nga kryesia e PD-së. Ishte fare e natyrshme që në këtë ambient dhe mjedis të dominojë tema për gjendjen dhe rrjedhat politike në Shqipëri dhe Kosovë. Atmosferën e tendosur, të ngarkuar me “rënien e Enverit”, e mbingarkonin edhe informacionet që ato ditë qarkullonin dhe e vërshonin kryeqytetin për komunistët e jugut të Shqipërisë, të cilët kinse paskëshin organizuar marshim drejt Tiranës për ta “rikthyer Enverin”. Andaj rekomandohej të mos dilej në qytet, se konfliktet mes grupeve radikale antienveriste dhe atyre në mbrojtje të Enverit, parashikoheshin gati si të sigurta.

Aty kah mesnata, në banesën e Berishës ishte futur një i panjohur për treshin kosovar. I porsaardhuri, pa përshëndetur dhe thujse pa i vërejtur fare mysafirët, do të ulet në një karrige në fund të sallonit, si të ishte i familjes. Ja si e përshkruan Ali Aliu, këtë takim të parë të vetin me Azem Hajdarin: “Gjëja e parë që bëri pasi u ul –

kërkoj bukë. Duke ngrënë filloi të rrëfejë për ndodhitë, peripecitë, përshtypjet, bëmat që i kishin ngjarë gjatë udhëtimit. Me një veturë të vjetër, e shoferin pranë, paskësh qenë gjatë tërë ditës në jug të Shqipërisë, sa për të kontaktuar me simpatizantët e PD-së, sa për të parë reagimet e popullatës në disa qytete të jugut, ku kishte ndeshëm përkrahës të Enverit. Nuk e morëm vesh nëse në një mision të tillë, i panjohuri për ne, ishte nisur kokë më vete apo i dërguar nga PD-ja. Më vonë, morëm vesh se i sapoardhuri ishte Azem Hajdari. Natyrisht që ia kisha dëgjuar emrin, meqë krahas atij të Sali Berishës, në shtypin e jashtëm, përmendej edhe ai i Azemit, si prijës i studentëve, nga lindi në fillim lëvizja demokratike shqiptare. Fliste për ndeshjet me policinë, për grupet e organizuara komuniste, për kundërgrupet, etj. Dikur, duke folur e duke përthypur, tregoi edhe një detaj në kuadër të kundërmasave nga ana e simpatizantëve demokratë ndaj mbështetësve komunistë: “U thashë t’ua ndalin ujin, shkërdhatave!”

Kosovarët nuk kishin thënë gjë deri në fjalët e fundit të Azem Hajdarit. Azem Hajdari kishte folur pa i bërë përshtypje se aty ishin edhe tre persona të panjohur për të. Mbase ka menduar se janë simpatizantë të rinj të PD-së, që asokohe ofroheshin dhe rekrutoheshin me të madhe. Ku ta dish, për ta bërë me dije prezencën e tyre, apo i ngacmuar nga qëndrimi mospërfillës i Azem Hajdarit ndaj tyre, Ali Aliu do të bëjë një ndërhyrje aspak të pritur dhe diplomatike: “Atyre shkërdhatave komunistë, nuk u vjen mendja duke ua ndaluar ujin, e me masa të ngajshme. Që të shpëtosh nga ata, më mirë falua Greqisë!”. Pas këtyre fjalëve, Hajdari kishte ngritur kokën dhe ishte dukur sikur për herë të parë kishte vërejtur praninë e të panjohurve.

Kishte shikuar Ali Aliun, pa komentuar ndërhyrjen e tij. Bukoshi kishte shkelur këmbën e Aliut, duke e lutur në këtë mënyrë që të mos vazhdojë tutje me këtë ton të bisedës. “Boll Azem, ha bukë!” – i kishte thënë Berisha, Azem Hajdarit. Dhe diku mes bisedave të papërfunduara dhe përplot paqartësish, kishte mbaruar edhe nata e parë e delegacionit të LDK-së në Tiranë, në dimrin e vitit 1991. Për të nesërmen ishte caktuar takimi i tyre zyrtar me Ramiz Alinë.

Përfaqësuesit e Kosovës, në presidencë, do t'i presë Ramiz Alia, Sofo Lazri dhe Xhelil Gjoni. Përzemërsia ishte e përmbajtur dhe pritja do të zhvillohet sipas protokollit zyrtar, të paraparë për vizita të delegacioneve të huaja: në fillim incizimi i kamerave të televizionit shtetëror, pastaj fjala e rastit e Ramiz Alisë për rrjedhat aktuale politike në Shqipëri. Delegacionit kosovar do t'i bëjë përshtypje se sa i informuar ishte Ramiz Alia për atë që ndodhte në botën komuniste. Nuk do të përmend në asnjë rast se perandoria komuniste ndodhej para rrënimit të plotë, por nga informatat që shtronte gjatë fjalës, dukej se edhe ai, me keqardhje, e kishte të qartë se ato ishin ditët e fundit të një rendi shoqëror. Ishte e qartë se përqendrimi kryesor i asokohshëm i Ramiz Alisë ishte si të shmangeshin konfliktet brendashqiptare, si të mos provokohej gjakderdhje. Ai asokohe nuk e kishte fshehur nga delegacioni i LDK-së se është ithtar i fillimit të një pluralizmi të kontrolluar.

Natyrisht, Ramiz Alia kishte folur me gjuhën që dëshmonte se e kishte parasysh Sali Berishën dhe demokratët e tjerë, me vetëdijen e njeriut se Rugova, Aliu dhe Bukoshi, gjatë qëndrimit në Tiranë, kishin kontaktuar me shumë miq të tyre, si edhe me themeluesit e PD-së.

Ai me siguri e dinte se treshi kosovar, natën e mëparshme e kishte kaluar në apartamentin e Sali Berishës, se PD-ja në të ardhmen do të jetë pala me të cilën do të bashkëpunonte më ngushtë dhe më lirshëm LDK-së. Treshi nga Prishtina shumë shpejt e kuptoi se Ramiz Alia i kishte ftuar në Tiranë që të ndikonin te Berisha të mos ngutej sa më shpejt të merrte pushtetin në duar, të kujdesej të mos vijë deri te gjakderdhja, meqë partia dhe shteti shqiptar, ishin të gatshme të mbrojnë rendin nga rebelimi në rrugë, nga shkatërrimi i vendit. Natyrisht që ky vizion nuk ishte në kundërshti me atë të përfaqësuesve të LDK-së. Në të vërtetë, ajo ishte rruga e vetme që do t'i mundësonte Shqipërisë të këndellej më shpejt, të siguronte përkrahje dhe miqësi nga shtetet e rëndësishme të botës, e me çka do të arrinte të bëhej krah i fortë për Kosovën, ta vinte çështjen e shqiptarëve të Jugosllavisë së atëhershme si të parën në rendin e ditës së politikës dhe aktivitetit diplomatik.

Por treshi kosovar, e kishte të qartë se as preokupimi i Tiranës zyrtare, e as ai i udhëheqësve të PD-së për Kosovën, nuk ishte as së afërmi në shkallën që e mendonin ata. Vizitën e tyre, Tirana e atëhershme komuniste e kishte iniciuar që të kërkojë ndihmë e jo të ndihmojë. Edhe atë, duke e ditur se Kosova dëshironte rrjedha shumëpartiake të qeta në Shqipëri, se të gjithë shqiptarët jashtë shtetit amë donin që mëmëdheu të dalë me sa më pak plagë nga periudha komuniste, se vetëm pa konflikte të brendshme partiake Shqipëria do të mundej t'i ndihmonte çështjes shqiptare. Dhe Ramiz Alia donte që delegacioni kosovar të ushtronte ndikim që demokratët e rinj të kishin kujdes, të mos i dehte së tepërmi etja për pushtet dhe ashtu të dehur të mos shihnin se cilat rreziqe i kanoseshin asokohe Shqipërisë.

Ngjarjet, rrjedhat politike në Kosovë, ardhmërinë e saj, kosovarët e shihnin të lidhur, të kushtëzuar ngushtë me rrjedhat dhe perspektivën e Shqipërisë. Pala kosovare i shihte aq ngushtë kushtëzuar nga njëra-tjetra, sa nuk mund ta kuptonte masën e pandjeshmërisë së Tiranës ndaj rrjedhave që do të pasonin. E këtë pandjeshmëri e vërenin thuajse në të gjitha takimet që asokohe patën me pushtetarët dhe kryesuesit e PD-së së Sali Berishës. Treshja kosovare e ndiente se në ato bisedime prania e çështjes së Kosovës ishte thuajse sa për të shpëlarë gojën dhe sa për të mos i lënë pa ushqim iluzionet kosovare. Ato iluzione që te kosovarët kishin filluar nga pak të zbehen.

Megjithatë, kosovarët ende i mbante shpresa se sa ta marrë veten nga kriza kaluese, Shqipëria do t'i rikthehet çështjes së shqiptarëve matanë kufirit, ashtu siç ia ka hije shtetit amë, shtetit të cilit ia kanë marrë dhunshëm gjysmën e trollit, gjysmën e shtëpisë, më shumë se gjysmën e popullit të vet. Mbase edhe nuk mund të ishte ndryshe për një shtet e për një popull politikisht të pjekur, për një elitë politike, e cila dinte të dëgjojë e të kuptojë qartë tik-takun e orës së bardhë të rrjedhave në Ballkan dhe në botë.

Se nuk do të ndodhte ashtu, Ali Aliu dhe gjithë iluzionistët e tjerë shqiptarë, do të binden disa vite më vonë. Këtë bindje Aliu do e përforcojë edhe gjatë grindjeve brendapartiake të viteve të fillimshekullit njëzet e një, kur thuajse çdo mbledhje e parlamentit shqiptar në Tiranë do të përfundonte me kacafytje mes deputetëve të Sali Berishës dhe atyre socialistë. Kacafytje edhe fizike, nga më primitivet, e që shqiptarët e kësaj ane të kufirit i çonte të pyesin veten: Nëse neve na përguan sllavët që të

bashkëpunojmë dhe shijojmë veprimin e përbashkët, nëse neve këndeje politikisht na përçajmë forcat e huaja policore që nuk e duan veprimin e njësuar tonin për çështjet madhore kombëtare, atëherë ç'është ajo që bashkëkombësit tanë në Shqipëri i çon t'ia hanë kokën njëri-tjetrit, që i shtynë të sillen mes veti si të ishin armiq të përbetuar, e jo si kundërshtarë të vetëdijshëm politikë? Edhe shumë pyetje të tjera logjike shtronin shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë, përderisa Sali Berisha në Shqipëri prodhonte armiq dhe Edi Rama ngadalë i bashkëngjitej politikës grindavece shqiptare, si të dëshmonte “kodin gjenetik” të “prindërve” partiakë që e lindën dhe nxorën në skenën politike. Dhe thuajse të dy njësoj, nuk e shihnin se shqiptarët atje dhe kudo që jetonin, i kalonin netët pa patur rrymë elektrike dhe pa mundur të pastrohen e të ngihen me ujë të pijshëm. Kjo dritë-terr, në fillim të mileniumit të tretë, në të cilin jetonin shoqëritë shqiptare në Shqipëri e Kosovë, thuajse fare nuk u pengonte politikanëve në Tiranë e Prishtinë, ku ushtonin rrymëprodhuesit me naftë. Politikanët e tillë nuk mundën të peshonin se sa e dëmtonin çështjen mbarëshqiptare grindjet e tyre absurde ndërpartiake, të cilat në thelb nuk kishin shkak konceptet politike, por përfitimet personale që ua sillte elitave partiake të qenit afër grazhdit pushtetar. Politikanët e tillë as që e dinin ç'përmasa kanë grindjet e tyre për atdhetarët si Ali Aliu, të cilët dhembshëm përjetonin çdo përplasje politike mes parive në Tiranë e Prishtinë. Mbase ata kurrë nuk do të dinin sesi e ndiente veten Ali Aliu kur udhëtonte nga njëra “shqipëri” në tjetrën, që në rini i kishte ëndërruar si më të begata dhe të përkushtuara për të mirën e popullit.

Është e pamundur që gjatë udhëtimeve të natës nëpër “arbëritë”, Ali Aliu të mos e ketë ndier veten si shumica e atyre që nuk i kishte dehur epshi për pushtet: thujse udhëton nëpër vende që jetojnë jashtë kohës, që nuk kanë asgjë të përbashkët me vendbanimet që i ke parë ditën. T’i jetë dukur sikur voziste nëpër një botë irrealë, e cila ekziston mes territ e dritës, ku njerëzit herë i shoqëron e herë i braktis hija e tyre dhe shëtisin pa të. Sepse qytetet dhe fshatrat e shqiptarisë në fillim të mileniumit të tretë jetonin dritëtërrin e vet politik dhe atë të vërtetin, për shkak të mospasjes rrymë elektrike sa duhet.

Edhe në vendbanimet ku natën s’kishte drita, të rinjtë shëtisnin rrugëve njësoj si edhe ata ku lagjet ishin të ndriçuara. Mbase terri i mbyllur mes katër mureve u bëhej më i padurueshëm se ai i hapësirës së paskajshme ku nata, njësoj e shtron mbulesën e vet si mbi hallexhinjtë ashtu edhe mbi të lumturit e kësaj bote. Ka mundur shpeshherë t’i ndodhë edhe Ali Aliut të jetë hamundur mos vallë shëtitesit e rinj dilnin rrugëve natën, që ashtu grupe-grupe dhe së bashku, më lehtë t’i përballin orët kur shteti dhunshëm i çonte të kursenin rrymën elektrike. Mund edhe Aliut, si edhe shumë të tjerëve, t’i ketë ndodhur të mendojë se shëtitja e tyre nëpër terr ka qëllim tjetër: të shohin hijen e zgjatur të vetvetes që shtrihet para apo pas tyre, sa herë që rrugës kalonte ndonjë veturë me drita të ndezura - të binden se nuk janë trup pa hije, se politikanët e tyre nuk ua kishin grabitur edhe të fundmen pronë që kishte trupi i tyre. Ali Aliut ka mundur t’i ndodhë ajo që u kishte ndodhur edhe shumë të tjerëve që asokohe nuk e kuptonin sesi Shqipëria me aq shumë ujë dhe Kosova me gjithë atë qymyr, të mos kenë energji të mjaftueshme elektrike: gjatë udhëtimeve të natës nëpër “arbëri”, gjatë

voztjave nëpër vendbanimet ku mbisundonte terri, të dëshirojë të ndalë veturën, të shohë nga afër ato fytyra të të rinjve që mbushnin kafenetë, apo qëndronin qosheve të rrugëve duke pritur të shfaqë dritat, që pastaj të kthehen nëpër shtëpitë e veta. Me siguri, nuk ka patur forcë ta bëjë këtë. E ka penguar trishtimi posa ka parë ata shikime të pashpresa, ata të rinj të cilët qysh në vitet e njoma të rinisë kishin zberthyer fshehtësinë e madhe, të cilën e shkruanin mbi pëllhurën e natës që i mbulonte: Jeta është aq e shkurtër, dhe terri i paskajshëm. Kishin zbuluar se dikush ua shkurtonte jetën, e cila është dritë, ua shtonte terrin që u takon lakuriqëve të natës dhe njerëzve që duan të veprojnë e të mos u shihet fytyra. Që të nesërmen, kur lakuriqët të varen nëpër shpella apo në trarët e shtëpive të braktisura, ata të shëtisin pranë kalimtarëve të tjerë, me buzëqeshjen e pafajësisë lëvarur në cep të buzëve.

Gjatë viteve nëntëdhjetë dhe në dekadën e parë të shekullit të njëzetentë, shqiptarët i jetonin mbrëmjet nëpër restorante që mbinin në çdo qoshe të rrugicave dhe shesheve të qyteteve. Sepse kafenetë dhe hotelet, e jo bibliotekat dhe spitalet, ishin gjithmonë të ndriçuara dhe kishin gjithmonë drita. Aty shqiptarët e kursenin veten nga orët kur ndalej rryma elektrike, kur nëpër shtëpitë e tyre ndizeshin qirinjtë, drita e të cilëve i zgjaste hijet e shtëpiarëve nëpër muret e dhomës si në teatër hijesh dhe, fillonte shpjegimi i heshtur për jetën e harxhuar në kohën kur shqiptarët ishin bërë hije që shihnin në ëndërr vetveten. Asokohe, shtëpiarët ndiheshin ngushtë kur u vinte mysafir ndonjë mik i dashur, sepse e dinin se askush nuk e do terrin dhe vështirë se ndonjërin e zë gjumi në dhomë ku nuk ka ngrohje. Andaj edhe mysafirrit nuk i mbetej gjë tjetër përpos të aktrojë se çdo gjë ishte në

rregull. Sepse e dinte se bujarinë shqiptare e kishin dëmtuar politikanët që nuk merreshin me sigurimin e energjisë elektrike dhe ngritjen e standardit jetësor, por fajësonin njëri-tjetrin se cili është vjedhës më i madh, se cili grupacion politik ishte më i korruptuar se tjetri. Ata politikanë, të cilët nuk shihnin se në “shqipëritë” ku pretendonin të bëheshin deputet, ministra apo kryetarë, kishte filluar të rrënohej edhe familja shqiptare, kishte filluar të harxhohet shpirti bujar i shqiptarisë, që mund të prodhonte energji ngrohëse dhe elektrike për tërë “arbëritë” e diçka të mbetej për t’ua shitur fqinjëve.

Kur asokohe njeriu udhëtonte natën nëpër Shqipëri, ose rrugëve të Kosovës, i bëhej se herë është duke dalë, e herë duke hyrë në tunele. Thuajse është duke udhëtuar nëpër hapësirë kafkiane. Ndërroheshin vendbanimet e ndriçuara me ato në terr, njerëzit që ecnin së bashku me hijet e veta dhe ata që rrinin rrugëve duke pritur të vijnë dritat që të shohin njëri-tjetrin. Dritëterri i netëve shqiptare, ishte i çuditshëm, i mërzitshëm, ngërthente në vete dy skajshmëritë që nuk i bashkonte asgjë përpos pritjes së lodhshme: disa prisnin të fiken dritat e të jetonin pjesën e territ që e kishin hise, të tjerët ishin në pritje t’u vinin dritat. Dhe askush nuk e dinte cila pritje ishte më e mërzitshme: ajo e atyre që prisnin se kur do t’u vijnë radha t’i jetojnë orët e territ, apo e atyre që prisnin terri të zëvendësojë dritën e përkohshme. Askush nuk e dinte ç’përralla u tregonte gjyshja nipërve, ç’bënte një i ri në ato orë kur ndizeshin qirinjtë dhe zgjateshin hijet e shtëpiarëve nëpër muret e dhomave. Mos vallë u stërzgjatej pikëllimi, apo ngulfateshin nga mendimet që luhateshin njësoj si flaka e zbehtë e qiririt. Ku ta dish, ndoshta aty diku, në ndonjë lagje ku përnjëherë fikeshin

dritat, kishte edhe të atillë që ndiheshin mirë, që terrin, e jo dritën, e kishim ambient më të përshtatshëm jetësor.

Shoqëria shqiptare e Kosovës kishte rritur gjeneratën e lotqeshjeve fëmijërore, lindur në fillimet e viteve tetëdhjetë, që u shkollua nëpër bodrume, që u burrërua në mes të luftës, që u nis rrugëve të jetës kur vendlindja e tyre u bë “unmik-stan”, kur atdheu u mbush me “kurbetçinj” të ardhur nga e gjithë bota. Shqipëria rriste fëmijët që kishin shijuar qumështin e trishtë të kooperativave bujqësore, ata që qysh në rininë e hershme e panë si rrëzohet shtatorja e lartë e Enverit, që arritën moshën madhore mes krismave “shqiptaro-shqiptare” të 1997-ës kur shqiptarët vranë Shqipërinë, fëmijë që u nisën rrugëve të jetës duke shikuar muret rrethues me gjemba të ambasadave perëndimore, e që shijonin jetën me shikim të drejtuar matanë Adriatikut. Shqiptaria e asokohshme ishte duke rritur gjeneratën e dritëterrit, fëmijët që edhe gjumin e bënin copa-copa, njësoj si gjyshërit e tyre para qindra vitesh, edhe ninullat e nënave i dëgjonin nën dridhmën e flakës së qirinjve që shkriheshin nga zëri i trembur i prindërve që të mos u ftohen trashëgimtarët. Bota shqiptare e dy dekadave në demokraci, rriste fëmijët, të cilët mund gabimisht të mendonin se kafenetë, e jo bibliotekat, janë vende ku kurrë nuk duhet të fiken dritat. Fëmijët që rriste bota shqiptare mund gabimisht të mendonin se edhe jeta zhvillohet para dhe pas perdes së territ: ajo që duhet ta shohin të gjithë dhe ajo që duhet mbajtur fshehur. Se terri, e jo drita është e vlefshme, se e fshehura e jo ajo që shihet, përcakton fatin e njeriut. Mund të mendonin se terri e jo drita është aleat i jetës. Sepse kur dilnin të shëtisnin në orët e vona të netëve pa drita, edhe në terr dëgjonin britmat e narkomanëve, ofertat e

dilerve të lëmive të ndryshme, ftesat e vendorëve dhe të huajve të “gjinisë së tretë”, të cilët ngutazi lidhën besë mes veti dhe e “ndihmonin” shoqërinë shqiptare të përmbushë standardet që të bëhet Evropë.

Ku ta dish, ndoshta dritëterri në të cilin jetonte bota shqiptare, një ditë do t'i frymëzojë krijuesit e vonuar shqiptarë - të cilëve thujse gjithmonë u është nevojitur thellësi kohore - që të japin shpjegime për atë që u ka ndodhur vite më parë. Një ditë, kur të gjithë shqiptarët do të kenë drita dhe ujë të mjaftueshëm, ndoshta shkrimtarët shqiptarë do të frymëzohen nga koha e shkuar e viteve të “tranzicionit” dhe, të lehtësuar nga frika se do të mund të hidhërojnë krerët e ndonjë partie, do të përballen me bardhësinë e letrës e do të shkruajnë për dekadat kur politikanët shqiptarë e “tranzitonin” popullin e vet nga terri në dritë, duke mos dhënë llogari se ia dëmtonin bebëzat e jetës. Do të vijë dita kur shkrimtarët shqiptarë – të atillë siç janë, disidentë të vonuar – një ditë do të shpjegojnë për veprat që ua ka gëlltitur terri i asokohshëm (njësoj siç bënin në vitet nëntëdhjetë dhe në fillim të mileniumit të tretë, kur të vonuar ua shpjegonin monizmin e egër atyre që e kishin jetuar) dhe do e zbërthejnë atë që do e shohin të gjithë: dritëterri demokratik i ditëve të kohës së tranzicionit, ishte më i pjellshëm veç për kultivuesit e këpurdhave, që duan terr e lagështi, si edhe për partitë grindavece politike shqiptare, që arë pjellore kishin paqartësitë, e për dilerët, trafikantët, të pafytyrët, narkomanët..., të cilët i parapëlqejnë rrugët pa drita, e jo të ndriçuara.

Shpjegimet për atë që ndodhte në vitet e tranzicionit të shoqërive shqiptare, mbase do të arrijnë kur të mos ketë nevojë për kursim të rrymës elektrike, kur të gjithë shqiptarët do e shohin se edhe terrin dikush e kishte

përdorur mirë asokohe. Ato shpjegime do të jenë më të qarta kur shqiptarët do të bëjnë numërimin e saktë të të rinjve që i gëlltiti koha kur “shqipëritë” kursenin rrymën elektrike. Por, në pritje të kohëve të tilla, të ngjashmit me Ali Aliun donin ta shpallnin publikisht se, sa herë që udhëtonin natën nëpër “arbëritë” e tyre, u bëhej se ishin duke e jetuar tregimin e vet më të trishtë që mund të pille imagjinata, por të cilin nuk donin ta shkruanin kurrë. Sepse gjatë udhëtimeve të tilla, atyre u fanitej se nga të gjitha anët ndriçonin minaret e xhamive, dëgjohej zëri i myezinëve dhe rënia e këmborëve në kishat shqiptare, se shqiptaria shumëreligjioze e luste Zotin pastër e shqiptani që kishin aq të huaj të të gjitha ngjyrave mes tyre, u ndodhte të trajtoheshin si popull shumëacorë. Këtë nuk e donin, jo pse ishin racistë, jo pse nuk e dinin se dashuria nuk njihete raca, se të gjithë njerëzit janë të zgjedhurit e Zotit, po që të ruanin gjakun e gjyshërve të tyre. Gjakun që mbrojti moralin e pastërtinë, edhe nën dritën e llambave të vajgurit, pa e ditur se një ditë, socializmi do të lavdërohet me elektrifikimin e gjithë fshatrave, e demokracia e mëvonshme me ditët kur nuk do të kishte ndërprerje të rrymës elektrike. Gjyshërit, të cilët qysh në vitet kur jetonin sipas kodeve të Kanunit të Lekës, e kishin kuptuar se ka disa vlera pa të cilat humbet vetvetja. E kur humbet vetvetja, humbet edhe besimi në njerëzoren. Kur zhduken ato vlera, njeriu harron se besimi në vetvete, e jo drita, është më i shpejtë se zëri.

Në vitet e demokracisë, Ali Aliut shpesh i ndodhte të udhëtojë natën nëpër rrugët e “arbërisë”. Ka mundësi që asokohe të ketë dëgjuar edhe rrëfimet e disa të huajve, të cilët me dhembje shpjegonin se shtetet e Ballkanit në “tranzicion” të asaj kohe, më lehtë e kishin të gjenin

donatorë për të përkrahur financiarisht ndonjë “shoqatë të lezbijkave”, sesa për të riparuar ndonjë termoelektranë me pajisje të ndryshkura. Mbase, thoshin ata, kjo vjen se çdonjëri ndihmon “gjininë” e vet, se disa nga ata që vinin nga të gjithë meridianët e botës - që të ndihmojnë “arbërinë” që sa më parë të përmbushë standardet demokratike – donin t’i dinin adresat e sakta të “vëllazërisë” së tyre, donin t’i kenë grumbull, në një vend, që ta bënë më lehtë zgjedhjen e “kuadrove” liberalë. Miqtë e shqiptarisë nga perëndimi, hapur rrëfenin edhe për raste kur të rinjtë shqiptarë, të përbullur nga varfëria, ishin të gatshëm t’u jepnin “shërbime” nga më të ndryshmet disa të huajve – në banesat e të cilëve mbase gjithmonë kishte drita dhe më lehtë mund të përballeshin orët e errëta të natës – me çka siguronin pagë për të jetuar ditët rinore. Me siguri ato ishin raste të rralla, ishin rrëfime që i stolisnin trullanët shqiptarë, ata që mendonin se të huajt përfitojnë nëse mjerimin tënd e bën edhe më të thellë seç është, por do të mjaftonin të alarmonin politikanët e papërgjegjshëm shqiptarë që nuk e shihnin se rinia u ikte nga duart. Nga rrëfimet e tilla terri bëhej më i dendur, aq sa ngjallte kokëfortësinë shqiptare nga do lindte klithja: Jo se nuk ka shqiptarë që janë edhe shitës të vetvetes, jo se në ato kohë përplot varfëri nuk ndodhnin edhe ngjarje të paparashikuara, por shqiptari edhe kur e ka pasur jetën ëndërr, e ka ditur se jeta dhe vdekja janë fletë të të njëjtit libër, se jeta është certifikatë për ta merituar vdekjen, se vdekja nuk i ndan njerëzit në të pasur e të varfër, por në ata që kanë pranuar përbuzjen dhe ata që e kanë ruajtur yllin e nderit e bujarisë njerëzore në ballë. Shqiptarët e dinin se pa ndihmën e të huajve, Kosova më vështirë do ta kishte të çlirohej nga prangat sllave, por

populli e kishte kuptuar se, si çdoherë më parë, nuk do ta shpëtonte vetëm përmbushja e standardeve për t'u "bërë" Evropë, por do të mbijetonte pse ka ditur t'i mbrojtë vlerat vetjake, kulturën dhe traditën e vet, rendin familjar. Shqiptari ka ruajtur të panjolllosur moralin, i cili e ka mbajtur gjallë edhe kur e ardhmja e ndritur për të ka qenë vetëm ëndërr e largët.

Është e pamundur udhëtarin e asokohshëm të natës nëpër "shqipëritë" të mos e ketë kapluar dëshpërimi i ngjashëm me atë të prindit që nuk di t'u japë shpjegim fëmijëve pse korporatat elektrike në Kosovë e Shqipëri, merreshin me shpërndarjen e drejtë të territ, e jo të dritës. Dëshpërimi i prindërve, të cilët nuk i shqetësonte gjithaq çmimi i lartë i rrymës elektrike, të cilën e paguanin edhe pse nuk e kishin, por e vërteta është se sa herë që shuheshin dritat, fëmijët e tyre shëtisnin rrugëve pa hijen e vet. E fëmijëve shqiptarë ajo u ndodhte mbase se prindërve të tyre nuk u kujtohet të dalin gjatë ditës rrugëve, e t'u thonë qeveritarëve: O idiotë, aty ku kursehet edhe rryma elektrike, askush nuk mund ta shohë në ç'drejtim shkojnë dhe me kënd shëtisin fëmijët natën. Aty ku dominon terri, të rinjtë e kanë vështirë të shohin se gabimet rinore janë më të shtrenjtët, se ato gabime i paguan gjatë tërë jetës, të ndjekin sa të jesh gjallë, të bëhen të pandashëm si hija e trupit, i ke bashkudhëtarë që të pengojnë të ecësh drejt ardhmërisë. Në shtetet ku korporatat elektrike bëjnë orarin sesi të shpërndajnë terrin, banorët e kanë vështirë të kuptojnë se njeriu dëshmon vetveten edhe nëpërmjet kushteve në të cilat jeton. E kushtet jetësore ndikojnë në shprehinë e njerëzve. Siç ndikonte asokohe dritëterri shqiptar në udhëtarët e natës, që ato udhëtime i përjetonin dhembshëm dhe me ankth.

Jo vetëm pse nuk i shihnin gropat e thella e të gjera nëpër rrugët e ngushta, por për shkak se ata që shëtisin rrugëve në pritje të vijnë dritat, u ngjanin njerëzve, të cilët kanë shtëpi, por jo edhe shtet.

E si njeri që ka shtëpi, por jo edhe shtet, Ali Aliu do të ndihet edhe pas qëndrimit treditör të vitit 1991 në Shqipëri, kur me Rugovën e Bukoshin do të ktheheshin në Prishtinë. Në aeroportin e Shkupit i priste Mehmet Kraja. Pa humbur kohë, meqë ishte thuajse gjysma e natës, do të nisen për në Prishtinë. Në Han të Elezit do t'i ndalë një patrullë policore dhe do t'i detyrojë të nxjerrin nga valixhet e çantat çdo gjë që kishin, dhe t'i radhisin në asfalt, nën dritat e rrugës së qytezës. Pas fyerjeve dhe të sharave (dy net më parë televizioni i Beogradit kishte dhënë pamje nga takimi i delegacionit të LDK-së me Ramiz Alinë), duke aluduar në vizitën e tyre të bërë në Tiranë, do t'i lejojnë të vazhdojnë rrugën drejt Prishtinës. Por, disa kilometra më larg, tek udhëkryqi që kthen për në Brezovicë, diku në mes të rrugës Shkup-Prishtinë, do t'i presë një patrullë më e madhe policore. Në të vërtetë, policia serbe kishte bllokuar rrugën me disa automjete dhe xhipa. Kordonët policore kishin rrethuar veturat me të cilat udhëtonin kryesuesit e LDK-së. I kishin urdhëruar të dalin jashtë. Ishte e qartë se çdo lëvizje jashtë urdhrit policor dënohej me plumb. Të radhitur njëri pranë tjetrit, kryesuesit e LDK-së ishin të vetëdijshëm se mund të përfundonin nën breshërinë e plumbave, si edhe shumë shqiptarë të tjerë që pësuan asokohe nga egërsia serbe.

Pasi kishte marrë fund kontrolli, policia serbe urdhëroi kryesuesit e LDK-së të vozisnin pas automobilave të tyre, për t'i çuar në Ferizaj. Aty i priste një shef, i cili mbase duhej të ishte përgjegjës i shërbimeve policore. Pse nuk

jeni ndalur në sinjalin e patrullës në Han të Elezit, i kishte pyetur kryeshefi i policisë. Në të vërtetë, kjo pyetje shpjegonte tërë skenarin që asokohe shpesh e përdorte policia serbe për likuidimin e shqiptarëve, me arsytim se nuk ishin ndalur pas urdhrit të patrullës policore. Pas sqarimeve të hollësishme se jo vetëm që ishin ndalur, por patrulla në Han të Elezit i kishte kontrolluar detajisht, komandanti i Ferizajt me vonesë e kishte kuptuar porosinë që ia kishin përcjellë kolegët e tij nga qyteza në afërsi të kufirit të Kosovës me Maqedoninë, nuk kishte kuptuar se kolegët e Hanit të Elezit donin t'i thonin: një bandë e armatosur e Ibrahim Rugovës është nisur drejt jush, andaj pritni me rafal!

Ali Aliu, si edhe shumë shqiptarë të tjerë, do të ndihet si ai që ka shtëpi, por jo edhe shtet edhe gjatë viteve të fillimshekullit të njëzetënjë, kur jetonte e vepronte në Shkup. Në mos tjetër, për shkak të zhurmës së madhe të partive shqiptare, të cilat luftonin mes veti, se cila do të bëhej pjesë e pushtetit, e nuk kishin kurrnjëfarë pushteti në duar. Ngaqë kishte filluar t'u pëlqejë të jenë ndihmës të pushtetarëve të etnitetit maqedonas, prandaj prijësit shqiptarë më mirë ndiheshin kur komunikonin me kolegët e etnitetit maqedonas se sa në mes veti. Kështu, për shembull, dihej se kënd PDSH-ja ka vëlla ideologjik në bllokun politik maqedonas, por kurrë nuk u mor vesh pse i konsideronte armiq thuajse të gjithë udhëheqësit e partive shqiptare dhe ata që nuk e përkrahnin aktivitetin e kryesuesve të kësaj partie; dhe, pse kjo parti nuk i duronte njerëzit që kishin kokë të vetën. Mbase kryesuesit e kësaj partie kishin harruar se për çdonjërin, vjen një kohë kur nuk ka si t'i mbulojë gjurmët që lë pas vetes, kur të tjerët do të vlerësojnë e do të rrëfejnë për bëmat e pararendësve.

Njësoj si shumë prej atyre që jetonin në shtetet që u mëvetësuan pas shpërbërjes së Jugosllavisë së Titos, u bënë rrëfyesit e së kaluarës socialiste dhe u shpjegonin pasardhësve Luftërat Ballkanike të viteve nëntëdhjetë, si dhe për formimin e shteteve të reja në Ballkan, për kohën kur u zhbë ëndrra e sllavëve të jugut, të cilët donin të jetonin mes veti vëllazërisht, duke mos mbajtur llogari se aty jetonin edhe popuj, të cilët nuk ishin as kushërinj të tyre, e lëre më të një gjaku, si më shumë se tre milionë shqiptarët.

Në rrëfimin për Ballkanin e fundshekullit të njëzetë, kaptina më interesante do të jetë ajo ku do të përshkruhet shpërbërja e Jugosllavisë. Ajo kaptinë do të ketë plot nëntituj absurd, si dhe fusnota ku duhet dhënë shpjegime plotësuese, si për shembull se nga kush serbët donin ta mbronin Slloveninë kur ajo u takonte sllovenëve, nga kush donin ta çlironin Kroacinë kur ajo me shekuj ishte pronë e popullit që atje jetonte, kënd donin ta dëbonin nga Bosnja, kur ajo u takonte boshnjakëve dhe si mund Kosova të ishte djep i ortodoksisë dhe kulturës serbe, kur me shekuj foshnjat shqiptare në këto treva s'mund të bënin gjumë të rehatshëm nga krismat e kolonizatorëve serbë që pushtonin tokat shqiptare. Rrëfimi për kohët e shkuara që i kishte përjetuar gjenerata e Ali Aliut dhe për të cilat ai u rrëfente ngandonjëherë nipërve të vet si për diçka të largët dhe "mos u ktheftë kurrë", do e ngërthejë në vete edhe pjesën më absurde, atë të mëvetësimit të Serbisë. Dhe këtë pjesë të rrëfimit mbase do e përcjellin pyetjet: nga kush u pavarësua Serbia, kush e pengonte të ndahet nga ata që nuk e donin Beogradin si kryeqendër të përbashkët. Gjyshërit do ta kenë vështirë t'u shpjegojnë pasardhësve se populli që i fundit shpalli pavarësinë e vet

pas shpërbërjes së Jugosllavisë së Titos, në të vërtetë ishte rob i vetvetes, ishte i ngulfatur nga kthetrat e së kaluarës, i pushtuar nga magjia e nacional-romantizmit, ishte nën sundimin e politikanëve të ardhur nga shekulli i nëntëmbëdhjetë, i magjepsur nga akademikët e historianët gënjeshtarë, të cilët arritën ta vënë popullin serb në gjumë, në shtratin e butë të mitologjisë, duke i premtuar se do ta zgjonin në livadhin parajsian ku jetojnë vetëm “popujt qiellorë” (kështu serbët e quanin asokohe vetveten).

Pa dyshim që kaptina më interesante e rrëfimit për proceset dezintegruese të viteve nëntëdhjetë në Ballkan do të përfshijë edhe parashikimet e sakta të atyre, të cilët qysh në fillim të viteve tetëdhjetë u bënë me dije akademikëve dhe udhëheqësve serbë se, nëse nuk heqin dorë nga megalomania nacionaliste, do të përfundonin me një Serbi jo më të madhe seç mbante pashallëku i Beogradit. Por, politikanët dhe akademikët serbë asokohe ishin të bindur se “Serbi quhet toka ku ka edhe një varr të vetëm serb”, e lëre më ndonjë kishë apo manastir. Dhe filluan luftërat kundër të tjerëve, që të arrijnë këtu ku janë sot: të masin se vallë janë çliruar plotësisht nga nacional-shovinizmi vetjak. Kuptohet, ndërkohë do të vijojë ndonjë pavarësi e radhës, parapërgatitje për pavarësinë e mirëfilltë, të cilën do e shpallin pasi Kosova edhe ndërkombëtarisht të pranohet si shtet i pavarur. Me çka populli serb përfundimisht do të arrijë të dalë nga djepi i mitologjisë së vet, që të ecë rrugës së ardhmërisë pa andrralla nacional-romantike.

Mbase në mesin e deputetëve që në vitin 2006 shpallën edhe një pavarësi të radhës të Serbisë, ka pasur edhe ndonjë nga ata të cilët në vitet '90 kremtonin marrjen e të drejtave të shqiptarëve, që aprovonin projektet

millosheviqiane të përpiluar në Akademinë e Shkencave të Serbisë. Dhe mbase ka mundur të rikujtojë në vetvete të vërtetën se gënjeshttrat shpërndahen me shpejtësinë e dritës, por sjellin vetëm terr. Pra, ka mundur përnjëherë të rikujtojë tunelin e errët drejt të cilit u nis lokomotiva e nacionalizmit serb, duke i zvarritur pas vetes të gjithë vagonët e popujve të tjerë të Jugosllavisë së Titos. Gjatë shpalljes së pavarësisë së vitit 2006, nga institucionet shtetërore u hoqën të gjitha simbolet e përbashkëta të Federatës Serbi – Mali i Zi, gjë që në mos më shumë, mund t'i rikujtojë Koshtunicës lartësinë e murit të ngritur me gjak, muruar që në vitet kur ai fotografohej me kallashnikov në duar; apo ta çojë ministrin e Punëve të Jashtme të Serbisë, Drashkoviç, të rikujtojë moshën e vet kur lavdërohej se “turqit” (boshnjakët) e Bosnjës do t'i nisë për në Anadoll, ndërsa shqiptarëve do t'ua presë dy gishtërinjtë e dorës që i çonin lart gjatë demonstratave rrugëve të Prishtinës.

Shumica midis udhëheqësve të Serbisë që në vitin 2006 shpallën pavarësinë e shtetit të vet, pasi nga ajo u nda edhe Mali i Zi, ishin ata të dikurshmit, të cilët në mos më shumë, duartrokisnin Millosheviqin në mitingjet ku ai shpaloste “epopenë më të lavdishme të serbëve”. Si të tillë, pritej të ishin ndër të parët që duhej të mbyllnin një kaptinë të përgjakur të Ballkanit dhe të fillonin të shkruajnë të renë: proceseve integruese të shteteve të popujve që jetojnë në këto hapësira. Duhej të rindërtonin urat e rrënuara të komunikimit normal mes popujve të një hapësire, ku siç duket, ende s'kishte përfunduar procesi i ndasive dhe stina e referendumeve për pavarësi e vetëvendosje. Proces, i cili do të përfundojë vetëm pasi Kosova të shpallet e pavarur.

Kësaj pjese të Ballkanit i duheshin më shumë se njëzet vite të kuptonte atë që të tjerët e shihnin sa mbyll e hap sytë: në fillimshkullin e njëzetenjë nuk hyhet me koncepte të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Shumë akademikëve e politikanëve të këtushëm u nevojiteshin gjak dhe varreza që të kuptonin se as të çmendurit e as trimat, nuk mund t'i shmangen asaj që doemos do të ndodhë: ajo që u është marrë të tjerëve me dhunë e padrejtësi, herdo-kurdo duhet t'i kthehet atij që i takon. Duke mos e kuptuar këtë të vërtetë, elitat intelektuale e politike serbe të viteve '90, shaluan kalin e miteve dhe vetëgënjimit, i cili vrapon shpejt, por nuk të çon më larg se në kthjellje të vonuar dhe të rrëzon në mes të rrugës. Pra, duke mos pasur ku të mbështesin ambiciet nacionaliste, elitat serbe u zhytën në mjegullën e miteve dhe të ardhmen e popullit të vet e flijuan në altarin e të kaluarës.

Në rrëfimin për të kaluarën e kësaj pjese të Ballkanit, do të zërë vend edhe shpallja e zhurmshme dhe plot gëzim e pavarësisë së Malit të Zi, në vitin 2006 si dhe heshtja e deputetëve të parlamentit serb gjatë shpalljes së pavarësisë së Serbisë. Sepse populli dhe deputetët malazez jetësonin ëndrrën e tyre të drejtë, ndërsa këta të dytët përballeshin me rrënojën e andrrallave gënjeshitare të mitologjisë së vet. Diku mes të zhurmës gazmore që derdhej rrugëve të Podgoricës gjatë shpalljes së pavarësisë së shtetit më të vogël në Ballkan, dhe heshtjes mortore në Beograd gjatë shpalljes së pavarësisë së Serbisë, fshihej e vërteta se fillimshkulli i njëzetenjë do të mbetej si një rruadhë më shumë në fytyrën e të ardhmes. Sepse, kaptina më e begatë e historisë ka qenë e do të mbetet ajo e gabimeve që bëjnë popujt. Pra, nuk rezulton aq i saktë pohimi se njeriu

mëson nga gabimet e bëra: sikur të ishte ashtu, të gjithë do të duhej të bënim sa më shumë gabime që do të na çonin në burg, e që pastaj të dinim ta çmonim lirinë. Pra, sikur të ishte ashtu, popujt e Ballkanit, të cilët që moti i kishin harxhuar të gjitha gabimet, do të duhej qysh dje, e jo sot, ta kuptonin se më të begatë janë popujt që kanë më pak histori luftërash. Njësoj siç janë më të ndershme gratë që nuk kanë të kaluar shumë të përfolur.

Rrëfimi për Ballkanin e fundshekullit të njëzetë do të përmbajë edhe kopertinën e shqiptarëve të ndarë në më shumë shtete të këtij gadishulli. Si të tillë ata mbetën të stolisur me dallueshmëri krahinore, fetare, të shkallës së arsimimit, të rrethanave kulturore ku ishin zhvilluar. Por, edhe me diçka që i dëshmonte se janë i të njëjtit fis dhe gjak: armiqësinë ndërpartiake kudo që ishin, mosdureshmëria mes faraonëve kulturorë dhe prirja të jenë të skajshëm që, qysh në kohë të komunizmit, bëri të jenë më komunistë se Stalini e në kohët e “katolicizmit” të bëhen “më katolikë se Papa”. Gjë e cila dëshmonte vetëdijen e shërbëtorit, i cili gjithmonë vuan që të jetë i pëlqyer nga “pronari”. Prandaj dhe, duke parë pandërprerë drejt “padronit”, harron të shohë veten. Andaj dhe ajo që mund të shihej edhe pa syzat e ekspertit, ajo që mund të vlerësohej edhe pa qenë ndonjë njohës i mirë i rrjedhave shoqërore, ishte e vërteta se sikur të kishte mundësi, çdo parti e shqiptarëve do të shpallte një “Shqipëri” të vetën dhe çdo elitë krahinore, me faraonin në krye, do të shpaloste flamurin e identitetit të vet kulturor dhe gjuhësor. Edhe në fillim të mileniumit të tretë partitë grindeshin për “të mirën e popullit”, duke mos parë se çdokund ku jetonin shqiptarë kishte reduktim të rrymës elektrike dhe gropa nëpër rrugët që lidhnin vendbanimet.

Elitat kulturore nuk shkuan ndër mend kurrqysh të zbulonin shkaktarin e akulturimit të shoqërive shqiptare dhe assesi të shihnin gropat e thella në vetëdijen bajraktareske. Andaj edhe mund të thuhet se shoqëritë shqiptare nuk ndiqnin rrjedhën e lumenjve të globalizimit botëror, as bëheshin gati t'u bashkëngjiten popujve të bashkuar të Evropës, por ende qëndronin përpara pasqyrës së vetënjohjes, ku shihnin trishtuar fytyrën e tyre të vërtetë dhe vërenin se janë duke u përpëlitur në shtratin e ngushtë të koncepteve të paqarta për ardhmërinë, që kishte shtrojë të kaluarën e përbashkët të ndritshme, përdorur për të mbuluar të sotmen e leckosur dhe të paqartë.

Në kohët e paqartësive shqiptare të fillimshekullit të njëzetënjë, nuk dihej se kush e kishte më rëndë: liderët partiakë, që politikën e kishin kuptuar si veprimtari, e cila të sjell përfitime personale dhe privilegje, por nuk bart përgjegjësi, apo elitat kulturore, të cilat nuk e vërenin se ashtu të ndara, çdonjëra nën flamurin e vet krahinor, ishin bërë shërbëtore të politikës së ditës. Por dihej kush vuante: i tërë populli dhe veçanërisht gjeneratat e reja, të cilat motiv të vetëm jetësor kishin braktisjen e vendlindjes. Përderisa politikanët, dehur nga mendësia që sa më shpejt të bëhen kapitalistë, kishin leverdi konkrete edhe nga grindjet e ndërsjella, mbeti i pakuptimtë mosdurimi mes elitave shqiptare kulturore, që mbase do të duhej të kishin qëllim parësor mbrojtjen e Makondos së tyre krijuese, murimin e kalasë kulturore, e cila gjithmonë ka qenë më e forta dhe më e dukshmjja, ajo që ka legitimuar përpara vetes dhe botës popullin e vogël shqiptar në këtë Ballkan ku jetojnë etnitete me ambicie të mëdha shtetformuese.

Tingëllon e vrazhdhtë, por nuk është edhe aq larg nga e vërteta, ajo që shqiptarët asokohe jetonin nën trysninë që

të gjithë të mbeteshin me shenjën partiake, krahinore dhe religjioze të shënuar në lëkurë. Mbeteshin kështu të damkosur me hekurin e nxehtë të mosdurimeve të ndërsjella bajraktareske. Andaj, në kohë të tilla, nuk ishin gjithaq trishtuese orët e territ kur ndalej rryma elektrike, as gropat nëpër rrugët që shkatërronin veturat; më e tmerrshmja fshihej pas të vërtetës se merrnin hov orvatjet që donin të dëshmojnë se baras me të qenit shqiptar, e rëndësishme ishte edhe të dihet se përpara cilit altar partiak, krahinor dhe religjioz gjunjëzohesh. Kjo, e jo diçka tjetër, përcaktonte ardhmërinë e popullit shqiptar. Ndërkohë, thujse të gjithë harronin se nga çasti kur njeriu pranon të jetë i shënuar, në të vërtetë, ai bëhet shpërndarës i mjegullës së lagësht të paqartësive e përçarjeve.

Nga dita në ditë, në shoqëritë shqiptare të kohës egërsohej lufta ndërpartiake, që më shumë i ngjante betejës mes dy ushtrive armiqësore, sesa garuesve që mbështeten në konceptet politike. Në shoqëritë shqiptare, grindeshin edhe faraonët e artit e kulturës dhe, përderisa pikërisht ata përcaktonin tiparet krahinore të shqiptarëve dhe shturnin kurorën e bukur të religjioneve ku besonin shqiptarët, vazhdonte akulturimi. Askush nuk merrej me daljen në rrugë të femrave shqiptare, të cilat zbritën çmimin në bursën e prostitucionit, apo me rininë që i ngjante lulishtes pa kopshtar dhe drogën që u bë “mastraf” i shumë familjeve shqiptare. Shumë ndërtues të Makondos krijuese, në vend të angazhoheshin në murimin e kalasë së vlerave të mirëfillta, i rrëmbeu mendësia e politikës së ditës. Andaj dhe, në fillimshkullin e njëzetënjë, si asnjëherë më parë, u stërmadhuan kryqet që të rinjtë mbanin në qafë, nga dita në ditë zmadhohej numri i atyre që mendonin se veshja arabe të bën mysliman

më të devotshëm. Emra e mbiemra të artit shqiptar - duke dashur të mbeten feud të paprekshëm të mendimit - harruan se qielli dhe toka nuk kanë as përkatësi etnike e as religjioze. Me këtë rast u dëshmuua e vërteta se aty ku krijuesit bëjnë politikë dhe politikanët përcaktojnë fatin e krijimtarisë, aty ku njerëzit e artit pastrojnë oborret religjioze dhe hoxhallarët e priftërinjtë bëjnë bekimin e artistëve, pra në shoqëritë ku tretet kufiri që ndan profesionet e përcakton standardet vlerësuese, bie mjegulla e hutesës, e cila nuk lë të shohësh se çdo gjë është vënë në shërbim të përfitimeve personale. Shumë nga mosdurimet e ndërsjella, të gjitha rirreshtimet në taborë, ishin të nxitura nga Faraonët që ëndërronin të kenë shtëpi më luksoze diku në bregdet, që donin sa më shpejtë të mbulojnë ëndrrat e mbrapshta nga e kaluara e tyre komuniste.

Pasi në Makondot krijuese marshuan hordhitë që bartnin tërë llumin e politikës ditore, dështimi i elitave kulturore shqiptare nuk kishte të bëjë vetëm me boshtin e tyre të dobët kurrizor, por edhe me turpin që këto elita s' ditën të mbrojnë më të vlefshmen e këtij populli. Edhe elitat kulturore kishin harruar se posa të kalojë ajo mjegull e shkaktuar nga grindjet, do të vinte dita të përballeshin me gjykatësit Kohë, do të vinte çasti kur nuk do të kishin mundësi të fshihnin të vërtetën, se jo rrallëherë ato kohë të turbullta, shumëkush i kishte përdorur për të fshehur portretin e vet të vërtetë. Apo, se shoqëritë shqiptare thuajse nuk mundeshin të çajnë rrugë përpara pa mos u armiqësuar, pa mos u ushqyer nga inatet e ndërsjella.

Nëse është i vërtetë vlerësimi se ishin kohë të turbullta, s'ka dyshim se ditët që vinin do të ishin të vulosura me turpin e mbjellë në të djeshmen; e nesërmja do të kishte shenjë njohëse edhe portretin e atyre që përdorën lapsin

të thellojnë hendekun mes shqiptarëve. Për fat të keq, numri i atyre që pas brengës për të ardhmen e shoqërisë shqiptare, fshihnin ambiciet për të mbetur faraonë të paprekshëm të së vërtetave, nga dita në ditë zmadhohej. Mbeti e paqartë se vallë shqiptarët ishin popull i vogël që ka shumë individë të mëdhenj, që do të mjaftonin për një kontinent të tërë, apo ndodhitë rridhnin aq shpejt sa çdo gjë mbetet e padukshme nga pluhuri i ngutjes. Apo ndoshta e tëra ishte vetëm një lumë vërshues mendimesh, lumë i cili bënte pastrimin e vonuar të truallit të urtësisë kolektive, për të cilin mbase kot thoshin se e kishin dëlirë si duhet rilindësit shqiptarë. Sido të jetë, nuk ishte e udhës të bëheshin vlerësime të ngutshme, siç asokohe i bën ata, dhe që për vlerësimet e tyre të gabuara, më vonë arsyetoheshin se i kishin bërë nga shkak se kishin qenë “gabimisht të informuar”. U pa qartë se ata vuajnë nga prirja që përgjithmonë të mbeten të vetmit që kanë të drejtë të gjykojnë e të shpallin të vërtetat.

Ajo që mund të thuhet qysh atëherë, pa pasur as dyshimin më të vogël se do të bëhej ndonjë gabim, ishte e vërteta që secili nga ata që kishte prirje të gjykojë publikisht, vetë e shkruante biografinë dhe se vetë jepte dëshmi për atë kohë të pakohë kur të paktë ishin ata të cilët nuk lejuan që Makondoja e tyre të mos bëhet vendbanim i kalkulimeve ditore. E sa i përket mosbesimit dhe frikës ndaj ditëve që do të vinin, mjaftonte që njeriu të mos u dorëzohej euforive të çastit. Duke kuptuar se ditët rrjedhin, rrjedhin, rrjedhin..., si një lumë që bart me vete edhe marrëzinë edhe urtësinë njerëzore. Dihej, ai lumë derdhej në detin pa brigje, me një zhurmë kumbuese, të cilës asokohe iu bashkëngjitën edhe ata që donin të ngacmonin nervin e ndjeshëm mbarëshqiptar,

atë religjioz. Zhurma i joshte njerëzit të “legjitimoheshin” si përkatës të këtij apo atij religjioni.

Ali Aliu qysh në rini e kishte kuptuar se vjen një kohë kur, nga e tëra që ka dhe posedon njeriu, mbeten vetëm gjurmët që ka lënë pas vetes. Gjurmët dhe fushëgropat e jetës në të cilat ai ka ecur, me ballin lart, apo duke u zvarritur. Njeriu i mbështetur në këtë vetëdije, hartën e vet jetësore e vizaton asisoj që t’i ketë të shënuara dëshpërimet, të mbajë në vetvete edhe çastet kur rrënohen iluzionet, por mbi të gjitha atë hartë ta karakterizojë shenja e bindjes se vlen të jetosh vetëm nëse arrin deri në fund të mbash drejt boshtin kurrizor. Njeriu i tillë ecën me shqetësimet e veta në gji dhe kur ato nuk ka me kënd t’i ndajë, i lë të shënuara në ditarin e vet.

Në ditarin e Ali Aliut ka një fjali që përdoret më së shpeshti: “Tërë kjo më shqetëson shumë...” çka dëshmon se shqetësimet i ka pasur shokë më të afërt thuajse gjatë tërë jetën. Ditari i tij është përplot shqetësime nga më të ndryshmet, ndërsa “natari” përplot shëtitje nëpër veprat krijuese, që mbase edhe e kanë ndihmuar të përballë shtrëngatat e shqetësimit lidhur me ngjarjet e bujshme politike të viteve ’90, kur shqiptaria mësonte orët e para të demokracisë, orë nga të cilat doli si nxënës që kishte mësuar vetëm grindjet ndërpartiake në parimin se ai “që s’është me mua, është armiku im”.

DON KISHOTI I SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË

Është një shqetësim i brendshëm, një shpirt në shpirt, është një ëndërr në ëndërr, një njeri në njeriun, i cili asnjëherë nuk i shkëputet krijuesit, pa të cilin ai nuk do të ishte i plotë, do të ndihej i cunguar, si me një mungesë pa të cilën do të ishte gjysmak, përherë në kërkim të pjesës së vet të porealizuar. Ai shqetësim, ai shpirt në shpirtin krijues, ajo ëndërr në ëndrrat e tij, ai njeriu tjetër në të, shpeshherë veprojnë jashtë vullnetit të zotit të vet, bëhet sundues i imagjinatës, e shtyn shkrimtarin të notojë nëpër detin pa brigje të artit. Pa pasur frikë mos vallë ai mund të mbytet, apo do të jetë notues i shkathët në kërkim të ujdhesës së vet, ku do të marrë përsipër t'i bëjë ballë jetës së vetmitarit, gjatë së cilës askush nuk mund t'i ndihmojë; ka me vete veç yjësinë e imagjinatës së vet dhe bardhësinë e letrës. Aty, si një vertikale që zbret qiellin e imagjinatës në bardhësinë e letrës, thjesht në dukje i vetmuar, në shoqëri të shpallur me veten, i bindur se është kalorës për të cilin nuk vlen fjala e urtë "trimi i mirë, me shokë shumë", një qenie që nuk llogarit as ndihmën e të afërmeve, e lëre më miqve e shokëve, pra ai që mbetet i ndrydhur mes galaktikës së vet krijuese dhe bardhësisë së letrës, nuk ka zgjidhje tjetër përpos asaj që shqetësimet krijuese

t'i përqafojë si fëmijë të vetëm që ka, të përkëdhelë shpirtin krijues që banon në shpirtin e tij, të shpалosë ëndrrën e vet artistike, e cila ka bërë fole në ëndrrën e tij jetësore, të ftojë atë njeriun tjetër në vetvete dhe ta urdhërojë që të fillojë e të mos e ndërpresë më kurrë punën e rëndë të krijimit: të përziejë shqetësimin me lotin e shpirtit, dhe me atë lëndë të nisë ndërtimin e Makondos së vet, të një vendbanimi paralel në të cilin do të jetojë ai "uni" tjetër i tij, ai njeriu i dytë në të, ai i cili nuk ka thuar asgjë të përbashkët me atë që jeton në botën reale.

Ndërtuesi i Makondos krijuese, ai muratori që si i vetmuar muron dhe prish perandorinë e vet krijuese, në të vërtetë vetëm se shëtit në përditshmëri: vendbanimi i tij i vërtetë është atje ku ai ndihet sundues, ku nuk mund t'i ndërhyjë askush. Ndërtuesin e Makondos krijuese, e shohim këtu, por më shpesh ai banon atje ku ndihet më i vetes i paprekshëm nga dora e kësaj bote, në njëfarë mënyre jeton në ekzil të përhershëm, në ikje të pafundme nga bota reale në atë ku e shoqërojnë vetëm shqetësimet, frymëzimet, lagjet e një vendbanimi, të cilin sa dëshiron t'ua shpалosë të tjerëve, po aq edhe druan, dyshon se vallë do të jetë udhërrëfyes i mirë, vallë do të arrijë atë botë të vetën ta paraqesë ashtu si e përjeton dhe ndien në vetvete.

Përderisa krijuesi jeton në mes të shqetësimeve të veta, përderisa në dhomën e punës ndërton botën nëpërmjet të cilës lexuesit duhet t'i ofrojë diçka më tej asaj që çdo ditë ai e sheh apo përjeton, mirëpo jo ashtu siç e përjeton dhe e sheh artisti, atëherë ku e gjen kritikun letrar frymëzimin që të bëjë tekstin e vet mbi atë që ka shkruar krijuesi? Mos vallë shkrimi i kritikut letrar dëshmon se frymëzimi krijues, vlen vetëm atëherë kur te lexuesi ngjall shqetësim apo frymëzim të ri?

Gjithsesi arti, veçanërisht vepra letrare, vlen aq sa ka nga ajo lënda e veçantë që i ofron lexuesit përjetime dhe pamje që e mahnitin, apo e joshin të provojë ndjenjën se po përjeton diçka të re, të papërjetuar e të paparë, qoftë edhe kur vepra sjell vetëm një shikim ndryshe nga ai që njeriu çdo ditë e përdor për të vërejtur ndonjë dukuri, ngjarje. Vepra letrare vlen kur është përplot me ndjesi të përjetuar, siç nuk i ka shkuar asnjëherë ndër mend lexuesit se mund të përjetohen, përshkruhen apo ndihen. Mbase arti është vetëm një realitet i zhvendosur, që ka kaluar nëpër punëtorinë e imagjinatës, vetëm një reflektim i yjesisë imagjinative, ndjesi që suksesshëm është qëndisur me vegun e imagjinatës, pëlhurë në të cilën fijet e thurura japin një tërësi që e fton lexuesin të ndiejë Festën e Leximit. Kështu mbase arrihet ajo plotësia e komunikimit të botës krijuese me atë të lexuesit, plotësi pa të cilën arti do të mbetet qëllim i vetvetes.

Nëse shkrimtari ka qëllim që vepra e tij të jetë rrezatim sa më besnik i botës së tij krijuese, atëherë lexuesi tenton të ngrihet në përjetuesin më të shkathët të kumtit letrar. Por, thujas asnjëherë, vepra letrare nuk arrin barazimin e asaj që përjeton krijuesi duke e shkruar, dhe përjetimit që ngjall te lexuesi duke e lexuar atë. Apo, thënë ndryshe, ajo që ka ndier krijuesi duke shkruar veprën, atë që ka përjetuar ai duke qëndisur përjetimet dhe ngjarjet në vegun e imagjinatës së vet, kurrë nuk mund të jetë plotësisht e njëjtë me përjetimin që vepra ngjall te lexuesi. Andaj edhe mbetet e përhershme orvatja e autorit të arrijë sa më bindshëm t'i përcjellë lexuesit atë që ndien dhe përjeton gjatë shkrimit të veprës, siç mbetet e përhershme edhe orvatja e lexuesit, të arrijë të lexojë jo vetëm ç'ka shkruar krijuesi në vepër, por edhe atë që e ka nxitur të shpalosë botën e vet krijuese.

Shikuar nga ky kënd, kritiku i mirëfilltë letrar nuk është asgjë më shumë përpos lexuesi i rrallë që veprën e një krijuesi arrin ta lexojë të “plotë”. Kritiku i vërtetë është mjeshtri që leximin e ngre në art, duke bërë veprimin e kundërt të krijuesit: duke e shthurur çarçafin krijues fije-fije, duke e kaluar mbrapsht nëpër vegun e imagjinatës së vet, duke e shndërruar në lëndë të parë, në thelbin nismëtar. Në njëfarë mënyre, kritiku letrar është mjeshtri që e çmuron veprën, që Makondon krijuese e ndan në pjesët e veta ndërtuese, me çka tenton të arrijë në zanafillën e saj. E më pastaj, t’ia dëshmojë lexuesit ku janë elementet e çmueshme të veprës, ku duhet kërkuar tharmi estetik i saj, pa të cilën çdo vepër mbetet veç një bukurshkrim shkollaresk që ka pushtuar letrën, por jo edhe urtësinë e bardhësisë së saj, objekt i brishtë që duron çdo shkrim, por nuk i dorëzohet çdo shkarravitjeje. Dhe përpos lëndës së parë ndërtuese të veprës, kritiku tenton të zbulojë mjeshhtërinë e ndërtimit, këndin nga autori ka ngritur vizionin e vet letrar, mjetet ndërtuese, ndikimet që e kanë joshur të shkojë të banojë në një botë të tillë.

Nëse krijimtarinë letrare e bëjnë krijuesit e mirëfilltë, epigonët dhe mediokrit, atëherë edhe kritikët mund të ndahen në disa kategori: kritikë-lexues “voajer” të sëmurë, që kënaqen të shohin veç shpirtin cullak të krijuesit dhe, si të tillë dëshirojnë vepra ku çdo gjë thuhet “qartë e shqip”; Kritikë-lexues shtegtarë, por besnikë të artit, që shëtisin nëpër botën e tij me qëllim të shohin sa më shumë bukuri të papara e të përjetojnë diçka të papërjetuar, duke dashur ta plotësojnë ditën e vet sa më këndshëm në këtë jetë monotone, dhe në kritikë letrare, të cilët leximin e ushtrojnë si nevojë shpirtërore, si “sëmundje” të

pashërueshme, që i ka infektuar po aq sa edhe të shkruarit krijuesin, duke u shndërruar në mjeshtëri.

Mbase kjo ndasi mund të vazhdohet edhe më tej dhe kritikët letrarë të grupohen në krijues të porealizuar, të cilët për shkak të këtij mosrealizimi të vet kërkojnë veprën që do e kishin shkruar ata, duke u prirur të shpartallojnë cilëndo vepër të huaj, individë të shndërruar në ushunjëza, të cilat pinë gjakun e krijuesit, prirë nga mendjemadhësia se veç ata e dinë si është dashur të shkruhet vepra e botuar dhe, në kritikë dashamirës të artit, të cilët mjeshtërinë e vet, njohuritë për artin, dituritë për aftësinë e shkrimit, e përdorin për të kremtuar Festën Vetjake të Leximit dhe për t'u bërë pjesëtarë në dhënien shpirt veprës.

Aliu bie në grupin e mjeshtërve të kritikës letrare, sepse gjatë punës disadekadëshe si studiues dhe kritik letrar, ai dëshmoi se as veprat letrare, e as shkrimtarët, nuk i shikon me zili, por me dashamirësi, si vëllezër të një gjaku, si banorë që jetojnë në të njëjtin vendbanim, në botën e artit. Me dallimin se Aliu ka shtëpinë në lagjen ku me vetëdëshirë kthehen krijuesit me veprën e vet në sqetull, vijnë aty duke e ditur se në atë shtëpi kanë mikun e librit të vet, se Aliu gjithmonë i mban të gatshme të gjitha peshoret për të matur tharmin estetik të një vepre. Pra, nuk ka dyshim se Aliu nuk është kritik që zbrëthen veprat me pezmin e zilisë, me inatin e atij që kërkon librin që do e shkruante ai vetë, por me kënaqësinë e mjeshtrit që e ka kuptuar se vepra pa lexues është e paqenë, se shkrimi që s'matet në peshoret estetike është si fëmijë i lindur pa aftësitë që i mundësojnë të shijojë më tej këtë botë, se mjeshtëria e të lexuarit nuk qëndron shumë mbrapa asaj të të shkruarit, se leximi është art po aq sa edhe të shkruarit, por vetëm atëherë kur krijuesi dhe

kritiku ndjekin rrugën e sinqeritetit krijues, atëherë kur në vendbanimin artistik njëri ecën si ndërtues i saj, e tjetri si banor që shpreh mahnitjen apo keqardhjen për lëshimet gjatë ndërtimit.

I tillë, i sinqertë, dashamirës, i pakompromis, me njohuri teorike për rrjedhat krijuese, i informuar për burimet dhe rrjedhën e mëtejme të lumenjve të letërsisë klasike dhe bashkëkohore, me një filozofi të heshtur në vetvete për artin dhe jetën në përgjithësi, Ali Aliu do të ketë fatin e studiuesit dhe kritikut që u nënshtrohet vetëm standardeve krijuese, që peshoret vlerësuese gjithmonë i mirëmban dhe nuk lejon të shtresohen lëndë që do e bënin të pabesueshme saktësinë e tyre, që do të rrisnin apo lehtësonin vlerat e veprës. Si i tillë, do të mbetet i adhuruar nga krijuesit e mirëfilltë dhe i padëshiruar nga epigonët dhe mediokrët e letrave shqiptare. Pra, do t'i ndodhë ajo më e bukura që e dëshiron cilido njeri që i takon dhe i është përkushtuar artit: të mos e çmojnë dhe të mos e duan ata të kallaballëkut artistik, dhe ta vlerësojnë lart dhe ta çmojnë krijuesit e vërtetë. Mbase kjo është dëshmia më e madhe për dhuntinë, virtytet kritike dhe studiuese të më të madhit të kritikës letrare në letrat shqiptare të dekadave të kaluara, Ali Aliut.

Thuajse s'ka krijues me emër e mbiemër në letrat shqiptare, që ashtu siç ka dëshirë që vepra e tij të dalë në dritë, të mos dëshirojë të dëgjojë edhe vlerësimin kritik të Ali Aliut. Të arrish këtë si kritik dhe studiues letrar, do të thotë të dëshmosh se je nga ata dashamirës, nga ata vlerësues të krijimit letrar, pa zërin e të cilit vepra ndihet si e cunguar, si e palexuar, pa fjalën e të cilit rritet dyshimi nëse vallë autori ka arritur qëllimin artistik apo jo. Të arrish këtë si kritik dhe studiues letrar, do të thotë se gjatë

tërë një jete je dëshmuar si vlerësues që ka peshore që nuk kanë matur gabimisht. Më në fund, të arrish këtë si kritik dhe studiues letrar, do të thotë të kesh guxim të vësh në peshoret estetike veprën dhe autorin e porsaardhur, njësoj si dhe ata që janë peshuar dhe vlerësuar nga të tjerët. Pra, të matësh ata që janë në pikënisjen e rrugëtimit të tyre krijues, ku ka shumë mundësi të mos ia qëllosh, dhe të vlerësosh ata që kanë kaluar nëpër duart e shumë studiuesve dhe vlerësuesve, me çka ke mundësi që peshoret vetjake, përballë atyre të të tjerëve, t'i dëshmosh si të pasakta.

Duke qenë i pari dhe i pagabueshëm që ka thënë fjalën e vet për të porsaardhurit në letrat shqiptare, Ali Aliu thujse është lartuar si një institucion letrar shqiptar që pagabueshëm nënshkruan “certifikatat” letrare. Duke qenë se te shumë letrarë të traditës shqiptare ka shpalosur vlera të pazbardhura më parë, ai u ngrit në riradhitësin e pamohueshëm të bibliotekës kombëtare shqiptare që nga rilindësit e këtej. Por, të vlerësosh veprën e krijuesit të ri, është guxim i barabartë me atë që të rivlerësosh veprën për të cilën janë shkruar shumë studime dhe kritika, si për shembull, për veprimtarinë letrare të Naim Frashërit. Të vlerësosh zërin fillestar të një krijuesi të ri, do të thotë të përballësh me rrezikun e dyfishtë: t'ia përcaktosh deri diku fatin krijues të një të porsaardhuri që as vetë nuk e di nga është nisur e ku do të arrijë dhe, njëkohësisht, të dëshmosh edhe për saktësinë e peshoreve kritike. Të rivlerësosh veprat dhe krijuesit për të cilët shumë emra dhe mbiemra të kritikës letrare kanë shkruar tema të doktoraturës, gjithashtu do të thotë të përballësh me rrezikun që dikush të zbulojë se sa të pasakta i ke peshoret që masin ajkën artistike të krijuesit dhe veprës. Do të thotë,

pra se këto rreziqe mund t'i ndërmarrë vetëm kritiku letrar që nuk dyshon në mjeshtërinë e vet vlerësuese dhe që nuk ka ndër mend të fshehë peshoret e veta matëse. Këto rreziqe mund t'i ndërmarrë një si Ali Aliu, kritik dhe studiues që u mbeti besnik letrave shqiptare me të njëjtin asketizëm sa edhe atdhetarisë e fatit të popullit të vet.

Si i tillë, ai u ngrit si një institucion i dyfishtë shqiptar: edhe në kalendarin e rrjedhave shoqërore të popullit shqiptar edhe në atë të zhvillimit të letrave shqipe. Pra, i është dashur të mbetet e të digjet mes dy “zjarreve”, ku zjarri i artit do të jetë gjithmonë si një mënyrë për të ikur nga shqetësimet e përditshmërisë, si një Festë ku krijuesi dhe kritiku kremtojnë bashkërisht ditën e lindjes së një vlere artistike; ditë festive kur kritiku jo vetëm ngrohet pranë zjarrit krijues që ofron vepra letrare, por shkon edhe më tej: do të zbulojë atë prushin e nxehtë që ka arritur të mbetet nga zjarri krijues, prej të cilit ka lindur vepra letrare.

Andaj, nëse vepra letrare është prushi i nxehtë i mbetur nga zjarri që ka djegur krijuesin gjatë shkrimit të saj, atëherë kritika letrare është ajo era e lehtë që largon pluhurin nga prushi dhe ia mundëson lexuesit që me të ta rindezë më lehtë zjarrin e zanafillës së veprës. Apo, nëse vepra letrare është syprinë e lëmuar liqeni, dhe nën të fshihen plot bukuri të tjera, nëse lexuesi i rëndomtë është ai shëtitësi i ulur në barkë, të cilin e kënaqin valët e bukuritë që krijuesi ofron në horizontin rreth tij, atëherë kritiku letrar është ai zhytësi i guximshëm që e di se në vlerat e mirëfillta letrare, bukuritë duhet kërkuar edhe nën syprinën e saj. Ndaj dhe i do zhytjet e guximshme në thellësitë e veprës, të rindezë zjarrin frymëzues që ka djegur krijuesin gjatë shkrimit të veprës dhe që është mbase, shkak i këtij guximi. Kritikë më të mirë letrarë

janë ata që arrijnë të rijetojnë festën e krijimit të veprës, ata që nga prushi krijues - vepra - mund të rindezin zjarrin e përafërt me atë që ka përvëlur autorin e librit në çastet kur autori ka qenë i vetëm në oxhakun prej nga janë zgjatur gjuhët e nxehta të atij zjarri.

Përderisa krijuesi ecën nëpër vepër i udhëhequr nga ndjesitë, botëkuptimet, përjetimet..., kritiku duhet të shkojë gjurmëve të tij, të zbulojë se ç'nxitje e kanë shtyrë autorin të ecë pikërisht në ato shtigje dhe ç'arsye e kanë detyruar të shpalesë përpara lexuesit botën e vet krijuese. Që më në fund, të vlerësojë se vallë ai përjetim, ajo shfryrje shpirtërore, ajo ngjarje e thënë nëpërmjet fjalës së shkruar, është vlerë artistike, peshon diçka në kandarin estetik, është qëndismë fjalësh që mund të quhet vepër artistike, apo vetëm një bukurshkrim, i cili nuk vuan nga të metat gramatikore, por ka mungesë të syprinës së gjerë që ofron bukuri të tjetër lloji, thellësi të pafundme ku lexuesi mund të zhytet varësisht nga aftësitë e veta për të zbuluar atë që ia ofron krijuesi.

Nëse krijuesi e fton lexuesin të hyjë në botën që ofron vepra e tij, nëse shkrimtari i ofron lexuesit vatan e sofër artistike, nëse shkrimtari është ai që ngjiz veprën, e lexuesi ai që asaj ia ndien shpirtin, nëse për autorin lexuesi është ai mysafiri i pritur gjatë, pa të cilin hiçgjë nuk i vlen konaku krijues që ka shtruar e gatitur, kritiku letrar është ai që hap derën e shtëpiarit, i shtrin dorën lexuesit dhe i jep guxim të hapërojë e shëtitë nëpër botën e krijuesit. Me çka, në njëfarë mënyre, kritiku letrar bëhet bashkënikoqir, e lidh fatin e vet me veprën e krijuesit, bëhet një nga elementët e trekëndëshit: autor, vepër letrare, lexues. Trekëndëshin ku kritiku lidh elementin e rëndësishëm që i ndihmon ëndrrës së autorit të bëhet jetë, frymëzimi

krijues të shndërrohet në frymëzim për ta lexuar veprën letrare.

Nëse vepra letrare është nën pretendimet e autorit – nga zjarri i të cilit ka mbetur vetëm prushi i ngrohtë – atëherë vepra letrare është nën atë që dëshiron dhe pret lexuesi apo kritiku letrar. Apo, nëse autori gjithmonë jeton me bindjen se vepra e tij i ofron lexuesit më shumë se çfarë ai ka arritur të marrë prej saj, se lexuesi është i paaftë të çmojë dhuratën artistike që i është dhënë, atëherë kritiku letrar dhe lexuesi, janë si ata fëmijët, të cilët jetojnë me bindjen se gjithmonë u është dhuruar më pak nga ç’kanë pritur nga sjellësi i dhuratës. Kështu që krijuesi gjithmonë është i rrezikuar të dëshpërohet nga vepra e vet, si ai që nuk është i vetëdijshëm si do ta përjetojë dhe sa do ta përjetojë nikoqiri – kritiku – dhuratën artistike që i ka bërë, ndërsa kritiku letrar gjithmonë është i kanosur nga rreziku që duke vlerësuar të tjerët, të harrojë të vlerësojë vetveten si lexues i mëvetshëm. Ndaj dhe krijues më të mirë janë ata që e njohin veprën e vet dhe ambiciet i kanë në proporcion me aftësitë e veta krijuese, ndërsa kritikët më mjeshtërorë janë ata që e dinë se duke matur të tjerët, në të vërtetë shpalosin mjeshtërinë e vet vlerësuese dhe peshoret që përdorin gjatë matjes së ajkës estetike të veprave letrare.

Nuk ka dyshim se gjatë kontributit prej afër pesë dekadash si studiues dhe kritik letrar, Ali Aliu u dëshmuar si matës shumë i saktë i vlerave letrare shqiptare. Ai mbeti thuajse i vetmi asket që nuk tradhtoi peshoret e veta, të cilat matin tharmin estetik të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore. Si i tillë, u bë udhërrëfyes i pagabueshëm i të gjitha “lagjeve” të krijimtarisë letrare shqiptare. Në librat e tij “Kërkime” (Rilindja, Prishtinë 1971), “Shqyrtime”

(Rilindja, Prishtinë 1974), “Rrjedhave të letërsisë” (Rilindje, Prishtinë 1977), “Katër romane të Petro Markos” (Rilindja, Prishtinë 1979), “Kritika” (Rilindja, Prishtinë 1980), “Ese letrare” (Rilindja, Prishtinë 1983), “Don Kishoti te shqiptarët” (Flaka, Shkup 1996), “Magjia e fjalës” (Dukagjini, Prishtinë 2003) si edhe në dhjetëra të tjerë, Ali Aliu ecën rrjedhave të letërsisë shqiptare duke nisur nga Naim Frashëri e deri te Lindita Ahmeti. Pra, që nga Rilindja e deri te vlerat letrare të fillimshekullit të njëzetënjë. Dhe si i tillë, ai nuk është vetëm vlerësuesi më i denjë i bibliotekës kombëtare shqiptare, por mbetet edhe orientuesi më i besueshëm për ata që duan ta bëjnë sa më drejtë renditjen e librave të autorëve shqiptarë në biblioteka. Si i tillë, Ali Aliu mbetet ndërmjetësi më i sinqertë dhe më kompetent, mes veprës së autorit dhe lexuesit, është ai të cilin e dëshiron çdo vepër e çdo autor, mbi të gjitha për shkak se kritikën letrare ai nuk e kupton as si vlerësim nëpërmjet të cilit kritiku ngrihet mbi autorin, as si gjurmues të dobësive të veprës, por si një ndërmjetës nëpërmjet tekstit të vet dashamirës në shërbim të veprës letrare dhe lexuesit. Por, edhe si i tillë ai nuk bëhet as “shërbëtor” i veprës letrare, as i lexuesit: ai dëshmohet vetëm si zotërues i mjeshtërisë së vet, mjeshtëri që kritikën letrare e ngre në rrafshin e një krijimtari të ngjizur nga frymëzimi që nxit leximi i një vepre.

Është plotësisht e qartë se lexuesi është ai që mund ta shkatërrojë dhe brejë veprën letrare, duke mos e marrë në dorë, ndërsa kritiku letrar mund ta dëmtojë vetëm duke e vlerësuar gabimisht, pa marrë parasysh nëse gabimi i tij do të shfaqet si kritikë afirmuese apo mohuese. Ka ndodhur që lexuesit e një vepre të kenë lindur më vonë se koha kur ajo është shkruar dhe botuar, siç ka ndodhur

edhe ajo që kritiku letrar të ketë zhvlerësuar apo mbivlerësuar ndonjë krijim letrar, por Ali Aliut kurrë nuk i ka ndodhur që letrën e bardhë ta mbushë i prirë nga dëshira për të dëmtuar veprën e cilitdo autor. Ndoshta prandaj mbeti kritiku më i preferuar të cilin e çmojnë ata që e dinë ç'është letërsi e vërtetë dhe e nënvlerësojnë ata që mendojnë se çdo shkarravinë në letër, çdo libër që ka qindra faqe, duhet doemos të bëhet pjesë e bibliotekës kombëtare. Pikënisje e çdo kritike letrare të Ali Aliut është kërkimi i thelbit estetik në veprën që trajton, gjë të cilën e bën duke përdorur teorinë moderne letrare, të gërshetuara me njohuri filozofike e estetike, pa të cilat peshoret vlerësuese ndryshken shpejt e bëhen të papërdorshme. Ai e vrojton veprën duke dashur të zbulojë të vlefshmen e saj; nëse kjo është më e rëndë se mangësitë, atëherë vlen të shpallet si vlerë. Veprën ai e vlerëson duke pasur parasysh parimin sipas të cilit duhet matur çdonjëra: sipas anëve të tyre të mira. Sepse, sikur njeriun, apo veprën, ta vlerësosh vetëm sipas dobësive që ka, atëherë do të konstatosh se nuk ka njeri të përsosur, se çdo njeri është mëkatar, se nuk është shkruar ende libri ku i vihet pikë krijimtarisë letrare dhe nuk ka libër pa mangësi. Dhe, çdo njeri bart me vete mëkatet dhe të mirat që ka, që e bëjnë të ndryshëm nga të tjerët, çdo vepër letrare ka bukuritë e mangësitë e veta, që e bëjnë të jetë e veçantë nga të tjerat. Apo, se freskia, e jo diçka tjetër, ngandonjëherë e përcakton vlerën e veprës. Sepse sot, kur janë shkruar gjithë librat, origjinaliteti duhet kërkuar në mënyrën si shpaloset vepra letrare dhe si ajo i ndërthur elementet përmbajtjesorë të saj.

Si njohës i shkëlqyer i ecjeve të mendimit teorik e kritik, të doktrinave letrare që thyhen në valët e lumit të historisë së artit, ku ka aq mendime për letërsinë sa edhe

krijues dhe kritikë letrarë, dhe ku mbeten vetëm ata që i rezistojnë peshores së kohës, Ali Aliu do të mbetet një ndër zbërthyesit më të mirë të poezisë shqiptare nga Rilindja e këtj. Andaj edhe “dosja” komplete e poezisë shqiptare, ndodhet në librat me studime dhe kritika letrare të Ali Aliut. E, ato libra do të mbeten pasuri e bibliotekës kombëtare shqiptare, sepse studimet dhe kritikat letrare të Ali Aliut janë bërë pjesë e veprave për të cilat janë shkruar. “Studimet e prof. Ali Aliut”, shkruan prof. Alfred Uçi, “do t’u vlejnjë jo vetëm poetëve e lexuesve që u drejtohet sot libri i tij, por edhe gjithë atyre që interesohen për fatet e letërsisë dhe të kulturës shpirtërore të kombit tonë. Ato do të mbeten një enciklopedi e letrave shqipe, një kontribut i shquar në studimin e historisë së tyre, një manual i ngjeshur me idetë bashkëkohore të teorisë e kritikës letrare, që ka arritur nivel të lartë mjeshëtor.” Ky është një vlerësim që duhet theksuar dhe nënvizuar, që duhet pranuar pa hamendje, sepse është i thënë nga një njohës gjithashtu i shkëlqyer i letrave shqiptare dhe njëkohësisht peshues i mirë i vlerave botërore. Si rrallëkush tjetër, Alfred Uçi e di sesi kritiku i afrohet veprës letrare, si ai i çel dyert e poezisë, sesi kritiku Ali Aliu gjurmon nëpër vargjet e poetit, prandaj edhe thotë: “Ali Aliu i afrohet poezisë duke kërkuar dhe gjurmuar në të asgjë më shumë veç thelbit estetik të saj, që e ka bërë kriterium më të lartë të vlerësimit të poezisë dhe të patosit të frymëzimeve, që e afrojnë dhe ia shtojnë dashurinë për të, që ia mundëson të zbulojë në të forma përmbajtjesore dhe përmbajtje të formësuara estetikisht, dhe bukuri klasike e moderne. Me këtë qasje bëhet e mundur që kritiku e poeti të mbeten të vetëmjaftueshëm, si dy binjakë të lidhur nga thelbi estetik i poezisë, pa e cenuar

funksionin e pavarur estetik e artistik të dy profesioneve të ndryshëm të tyre.”

Nëse dy binjakët që përmend prof. Alfred Uçi – poeti dhe kritiku – kërthizë të përbashkët kanë thelbin estetik të poezisë, atëherë gjithsesi që poezia pa thelbin estetik është si farë që nuk mbin, si një bukurshkrim që nuk ka pas konsiderata ndaj bardhësisë së letrës, bardhësi e cila në vete ngërthen vargjet e pashkruara, të gjitha veprat letrare që i ëndërron kritiku letrar dhe lexuesi. E ëndrra e kritikut letrar i ngjan asaj të arkeologut, i cili gjithmonë shpreson se do të gjejë ndonjë vlerë të fshehur nën shtresat e tokës. Edhe kritiku, njësoj si arkeologu, ka “detektorët” e vet, të cilët marrin sinjale të ardhura thellë nga nëntoka, nga thellësitë e nëntekstit. Andaj edhe vlejnjë vetëm krijimet letrare nga thellësitë e të cilëve arrijnë shenja se ka diçka që e çon lexuesin të gërryjejë sa më thellë, të kërkojë shtresa të reja nën vargun që mbulon “xehen” e çmuar - vlerën estetike - pa të cilën asnjë krijim nuk mund të quhet vepër e mirëfilltë letrare. Andaj edhe mund të thuhet se poeti është ai që ngjiz thelbin estetik, ndërsa kritiku letrar është ai që duhet ta shpalosë atë thelb, t’i shënojë “vulën” e saktë të vlerës, pa të cilin lexuesi mbase edhe nuk do ta bënte pjesë të rafteve të bibliotekës së vet.

Dihet se s’ka vepër letrare të vërtetë, të cilën e kanë bërë apo shkatërruar kritikët letrarë, njësoj siç është e ditur se nuk ka vepër letrare, e cila ka mundur të prishë peshoret vlerësuese të kritikut të vërtetë. Ka vepra letrare që gabimisht i ka matur peshorja e kritikut, por nuk ka kritik letrar të mirëfilltë që mat me peshoret e ndryshkura të mospërfilljes veprën letrare. Në librat me studime dhe kritika letrare të Ali Aliut, qartë pasqyrohet prirja e tij që vlerësimi të mos ketë gjykimin përfundimtar, por të jetë

element nga më të rëndësishmit që do të ndihmojë të caktohet pesha e saktë e veprës letrare. Si e tillë, veprimtaria e tij studiuuese dhe kritike, është ngritur në rrafshin e mendimit përcaktues të së vlefshmes në letërsinë shqiptare. Kuptohet, duke mos përcaktuar vetëm portretet krijuese dhe vlerat e veprave të tyre, por edhe duke përcaktuar drejtimet letrare, rrjedhat nga vjen dhe nga shkon një drejtim krijues. Lidhur me këtë, Nehas Sopaj thotë: “Pena e tij kritike (e ka fjalën për Ali Aliun – K.M.) shumë rrallë (për të mos thënë aspak) s’harroi të regjistrojë pothuaj çdo lëvizje brenda letrare; ai pastaj atyre proceseve ua ka gjetur emërtuesin adekuat – i ka lavdëruar për përparësitë që kanë, ndërkaq mangësitë jo rrallë i ka lënë të kalojnë të papërfillur, kështu që pothuaj tërë krijuesit që i “merr në gojë” sot janë emra me vlera eminente letrare, ndaj me fare pak heqje dhe marrje (ma merr mendja mua), e tërë galeria e letrarëve bashkëkohorë shqiptarë që i avancon ai, janë eminenca e letërsisë sonë bashkëkohore.”

Krijuesit që “merr në gojë” Ali Aliu janë ata të cilëve vlen t’u dëgjohet zëri letrar. Krijuesit e “përfolur” nga kritiku Ali Aliu, mund të besojnë se nuk e kanë dhunuar bardhësinë e letrës. Në mos për hiçgjë tjetër, për shkakun se kritiku Ali Aliu sikur ka parimin që paraprakisht përcakton ata që shkruajnë kritika afirmuese për veprat që trajton: lexon vetëm libra të vlefshëm. Nuk është nga ata që e inspirojnë dobësitë, por mjeshtëritë krijuese. Prandaj edhe veprimtaria e tij kritike është në njëfarë mënyre “adresar” i saktë i emrave dhe veprave që përbëjnë pasurinë letrare të popullit shqiptar. Dhe, përderisa krijuesve bashkëkohorë, Aliu u përcakton vendin që u takon dhe u hap rrugën drejt lexuesit, në veprat e krijuesve

të traditës letrare shqiptare ai zbulon vlera të reja, zbardh cilësi të tyre, të cilat askush para tij nuk ka arritur t'i zbulojë. Apo edhe të bëjë korigjimin e të plotësojë studimet letrare që kanë të bëjnë me veprimtarinë krijuese të Naim Frashërit, De Radës, etj. Pra, derisa veprat letrare të Ali Podrimes, Azem Shkrelit, Fatos Arapit, Ismail Kadarese, Xhevahir Spahiut, Eqrem Bashës, Visar Zhitin, Mihail Hanxharin, Luljeta Lleshanakun, Lindita Ahmetin, Faruk Myrtajn, Lazer Stanin, etj., ai kujdesshëm i vendos në vendet e caktuara nëpër raftet e bibliotekës kombëtare, pa dashur të bëjë renditje të gabuar dhe tollovi, ato që më parë ndodhen të radhitura në raftet e bibliotekës, i rirendit duke bërë zbulime të reja që qartësojnë veprën dhe e bëjnë më të qëndrueshme në bibliotekën kombëtare, ku do ta kërkojë lexuesi i sotëm dhe ai i ardhshmi.

Ndoshta në asnjë libër të Ali Aliut nuk shihet aq qartë aparaturo e tij kritike si në të titulluarin “Si të lexojmë poezinë”, libër ku shihet qartë sesi Ali Aliu e lexon poezinë dhe ku kritika letrare nuk është asgjë tjetër përpos se shqetësim krijues, të cilin e ngjall poeti te kritiku. Andaj, nëse në poezitë e veta Azem Shkreli derdh shpirtin e etur për liri, nëse vargjet e këtij poeti janë gjurmë të përrjetshme shpirtërore të plagëve që gjakojnë dhe janë tharë, atëherë zbërthimi i kësaj poezie nga kritiku Ali Aliu është një ripërjetim i dhembjeve të këtyre plagëve i tjetër lloji, një riplagosje e kritikut, i cili mundëson që ai shpirt krijues, ato gjurmë plagësh të mbetura në shpirt, të shpalosen asisoj që bëhen të qarta nëpërmjet shumëkuptimisë së tyre. *Ujqit në këmbë do të jenë,/Kosova në këmbë/Natë që s'mori/Pushkë, as s'të mori pushka/*, janë vargje nga poezia “Sogje” e Azem Shkrelit, vargje që i thur poeti e më tej i “shthur” kritiku, Ali Aliu, duke shpalosur atë që

ngërthejnë në vete vargjet: “Por s’është vetëm Kosova zgjuar – zgjuar janë edhe ujqit: e gatshme Kosova, të gatshëm edhe ujqit... Vizioni dhe vizionariteti i poetit në këtë poezi, në këtë natë mbi të cilën bën rojë, vjen si parandjenjë e të qenit të Kosovës ballë për ballë me ujqit, përballje që kishte filluar të përgatitet e që ndodhi rreth një vit më pas...” (marrë nga libri i Ali Aliut “Si të lexojmë poezinë”). Nëse shqetësimi poetik e ka nxitur Ali Podrimen të thurë vargjet: *Na bënë pikëpësë shqipëritë/Nuk dimë ku e bëjmë vdekjen/vaji na është këngë/*, atëherë shqetësimi kritik e ka çuar Ali Aliun të niset vargjeve të poetit dhe, duke ecur nëpër to, të përcaktojë saktë se poeti është përplasur në “mallkimfatin” kolektiv, në të vërtetën se shqiptarinë e përçanë “bajraktarët e fantaksur” që shëtisin nëpër Ballkan “me nga një copë shqipëri nën sqetull”, duke e lënë poetin (mbase edhe kritikun letrar) si somnambul, i cili “s’di as ku i ka varret, s’di ta dallojë këngën nga vaji, dhe të dytën nga e para, në shumëshqipëritë.”

Ali Aliu i takon gjeneratës krijuese që mbloodhi dituri nga ara shumëgjuhësore e Jugosllavisë së dikurshme federative. Prandaj dhe nuk i ishin të panjohura drejtimet dhe arritjet letrare të popujve të tjerë që jetonin në ish-Jugosllavi. Dhe jo vetëm aq. Qendrat përkthyes të asokohshme si Prishtina, Beogradi, Zagrebi, Sarajeva, Novi Sadi, etj. i mundësonin kritikut letrar shqiptar nga kjo anë e kufirit të ndjekë edhe rrjedhat bashkëkohore letrare botërore. Shumë më mirë se në kryeqendrën administrative e kulturore të mëmëdheut, sepse në Tiranë mund të përktheheshin vetëm veprat që nuk dëmtonin shtyllën vertebrare të burgut komunist të Enver Hoxhës. Pra, sa i përket letërsisë botërore dhe librave të teorisë letrare, edhe biblioteka e Ali Aliut ishte përplot me libra

në gjuhën e “nënës së tyre” – në gjuhët e sllavëve të jugut. E, bibliotekat e dikurshme të krijuesve dhe kritikëve shqiptarë nga kjo anë e kufirit, nuk bartnin në raftet e veta vetëm artin letrar dhe urtësinë botërore, por shpjegojnë në heshtje për vitet kur librin në gjuhën shqipe, shqiptarët e jashtë mëmëdheut duhej ta fshihnin nën sjetull, që të mos ua shihnin rojtarët e bashkim-vëllazërimit të ish-Jugosllavisë. Veçanërisht librat e ardhur nga matanë kufirit, andej ku planet pesëvjeçare i bënte partia e xhaxhit Enver, që preferonte të lexosh rasishten në shqip dhe kishte harruar se nga kjo anë e kufirit, komunistët e Jugosllavisë i shtynin shqiptarët që gjuhën e tyre shqipe ta lexonin në sllavishtet e shumta. Sepse, edhe partitë e atëhershme komuniste nga kjo anë dhe nga ana e kundërt e kufirit shqiptaro-shqiptar, kishin gjuhën e nënës së tyre, gjuhën ideologjike, e cila Shqipërinë me det e la pa peshkatarë. Aty, vetëm të dashurit e partisë shijonin peshkun e mund të lexonin veprat që qenë të ndaluara për lexuesin e gjerë. Asokohe, edhe nxënësit shqiptarë në tetëvjeçaret e ish-Jugosllavisë e dinin cilat libra mund t’i ruanin në çantë, e cilat duheshin fshehur nën sjetull, të ngjitura për lëkure nga thithnin etjen për të lexuar dhe hutesën se vallë lëkura e djersitur i ngrohte kopertinat e librit, apo trupin e tyre e nxehte frika që librin e ardhur nga matanë kufirit të mos ua zbulonin rojtarët e pastërtisë ideologjike. Mbase për shkak të fshehjes së librave nën sjetull, shumë letrarë të atyre kohëve ende e mbajnë më shtrënguar nënkrahun e djathtë se atë të majtën. Si për të dëshmuar se krijuesit shqiptarë të gjeneratës së Ali Aliut, edhe për një periudhë të gjatë kohe, të kaluarën do ta bartin si djersë kundërmuese të lodhjes së ardhur nga bota e së djeshmes.

Si vizitues i Shqipërisë edhe në kohën e socializmit, Ali Aliu kishte lidhur miqësi me poetët e njohur të atjeshëm. Me kohë kishte kompletuar bibliotekën e vet me librat e Ismail Kadaresë, Petro Markos, Dritëro Agollit, Xhevahir Spahiut, Fatos Arapit... Qysh moti e njihte peshën e librit të fshehur nga sytë e policëve kufitarë. Vitet e shembjes së murit shqiptaro-shqiptar, si shumë bashkëmoshatarëve të tij, do t'i rikujtojnë kohët e Enverit e Titos, kur “kontrabandistët” e librave ishin më të rrezikuar sesa trafikantët e mëvonshëm të kohëve të demokracisë, të cilët drogën e armët do t'i bartin nga njëri në tjetrin shtet të Ballkanit, por tash si nënsqetull kishin maunet. Do t'i kujtojnë kohët kur kontrabanduesit e zbuluar të atëhershëm të librave, merrnin më shumë vite burg se ata të kohës së demokracisë, që në kufijtë shqiptaro-shqiptarë kalonin të pakontrolluar, me maunat mbushur përplot me udhëtarë pa pasaporta, që “çanin ferrën” duke u nisur drejt metropoleve të Perëndimit.

Biblioteka e Ali Aliut edhe sot ka një veçori që nuk e kanë ato të lexuesve të tjerë: raftin me përplot libra të autorëve që shëtisin nëpër panaiet e shumtë të librit shqiptar, ku i zbrazin çantat me botimet e tyre më të reja. Mund t'i ketë ndodhur edhe atij të ndiejë një kënaqësi-dhembje nga shkaku se shoqëritë shqiptare të viteve nëntëdhjetë kishin më shumë panire librarish sesa librari. Mund t'i ketë ndodhur edhe Ali Aliut, që raftet me libra të botuar në kohën e demokracisë, t'i kenë ngjarë si një anije që lundron nëpër detin kaotik të letërsisë shqiptare të ndarë në “principata”. Anije, e cila kufirin shqiptaro-shqiptar e kalonte më rëndë sesa maunat përplot me alkool dhe cigare të padoganuara. Mbase këtu qëndronte shkaku pse autorët shqiptarë, kufijtë e “shqipërive” i kalonin me

çantat për lot me libra të sapobotuar: nuk kishte më të interesuar që do ta “kontrabandonin” librin nga Prishtina në Tiranë. Ndërkohë, mbetej e vërteta se pushtetarët e demokracisë nuk ishin si ata të dikurshmit të komunizmit, që donin t’i mbanin nën kontroll krijuesit: udhëheqësit e “maunokracisë” donin të dinë si t’i kapërcejnë kufijtë me maunat, e jo me librin, librin në shqip, që edhe në fillimshkullin e njëzetën vështirë kalonte doganat e Ballkanit. Pastaj edhe krijuesit kishin ndryshuar: nuk i thurnin poezi lidërshipt demokratik, si dikur Enverit e Titos, që pastaj prijësit partiak të interesoheshin që libri i tyre të shpërndahej në gjithë hapësirën shqiptare.

Shumë biblioteka të krijuesve të gjeneratës së Ali Aliut, do të mbeten të papërdorshme për pasardhësit e tyre, të cilët as që do të kenë nevojë të lënë anash anglishten apo ndonjë gjuhë tjetër botërore, për të mësuar ndonjë gjuhë të sllavëve të jugut. Pasardhësit e shumë krijuesve që vepronin në kohën e socializmit, në të vërtetë e zbrërthyen saktë “bajraktarokracinë” e viteve nëntëdhjetë dhe nuk e kishin vështirë të bëjnë krahasim në mes ardhmërisë së zyrtë të shtëpive që kishin biblioteka, me të nesërmen “e ndritshme” të pallateve me bodrume të mëdha ku natën ngarkoheshin e shkarkoheshin maunat. Librat e renditur në raftet e bibliotekave “socialiste” rrëfenin për një të kaluar dhe pasqyronin të vërtetën për kohën e ndritshme të fëmijëve të “maunokratëve” që “lexonin” kënaqësitë e jetës dhe harxhonin të nesërmen e fëmijëve të rritur mes bibliotekave. Me çka bëhej e ditur se elita e ardhshme shqiptare nuk do të dilte nga shtëpitë me biblioteka, por nga pallatet përpara të cilëve parkoheshin maunat që kalonin kufijtë atëherë kur doganierëve u jepej urdhër të binin në gjumë.

Bibliotekat shumëgjuhëshe të socializmit jugosllav do të mbeten rrëfim i një të kaluare dhe shpjegues sesi ndodhi që bibliotekat e ardhmërisë të zhvendosen nëpër pallatet e “maunokratëve” e lidërshpëve partiakë, fëmijët e të cilëve nuk kishin nevojë të lexojnë as shqip, as në gjuhët sllave; mjaftonte të kishin durim të kalonin disa vite nëpër kolegjet perëndimore, nga do të ktheheshin si zotërinj, thujse veç të dëshmonin të vërtetën po aq të vjetër sa gjinia njerëzore: kur ndodhin thyerje të mëdha të rendeve shoqërore, e pësojnë ata që janë edukuar të mbrojnë njerëzoren. Prandaj dhe në kohët e zhvendosjeve të mëdha, më të përvojatur janë të rinjtë e edukuar nëpër shtëpi me biblioteka, sepse askush nuk u kishte treguar se ka kohë kur asgjë nuk vlejnë aftësitë dhe vlerat njerëzore. Të rinjtë të cilët, të hutuar, i jetonin orët kur fikeshin dritat në “shqipëritë”, ku kishte pak rrymë elektrike, por terr të mjaftueshëm sa të mos shihen ngarkuesit e maunave që trafikonin mjerimin e shoqërive shqiptare. Fëmijët e këtillë të viteve nëntëdhjetë, jetonin ardhmërinë e “ndritshme” që ua ndërtonin prindërit e tyre gjatë dekadave të socializmit, qëndronin të përballur me varrin ku ishin groposur kufomat e njerëzores dhe aftësitë individuale, a mbi ato varre ku mburshëm ngrihej obelisku i destruktives.

Bibliotekat e shqiptarëve të ish-Jugosllavisë filluan të ripërtërihen në vitet nëntëdhjetë kur sadopak filloi qarkullimi shqiptaro-shqiptar. Me çka, shqiptarët nga kjo anë e kufirit donin të gjenin raft të veçantë biblioteke për ëndrrat e botës së tyre të djeshme, etazherin për mëmëdheun. Në atë raft ata duhej të vendosnin të sotmen dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre. Në ato rafte përgjithmonë do të mbeteshin titujt – kufij, librat themel

të bibliotekave të tyre në gjuhën amtare, titujt e ardhur nga Shqipëria në vitet kur kufirin shqiptaro-shqiptar e ruanin partizanët ideologjikë. Kur në të vërtetë, titujt e librave të shkrimtarëve të mëmëdheut e kritikëve letrarë nga kjo anë e kufirit, si Ali Aliu, i shtrëngonin nën sjetull me frikën që të mos u binin diku, e pastaj ta pësonte ai që ua kishte sjellë. Mbase edhe tani i kaplon djersa ata që dikur “kontrabandonin” librin në gjuhën shqipe nga ajo anë, në këtë anë të kufirit shqiptaro-jugosllav. I kaplon djersa e ftohtë e dikurshme, e cila kush e di për të satën herë u rikujton ëndrrat e botës së djeshme: të kishin biblioteka të pasura në gjuhën amtare. I ballafaqon edhe me të sotmen e pasardhësve të tyre, të cilit në vend të librit “shfletojnë” faqet e internetit ku kërkojnë bashkëbisedues nga bota perëndimore, kërkojnë ndonjërin që do t’u sigurojë një vizë, që do t’u mundësojë të braktisin këto hapësira ku, nga Tirana në Shkup, më lehtë mund të kalosh me një maunë përplot me cigare të padoganuara, sesa me një valixhe me libra. E në vitet nëntëdhjetë kur edhe shqiptarët zbuluan internetin, nga ana tjetër e ekraneve të kompjuterëve ishin ulur “gjuetarët” e rinisë shqiptare, të cilët shtreshin se ofrojnë realizim të ëndrrave rinore, a në të vërtetë ishin të etur vetëm për freskinë trupore të fëmijëve, të cilët prindërit e tyre i kishin rritur mes bibliotekave, pa e ditur se nga raftet ku kishin vendosur peshën e botës së vet, dikush e kishte vjedhur titullin e kohës së re. Andaj prindërit shqiptarë të fillimshekullit të njëzetënjë gjithnjë e më pak i shqetësonte e vërteta se bibliotekat e tyre do të mbeteshin si dëshmi e heshtur e një kohe të largët, e gjithnjë e më shumë trembeshin nga “internet-kafenetë” ku fëmijët e tyre komunikonin me blerësit e rinisë shqiptare, ku bënin trafikimin e vetvetes,

kontaktonin me ata të cilët e dinin se të riun shqiptar mund ta kalosh nëpër kufi si të ardhur nga askund, si libër të bartur nën sqetull, e të cilin pastaj askush nuk e kërkon, përpos era e djersës së prindërve që e kishin rritur.

Nga e gjithë djersa e derdhur shqiptare, ajo e krijuesve letrarë do të mbetet më frutdhënësja. Qysh gjatë dekadave të mureve të larta mes kufijve të shteteve të Ballkanit - falë gjurmuesve të vlerave letrare shqiptare, të ngjashëm me Ali Aliun - Prishtina e viteve shtatëdhjetë, kishte arritur sadopak të kompletojë bibliotekën kombëtare edhe me krijuesit bashkëkohorë shqiptarë. Kështu që “Rilindja” kishte botuar veprat e Ismail Kadaresë, poezitë e Lasgushit, romanin “Hasta La Vista” të Petro Markos. “Rilindja” thajse kishte kompletuar edhe raftin e bibliotekës kombëtare me veprat e rilindësve shqiptarë, të cilat u mungonin bibliotekave të Tiranës. Kështu që u krijua një lidhshmëri letrare e një populli të ndarë me mure të larta ndërkuftare. Këtë ndërlidhje, veçanërisht e ndihmonte Ali Aliu, i cili kurrë nuk lejoi që letërsinë kombëtare ta trajtojë të pjesërishtme, të ndarë sipas kufijve të shteteve ku jetonin shqiptarët. Ai do t’u përkushtohet edhe veprave të shkrimtarëve, të cilët Tirana zyrtare e asaj kohe i shihte si “dekadentë”.

“Aliu”, shkruan Alfred Uçi, “nuk u drojt t’i çmojë edhe veprat e disa shkrimtarëve që ‘*cilësoheshin*’ nga autoritetet e asaj kohe, që ishin përndjekur, dhe në mjaft raste ndikoi pozitivisht edhe në rehabilitimin e tyre, siç ishte rasti me veprën e shquar letrare të Petro Markos. Dhe këtë nuk e bëri duke përdorur ndonjë lloj pragmatizmi politiko-ideologjik, që n’ato kohë pat qenë modë në disa rrethe kritikësh, por duke argumentuar bindshëm vlerat e mirëfillta estetike të tyre.”

Të veprimtaria kritike dhe studiuese e Ali Aliut, ka diçka që shumë mirë e definon Uçi, e që ka të bëjë me boshtin kurrizor të njeriut që u ngrit në enciklopedi të letërsisë shqiptare: “Ai nuk ka qenë kurrë nga ata që nxitojnë të ecin në rrugë të pasigurta “izmash” estetikisht të dyshimta: gjithë patosin e frymëzimeve të tij kritiko-letrare e pat ushqyer me kuptimin e thelbit estetik të letërsisë, të artit.” Pra, gjatë veprimtarisë si kritik letrar, ai ndoqi të njëjtën rrugë në të cilën eci gjatë veprimtarisë së vet atdhetare e shoqërore: duke u ikur të gjitha furtunave të politikës së ditës që sillnin famë të përkohshme, por mjegull afatgjatë. Apo, thënë ndryshe, punoi për popullin, pa pasur ambicie të bëhej i pazëvendësueshëm. Edhe kur doli në krye të kolonave, e bëri vetëm sa të ndihmojë që ato të renditeshin si duhet. Mbase shkaku qëndronte në atë se ai e dinte se jetonte dhe vepronte në kohën kur shumë jeniçerë kishin pretendime të bëheshin Skënderbe.

Më në fund, ishte e pamundur që një dijetar si Ali Aliu të mos e kishte kuptuar se jeta e njeriut është një tërësi, në të cilën lindja mban mbi vete gjithë stinët e ardhshme. E vdekja mbetet si kulm, i cili jo vetëm që nuk bart asgjë mbi vete, por edhe gjithë më poshtë vetes i shlyen. Ali Aliu i takonte gjeneratës së krijuesve dhe aktivistëve atdhetarë që kishin jetuar në hutesë stinët më të vlefshme të jetës së vet: ato të lazdranisë fëmijërore dhe të rinisë. Por, ai e dinte se gjithmonë ia vlen të jetosh, posaçërisht nëse lexon mirë kalendarin që të takon dhe nëse arrin që të lësh aty sa më shumë gjurmë vetjake dhe sa më shumë ditë festive. Mbase edhe fëmijëria, si edhe rinia e varfër, në mos më shumë, bartin në vete bukurinë e freskinë e asaj moshe, sinqeritetin e bindjes se i takon vetëm vetes dhe atyre që të duan dhe i do pa hile. Sikur

mos ishte ashtu, njeriu kurrë nuk do të arrinte t'i përballë ditët përplot dhembje, përplot hutesë, siç ishin ato të fëmijëve të dekadave të socializmit jugosllav, të cilët jo rrallë shkollimin duhej ta kryenin në gjuhën joamtare. Ata fëmijë kurrë nuk harruan ditët kur u ishte dridhur dora që ua shtrëngonte prindi, i cili e çonte fëmijën të shtegtojë në një botë tjetër, në një gjuhë të huaj, në një kulturë dhe traditë të largët nga ajo që kishte thithur së bashku me qumështin e nënës. Prindërit e asaj kohe e dinin se fëmijët e tyre nuk mbështeteshin mbi vullnetin për të mësuar përmendësh poezi në gjuhët sllave, por mbi besimin e prindërve se do të vinte dita kur pasardhësit e tyre lirshëm do të recitonin vargjet e Naimit.

Nuk ka dyshim se do të vijnë kohët kur ndonjë krijues do të frymëzohet nga jeta e të rinjve shqiptarë që jetonin në ish-Jugosllavi, nga ecja e tyre në jetë përmes shtigjeve të një "jeniçerizmi" socialist kur shumica e vogëlushëve shqiptarë duhej të vazhdonin shkollimin në gjuhët sllave. Edhe atë në moshë kur ende nuk e kishin përvetësuar sa duhet gjuhën e unifikuar letrare shqipe. Do të shkruajë dikush për gjeneratat shqiptare të ish-Jugosllavisë, të cilat, duke mos pasur rrugë tjetër si të realizonin ëndrrat e veta dhe të prindërve që të mos mbeteshin druvarë, bëheshin pjesë e një kulture dhe tradite që s'kishte asgjë të përbashkët me atë të qumështit të nënës. Për gjeneratat e të rinjve shqiptarë të botës së djeshme komuniste, të cilët duhej të bindeshin se gjuhët e sllavëve të jugut, e jo ajo amtaria, ishin ato që t'i hapnin apo mbyllnin rrugët e mbijetesës. E ato gjenerata i kishin shijuar deri në dhembje talljet e shokëve, për shkak se nuk e njihnin gjuhën e "vëllezërve" me të cilët ndërtonin shoqërinë ku puna e bënte njeriun, e njeriu zhbënte vetveten. Qysh në ditët e

para të shkollimit të tyre, fëmijët shqiptarë mbase fillonin ta urrenin shkronjën “h” të fortë të gjuhëve sllave, e cila u dilte nga goja gjithmonë si ajo “h-ja” e mekur e gjuhës së nënës, njësoj e butë dhe mikluese sa edhe psherëtimat tek “Oh, moj nënë...”. Pra, njëlloj si psherëtimat që u gufonin nga kraharori sa herë që u duhej të shuajnë të skuqurit në fytyrë. Por mbase edhe kjo psherëtimë, u ndihmonte shkollarëve shqiptarë të asaj kohe që ngutshëm të përvetësonin gjuhën serbe apo atë maqedonase, dhe Ohrin kurrë më të mos e quajnë “Orid”, sepse “Oh-ët” dilnin nga thellësitë e kraharorëve rinorë, nga botëshikimi, i cili në atë moshë nuk mundej ta dinte se jeta është si ndërtesë, e cila kërkon mjeshtëri që ta murosh, se shpeshherë ka konstrukt, të cilin nuk e përcakton ti, por rrethanat jetësore.

Asokohe as që mundeshin gjeneratat e reja të shoqërisë shqiptare nga kjo anë dhe matanë kufirit, të paramendonin se do të përballeshin me muratorë që nuk dinin as gjërat më elementare në mjeshtërinë e murimit të kalasë kulturore kombëtare; nuk dinin se kulla e vlerave kombëtare duhet të ndërlihet si një tërësi, në të cilën çdo pjesë bart të ardhshmen, vetëm themelet nuk i bart asgjë edhe e tëra qëndron mbi ta, dhe se majat nuk bartin asgjë përpos që janë të kërcënuara nga furtunat dhe rrufeja.

Dekadat e socializmit jugosllav janë lëndë e mirë për krijuesit letrarë. Posaçërisht kaptina që do të zbërthejë jeniçerizmin e shumë gjeneratave të rinisë shqiptare në Jugosllavinë e Titos, gjenerata që në të vërtetë bartën barrë të rëndë mbi shpatullat e veta, në mos më shumë për shkak se duhej të përballonin beteja të shumta për të mbrojtur traditën dhe kulturën, ndarë nga trangu kombëtar. Ata jeniçerë, shpeshherë nuk ishin vetëm larg atdheut

gjuhësor, por edhe larg vendlindjes. Shkollat profesionale dhe universitetet, shumë vonë nisën të ndërtohen në vendbanimet shqiptare. Kështu që i riu shqiptar i dekadave të pesëdhjeta dhe gjashtëdhjeta, duhej ngutshëm të mësonte gjuhën që asokohe kishte vetëm një emër – serbokroatishten, e cila më vonë u ngatërrua në ngjashmërinë kulturore dhe gjuhësore të katër popujve, dhe mori po aq emërtime – bosançe, malaziasë, kroate dhe serbe. Ndërkaq, me po të njëjtën ngutje kohore, bëhej e fjetur gjuha e qumështit - ajo e nënës. Shumë nga këta të rinj shqiptarë që shkolloheshin në gjuhët jo-amtare, kishin filluar të shkruanin dhe të botonin në gjuhët e sllavëve të jugut. Duke mos pasur mundësi të mësojnë gramatikën e gjuhës amtare, mbase edhe vetëgënjuheshin se gramatika u duhet vetëm atyre që nuk dinin si t'i shprehnin mendimet e veta. Pra, në dekadat e para të socializmit jugosllav, kishte filluar jeniçerizmi kulturor, i cili kërkonte nga krijuesi shqiptar së pari të dëshmohej në “oborrin mbretëror”, e pastaj, nëse gjer atëherë nuk e ke harruar erëminin e qumështit të nënës, t'i kthehet vetvetes.

Do të jenë interesante për krijuesit e ardhshëm edhe letrat në të cilat fjalët shqip ishin shkruar me shkronja cirilike, e që prindërit e atëhershëm ua dërgonin fëmijëve të vet nëpër qendrat jugosllave ku ata arsimoheshin. Ishte një alfabet i panjohur dhe i pastudiuar, por i përdorur pas Luftës së Dytë Botërore. Ishte alfabeti i një disfate shqiptare, i ardhur shumë dekada pasi ishte kodifikuar alfabeti i gjuhës shqipe në Manastir, por përpara se shqiptarët e proletariatit socialist jugosllav të kuptonin se edhe ata që përdornin shkronjat shqipe, në të vërtetë që moti fjalët shqip i radhisnin sipas pentagramit sintaksor

sllav. Kështu, letrat e prindërve me plot fjalë të një shqipeje arkaike e të shkruara me shkronja cirilike, dhe ato të fëmijëve të tyre të shkruara me shkronja dhe fjalë të pastra shqip, por të radhitura në mënyrë sllavishte, në të vërtetë ndërthurnin vazhdimësinë e jeniçerizmit shqiptar që vazhdonte edhe në shekullin e njëzetë. Letrat që dërgoheshin nga prindërit ishin përplot me ëndrrën që pasardhësit e tyre t'i shpëtonin sharrës e të bëheshin njerëz të “lapsit”. Ku e dinin ata të gJORËT se atje ku kishin shkuar fëmijët e tyre nuk mësonin vetëm gjuhët që “çelnin dyert” e ardhmërisë socialiste, por mësonin të bartnin në duar edhe flamurin e jeniçerizmit kulturor...

Ajo që pasoi më vonë, pas viteve tetëdhjetë – mbetet pjesë e një historie tjetër! Materie për letrarët e ardhshëm që do të frymëzohen nga bëmat e paraardhësve të tyre, brumë që sot ngjeshet nga jeniçerët e dikurshëm, të cilët në vitet nëntëdhjetë ngutazi u bënë demokratë. Ata që kurrë nuk do të mundin realisht ta pasqyrojnë të kaluarën e vet, për shkak të ambicies vetëgënjesëse se janë “skënderbetë” e demokratizimit. Të shtyrë nga ato ambicie, shumica e tyre ngutshëm doli në krye të partive, mori në duar institucionet kulturore e shtetërore, mbylli rrethin e klaneve të veta dhe përuroi një koncept të ri të mbijetesës së vet, si listë emrash, koncept të cilin duhet ta mbajë mend ky popull: fjala kufomëngrënës, që nënkuptonte t’ia hash kokën kundërshtarit politik, dhe të pranosh vetëm meritat e të vdekurve.

Jeniçerizmi shqiptar i kohëve socialiste solli me vete edhe gjeneratën, e cila fjalitë e thëna pastër, shqip, i kishte të kompozuar në “pentagramin” sintaksor sllav. E mësuar me këtë melodi, më vonë do të ngjallë në disa qarqe edhe dëshirën e promovimit të identitetit të veçantë gjuhësor

dhe kulturor. Ku ta dish, ndoshta shoqëria shqiptare e fillimshekullit të njëzetënjë, ende jetonte fazën kur duhet të paguajë çmimin e jeniçerizmit të dikurshëm, çmim të cilin e caktonin ata që nuk e kishin kuptuar dot se nuk mundej çdo jeniçer të bëhej “skënderbe”. Pra, ata që s’e kishin kuptuar se mjafton t’i kthehesh qumështit të nënës, për të njohur vetveten dhe të kuptosh se jeniçerizmi s’është i turpshëm, se askush nuk do ta kishte zgjedhur me vetëdëshirë, por atë ta përcakton fati jetësor. Bile, në rrethana të caktuara, ai ka ndihmuar të mbijetojë shqiptaria e shkëputur nga trangu kombëtar.

Shumë të rinj shqiptarë që shkolloheshin nëpër qendrat universitare të ish-Jugosllavisë në vitet pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë, vonë e kishin kuptuar se “jeniçerizmi” s’kishte përfunduar me shkatërrimin e perandorisë turke. Nga ta dinin se për shqiptarët ai do të vazhdonte deri në fundshekullin e njëzetë. Në trojet shqiptare të asaj kohe nga kjo anë e kufirit, edhe valët e Radio Tiranës nuk mundeshin të kapen si tani. Të rinjtë e atëhershëm që fshehurazi dëgjonin emisionet e Radio Tiranës, mahniteshin me suksesin e bashkëmoshatarëve të vet matanë kufirit, për të cilët zëri mburrës i spikerit lajmëronte se kishin mbushur thasët me kokrra gruri të mbledhura nëpër arat pasi kishin mbaruar korrje-fshirjet. Dhe as që u shkonte ndër mend se mbledhësit e kokrrave të grurit nëpër ara, në të vërtetë bënin mëkat: ua merrnin hisen zogjve, i linin pa ushqim shpendët këngëtarë pa të cilët poetëve kurrë nuk do t’u kujtohej metafora e fluturimit.

Të rinjtë shqiptarë të dekadave pas Luftës së Dytë Botërore, nuk kishin hallin se si të qartësonin drejt propagandën ideologjike të Enverit, por si të sforconin

“h-në” e sllavëve të Titos, që të mos i tallnin mikeshat e tyre joshqiptare, të cilat bëheshin edhe robëresha të shtratit të tyre të ngrohtë. Atëherë, as që u shkonte ndër mend se do të vinte koha kur do ta varrosnin “parajsën socialiste” dhe do të bëheshin ndërtues të shoqërive të “hapura” shqiptare, në të cilat të gjithë së bashku, jeniçerë dhe kurbetçinj të dikurshëm, atdhetarë të vonuar dhe demokratë të porsaemëruar, do të duhej ngutshëm të mësonin gjuhën e vetme me të cilën do të mund të komunikonin me ata që mbanin rend në protektoratet shqiptare – anglishten!

Jo të gjithë shqiptarët, shkolluar në dekadat e para të pasluftës në qendrat e ish-Jugosllavisë, e kishin kuptuar atë që dinte Ali Aliu: një popull mbetet pa atdhe, atëherë kur e humb gjuhën dhe kulturën e vet. Duke e ditur këtë, Ali Aliu i mbeti gjithmonë besnik toskërishtes së vet, këngës polifonike prespare, artit e kulturës shqiptare. Këtë besnikëri e thuri në studimet dhe kritikata letrare, në shkrimet e viteve nëntëdhjetë ku shprehte brengën për akulturimin e shoqërive shqiptare, ku pasqyronte një realitet të çuditshëm letrar kur, për botimin e një libri, ishin vendimtare paratë e autorit, e jo vlera që kishte ai.

Pa dyshim se Ali Aliu do të mbetet ndër të rrallët që arritën të mos lejojnë që kultura – krijimtaria letrare – të copëtohet në po aq pjesë sa ishin shtetet ku jetonin shqiptarët. Aliu këtë e arriti duke sjellë fshehurazi libra nga Tirana, por edhe ngaqë e dinte se çmimi i jeniçerizmit që duhej të paguanin shqiptarët në ish-Jugosllavi do të ishte shumë më i lartë e më tragjik për qenien kombëtare, po qe se lejohej koncepti i qarqeve antishqiptare sllave që kishin qëllim që kulturën dhe identitetin shqiptar ta ndanin në dy pjesë – në “albanksa” dhe “shqiptarska”.

Andaj edhe veprimtaria e viteve gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë e Ali Aliut, i ngjan një donkishotizmi të guximshëm për të mbrojtur identitetin kulturor të shqiptarëve nga kjo anë e kufirit.

Pasi kishte shijuar donkishotizmin në lëkurë të vet, Ali Aliu nuk do ta ketë rëndë të zbërthejë edhe donkishotizmin e krijuesve shqiptarë. Këtë portretim të Don Kishotëve krijues do ta rrumbullakësojë në librin “Don Kishoti te shqiptarët”, libër i cili është i veçantë për nga mënyra e trajtimit të veprimtarisë krijuese të Jeronim de Radës, Naim Frashërit, Fan Nolit, Faik Konicës, Lasgush Poradecit, Fatos Arapit, Ismail Kadarese, Azem Shkrelit, etj. Në këtë libër, Aliu nuk do të vërë në peshore vlerësuese vetëm tharmin estetik të veprave letrare të autorëve, por do të ndërlihdë zinxhirin historik të krijimtarisë letrare shqiptare, do të kompletojë mozaikun e letrave shqiptare, ku do të dalë i qartë portreti i krijuesit shqiptar në të kaluarën dhe në të sotmen: mbrojtës të atdheut gjuhësor dhe kulturor të popullit. “Rilindësit e hapësirës ballkanike, sidomos shqiptarët”, shkruan Ali Aliu, “kishin qëndrim në shkallë të kultit dhe mitit, qëndrim që kufizonte me entuziazmin donkishotesk.” Ky entuziazëm dhe ky qëndrim ndoshta buronte nga bindja e tyre se vepronin në kohë dhe rrethana kur gjuha dhe kultura u kishin mbetur atdhe i vetëm. Se, krahas bukës dhe ujit, kultura dhe gjuha ishin ushqimi i vetëm që do të mundësonte të mbijetojë populli shqiptar, si i veçantë dhe i pa lidhje farefisnore me ballkanasit e tjerë.

Nëse vitet studentore në Beograd do të paralajmërojnë ardhjen e një Don Kishoti në kulturën shqiptare, pa dyshim se vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë do të jenë ato kur Ali Aliu me dorën e vet do ta nënshkruajë fatin e

vet donkishotesk. Veprimtaria e tij në “Flakë”, si gazetar dhe redaktor i rubrikës së kulturës, artikujt e tij të llojlojshëm, por thuajse gjithmonë me të njëjtën ngjyrë – atë të zymtën, tek shprehte brengën për arsimimin dhe të drejtat e popullit shqiptar - do t’i vizatojnë tiparet bartëse të portretit të tij, portret i cili gjatë viteve të mëvonshme vetëm se do të bëhet më i dukshëm për letërsinë dhe atdhetarinë shqiptare. Pa dyshim që do të bëhet më i dukshëm dhe më tërheqës edhe për organet policore që kompletinin dosjet e atyre që mbaheshin si të rrezikshëm për sistemin e atëhershëm. Ndërsa policia e atëhershme jugosllave ngutej të kompletonte dosjen e Aliut, ai shpejtonte të ngjitet majave të veta duke e ditur se atje mund të arrijë vetëm nëse i mbetet e padëmtuar emblema njerëzore, nëse i mbetet besnik besimit se po aq e rëndë sa ngjitja drejt majave për ku je nisur, është edhe të qëndrosh ndershëm në to. Sepse, duke ecur drejt tyre e sheh edhe cilët i ke miq edhe cilët të janë keqdashësit, e kur arrin lart, të shoqëron vetëm vetmia dhe shikimi i atyre që janë atje poshtë, në rrëzë, e të cilët ti nuk mund t’i dish as t’i dallosh se cilët janë. Aq më shumë, nuk e di nëse bëhet fjalë për shikim admirues apo ziliqar, për shikim miqësor apo smirëtar.

Se Ali Aliu shumë shpejt u ngjit në majat, prej nga shikonte më larg se shumë të tjerë, dhe asnjëherë nuk ngurronte të thoshte atë çka shihte nga ato lartësi, me pak fjalë dhe me dashamirësi e shpjegon Fejzi Bojku: “Ne të redaksisë së “Flakës së vëllazërimit” të viteve gjashtëdhjetë, Aliun e kishim si burim dhe nxitës të guximit intelektual dhe krijues, e ndienim si bosht të redaksisë, ishte ai që sillte tronditje, që i lëvizte gjërat, që kishte guxim t’u kundërvihej, e bile edhe t’i përqeshë ata që ishin në

piramidat partiake. Ai ishte njeriu, i cili qysh atëherë i thoshte publikisht gjërat, të cilat shumica nuk guxonin as t'i mendonin." Këto vlerësime të Fejzi Bojkut (shkrimtar i njohur për fëmijë dhe ish-kryeredaktor i "Flakës së vëllazërimit") më së miri e mbështesin tekstet e Ali Aliut të botuara në "Flakën e vëllazërimit" të viteve gjashtëdhjetë, si për shembull artikulli i datës 20 korrik 1967, me titull "Sukseset dhe mossukseset në kandar", të cilin kur e lexon, të bëhet se është shkruar në vitet nëntëdhjetë, në dekadën kur partitë shqiptare në Maqedoninë demokratike, luftonin pasuksesshëm për përfshirjen e drejtë të shqiptarëve nëpër institucionet shtetërore. Në këtë artikull, Ali Aliu shkruan: "Tetova relativisht është komunë e zhvilluar në R.S të Maqedonisë, ka afër dhjetë objekte ekonomike të rëndësishme, sikurse ka edhe një mori asish më të vogla. Ka rreth 100 ndërmarrje, objekte ekonomike, dyqane dhe qendra përfaqësuese ekonomike. Gjithashtu ka edhe 60 ente dhe organizata të ndryshme të ngjashme. Së bashku, të gjitha këto absorbojnë një fuqi pune prej 11.500 punëtorësh. Ky numër, për një komunë, ashtu sikurse është Tetova, nuk është gjithaq për t'u nënçmuar. Ndërkaq profili i kësaj fuqie pune të inkuadruar, sipas përbërjes së kombësive, nuk kënaq aspak. Gjegjësisht, prej krejt këtij numri, vetëm 3.000 punëtorë janë popullsia shqiptare – një disproporcion absurd."

Të theksosh "disproporcionin absurd" mes të punësuarve shqiptarë dhe atyre të etnitetit maqedonas në vitet gjashtëdhjetë, atëherë kur "lulëzonte bashkim-vëllazërimi" dhe "proletariati" jetonte ditët e veta më të lavdishme, do të thoshte me dorën tënde të nënshkruash dosjen si kundërshtar i sistemit. Mbase këtë nënshkrim,

Ali Aliu e kishte vënë në dosjen e vet qysh më parë, me tekstet e përmendura, “Tetova shikuar së afërmi”, vetëm se e vulos fatin e vet. Por, për çudi, edhe pas demonstratave të Tetovës, kur hapur u shpall si nxitës i tyre, nuk do të përfundojë në burg. Gjë e cila shumicën e çoi të habitej dhe të pyesnin veten sesi ndodhi që të tjerët - edhe pse jo aq të apostrofuar e të përmendur si armiq – morën disa vite burg, kurse Ali Aliu shpëtoi vetëm me shtegtimin e ngutshëm në Prishtinë. Këtë të gjithë e shpjegonin ashtu si u vinte për mbarë. Mosburgosjen e Aliut, shumica do ta ndërlihdhë me vëllanë e gruas së tij, Meti Kërliun, asokohe funksionar i lartë në piramidën partiake. Pra, shpëtimin pa pasoja do t’ia adresojnë “ombrellës mbrojtëse” familjare, e cila do të mbetet e tillë edhe gjatë qëndrimit në Prishtinë.

Nuk ka dyshim se është jonjerëzore të presësh që kunati të mos e ndihmojë dhëndrin e vet, burrin e motrës, babain e nipërve të vet, kur ai është i rrezikuar me burg. Është jonjerëzore të presësh që njeriu, të cilit i kanoset rrezik i tillë, të mos u drejtohet të afërmeve ta ndihmojnë. Njësoj siç është shumë jonjerëzore që rastësitë e fatit jetësor – të jesh familjar me ndonjë që asokohe ka qenë në pushtet – ndonjërit t’ia përshkruash si mangësi, vetëm pse ai nuk ka përfunduar në burg. E ndërkohë të mos e vlerësosh drejt bile edhe këtë lidhje familjare, e cila, mbase më shumë se çdo gjë tjetër, e dëshmon Ali Aliun si njeri të parimeve të veta, si individ me bosht të fortë kurrizor dhe si njeri që të afërmit i do dhe i respekton, por nuk i përdor për ngjitje-uljet karrieriste. Sepse sikur të ishte ndryshe, ai nuk do të krijonte situata që kunati ta shpëtonte nga burgju, por këtë “ombrellë” familjare do ta përdorte për t’u ngjitur drejt majave të mirëqenies dhe lartësive të

piramidës karrieriste. Me aftësitë që kishte, dhe sikur ta “ulte pak kokën” e të bëhej “më i dëgjueshëm”, ai me siguri do të arrinte më larg e më lart se shumë të tjerë, të cilët ishin ngjitur duke u përkulur dhe gjunjzuar. Sikur mos ishte Don Kishot i kulturës dhe atdhetarisë shqiptare, vitet e socializmit do t’i shijonte shumë më mirë dhe më lezetshëm se ata të paaftët që dinin vetëm të denonconin dhe të shkelnin mbi trupin e popullit të vet. E ai këtë nuk e bëri kurrë. Për fat të tij, por edhe të letërsisë shqiptare, në vitet gjashtëdhjetë i shpëtoi edhe burgut. Por nuk u shpëtoi përfoljeve, edhe pse të gjithë e dinin se kanë të bëjnë me njeriun, i cili i donte të gjithë të familjes së vet, mbase ngaqë të gjithë e admironin për punën që bënte. E admironin bile edhe atëherë kur familjarëve të tjerë u sillte telashe nga më të ndryshmet. Më në fund, aq sa për Aliun ishte “bisht” të qenit dhëndër i një familjeje revolucionarësh të dëshmuar, po aq edhe Aliu për ata ishte “dele e zezë” që u sillte telashe nga më të ndryshmet. Pra aq sa eventualisht Aliun e mbronin familjarët e tij funksionarë të asokohshëm në Maqedoni, po aq Aliu i dëmtonte me qëndrimet e veta “mbrojtësit” – vëllezërit e gruas – të cilët do të ishte e panatyrshme ta flijonin dhëndrin për shkak të karrierës së tyre. E tëra kjo shpalos edhe një të vërtetë tjetër të pamohueshme: komunizmi titist, kurrë nuk mori përmasat e atij enverian, i cili për hir të qëndrimeve të një anëtarit të familjes, bënte ta pësonte thuajse i tërë fisi.

Që Don Kishoti tek Ali Aliu asnjëherë nuk u dorëzua dhe nuk e la atë pa shqetësime - edhe pse e dinte se gjithnjë e më shumë e vuloste fatin si “armik” i Jugosllavisë së Titos - dëshmon edhe një tekst i tij i botuar më 9 shkurt 1967, në gazetën “Flaka e vëllazërimit”, me titull

“Tendenca për zgjedhje formale të parimit dygjuhësor”, ku në mes të tjerave shkruan: “Nëse përvetësimi i të dy gjuhëve, apo tri, të popullsive e kombësive në një qytet nuk ndihet si nevojë e domosdoshme komunikimi në përditshmërinë, nëse ajo nuk trajtohet dhe nuk vihet në pozita të tilla që do të ishte pjesë organike e qytetarit, që si praktikë do të imponohej me domosdoshmërinë reale shoqërore dhe ekonomike, edhe pas njëzet e dy vite çlirimi ne do të vazhdojmë të deklarojmë, të përmendim dhe të përkrahim intencat e Kushtetutës, të statuteve, por në realitet dhe praktikisht të mos ndërmarrim asgjë... Dihet edhe ajo se në Tetovë disa ‘komunistë’ kanë deklaruar se a priori zbatimi i përdorimit të dy gjuhëve në jetën e përbashkët dhe të përditshme në terren është e pamundur?”

Aliu në këtë tekst thekson problemin e pazgjidhur të dygjuhësisë, edhe pas njëzet e dy viteve të çlirimit dhe me siguri që asokohe nuk i ka shkuar mendja se tekste me përmbajtje të ngjashme do të shkruante edhe në vitet '90, kur në Maqedoni sërish do të rihapet tema e dygjuhësisë, kur do të problematizohej përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe, kur edhe në Tetovë, me tetëdhjetë përqind banorë shqiptarë, nuk do të ketë asnjë shenjë rrugësore në gjuhën shqipe.

Në shumë tekste të veta gazetareske të viteve gjashtëdhjetë, Aliu do të theksojë padrejtësitë që iu bëheshin shqiptarëve, do të aktualizojë probleme që do të mbeten të pazgjidhura deri në vitin 2001, kur në Maqedoni plasi konflikti i armatosur dhe, si pasojë e tij, u nënshkrua Marrëveshja e Ohrit. Tërë ato artikuj, gjithë ato qëndrime të guximshme të thënë publikisht, e jo nëpër kafene e çajtoje, vetëm se e kompletojnë portretin e një

Don Kishoti kulturor dhe shoqëror të shqiptarëve të Maqedonisë, karakter që tërë jetën mbeti i nënshtruar besnik i bindjeve dhe parimeve të veta. Dhe normalisht, si i tillë, gjithmonë i gjunjëzuar përpara altarit të njerëzores në vetvete, parimor, përbuzës ndaj atyre që fatin e popullit e keqpërdornin për përfitime personale, ai ishte i sulmuar nga servilët dhe pakurrizorët e të gjitha kohëve. Më në fund, në mes të mbrojtjes së njerëzores në vetvete dhe të kënaqësive të përkohshme të paguara me nënshtrim, me përbuzje të vetvetes e popullit që i takon, Ali Aliu kishte zgjedhur të mbetej Don Kishot i përhershëm, duke e ditur se donkishotizmi të grabit edhe qetësinë familjare. Se cilat dhe sa të mëdha ishin shqetësimet e tij dhe të familjes, më së miri do të flisnin rrëfimet e bashkudhëtares së tij jetësore, Merza Aliut, e cila në flokun e thinjur kishte të regjistruara netët pa gjumë për shkak të bastisjeve policore. Në ato thinja, kishte mbetur edhe malli për nipërit e saj, të cilët në vitet nëntëdhjetë rriteshin në gjitha “shqipëritë”, pa pasur shtëpi të vetën në asnjë nga ato. Në heshtjen e asaj gruaje fisnike që edukoi shumë të rinj shqiptarë në Shkup e Prishtinë, mbeti e ngulfatur edhe dhembja për shtëpinë e rrënuar në Brezovicë nga ana e policisë serbe. Në çdo lëvizje të Merzës lexohej një shqetësim i heshtur, të cilin nxitonte ta merrte nga burri i saj, me qëllimin që ai ta kishte më lehtë. Ky shqetësim i Merzës, i dyfishuar, e shoqëroi deri në ditët e fundme të jetës së saj, deri në çastet kur edhe atëherë, dukej se më shumë ishte e shqetësuar sesi Aliu do ta përballte ndarjen e përrjetshme, sesa vetë ajo do të ndahej nga kjo botë. Si askush tjetër ajo e dinte se Aliu i saj, i cili nuk e ulte kokën para askujt, në të vërtetë kishte shpirt të brishtë dhe ishte shumë i ndjeshëm ndaj atyre që i donte. Më mirë se askush, Merza

e dinte se sa ndershëm burri i saj mbante “shtizën” e Don Kishotit, sepse ajo shtizë shpeshherë ia rëndonte supet edhe asaj. Dibrania e rritur në një familje bujare, bijë e hoxhës, dinte ta lexojë “toskën” e saj po aq mjeshtërisht sa Aliu veprat letrare që i trajtonte në kritikak e studimet e veta. Nëse Ali Aliu ishte dhe mbeti njohësi më i mirë i letërsisë shqiptare, gruaja e tij, Merza, deri në ditën e vdekjes mbeti mbështetësja më besnike dhe njohësja e vetme, më e mira e Don Kishotit të shqiptarëve të Maqedonisë, Ali Aliut.

KËSHTU LIND E ECËN NJERIU

Është vjeshta e vitit 2006. Kosova është duke pritur pavarësinë e vet, Shqipëria mbetet e ngulfatur nga kthetrat e zënkave partiake, shqiptarët e Maqedonisë janë kapur në pezhishkën e inateve ndërpartiake, dhe prej aty brenda nuk shohin sa vuajnë nga ajo që u shkaktohet prej të tjerëve dhe po aq, e ndoshta edhe më shumë, nga bëmat e ulëta partiake që kurdiseshin nga “strategët” e tyre kombëtarë, veç të jenë pjesë e pushtetit edhe atëherë kur nuk kanë mbështetjen e popullit. Shqiptarët e Maqedonisë mbetën peng i ambicieve të strategëve partiakë, të cilët në Prishtinë e Tiranë shisnin koncepte mbarëkombëtare, teksa në Tetovë e Shkup bënë lojëra politike nga më të errëtat. Shqiptaria jetonte në pezhishkën e politikave të paafta të lexojnë kalendarin e kohës dhe të kuptojnë se veprimi i sotëm ka vulën e së kaluarës, andaj dhe sot, njësoj si në shekullin e kaluar, politikat shqiptare vuanin nga inferioriteti i dyfishtë. Ky inferioritet i bënte politikanët shqiptarë të jenë shumë të kujdesshëm ndaj kolegëve të tyre fqinjë dhe evropianë, por fare të pasjellshëm ndërmjet veti dhe ndaj popullit të vet.

Megjithatë, nuk ishte çdo gjë aq e errët dhe dëshpëruese në botën shqiptare. Kishte një bimë, e cila rritej edhe atëherë kur shoqëritë shqiptare ishin ara

pjellore ku mbillej dhe rritej grindja ndërpartiake, ku bimëzonte urrejtja e papërmbajtur ndaj njëri-tjetrit. Kjo bimë ishte dhe mbeti arti shqiptar në përgjithësi, e veçanërisht krijimtaria letrare. Pra, edhe në rrethana kur mediat vlonin nga polemikat e shpikura, nga nxitja e ndasive partiake, klanore, krahinore..., njerëzit e artit i mbeten besnikë dhomës së vet të punës, letrarët vazhdonin të përballen me letrën e bardhë, kështu që në Tiranë e Prishtinë botoheshin vepra të reja letrare. “Ndërtuesit” e letërsisë shqiptare, Kadareja, Agolli, Arapi, Spahiu, Kongoli, Zhiti, Podrimja, Kraja, Myrtaj, Stani..., për fat të mirë, nuk i ngulfati zhurma politike. Ata e ruajtën dhe mirëmbajtën “atdheun” e tyre më të sigurt – krijimtarinë, e cila jo njëherë i ka mundësuar popullit shqiptar t’i mbijetojë të gjitha shtrëngatat e Ballkanit. Pra, nëpërmjet veprave të tyre ata arritën të mirëmbajnë dhe ta bëjnë edhe më të pjellshme ujdhesën ku është strehuar shqiptaria sa herë që pushtetarët e tyre kanë humbur rrugën - ujdhesën që quhet gjuhë, kulturë dhe traditë shqiptare, e vjetër sa edhe kullosa e Ballkanit.

Të gjithë librat e botuar në Prishtinë, Tiranë apo Shkup, më së shumti gëzojnë “enciklopedinë” e letrave shqiptare – Ali Aliun, i cili ngado që të kthehej, në shtëpi arrinte me çantën përplot botime të reja. Kuptohet, moshë nuk ia lejonte leximin e ngutshëm si dikur, as mundësinë që pagjumësinë ta ndajë me librin, por librat që e gëzonin e që dalloheshin edhe nga ato që do të zënë vend në bibliotekën e tij, ia gjeje ende duke i bartur në çantë. Librat që t’i sillnin gëzim ato ditë të bezdisshme, do të kenë fatin që jo vetëm t’i lexojë, por edhe t’i mbushë me shënime dhe mendime të veta në hapësirën e bardhë anash faqeve. Andaj edhe biblioteka e tij personale, është si një

rrëfimtore e madhërishme ku dëgjohen mërmëritjet e kritikut, dhe ku kanë mbetur të shënuara përsiatjet që kanë lindur gjatë leximit të veprës.

Në mijëra titujt në raftet e bibliotekës së Aliut, jo të gjitha mund të kenë shënime në bardhësitë anësore të fletëve; i gjen tek ndahen në librat që kritiku i ka kompletuar me “kaptinën” e fundme të tyre – tekstin e tij kritik, dhe në ato të cilat kritiku nuk ka mundur t’i shkojë leximit në mënyrën e vet deri në fund. Mbase për shkak se qysh në fillim ka hetuar se në atë arë krijuese nuk është mbjellë mirë fara e artit.

Viti 2006 është ai që duhet të sjellë kthesa të mëdha në Ballkan, e veçanërisht në shoqëritë shqiptare. Mbase si i tillë, ai shton mosdurimin, nxit nervozizmin që ka kapluar thuajse të gjitha shtresat e popullit, i çon ato të grinden mes veti edhe për gjërat që shqiptaria i kishte pastruar qysh në kohën e rilindësve. Dhe, jo se mes krijuesve nuk kishte grindje dhe padurim, jo se mes tyre ishte futur engjëlli i pajtimit dhe harmonisë, por kishte diçka që e shpëtonte shpirtin e tyre edhe kur grindeshin: vlerat që i linin gjuhës së tyre dhe lexuesit. Pra, jo se s’kishte të atillë që nuk ecnin në elementet e trekëndëshit kulturor Prishtinë-Tiranë-Shkup me çantat përplot me letra nga më të ndryshmet për të njollosur shokët e vet të penës, por arti këto gjëra i gëlltit më lehtë se politika: mediokrët e artit janë “stimulues” dhe ia shtojnë imunitetin vlerës së vërtetë. Ata, me asgjë nuk dëmtojnë vlerat e mirëfillta, madje shërbejnë që lexuesi të bëjë më lehtë dallim mes veprës me vlera estetike dhe asaj që keqpërdor bardhësinë e pambrojtur të letrës, dhe të veçojë krijuesin nga shkruesi i rëndomtë. Ndërsa mediokriteti politik merr në qafë njerëz, dhe mund të jetë fatal për një popull.

Është vjeshta e vonë e vitit 2006. Fundi i stinës kur bien gjethet, kur ngadalë i afrohet fundit edhe këtij rrëfimi mbase jo të plotë për jetën e Ali Aliut dhe për peizazhin shoqëror e kulturor në të cilin jetoi. Mbase Ali Aliu kurrë nuk do ta shqyrtojë këtë libër, a ndoshta vlerësimin do ta ruajë thellë në vete përkundrejt trishtimit për të pathënat a vlerësimet e pasakta. Është vit i kthesave të mëdha në shoqëritë shqiptare. Edhe pse qysh tani është e qartë se shqiptarët, edhe për një kohë të gjatë, do të bëjnë gjumë në shtretër të ndarë në shtetet e Ballkanit duke ëndërruar Evropën e bashkuar. Do t'u nevojitet kohë të kuptojnë se një shoqëri - njësoj si edhe individit - kur s'mund të arrijë atë që dëshiron, duhet të mësohet të dojë, të vlerësojë dhe të përdorë drejt atë që ka. Pa këtë urtësi, shoqëritë shqiptare vështirë të kuptojnë se e vetmja shtyllë e fortë, mbi të cilën mbështetet identiteti i tyre, është trashëgimia dhe e sotmja e tyre kulturore; vështirë të pranojnë se portreti i identitetit të tyre ndërlidh veçoritë krahinore, dialektore të një populli shumëreligjioz, të cilin e ka përshkuar edhe puhiza e qetë e lindjes edhe freskia e këndshme e kulturës oksidentale. Një puhizë e flladshme, që duhet këtë popull ta mbajë të kthjellët sa të mos harrojë se identitetin e tij nuk mund ta dëmtojë asgjë, aq sa moskomunikimi i shoqërive shqiptare, të cilat zhvillohen në pesë shtete të Ballkanit.

Ky moskomunikim, gjer edhe të mençurve të këtij populli, ua mjegullon shikimin deri në atë shkallë sa të mos vërejnë se nëse Ballkani është “fuçi baroti”, atëherë Evropa është “depo” e mbushur përplot me mbeturina eksplozuese politike; nëse Ballkani është një gropë e madhe përplot me “ndotësira historike”, të mbledhura në tavolinat mbi të cilat të mëdhenjtë arnojnë hartat e

popujve të vegjël të këtyre hapësirave, atëherë Evropa është vetëm një bibliotekë e madhe përplot me memoare të rrejtshme ku flitet për barazi mes popujve, thjesht sa për të fshehur standardet e dyfishta që përdoren edhe sot; nëse Ballkani është një karrocë e thyer, e cila mezi mban peshën e miteve të shumtë, atëherë Evropa është tren me shumë drejtues, por pa lokomotivë; nëse Ballkani është një nxënës që kurrë nuk arrin t'i mësojë leksionet nga e kaluara, atëherë Evropa është një mësuese e plakur harrimtare, e cila jo vetëm që nuk rikujton rininë e saj, por as nuk është gati të pranojë se nga historia askush nuk ka mësuar. Dhe, më në fund, individët përfaqësues të shqiptarëve duhet të kuptojnë se nëse Ballkani është hapësirë ku jetojnë popuj të pafuqishëm të përcaktojnë rrugën e ardhmërisë së vet – ngaqë janë të detyruar që nga padrejtësitë e trashëguara të murojnë besimin se “fatit nuk mund t'i iket” – atëherë, pjesa tjetër e Evropës është vendbanim i atyre, të cilët nuk janë të gatshëm të përballen me të vërtetën se Ballkani nuk është asgjë tjetër përpos pasqyrë në të cilën shihet fytyra e pazbukuar e këtij kontinenti.

Në fytyrën e vrazhdtë të kësaj pjese të Evropës, gjithsesi bëjnë pjesë edhe shoqëritë shqiptare, pa marrë parasysh në cilat njësi shtetërore janë përfshirë. Këto shoqëri, për më shumë se një dekadë të shekullit të njëzetë, mbetën të ngulfatura në “maunokracinë”, si fazë kalimtare drejt kapitalizmit të mirëfilltë. Pra, edhe shoqëritë shqiptare mbetën në duart e “pashallarëve demokratikë”, në kthetrat e partive politike që funksionojnë si shoqëri private me përfitime personale vetëm të atyre, të cilët populli gabimisht i quan liderë partiakë. A thua sikur shumica kanë bindur veten se nënë e veprimi politik është

gënjeshtra dhe babë i suksesit partiak është pafytyrësia. Mundësuan kështu që imazhi i sotëm i shoqërive shqiptare të ketë vulë njohëse një rini të çorientuar, me prindër të ngulfatur nga kthetrat e politikës së ditës. Kjo dëshmon se shqiptaria ishte dhe mbeti e kapur ndër kthetrat e parullave pa përmbajtje konkrete, e ngulfatur nga llafazanëria e grindjet ndërpartiake, që edhe ardhmërinë e ndërton të fragmentuar. Ndihen të frikur të dalin përpara pasqyrës ku do të shohin se shumica e shqiptarëve - demokratëve të sotëm e disidentëve të vonuar të së djeshmes, që braktisën grazhdin ideologjik kur në të nuk mbeti asgjë - janë bërë shpjegues të identitetit vetëm pse nuk dinë t'i tregojnë këtij populli si të mbijetojë dhe cilën rrugë të ndjekë që sa më shpejt të dalë nga ky tunel i pashpresës. Apo, edhe pse nuk duan të pranojnë se ora e zhvillimit të shoqërive shqiptare ende tregon kohën e Konicës e të Nolit, ngushëllohen mjerisht duke pretenduar se sot nuk ka as “Konicë” as “Nolë” që të dalin në krye të kolonave intelektuale. Pra, nuk kanë guxim të pranojnë se pengesë e zhvillimit të shoqërive shqiptare nuk janë vetëm politikanët e ardhur nga e djeshmja, por edhe Faraonët intelektualë, të cilët japin mësimë që të tanishmen shqiptarët ta jetojnë njësoj si ëndërrimtarët e djeshëm: duke mos e kuptuar botën si ylber shumëngjyrësh, por si përbërje bardhezi, si një tërësi ku jetojnë të mirë dhe të këqij. Duke mos parë se identitetin shqiptar nuk e dëmtojnë dhe as e kanë dëmtuar as kryqi e as gjysmëhëna, por politika bajraktareske, akulturimi, arat e mbjella me bimë narkotike, shkatërrimi i familjes shqiptare, gjeneratat e reja të çorientuara dhe të pashpresa...

Si dje, edhe sot, shqiptaria thuajse mbetet me hapin në ajër, luhetet mes kryqit dhe gjysmëhënës, jo pse atë e ka kolovajzë të vetme, por pse ka të atillë që edhe

identitetin etnik, këtij populli ia shpalosin si të ishte çështje sezonale, i cili varet nga disponimi i atyre që kanë ambicie të bëhen Kishë e vetme e urtësisë kombëtare. Duket se ata nuk kanë kuptuar se s'ka ujë që të shpëlan nga e kaluara, por ka lumenj ku mund të lahesh në të ardhmen. Pra, nuk ka ujë që dy herë kalon mbi të njëjtët gurë, ashtu siç nuk ka njeri, i cili mund ta ripërshtojë të kaluarën e vet. Ata duan ta ushqejnë popullin vetëm me gënjeshtat e politikës ditore, ofruar në sofrën e premtimeve se shqiptaria shkon drejt rrugës së Evropës së bashkuar. Që pastaj, i ngirë nga ai aheng gënjeshtar, populli të harrojë që prijësve politikë dhe Faraonëve intelektualë t'u shtrojë pyetjen më të rëndësishme: si mendojnë ta bashkojnë shqiptarinë me pjesën tjetër të Evropës, kur ajo mbetet këmbëzbathur dhe e uritur?

Mbase shqiptaria ngutet të bashkohet me pjesën tjetër të Evropës veç të shpëtojë nga copëzimi vendor ku e çojnë prijësit lokalë, duke shpresuar se Brukseli do t'i mësojë politikanët e saj sesi të jetojnë pa shpikur armiq. Ndoshta pjesa tjetër e Evropës një ditë do ta përqafojë edhe Ballkanin si pjesë të saj, veç sa ta largojë nga pamja pasqyrën ku shihet fytyra e saj e pastolisur. Sido të jetë, mbetet e vërteta se edhe sikur shoqëritë shqiptare qysh nesër të bëheshin pjesë e Evropës pa kufij, të rinjtë e tyre njësoj do të ëndërronin që sa më parë t'i braktisin këto hapësira me rrugë përplot me gropa, ku vetëm mafia ballkanike kishte arritur të realizojë konceptin multietnik duke bashkëpunuar mes veti pa ngarkesa e paragjykime nacionaliste. Mbase të gjithë ata që jetojnë në këto hapësira s'e kanë nevojë gjithaq të dëshmojnë "identitetin e tyre evropian", sesa atë ballkanik, pra të dëshmojnë se dinë sesi të shpjegojnë ëndrrën gënjeshtare, se në Evropën e

bashkuar mund të hyhet me mafiozët dhe kontrabandistët e bashkuar, të cilët që moti i kishin rrënuan kufijtë e Ballkanit dhe i kishin tejkaluar të gjitha mosmarrëveshjet religjioze dhe etnike.

Ëndrra e zhurmshme e shqiptarëve për t'iu bashkëngjitur pjesës tjetër të Evropës, prej moti ishte bërë vetëm mbulesë fitimprurëse për ata që duan të shpallen Faraonë të së sotmes. Dhe ajo zhurmë jo se nuk dëgjohet edhe në dhomën e punës së Ali Aliut, jo se ajo nuk e çonte të reagojë publikisht për dukuritë negative, por sa herë që ndiente lodhje nga ajo britmë mediatike dhe politike, ai “shtegton” në botën letrare ku ishte dhe mbeti perandor i saj. Pikërisht aty ishte dhe mbeti i mbrojtur nga grindjet mes Faraonëve kulturorë që ëndërronin të mbeten të përjetshëm duke u varrosur në piramidat shtetërore. Ndërkohë, nuk e shihnin se edhe Evropa e fillimshkullit të njëzetentjës nuk ishte gjithaq e “evropianizuar” sa e lavdëronin ballkanasit. Njësoj si dikur, edhe sot, posa u thua “evropianëve” se turqit janë nisur drejt Brukselit, ata përjetojnë frikën e viteve kur osmanllijtë kishin rrethuar Vjenën. Kur dëgjojnë se drejt kryeqendrave të tyre është nisur treni ballkanas, ata parafytyrojnë vagonët e mbushur përplot me kriminelë dhe të papunë. Në të vërtetë, Evropa e vitit 2006 ende nuk ishte çliruar tërësisht nga stereotipat e ndërtuar me vite për kulturën lindore dhe për ballkanasit.

Ëndrra e larmishme e shqiptarëve, nganjëherë nuk u lejon atyre të shohin se edhe Evropa e bashkuar ende nuk kishte shpëtuar nga mëdyshjet nëse kishte për qëllim të bëhej një “klub” katolik, apo një shumësi shtetesh të qytetarëve të barabartë. E mbetur në mes hamendjeve të këtilla, Unioni Evropian nuk shkoi më larg sesa të pranojë

në gjirin e vet vetëm kryqin ortodoks. Më saktë, të pranojë në radhët e veta Greqinë e sotme, e cila kurrë nuk arriti të pranojë realitetin e vet të deridjeshëm asimilues dhe dëbues “demokratik”, atëherë kur bëri që ta pësonin dhe të braktisen vatrat e veta shekullore mijëra familje nga Çamëria. Evropa, pra, pranoi në radhët e veta Greqinë, e cila është mbase e vetmja anëtare e Unionit Evropian që nuk pranon se ka pakica në shtetin e vet. Kjo Greqi, e cila shqiptarëve të ngratë, që kanë shkuar në atë shtet që të nxjerrin kafshatën e gojës, u ofron shtetësi, por vetëm nëse ndërrojnë fenë, kombësinë dhe nëse shpallen grekë. Duke e bërë këtë përpara syve të Evropës demokratike, përpara hundës së politikanëve shqiptarë që heshtin, sepse edhe sot, njësoj si dikur, fati i tyre politik mban vulën e Athinës apo të Beogradit. Kjo varësi i bën të verbër, të mos shohin se Evropa mbeti peng i standardeve të veta të dyfishta, i luhatjeve nëse i duhej të shkojë më tutje dhe kryqit në Bruksel t’i bashkëngjitë edhe gjysmëhënë.

Ndërkohë, shqiptarët, të prirë nga abdallët e tyre politike dhe Faraonët ziliqarë, intelektualë që pretendonin të bëhen Tempuj të Urtësisë Kolektive, mbetën peng i inferioritetit, i cili i çonte t’u nënshtroheshin koncepteve sezonale. Të luftojnë kundër të kaluarës, duke dashur të bëhen të pëlqyer nga ata që përcaktojnë të ardhmen e popujve të Ballkanit. Dhe si të tillë, të mos shohin se as kulturat që kanë shenjë gjysmëhënë, as ato që i stolis kryqi, nuk ushqejnë amoralin, shthurjen njerëzore, nuk nxisin urrejtjen, nuk përkrahin qëndrimet përbuzëse ndaj cilitdo populli apo kulture. Pra, të mos shohin se me këto shoqëri shqiptare, të cilat mbështeten në bajraktarizmin primitiv, shqiptarët nuk mund të bëjnë asgjë më shumë, sesa të trillojnë armiq brenda vetvetes, me të cilët do t’i

arsyetojnë dështimet. Sikur mos ishin të këtillë, shqiptarët që moti do të shihnin se Evropa e fillimshekullit të njëzetënjë, i ngjante një zonje plakë, të cilës posa t'ia heqësh kapelën e stolisur me pupla, dhe posa t'ia marrësh bastunin e stolisur me gurë të çmuar, do të njohësh në të prostitutën e dikurshme politike që ende s'ka arritur t'i shërojë të gjitha traumat dhe varret nga rinia e saj e hershme.

Ende është vjeshta e vonë e vitit 2006. Shpjeguesit e numrave, do të thoshin: ky mund të jetë “viti i farës së mbarë” për shqiptarët. Do të vazhdonin arsyetimin duke shpjeguar se numri dy i këtij viti simbolizon dualizmin mbi të cilën qëndron e tërë dialektika, se dyshi simbolizon dy pamjet dhe të kundërtat që mund t'i vërejmë te ne dhe t'i shohim rreth nesh, dyshi është shpjegues i gjitha ligjeve hapësinore, ai paraqet terrin dhe dritën si dy forma në të cilën ndodhemi dhe ndodhet kjo botë, dyshi rikujton harrimtarët se edhe botët janë dy – kjo dhe ajo e matanëbotshmja, si dy vendqëndrime, të cilat njësoj janë sa ndjellëse po aq shqetësuese, dyshi na e rikujton se kjo botë është dydyershe – një hyrëse e një dalëse, ai numër shpreh edhe shkurtësinë e kësaj jete që zgjat sa dy ditë – atë të lindjes dhe të vdekjes. E dy zerot në të, do të pyesnin kureshtarët, çfarë domethënie kanë ato? Zeroja simbolizon asgjësinë, por gjithashtu edhe njeriun, të cilit forca i vjen nga askund, pra që dhuntitë i ka të lindura, që as mund t'ia marrësh, as t'ia shtosh. Gjashta, si numër i fundit i vitit 2006, është emblemë e saktësisë matematikore, i pjesëtueshëm me një numër çift (dyshin) e me një tek (trashin), i vendosur si përballë imagjinatës krijuese dhe poezisë. Shuma e gjithë këtyre numrave është teta, numri, i cili simbolizon baraspeshën hapësinore, që

shënon të gjitha anët kryesore dhe ato të mesanshme të botës, përcakton numrin e engjëjve që bartin qiellin, i cili pasqyrë të vetën ka detet dhe liqenet. Mbase një nga ato pasqyra më të vogla ku qielli sheh një pjesë të fytyrës së vet, është edhe liqeni i Prespës buzë të cilit shëtiste Ali Aliu gjatë vjeshtës përplot me diell të vitit 2006. Për liqenet në të vërtetë thuhet janë sy të tokës me të cilët të vdekurit e shohin këtë botë.

Mbase jo një herë, Aliun mund ta ketë kapluar dhembja pse liqeni nuk është më ai i fëmijërisë së tij edhe sa i përket madhësisë: uji është tërhequr nga bregu i dikurshëm thuajse po aq metra sa ka Aliu vite. Nga të gjitha anët është mbuluar me kullosa dhe kallame. Ka filluar t'i ngajjë një kënete. E për kënetat thonë se janë simbol i syrit që ka derdhur shumë lot.

I tërë regjioni i Prespës është sy që ka derdhur shumë lot. Sikur ato lot të mos ishin tharë, sikur të kishte mundësi që ato të mblidheshin, lotët e derdhur nga takim-ndarjet e përvjetshme mes kurbetçinjve që shkojnë dhe atyre që mbeten, do ta mbushnin liqenin dhe ky s'do të kishte nevojë të tërhiqet aq shumë nga brigjet e fëmijërisë së Aliut. Sikur aty të kishte fëmijë si në vitet kur fëmijëronte Ali Aliu, brigjet e liqenit të Prespës nuk do të ishin të mbuluar me kullosa dhe kallama, por do të mbanin shenjat e shputave që dikur kishin vrapuar buzë brigjeve të tij. Ende do të shiheshin shtigjet nga dikur kishin ecur peshkatarët dhe nga gjyshja kanë shëtitur nipërit.

Nuk është e mundur që atë ditë vjeshte të vitit 2006, Aliut të mos i ketë bërë përshtypje titërimita shurdhuese e heshtjes. Heshtje, e cila mbase i ngërthen në vetvete të gjitha zërat që nuk mund t'i dëgjojmë më, ato që janë vulosur diku në imagjinatë dhe mund t'i ripërtërijmë jo

si jehonë që ledhaton syprinën e liqenit, por si thirrje e ardhur në imagjinatë nga thellësitë e së kaluarës. Mundet që ai asaj dite të ketë dëgjuar edhe thirrjet e veta gazmore të ardhura nga larg, nga koha e fëmijërisë, pastaj britmat lazdrane të nipërve të tij që vinin këtu kur ishin më të vegjël, të qeshurit e fëmijëve të vet kur i shëtiste këtej pari që t'ua lehtësonte rritjen, si dhe pëshpëritjet e qeta të Merzës. Ka mundur asaj dite Aliu të ringjallë në kujtesë edhe ndonjë britmë të vetën, të zbrazur buzë liqenit, një nga ato britmat që shprehin të pathënat në njeriun, apo edhe atë që as ne nuk e dimë se ç' domethënie do të ketë pasur.

Çkado që të ketë ndier atë ditë vjeshte me diell, çkado që t'i jetë sjellë nëpër imagjinatë duke shikuar syprinën e lëmuar të liqenit, Aliu nuk ka mundur të mos ndiejë një ngjashmëri në mes natyrës së vet si njeri dhe liqenit: nën qetësinë e këtij njeriu, i cili thujse asnjëherë nuk e mësoi mjeshhtërinë e përbuzjes, të nënshtrimit..., fshihet një vorbull i madhe ku përplasen shumë pakënaqësi me atë që ndodh rreth tij dhe atë për çka kishte kontribuar dhe ëndërruar me vite. Nën syprinën e njeriut të qetë që është i gatshëm të dëgjojë, por jo edhe të flasë marrëzira, fshihet një vrull i paparë, i cili i ngjan një shtrëngate, kur përballet me të padrejtat që u bëhen njerëzve dhe popullit të tij.

Nën qetësinë e Ali Aliut mbetet e shtresuar kujtesa e shumë dekadave përplot me shpresë se do të realizohen ëndrrat e gjeneratës së tij, që populli shqiptar ta lërë pas të kaluarën e hidhur. Në kujtesën e tij kanë mbetur të gjalla ndodhi nga më të ndryshmet, njerëz dhe shtegtime. Ai nuk ka si t'i harrojë stinët e jetës së vet, e as vitet kur filluan luftërat në shtetet e ish-Jugosllavisë dhe kur shumë të rinj shqiptarë nga radhët e armatës së kësaj federate kishin mbetur si qengja pa bari. Në kujtesën e tij

gjithmonë do të mbeten të gjalla tentimet e viteve nëntëdhjetë që të rinjtë që dezertonin nga armata jugosllave, të strehoheshin diku, për çka edhe u hap kampi i Labinotit, ku u strehuan më shumë se pesëdhjetë të rinj nga kjo anë e kufirit. Ai nuk mund të harrojë kurrë edhe sjelljen e disa të rinjve në këtë kamp, posaçërisht të atyre që një mëngjes ishin veshur me uniforma ushtarake shqiptare dhe ishin fotografuar pranë një fotoje të madhe të Enver Hoxhës. Nuk kishin lejuar as oficerin përgjegjës të ndërhynte, e madje as të prekte fotografinë e Enver Hoxhës. Kur do t'i takojë Ali Aliu, që të sqarohet çështja, të rinjtë do t'i shpjegojnë profesorit se nuk “kishte asgjë të keqe pse kishin bërë një foto kujtim nga qëndrimi i tyre në Labinot të Shqipërisë!”. E vite më vonë, shtypi i Serbisë, duke nxitur urrejtje ndaj shqiptarëve edhe përmes rasteve të trilluara, diku në faqet e gazetave beogradase, do të botojë edhe foton “për kujtim” nga Labinoti, si dëshmi e sigurt e përgatitjeve ushtarake terroriste të kosovarëve enveristë.

Aliu mbase kurrë nuk do të sqarojë se cilët ishin ata që u fotografuan dhe sesi ajo foto kishte arritur deri në Beograd. Por në vjeshtën e vitit 1999, menjëherë pas çlirimit të Kosovës, rrugëve të Prishtinës do të takojë të riun që dikur moti, në Labinot, i kishte shpjeguar se nuk kishte “asgjë të keqe pse ishin fotografuar pranë fotos së Enverit”. Ai i riu i dikurshëm, biondi i kampit të Labinotit, të cilin Aliu do ta takojë rrugëve të Prishtinës, tanimë ishte pjesëtar i sigurimit të njëjës palë shqiptare në Kosovë. Dhe ishte i veshur me shumë shije. Sepse ndërkohë, në Kosovë, e çdokund ku jetonin shqiptarët, të gjithë kishin veshur katllëqe të reja dhe ishte e vështirë të dalloje të dikurshmit e lëre më rolin e tyre në të kaluarën. Më në

fund, kujt i duhej kjo? Kur të gjithë njësoj prisnin pavarësinë e Kosovës, kur thuajse të gjithë thoshin se çdo gjë që kishin bërë gjatë jetës së tyre, kishte qenë flijim në altarin e çlirimit të popullit.

Nga të gjitha vetitë e Ali Aliut, më e madhërishmja dhe mbase edhe më e çuditshmja është se kurrë nuk i rikujton dhe nuk do të flasë për veprat e dobëta letrare dhe për njerëzit e dyshimtë e të pavlerë. Shpjegimi i kësaj vetie të tij nuk është aq i rëndë për atë që e njeh këtë njeri: librat e këqij ai nuk i lexon, ndërsa ndaj njerëzve pa vlerë sillet si ndaj çdo gjëje të pavlefshme – i shlyen nga kujtesa posa t’ua zbërthej qëllimet dhe intrigat. Andaj albumi i kujtesës së tij është përplot me fytyra që bartin portretin e njerëzores. Mes tyre është dhe do të mbetet, edhe Zymer Berisha, vëllai i Ymer Berishës, njërit nga më të afërmit e Jusuf Gërvallës dhe Hafiz Gagicës. Familja e tij në Prishtinë, ishte dhënë e tëra në shërbim të lëvizjes shqiptare për rezistencë që nga vitet tetëdhjetë. Banesa e vëllait të madh, Ymer Berishës, në Zyrih ishte konaku më i vizituar – në mos edhe i vetmi – për anëtarët e kryesisë së LDK-së, në vitet nëntëdhjetë. Ali Aliu, si edhe disa të tjerë, kishin edhe çelësin e kësaj banese dhe sa herë shkonte në Zvicër, pa marrë parasysh nëse kishte në shtëpi ndonjë nga familjarët Berisha, strehohej në banesën e tyre dydhomëshe. Aliu ishte njeri që nuk e harronte këtë të mirë, e aq më pak të zhvlerësonte kontributin e një familje që gjithçka ia kishte përkushtuar Kosovës dhe popullit të vet.

Pikërisht për këtë arsye, Zymerin, vëllain e Ymerit, po ashtu të arratisur në Zvicër, Aliu do e marrë me punë në zyrën e Kosovës në Tiranë. Zymeri ishte nga ata për të cilët thuhet ‘ka gojë, po nuk flet’, dinë çdo gjë çka ndodh, por bën vetëm punën e vet. Ai ishte nga ata që i çmonte

Aliu, që e dinë se ka disa momente kur çlodhje është puna e palodhshme. Zymeri kishte ndihmuar në vendosjen e të rinjve kosovarë që vinin në Tiranë për të kryer stërvitjet ushtarake. Ai aq mirë e kishte shpalosur karakterin e Aliut, sa gjithmonë dhe saktësisht e dinte se çfarë duhej e çfarë s'duhej të dinte punëdhënësi i tij. E mbante të hapur përfaqësinë e Kosovës thuajse njëzet e katër orë të ditës. Ai dhe Aliu ishin personeli i vetëm i kësaj përfaqësie, e cila asokohe, mbase edhe sot, përmendej nëpër shkrime të ndryshme. Duke filluar nga roli i saj i atëhershëm, e deri te harxhimet e bëra.

Sa i përket rolit të përfaqësisë së Kosovës në Tiranë gjatë viteve nëntëdhjetë, mbetet e vërtetë se ajo bëri të mundshmen që mund të bëhej asokohe. E, sa u përket harxhimeve, të gjitha shpenzimet nga fondet e LDK-së për Ali Aliun e Zymer Berishën nuk kalonin shumë e dhjetë mijë markave gjermane për një vit. Me këto shpenzime mbulohej qiraja e dy banesave, me nga dy krevate, sjellë nga kazermat ushtarake, dhe ushqimin që e shoqja e Aliut, Merza e blinte nëpër pazaret e varfra të atëhershme të Tiranës. Përfaqësuesit e Kosovës në Tiranë filluan të paguhen me rroga mujore vetëm pas largimit të Aliut nga kjo përfaqësi. E asokohe nuk ishin të paktë ata që në Prishtinë flisnin për jetën luksoze të Aliut në Tiranë, për banimin e familjes së tij në vila luksoze. E flisnin këtë edhe disa nga ata që i kishin parë dy krevatet ushtarakë në banesën e përfaqësuesit të Kosovës dhe kishin parë bashkëshorten e tij, Merzën, sesi shëtiste rrugëve të Tiranës për të gjetur diçka për të gatuar drekë apo darkë. Këtë e flisnin edhe disa nga ata që më mirë se çdokush e dinin se asokohe luksi i Tiranës nuk ishte as i përafërt me cilëndo shtëpi të Prishtinës në Dragodan dhe kur restorant

më luksoz në Shqipëri ende ishte ai i hotelit “Dajti”, e që nuk ishte shumë më lart se disa kafene të fshatrave të Kosovës.

Pikërisht njeriun më të besuar të përfaqësisë së Kosovës, Zymer Berishën, pas largimit të Aliut nga Tirana, do e burgosë SHIK-u i atëhershëm i Shqipërisë. Këtë do ta bëjë publikisht, duke demonstruar “ligjshmërinë” e atëhershme: një mëngjes, i kishte shkuar policia në banesë, e kishte bastisur dhomën e vetme që kishte, i kishte gjetur një revole dhe e kishte marrë me vete. Gjatë atyre ditëve të dimrit '92-'93, Aliu ishte në një udhëtim në Norvegji (ishte rasti i disa mijëra kosovarëve, ngujuar në kishat e Norvegjisë, menjëherë pas vendimit të asaj qeverie për largimin e tyre, me ç'rast opozita politike e Norvegjisë ishte vënë në përkrahje të tyre dhe kishte iniciuar një tribunë publike në të cilën ishin ftuar edhe përfaqësues të qeverisë për të ballafaquar argumentet, dhe në këtë kontekst donin të dëgjonin edhe mendimin e Kosovës). Gjatë kthimit nga ky udhëtim, Aliu do të shkojë në Tiranë që të qartësojë burgosjen e Zymerit, si edhe çështjen tronditëse për subjektin politik shqiptar në Maqedoni, përçarjen e partisë së Prosperitetit Demokratik.

Por, Zymer Berisha, i burgosur dhe i liruar pas pesë ditëve me kusht që ta braktisë Shqipërinë, ndërkohë kishte udhëtuar për në Zvicër. Të nesërmen pas arritjes në Tiranë, Aliu do të kërkojë në telefon Bashkim Gazideden, dhe do të takohen në zyrën e numrit një të SHIK-ut shqiptar, ku ishin takuar edhe disa herë më parë. Aliu e dinte se Gazidede ishte vetëm dora e Sali Berishës dhe jo më ai i mëparshmi i takimeve të dikurshme, ai për të cilin Aliu kishte krijuar bindjen se bëhej fjalë për një idealist dhe njeri të pastër. Pas bisedës së zakonshme, Aliu do ta

pyesë Bashkimin se cilat ishin arsytet e burgosjes së Zymer Berishës. “Jo profesor!”- do të përgjigjet Bashkim Gazidede – “Kush tha që e burgosa! Zymeri qëndroi disa ditë në një vilë në Durrës, sa për të sqaruar disa çështje, pra e kishim në një bisedë që zgjati disa ditë...” Aliu e kuptonte se ai mund të ishte i shtrënguar të mos ia thoshte të vërtetën. “Por përse atëherë e bastisi policia banesën e tij, pse e morën me vete dhe nuk e thirrën të paraqitej vetë në polici?!” – do ta pyesë Aliu, Gazideden. Kryetari i SHIK-ut të atëhershëm, do të bëjë se nuk dinte asgjë, do të pohojë se askush nuk e ka përzënë nga Shqipëria, por vetëm i “është kërkuar të mos merrej me aktivitet politik.” Ishte e qartë se Gazidede vetëm kishte zbatuar një urdhër të marrë nga lart.

Vite më vonë, kur Ali Aliu do të takohet me mikun e vet Zymerin, ai do t’i shpjegojë se në të vërtetë ishte viktimë e atyre që nuk donin Ali Aliun dhe do t’i thotë: “Profesor, unë e prisja një gjë të tillë, posa u larguat ju nga Tirana... Gjatë qëndrimit në arrest (çfarë vile e çfarë bisede miqësore) unë kuptova dy gjëra: me shpirt e dëshironin që të gjejnë diçka gjatë punës suaj në përfaqësinë e Kosovës. Dhe e dyta: nuk e donin në Tiranë praninë e syve të mi që dinin çdo gjë... ama pikërisht çdo gjë. Kjo ishte e tëra profesor dhe mos u mundoni, mos vrisni mendjen më rreth kësaj çështjeje!”

Vallë ishte e mundur njeriu që kishte flijuar shumëçka të vetën të mos e vriste mendjen me këto lojëra të ndyra që zhvilloheshin në vitet kur Kosova jetonte terrin e vet më të rëndë. Gjithsesi jo. Por, gjatë bisedës së atëhershme me Gazideden, Aliu duhej të pastrojë edhe diçka tjetër tronditëse e tragjike për shqiptarët këtë kufirit: pse Tirana zyrtare ndihmoi shpartallimin e partisë më të madhe të

shqiptarëve të Maqedonisë – atë të Prosperitetit Demokratik? Pra, pse ato komente të ATSH-së, pse në vend që të kontribuojë në bashkimin e shqiptarëve, Tirana zyrtare futi përçarjen mes tyre. Përgjigjet e marra ishin gënjeshtarë, të njëjta me ato që i dha lidhur me burgosjen e Zymer Berishës. Me çka Aliu edhe një herë ndjeu sesi tek ai përplasen iluzionet me deziluzionin; dëgjonte jehonën e kësaj përplasjeje dhe ndiente sesi nga ajo lind një vetëgënjim i madh, te të gjithë shqiptarët e ish-Jugosllavisë që besonin dhe shpresonin se Tirana zyrtare ka vetëm një qëllim – të ndihmojë çlirimin e Kosovës, e jo të pengojë atë.

Por kush ua kishte fajin shqiptarëve të Maqedonisë dhe të Kosovës që aq ngadalë dilnin nga iluzionet e veta, që edhe pas shumë ngjarjeve që shpalosnin veprimin e gabuar politik të Tiranës zyrtare të viteve '90, ardhmërinë e vet e shihnin të lidhur ngushtë me rrjedhat dhe perspektivat e Shqipërisë, udhëhequr nga Sali Berisha? Kush ua kishte fajin pse ata nuk gjenin shpjegim për masën e pakuptimtë të mosndjeshmërisë së Tiranës zyrtare ndaj asaj që ndodhte mes shqiptarëve të Maqedonisë dhe kosovarëve? Prania e çështjes së Kosovës në Tiranë prej moti ishte sa për të shpëlarë gojën dhe sa për të ushqyer iluzionet e kosovarëve. Por iluzionet që moti kishin filluar të zbehen. Posaçërisht pas viteve kur veprimi politik i Sali Berishës njihnte vetëm një koncept: të përkrahë vetëm të dëgjueshmit e vet nga kjo anë e kufirit. Duke e arritur këtë me përçarje partiake brenda dhe jashtë Shqipërisë, ai mbase u bëri edhe dëmin më të madh shqiptarëve të Maqedonisë, nga i cili vuajnë edhe sot. Mbase ky veprim politik ndikoi që Shqipëria të arrijë në vitin 1997, kur shqiptarët e vranë mëmëdheun e shqiptarëve të këtej

kufirit. Vitin '97, kur shqiptarët që jetonin jashtë Shqipërisë nuk arrinin të kuptonin sesi ishte e mundur që shqiptari të ngrinte dorë mbi mëmëdheun që ushqente iluzionet e tyre. Dhe pyesnin veten: nëse neve këtej na përçajné dhe manipulojné të huajt, kush janë ata që i pengojné politikanët shqiptarë në Tiranë të merren vesh mes veti.

Për shumëçka nuk e pyetën njëri-tjetrin shqiptarët e asaj kohe, edhe duke mos ditur se përgjigjet e disa pyetjeve do të vijnë pasi të mos jenë fizikisht gjeneratat që e kanë ngulfatur të vërtetën. Andaj dhe shumëçka lidhur me veprimin politik të Tiranës së viteve nëntëdhjetë dhe të aktivistëve kosovarë të asokohe, do të zbardhen kur do të hapen jo vetëm dosjet e Tiranës, por edhe ato të Beogradit. Dhe në këto dosje fshihet një rrezik i madh: ato të Beogradit mund të jenë ashtu të “fabrikuara” sa të nxijnë të vlefshmin, e të rrisin kontributin atdhetar të spiunëve të dikurshëm. Por, edhe si të atilla, kurrë nuk do të arrijnë plotësisht të fshehin disa të vërteta që janë të mbyllura në vetëdijen dhe në kujtesën e njerëzve që vepruan në një kohë të hutesave e paqartësive të mëdha.

Nuk ka dyshim se ajo që ka mbetur e vulosur në vetëdijen e Ali Aliut është si syprina e liqenit të Prespës, në thellësitë e të cilës fshihen shumë të vërteta që ndoshta edhe ai vetë do t'i thotë një ditë, jo që të akuzojë të tjerët e të zmadhojë kontributin e vet të atdhetarit e kritikut letrar, por që pasardhësit ta kenë më lehtë të vizatojnë portretin e paraardhësve të tyre. Pa dyshim se do të ishte mirë që një ditë ai vetë të shkruante “kritikën” më të vështirë: jetëshkrimin e vet. Aty ku do të rrëfente për shqetësimet krijuese dhe ato atdhetare. Me këtë do të vinte një pëllhurë shumë të rëndësishme të një pjese të historisë

së popullit shqiptar, në të cilën roli i tij kurrë nuk do të mund të anashkalohet. Edhe atë jo për shkak se i ra në hise t'i takonte një gjenerate që do të jetojë në ëndrrën ku shihej fluturimi i shqiponjës nga Vlora në Prishtinë, por pse ishte i lindur të jetojë si Don Kishot i vetmuar, që dha çdo gjë që kishte për "shqipëritë" e ndara në shumë shtete të Ballkanit. E si shpërblim mori shqetësimet, të mbuluara nën paraqitjen e njeriut që në shikim të parë duket i qetë. Ky njeri ndërroi vendbanime, shkoi e erdhi nga Tirana, Prishtina e Shkupi, por kurrë nuk harroi Arvatin e vet, liqenin e Prespës. Mbase ngaqë aty më së miri ndiente jehonën e të kaluarës së vet dhe zhurmën e të sotmes.

Në Arvatin e sotëm ende qëndron kulla e ndërtuar në vitin 1929, ku ka lindur Ali Aliu. Posa del nga porta e saj, përballësh me një udhëkryq: një rrugë që të çon përpjetë, drejt majave të Pelisterit, dhe atë që lëshohet teposhtë, drejt liqenit. Udhëkryq ky që të rikujton të vërtetën se edhe jeta ka ngjitje dhe zbritje. Në muret e kullës së lartë janë shtresuar e kaluara e largët dhe e sotmja prespare, në çardakun e saj thuajse janë ulur burrat e fshatit që t'ia thonë këngës së mallëngjyeshme polifonike, në jehonën e të cilës mbetën plot dëshira, ëndrra dhe shpresa të shumë gjeneratave, jehonë e të cilës këngë flet për një degëzim të çuditshëm të popullatës nga kjo hapësirë. Një popullatë që trungun e ka këtu, por degët çdokund nëpër botë, me njerëz që shëtitin diku matanë oqeanëve, por ëndrrat u vijnë nga brigjet e liqenit të Prespës. Edhe sot, kullat e Arvatit, përfshi këtu edhe atë të Ali Aliut, vazhdojnë të numërojnë ardhjet dhe shkuarjet e njerëzve që lindën këtu, kujtojnë të shkuarit që nuk do të kthehen kurrë më, si edhe ata që mbetën në fshat thuaj vetëm sa të ruajnë kujtimin e një të kaluare kur u mbyll kufiri me Shqipërinë

dhe shqiptarët e mbetur nga kjo anë e liqenit ndiheshin si të mbetur në fund të botës, ngaqë s' mundeshin të mbajnë lidhjen e natyrshme me qendrat arsimore dhe tregtare matanë kufirit. Kjo pamundësi i çoi të shtegtojnë nga këto hapësira.

Kulla e Ali Aliut ende ruan pastërtinë dhe rendin e duarve të kujdesshme të Merzës, e cila shumë vera të nxehta e dimra të ftohtë i kaloi këtu duke i qëndruar pranë bashkudhëtarit të saj jetësor, Aliut. Mbase ajo kullë do të ruajë edhe pëshpëritjet e tyre pranë zjarrit, apo në oborrin e mbuluar me bar, për të kaluarën e tyre të përbashkët dhe për të ardhmen që kishin shpresuar se do të vijë. Ajo kullë do të ruajë kujtimin e shtëpiakes së kujdesshme, e cila së fundmi herë e braktisi Arvatin në vitin 1995. Dhe nuk u kthye kurrë më, me çka asaj kulle thuajse përgjithmonë i mungonte shumëçka që e bënte aq të dashur për Ali Aliun.

Në Arvatin e Prespës, gjithnjë e më shumë, pakësohet numri i banorëve, por shtohet ai i shtëpive të reja, të cilat i ndërtojnë ëndërrimtarët kurbetçinj që kurrë nuk humbin shpresën se një ditë rishtas do të kthehen në vendlindje. Në mos për shumëgjë tjetër, së paku që derën e fundme të jetës së tyre ta mbyllin aty ku dikur hapën portën dhe lanë pas vetes sytë e përlotur të të afërmeve të vet. Në atë fshat qëndron edhe sot kulla, e cila kujton zërin e thekshëm dhe gazmor të gjyshes Meleke nga Nikolica e Frashërit, zërin e mbetur në vitin e largët të 1934-ës, kur ua kumtoi burrave lajmin se kishte lindur nipçja, se ajo shtëpi do të duhej të rriste dhe të bëjë gati për udhëtimet nëpër jetë edhe të një pasardhësi të tyre. Mbase ai zë gazmor i dalë nga lumturia se vatra familjare ishte shtuar, në vetvete ka bartur edhe bindjen se banorët e asaj kulle e

dinin se po aq e bekuar me madhështinë e lindjes, është edhe mjeshtëria të rrisësh njeriun, se jeta është dydyshe, atë mund ta përshkosh nëpër shumë udhë e shtigje, por dëshmi se ke mbetur njeri është ajo kur të gjitha ato rrugë dhe shtigjet e kaluara të mund t'i rikujtosh pa e ulur kokën.

Pa dyshim se jetëshkrimi i Ali Aliut është ai i udhëtarit që ndershëm ka ndërlidhur në vetvete nyjat e jetës dhe ka thurur një tërësi për të cilën edhe më tej do të shkruhet. Jeta e tij ndërlidh kohët e largëta, kur gëzimi i lindjes është ngulfatur nga brengat se çka do të sjellë e nesërmja, që kanë ngulfatur edhe dënesjen e foshnjës shqiptare. Jeta e tij ndërlidh kohën kur shqiptarët e kësaj ane e dinin se linden që të qëndrojnë përballë shtrëngatës, me kohën e sotme, që kërkojnë përherë të jesh i gatshëm të vësh në sprovë shtyllën kurrizore. Jetëshkrimi i tij është dashur të jetë një qëndismë e saktë që rrëfen për Aliun, i cili qysh në vegjëli kishte vërejtur se me shumëçka jeta e njeriut i ngjan ambientit të fëmijërisë së tij: lart mbi fshat maja e Pelisterit, e teposhtë syprina e kaltër e liqenit. E mbi këtë syprinë, si mbi një pasqyrë gjigante të lëmuar, pasqyrimi i qiellit të kaltër, i reve që lundrojnë nëpër hapësirat e paskajshme, thujse kërkojnë atdheun e humbur. Ai qysh fëmijë është përballur me të vërtetën se udhëtimi nëpër jetë është njësoj sikur edhe ëndrrat fëmijërore: nxisin të shkosh matanë vargmaleve që rrethonin vendlindjen. E pastaj, kur të arrish sa më larg dhe sa më lart, prapë të mos harrosh nga je nisur dhe cili ka qenë qëllimi i udhëtimit, sërish të të thërresë ngrohtësia e vatrës familjare. Nuk ka dyshim se Aliu, qysh fëmijë e kishte kuptuar se në jetë mund të zgjedhësh dy gjëra; të ngjitesh drejt lartësive apo të notosh në hapësirë të mbyllur. Mbase vendimin e kishte marrë ende duke qenë në prehrin e

ngrohtë të gjyshes, ende duke qenë në atë fole të sigurt ku sforcohej kolona vertebrale në përballje të vështirësive të shumta jetësore.

Është ditë vjeshte e vitit 2006. Mallit të dikurshëm fëmijëror për gjyshen, tani i janë bashkëngjitur shumë të tjerë. Ai mall është bërë si një ndërthurje që mban të shtrënguar shpirtin, si rrjetë peshkatari ku mbetet e kapur një jetë e tërë. Në të mbeten edhe vitet e kaluara në tetëvjeçaren e Manastirit, ato të normales në Tetovë e Shkup, vitet kur Aliu filloi miqësinë e përjetshme me librin. Miqësitë rinore mbeten të paharrueshme. E kanë hijen e gjatë, po aq sa edhe vetë jeta e njeriut. Andaj edhe leximi do të mbetet shoqërues i Aliut edhe pas shpërnguljeve nga një qytet në tjetrin.

Edhe sot e kësaj dite, në Arvat qëndron kulla e vjetër ku ka lindur Ali Aliu. Në jug të saj shtrihen kopshtet që arrijnë deri buzë liqenit. Përpara kullës është oborri me pusin në mes dhe përplot bar. Duket se ai oborr vuan për ecjen çaplehtë të Merzës, e cila kurrë më nuk do të vijë që ta rregullojë kullën. Kullës dhe oborrit i mungojnë edhe qeshjet e fëmijës që rritej gjatë viteve kur “ra Italia”, kur brenda natës ndryshonin kufijtë dhe arvatlinjtë nuk e dinin a janë nga kjo anë apo nga ajo anë e kufirit, a do të mbeten këtu apo do të “shkonin në Shqipëri”. Ai fëmija i dikurshëm, është Ali Aliu i sotëm, që edhe në vjeshtën 2006 shëtiti nëpër kopshtet rreth kullës së lindjes dhe mbase bën plane se në cilën nga “Shqipëritë” e shumta ta kalojë dimrin: në Kosovë ku ka fëmijët dhe nipat, në Tiranë ku i mbetën miqtë e dashur, apo në Shkup ku kaloi rininë. Thuajse njësoj si në vitet kur rritej, Ali Aliu shikon kullën e lartë dhe ndoshta rikujton ata që dikur jetonin mes atyre mureve. Kjo e shtyn dhe e josh të ulet pranë

pusit, për të lexuar librin e posamarrë nga miku. E pastaj sërish të çohet e të ecë më tej. Hapat e tij janë të lehta, sikur bëjnë kujdes të mos lëndojnë barin e njomë.

Ashtu ecin njerëzit: në kujdes të mos lëndojnë të tjerët, duke mos i numëruar varret e veta...

TRYEZA E LËNDËS

Bukuri e braktisur	3
Ditari i papërfunduar	24
Izoipset e jetës	58
Heshtja e djeshme dhe zhurma e sotme	91
Rrënojat e iluzioneve	124
Don Kishoti i shqiptarëve të Maqedonisë	185
Kështu lind e ecën njeriu	223

KIM MEHMETI
KËSHTU ECËN NJERIU

Formati: 13x20 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: (4) 240116
Tiranë, 2007